



BASHKIA KRUJË

Plani i Përgjithshëm Vendor

Analiza dhe Vlerësimi i Thelluar i Territorit të Bashkisë Krujë

Krujë 2016

**ANALIZA E THELLUAR DHE
VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE TË TERRITORIT**

- BASHKIA KRUJË -

Parathënie

Në korrik të vitit 2015, Qeveria Shqiptare mori nismën për mbështetur 26 bashki në hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore me financim nga buxheti i shtetit.

Njëkohësisht u mbyllën në Tiranë takimet publike për prezantimin e drafteve të tre instrumenteve themelore të planifikimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, mbas një procesi shumë të gjerë konsultues: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës, që përbëjnë shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë të vendit.

Në përgjigje të problemeve komplekse që po paraqet procesi i urbanizimit në Shqipëri, mbështetur në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin bazë “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Nr 107/2014 datë 31.07.2014, Bashkia Krujë, ka nisur Projektin për Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit, mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi dhe termave të referencës së publikuara.

Për të koordinuar dhe monitoruar sa më mirë këtë proces, në Janar 2016, u nënshkruan akt marrëveshjet trepalëshe ndërmjet kryetarit të bashkisë, skuadrës fituese "UTS-01" dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban, e cila nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, do të mbështesë dhe bashkërendojë procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit vendor me bashkinë.

Ky projekt përfshin hartimin e Instrumenteve Vendore të Planifikimit për Bashkinë Krujë, ku theksi vihet dhe është i orientuar drejt zhvillimit të njësisë në aspektin ekonomik, urban, mjedisor dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për njëzetë vitet e ardhshëm. Nisma në fjalë është pjesë e procesit për disiplinimin e ndërtimeve dhe planifikimit mbi bazat e zhvillimit të qëndrueshëm të zhvillimit të territorit, që po zbatohet në tërë vendin.

Pjesë e këtij projekti, është ky dokument, “Analiza e thelluar e gjendjes ekzisutese të zones” bashkë me hartat përkatëse dhe problemet e sfidat që dalin nga situata aktuale.

Në këtë fazë të parë të projektit jepen bazat, të dhënat statistikore dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm nga Bashkia Krujë, gjithë informacioni shtetëror ose lokal në lidhje me zonën e marrë në studim si dhe publikime të ndryshme të besueshme dhe ligjore.

Duke e konsideruar këtë dokument si shumë të rëndësishëm, që do shënojë fillimin e procesit të punës për Planin e Përgjithshëm Vendor dhe do të hedhë bazat për kuptimin dhe adoptimin e planit, vlerësojmë maksimalisht përkushtimin dhe seriozitetin e shprehur nga anëtarët e Bashkisë Krujë, Qarkut Durrës dhe AKPT-së, të cilët vazhdimisht kanë mirëpritur diskutimet dhe kanë dhënë udhëzime shumë të vlefshme për përfundimin e këtij Dokumenti.

TABELA E SHKURTIMEVE

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BE	Bashkimi European
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjië, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumeteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MEI	Ministria e Energjië dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Minsitria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturrës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Minsitria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjië Elektrike sh.a.
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1: Rrënojat e Albanopolit (Zgërdhesh).....	14
Fig. 2: Emblema e Kastriotëve prej nga vjen edhe flamuri kombëtar.	15
Fig. 3: Plani i zhvillimit të bashkisë së Krujës/Zonim funksional (1998)	25
Fig. 4: Plani i zhvillimit të zonës së Krastës (1996)	26
Fig. 5: Gjendje ekzistuese e bashkisë Fushë Krujë (PPV Fushë Krujë 2014)	27
Fig. 6: Influencuesit e qytetit (PPV Fushë Krujë 2014).....	28
Fig. 7: Gjendje ekzistuese e sektorëve të qytetit (PPV Fushë Krujë 2014).....	28
Fig. 8: Analizë e Planit Rregullues të vitit 1976 (shkëputur nga analiza e PPV Fushë Krujë 2014).....	29
Fig. 9: Zhvillimi real nga 1976 deri me 2007 (shkëputur nga analiza e PPV Fushë Krujë 2014)	29
Fig. 10: Harta e skenarëve strategjikë të zhvillimit të bashkisë Fushë Krujë (PPV Fushë Krujë 2014).....	30
Fig. 11: Kalimi i integruar nga zona urbane në atë rurale (PPV Fushë Krujë 2014) .	31
Fig. 12: Harta e kategorive të përdorimit të tokës (PPV Fushë Krujë 2014)	32
Fig. 13: Skenarë të zhvillimit të sektorëve ekonomike e të banimit (PPV Fushë Krujë 2014)	32
Fig. 14: Draft PPK. Rajonet ekonomike. Pozicioni i territorit të Krujës	34
Fig. 15: Draft PPK. Hierarkia e propozuar e qendrave urbane	35
Fig. 16: Draft PPK. Ndërlidhja hapësinore e qendrave sipas hierarkizimit të propozuar	36
Fig. 17: Draft PPK. Ndërlidhja hapësinore infrastrukturore. Pozicionimi me Hub-et e lëvizjes.....	36
Fig. 18: Draft PINB. Pozicionimi i bashkisë Krujë në rajonet e bregdetit.....	38
Fig. 19: Draft PINB. Potencialet agrikulturore	38
Fig. 20: Draft PIN Durana. Hierarkizimi dhe specializimi i qendrave urbane të rajonit.	40
Fig. 21: Draft PIN Durana. Zhvillimi i Cluster-ave të kulturës e të turizmit.	41
Fig. 22: Draft PIN Durana. Networku i qendrave të sistemit Urban-Rural	42
Fig. 23: Draft PIN Durana. Analizë e zonave të gjelbra të territorit.....	43
Fig. 24: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Krujë	50
Fig. 25: Njësitë administrative të Bashkisë Krujë.....	51

Fig. 26: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Krujë	52
Fig. 27: Harta e zonave klimatike	54
Fig. 28: Diellzimi mujor në orë.....	55
Fig. 29: Temperaturat mesatare mujore. Stacioni Krujë	55
Fig. 30: Harta e temperaturave mesatare vjetore	56
Fig. 31: Reshjet mesatare mujore. Stacioni Krujës.....	56
Fig. 32: Lagështia mesatare mujore. Kruje	57
Fig. 33: Harta e trëndafilave të erës.....	57
Fig. 34: Hartë Hidrografike e Shqipërisë.....	71
Fig. 35: Deformime shtratore, erozion i brigjeve dhe rrezikim i objekteve inxhinierike	73
Fig. 36: Zona me rrisht përmbajtjeje.....	75
Fig. 37: Harta e epiqëndrave të tërmeteve karakteristike	78
Fig. 38: Harta e izoseisteve të tërmetit të 1 Qershorit 1905	79
Fig. 39: Harta e izosejsteve të tërmetit të 17 dhjetorit 1926	80
Fig. 40: Harta e izoseisteve të tërmetit të 30 Nëntorit 1967.....	81
Fig. 41: Harta e izoseisteve të tërmetit të 15 Prillit 1979	82
Fig. 42: Harta e zonimit neotektonik (Pliocen-Kuaternar) të Shqipërisë.....	83
Fig. 43: Harta sizmotektonike e Shqipërisë në shkallë 1: 500.000.....	85
Fig. 44: Harta e PGA për Shqipërinë në truall shkëmbor, me RP 475 vjet	86
Fig. 45: Vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë bujqësore, livadhe kullota dhe pyjore për rrethin Krujë (AKKP, 2013)	88
Fig. 46: Pamje e Kalasë	92
Fig. 47: Pamje e urës	94
Fig. 48: Pamje e urës	95
Fig. 49: Pamje e Teqes	96
Fig. 50: Pamje e Hamamit.....	97
Fig. 51: Majtas: Ilustrim i Pazarit; Djathtas: Pamje e Pazarit në mbrëmje.....	97
Fig. 52: Pamje e banesës	99
Fig. 53: Pamje nga Parku Kombëtar i Qafë Shtamës.....	104
Fig. 54: Pamje nga Sarisalltiku.....	105
Fig. 55: Pamje nga Shkëmbi i Vajës	106
Fig. 56: Pamje nga Gryka e Zezë	106

Fig. 57: Pamje nga Selvia e Teqesë	107
Fig. 58: Rrapi i Buranit	107
Fig. 59: Sipërfaqe të mbuluara nga Pisha e Zezë në Qafë Shtamë	108
Fig. 60: Pamje nga Kroi i Nënës Mbretëreshë	108
Fig. 61: Rrapi i Bretit.....	109
Fig. 62: Rrapi i Ballabanecit	109
Fig. 63: Rrapi i Taslloit.....	110
Fig. 64: Rrepet e Arramerasit.....	110
Fig. 65: Aktivitetet me impakt mjedisor	111
Fig. 66: Harta e zonave të urbanizuara të miratuara sipas VKM Nr. 5, Dt. 29.12.2014 për Bashkinë Krujë	119
Fig. 67: Zona informale e miratur – Fushë Krijë.....	120
Fig. 68: Terminali i Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza	126
Fig. 69: Harta energjitike Kruje.....	133
Fig. 70: Skema e furnizimit me energji elektrike Kruje.....	134
Fig. 71: Skema principale NS 110/6kV Kruje.....	135
Fig. 72: Numri i lindjeve dhe i vdekjeve sipas muajve, 2011	140
Fig. 73: Koeficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016)	141
Fig. 74: Paraqitje skematike e përpunimit të informacionit	173
Fig. 75: Paraqitje skematike e tipeve të topologjisë.....	174
Fig. 76: Hartat dhe tabelat e përdorura në terren	175

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Kuadri ligjor	19
Tabela 2: Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Krujë.....	22
Tabela 3: Njësitë administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara	49
Tabela 4: Shpejtësitë mesatare të erës sipas drejtimeve	57
Tabela 5: Klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierike i shkëmbinjëve dhe dherave	60
Tabela 6: Vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë bujqësore, livadhe kullota dhe pyjore për rrethin Krujë (AKKP, 2013)	89
Tabela 7: Sasia e tokës bujqësore dhe cilësia e saj.....	89
Tabela 8: Monumentet në territorin e Bashkisë Krujë.....	90

Tabela 9: Shpërndarja në bazë të sipërfaqes për speciet kryesore pyjore. Burimi: Kadastra e pyjeve dhe kullotave 2014 (Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Krujë).....	102
Tabela 10: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Krujë. Burimi: Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor (Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë).....	103
Tabela 11: Përdorimi i tokës rrethi Krujë (Burimi: Qarku Durrës)	117
Tabela 12: Inventar i ndërtesave publike (Bashkia Krujë)	121
Tabela 13: Sipërfaqet e sistemit natyror	123
Tabela 14: Sipërfaqet e sistemit bujqësor.....	124
Tabela 15: Inventari ARRSH (Bashkia Krujë)	127
Tabela 16: Inventari rrugëve rurale (Bashkia Kurbini)	129
Tabela 17: Numri i mjeteve që kalojnë në 24 orë në aksin rrugor Fushë Krujë (SH 1) – Milot	129
Tabela 18: Ndryshimi i popullsisë 1989-2011 (INSTAT).....	139
Tabela 19: Popullsia 2014-2015 (Bashkia Krujë)	139
Tabela 20: Popullsia banuese, Dt. 31.12.2011 (Bashkia Krujë)	140
Tabela 21: Numri i lindjeve dhe i vdekjeve sipas muajve, 2011 (Bashkia Krujë)	140
Tabela 22: Evidenca në lidhje me bizneset (Bashkia Krujë)	143
Tabela 23: Ferma Bujqësore, 2014.....	144
Tabela 24: Ferma Blegtorale, 2014.....	145
Tabela 25: Ferma Bujqësore dhe Blegtorale, 2014	145
Tabela 26: Të ardhurat (Bashkia Krujë).....	150
Tabela 27: Numri dhe përqindja e personave që udhëtojnë çdo ditë për arsye punësimi (INSTAT, 2011)	150
Tabela 28: Shpërndarja e objekteve arsimore (Bashkia Krujë)	152
Tabela 29: Shpërndarja e objekteve shëndetësore (Bashkia Krujë)	153
Tabela 30: Treguesit e varferise (në %) sipas qarqeve (INSTAT, Anketa e matjes së nivelit të jetesës, 2012).....	153
Tabela 31: Treguesit e varfërisë (në %) sipas rajoneve (INSTAT, Anketa e matjes së nivelit të jetesës, 2012).....	154
Tabela 32: Shkalla e papunësisë (Bashkia Krujë)	154
Tabela 33: Shpërndarja e të papunëve sipas njësive administrative (Bashkia Krujë)	154
Tabela 34: Punësimi për moshat mbi 18 vjeç (Bashkia Krujë)	155
Tabela 35: Numri i familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike (Bashkia Krujë) .	155

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Tabela 36: Statusi i banimit të banesave (INSTAT, 2011).....	155
Tabela 37: Statusi i përdorimit të banesave (%).....	158
Tabela 38: Tabela e stokut të banesave.....	158
Tabela 39: Legjislacioni për pronat pas viteve '90.....	162
Tabela 40: Struktura e të dhënave nga AKPT	169
Tabela 41: Struktura e të dhënave Gjeoportali Kombëtar	170

Përmbajtja

Hyrje	12
1 Të përgjithshme	14
1.1 Bashkia Krujë – historik i shkurtër	14
1.2 Konteksti aktual dhe sfidat kryesore	15
1.3 Qëllimi dhe objektivat.....	17
2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve 19	
2.1 Kuadri ligjor, standardet dhe normat.....	19
2.2 Rishikimi i gjithë inventarit të të dhënave teknike	21
2.3 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme	22
2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale	33
2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar	33
2.4.2 Planet ndërsektoriale.....	37
2.5 Zbatueshmëria e dokumenteve strategjik dhe planifikues	43
2.6 Çështje dhe zonat e rëndësisë kombëtare	44
2.6.1 Të përgjithshme.....	44
2.6.2 Analiza e elementeve përjashtuese	45
3 Skanimi i territorit dhe vlerësimi	49
3.1 Vështrim i përgjithshëm	49
3.1.1 Topografia dhe klima;.....	53
3.1.2 Gjeologjia inxhinierike;	58
3.1.3 Hidrogjeologjia dhe hidrologjia;	71
3.1.4 Zonimi makrosizmik dhe në varësi të rëndësisë, zonimi mikrosizmik; ..	76
3.1.5 Pjelloria e tokës	88
3.1.6 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike	90
3.2 Analiza mjedisore.....	100
3.2.1 Burimet natyrore	100
3.2.2 Zonat e mbrojtura natyrore.....	103
3.2.3 Evidentimi i problemeve mjedisore, hotspote, burimet e ndotjes dhe ndikim në shëndetin publik.....	111
3.3 Përdorimi ekzistues i tokës; Aktivitetet dhe ndikimet e tyre.....	116
3.3.1 Ndarja në 5 sisteme bazë	116

3.3.2	Sistemi urban	117
3.3.3	Sistemi natyror	121
3.3.4	Sistemi Bujqësor	123
3.3.5	Sistemi Ujor	124
3.3.6	Sistemi Infrastrukturor	126
3.4	Analiza e vlerësimeve demografike	138
3.4.1	Lëvizjet natyrore dhe hapsinore	141
3.4.2	Projeksionet.....	142
3.5	Aspektet sociale dhe ekonomike	143
3.5.1	Biznesi	143
3.5.2	Sektori i Bujqësisë.....	144
3.5.3	Sektori i Turizmit.....	146
3.5.4	Sektori i Industrisë.....	148
3.5.5	Të ardhurat e Bashkisë Krujë.....	149
3.5.6	Analiza e periferialitetit	150
3.5.7	Arsimi dhe shëndetësia	152
3.5.8	Papunësia dhe përkrahja sociale	153
3.5.9	Kriminaliteti dhe zonat e marginalizuara	156
3.5.10	Stoku i banesave	157
3.5.11	Toka dhe çështjet e pronës.....	159
3.5.12	Pronat publike	166
4	Përgatitja e bazës të dhënave territoriale në platformën GIS.....	168
4.1	Përditësimi i të dhënave ekzistuese	168
4.1.1	Harta bazë dhe GIS.....	168
4.1.2	Legjislacioni	168
4.1.3	Identifikimi dhe Mbledhja e të dhënave.....	169
4.1.4	Analiza e informacionit	172
4.1.5	Përpunimi i Informacionit.....	173
4.1.6	Analiza e situatës ekzistuese	176
4.1.7	Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave	178
5	Aneksi i Hartave	187

Hyrje

Në këtë dokument është paraqitur një skanim i territorit të Bashkisë Krujë, bazuar në gjithë informacionet teknike të vëna në dispozicion nga institucionet qendrore dhe lokale. Përveç informacionit të dhënë nga AKPT, konsulenti në zbatim të Termave të Referencës është angazhuar në grumbullimin e informacioneve të ndryshme edhe në institucionet lokale në varësi të Qarkut Durrës dhe Bashkisë Krujë. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e analizës së thelluar të territorit, në lidhje me dokumentin e Strategjisë Territoriale dhe produktin final (PPV) konsulenti është angazhuar maksimalisht në përditësimin dhe saktësimin e të dhënave (statistikore dhe hartografike). Ky dokument do të jetë i ndarë në 3 kapituj kryesor të përshkruara në vijim.

- Analiza e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve;
- Skanimi i territorit dhe vlerësimi;
- Përgatitja e bazës së të dhënave territoriale e integruar në platformën GIS.

Analiza e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve nënkupton rishikimin e gjithë raporteve përkatës dhe dokumenteve të punës ofruar nga Bashkia, AKPT-ja dhe MZHU-ja. Në territorin e bashkisë janë kryer disa studime urbanistike, në shkallë të ndryshme, disa të aprovuara e disa të mbetura në tentative. Analiza e arritjeve të tilla në vite është me rëndësi për të kuptuar evolucionin e prioriteteve dhe vizionit për territorin.

Po me sa rëndësi është njehja me Projektin e Përgjithshëm Kombëtar dhe projektet Sektoriale dhe Nënsektoriale të konceptuar rishtas, si elementë me rëndësi strategjike në nivel të gjerë.

Skanimi i territorit dhe vlerësimi ka për qëllim ta njohë Konsulentin me kontekstin e planifikimit vendor të Bashkisë, në të gjithë shtrirjen e saj gjeografike. Kjo e fundit përbëhet nga:

- mjedisi fizik (topografia, rrugët, ndërtesat, infrastruktura, etj)
- mjedisi social dhe ekonomik, strukturat institucionale administrative, banorët, veprimtaria prodhuese që ndodh në këtë zonë dhe shërbimet që ofrohen.

Kjo procedurë do të zhvillohet në dy drejtime:

1. Përfundimi i Inventarit të Bashkisë, përmes mbledhjes së të dhënave të vazhdueshme nga të gjitha fushat, të cilat kanë të bëjnë me aspektet fizike, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Konsulenti, ka kryer dhe po vazhdon të thellojë studim/vrojtim të gjithanshëm, në tre nivele, duke përdorur:
 - Evidentimin e përdorimit të tokës si në zonën Urbane dhe në atë Rurale. Konsulenti, në shërbim të këtij studimi, analizoi çdo të dhënë duke shkuar në vend, në çdo fshat e lokalitet;
 - Vëzhgimin në lidhje me situatën ekzistuese hidrogeologjike, gjeologjike, sizmologjike, mjedisore, me evidentimin e “pikave të nxehta”;

2. Konsultime teknike dhe intervista të rëndësishme me institucionet e lidhura me këtë proces, agjensi të ndryshme, dhe institucionet rajonale apo ekspertët vendas, që bënë të mundur përfundimin e procesit të mbledhjes së të dhënave paraprake për zonën e studimit.

Përgatitja e bazës së të dhënave territoriale e integruar në platformën GIS kërkon mbledhjen e të dhënave gjeografike me përdorimin e GPS dhe materialeve të tjera fizike dhe elektronike nga burime të ndryshme. Këto të dhëna janë integruar në një sistem të përbashkët gjeoreference, që do të përdoret si një bazë për procesin e planifikimit. Paketa GIS dhe të dhënat gjeografike janë mjete thelbësore për forcimin e planifikimit dhe menaxhimin e tokës.

Procesi i identifikimit të vlerave dhe i vizionit për të ardhmen e bashkisë është realizuar në një komunikim të vazhdueshëm me komunitetin si e vetmja mënyrë për të rezultuar në një përfaqësim sa më të plotë të tendencave dhe dëshirave të vet komunitetit. Roli i këtij vizioni do të jetë thelbësor, pasi ofron pikturën e përgjithshme që duhet të arrihet në momentin që përcaktohen qëllimet, objektivat dhe veprimet konkrete që do të ndërrmarë bashkia për zhvillimin e qytetit.

1 Të përgjithshme

1.1 Bashkia Krujë – historik i shkurtër

Bashkia Krujë shtrihet në qendër të territorit të Shqipërisë në veri të kryeqytetit. Gërmimet arkeologjike në Kështjellën e Krujës dëshmojnë se ka qenë vendbanim ilir që në shekullin III para erës sonë. Fshati Zgërdhesh mendohet se ka qenë Albanopolisi i përmendur nga Ptolemeu në shekullin II të erës sonë. Prej këtij mendohet që trashëgohet emri i sotëm për Shqipërinë "Albania". Me braktisjen e tij në fillim të Mesjetës banorët gjetën një vend më të mbrojtur në Krujë ndaj me kalimin e kohës qyteti mori rëndësi për gjithë krahinën. Për herë të parë emri "Krujë" përmendet në shekullin e IX në një dokument kishtar të vitit 879-të e.s redaktuar nga peshkopi i krahinës, në përmbajtje të së cilit citohet në latinisht, emri i qytetit "Croia". Emri "Krujë" mendohet ta ketë origjinën nga fjala "krua" (burim uji), sepse në Krujë ka shumë burime të tilla. Banorët e Krujës i thërrasin qytetin të tyre dhe burimeve të ujit me të njëjtin emër "krò".



Fig. 1: Rrënojat e Albanopolit (Zgërdhesh)

Në afërsi të qytetit të Fushë Krujës mendohet të gjenden edhe rrënojat e qytetit antik të Pistulit që përmendet në dokumentet e vjetër historik. Kruja përmendet si seli peshkopale që në shek. IX dhe si kala që në shek. XII-XIII. Për shkak të pozitës gjeografike dominuese mbi luginën e lumit Ishëm dhe Erzen dhe mbrojtjes natyrale për shkak të relievit ku ngrihej, kjo kështjellë do të kthehej në kryeqendrën e principatës së Arbrit. Më në Jug ndodhet kalaja e Prezës në një kodër 277 m të lartë në një pikë dominante mbi luginën e Ishmit. Përmendet edhe një kala tjetër e quajtur kalaja e Ishmit e ndërtuar në vitin 1591 nga sulltan Selimi II për të mbrojtur më nga afër karvanet që vinin ose drejtoheshin drejt Stambollit e Strugës nëpërmjet Tiranës, Fushë Krujës e Lezhës dhe më pas në portin e Shëngjinit ose Ulqinit.

Kruja ishte në qendër të shtetit të parë feudal shqiptar që rreth viteve 1190 kishte në krye Progonin e më pas djemtë e tij, Gjinin (1198-1206) dhe Dhimitrin (1206-1216).

Qyteti arriti pikun e zhvillimit në shekujt XIII dhe XIV. Ormanët e pushtuan për herë të parë në 1396 dhe për së dyti në 1415. Në 1430 shpërtheu një kryengritje e drejtuar nga Gjon Kastrioti. Me kthimin e djalit të tij Skënderbeut në 1443, Kruja u bë qendër e epopesë shqiptare të shekullit XV kundër osmanëve dhe emri i saj, asokohe ishte i njohur në gjithë Europën. Me Skënderbeun u rezistoi tre rrethimeve 1450, 1466 dhe 1467. Osmanët arritën ta marrin në 1478. Qyteti u rrënuar, shumë banorë u masakruan, pjesa tjetër mërgoi.



Fig. 2: Emblema e Kastriotëve prej nga vjen edhe flamuri kombëtar.

Vendbanimi i Fushë Krujës është formuar në fillimet e tij si një stacion në korridorin Veri-Jug dhe pikërisht përreth urës së vjetër mbi lumin Zezë sepse aty kryqëzoheshin dy itinerare të vjetra: ai i karvaneve Veri-Jug që lidhte Shkodrën dhe Shëngjinin me rrugën Egnatia dhe më pas me Lindjen e Ballkanit dhe ai që lidhte Krujën me Durrësin. Në vitin 1970, Fushë Kruja u shpall qytet.

Në veprën “Shqipëria më 1927” me autor Teki Selenicën jepet një pasqyrë e detajuar në shumë aspekte për vendbanimet shqiptare në vitin 1927. Nënprefektura e Krujës ishte një krahinë me 14400 banorë që mbahet kryesisht me bujqësi, arat në luginën e Ishmit dhe blegtori. Industria përfaqësohej kryesisht nga prodhimi lëndës drusore dhe prodhimi i tullave dhe gëlqeres për ndërtim.

1.2 Konteksti aktual dhe sfidat kryesore

Arsyet e nevojës së hartimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Krujë lidhen edhe me sfondin ligjor por edhe me situatën e gjendjes ekzistuese të Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrative - territoriale të njësivete qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, kufinj të administrativë të Bashkisë Krujë ndryshuan dhe për rrjedhojë një Plan i Përgjithshëm Vendor për është mjaft i rëndësishëm të kryhet, pasi nevojitet integrohen studimet e mëparëshme zonale dhe do trajtohen së bashku të gjitha njësitet administrative brenda territorit të ri.

Nga ana tjetër Ligji për Planifikimin e territorit ka ndryshuar dhe orjenton të gjitha njësitet vendore në kryerjen e planit. Në këtë mënyrë, hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor vjen edhe si detyrim ligjor, por edhe si nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të territorit dhe të gjitha sferave të tjera të zhvillimit në Bashkinë e re.

Një ndër sfidat me të cilat do të përballë bashkia e re është territori dhe zhvillimi i tij i qëndrueshëm. Territori i bashkisë është kompleks, për faktin që në përgjithësi gjatë

25 viteve të fundit territori në Shqipëri është zhvilluar vetëvetiu dhe dirigjuar mjaft pak. Si rrjedhojë kjo qasje ka prodhuar sfida të shumëllojshme, por edhe pasi bashkia tashmë është një aglomerat i tokës urbane ku jetohet, punohet e konsumohet, i tokës së kultivuar ku prodhohet dhe i territoreve periferike që ndërmjetësojnë mes të dyjave. Bashkia Krujë nuk është më një qytet, ku sfida e vetme e zhvillimit është si të ofrosh hapësira të banueshme me standarte të larta, hapësira pune e shpërndarje të integruara me njëra-tjetrën, por territor apo organizëm kompleks, ku cikli i jetës ndodh i plotë. Sfida e bashkisë së sotme do të jetë si të përdoren burimet natyrore e sidomos tokën bujqësore; për të arritur vetëmjaftueshmërinë dhe fleksibilitetin e domosdoshëm ekonomik në kushtet e një organizimi të ri dhe të një ekonomie të re, e cila nuk kërkon të varet aq shumë nga zhvillimet urbane/ekspansioni urban, sikurse ka qënë rasti deri pak kohë më parë, sepse ky ekspansion ka ndodhur kryesisht në mënyrë spontane dhe mjaft pak i drejtuar nga ide/dokumente zhvillimi të qëndrueshëm.

Në mënyrë të veçantë kjo fazë e parë e PPV-së, përpiqet të evidentojë të gjithë vlerat që përbëjnë thelbin e ekzistencës së Bashkisë jo vetëm si territor dhe njësi administrative, por edhe si një komunitet me identitetin e tij, si edhe të identifikojë vlera të reja potenciale që do e përforëconin këtë identitet. Qëllimi është jo vetëm për ti ruajtur ato por, për më tepër, për ti forcuar dhe promovuar ato vazhdimisht.

Bashkia Krujë shërben si portë veriore për zonën ekonomike Tiranë – Durrës të cilën e lidhet me korridoret kryesore që përshkrojnë veriu dhe verilindjen e vendit. Bashkia Krujë ka një karakter kompleks që mbetet i dyzuar mes aneksit periferik dhe industrial të Tiranës dhe oazit turistik, historik dhe peizazhistik që ofron qyteti i Krujës dhe zona natyrore përreth tij.

Bashkia përbëhet nga 6 njësi administrative dhe 52 qendra urbane, dy prej të cilave qytete. Kruja dhe Fushë Kruja janë dy qendrat urbane me intensitet më të lartë të aktivitetit ekonomik dhe urban.

Aktualisht bashkia Krujë përbëhet nga zona me tipare të ndryshme të cilat zhvillohen të pavarura dhe të pintepruara në një sistem të harmonizuar. Ndër hapësirat kryesore që përbëjnë karakterin e bashkisë mund të përmendin zonën historike të qytetit të Krujës, zonën industriale të Fushë Krujës, zonat natyrore, zona e mbrojtur e Parkut Kombëtar të Qafë Shtamës, zona rekreative dhe kurative e burimeve termale në Bilaj, zona me karakter bujqësor etj. Zhvillimi strategjik i bashkërenduar i këtyre zonave në një skenar të balancuar, është objektiv primar i PPV dhe një sfida e rëndësishme për pushtetin vendor. Pa dyshim që në kuadrin e një modeli zhvillimi të qëndrueshëm, duhet të kemi një përputhshmëri në shkallë kombëtare dhe rajonale me strategjitë e politikave zhvillimore sidhe përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe atyre Ndërsektoriale.

Potenciallet turistike dhe artizanati janë ndër elementët kryesorë për të promovuar dhe zhvilluar karakterin historik të qytetit të Krujës. Gjithsesi, motori ekonomik i mbështetur tek industria duhet të vendosë një balancë mes punësimit dhe zhvillimit ekonomik me shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore dhe kryesisht të resurseve të gëlqerës, të cilat kanë shkatërruar tashmë pyjet dhe kanë krijuar një nivel shumë të lartë ndotjeje.

Gjetja e raportit midis zhvillimit të turizmit dhe industrisë është një element mjaft delikat i kontekstit territorial, social dhe ekonomik të bashkisë Krujë.

Krahas dëmtimit të mjedisit, lumi Ishëm që kalon përmes bashkisë Krujë është një ndotës i vazhdueshëm. Ruajtja dhe zhvillimi i luginës së Ishmit, është një problem që duhet të zgjidhet në bashkëpunim me të gjitha bashkitë e këtij baseni ujëmbledhës, përfshirë Tiranën dhe Kamzën. Rehabilitimi i potencialeve mjedisore dhe zhvillimi i bujqësisë janë baza e një sistemi të qëndrueshëm ekonomik dhe ambiental për një pjesë të mire të territorit të bashkisë. Gjithashtu, konservimi i peizazhit është një domosdoshmëri sidomos për zonat me vlera të spikatura urbane, historike dhe natyrore.

Përmirësimi dhe shtrirja e sistemit të infrastrukturës mbetet një sfidë drejtpërdrejtë e lidhur me zhvillimin ekonomik dhe turizmin sidomos në zonat malore dhe në fshatrat e thellë.

1.3 Qëllimi dhe objektivat

I parë në këndvështrimin rajonal, zhvillimi i qëndrueshëm i Bashkisë Krujë, synon të arrijë objektivat ligjorë, respektimin e normave dhe standarteve territoriale dhe mjedisore, si dhe të respektojë zhvillimin demografik duke siguruar mundësitë për ecurinë e aktiviteteve industriale, tregëtare, të biznesit, të infrastrukturës; plotësimin e nevojave sociale, të banimit, të pushimit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si mjete të domosdoshme, që garantojnë qëndrueshmërinë dhe integrimin e zhvillimit të Bashkisë.

Kjo fazë është tepër e rëndësishme, për shkak se produkti final do të bazohet pikërisht mbi këto të dhëna. Më konkretisht, për procesin e Analizës objektivat do të ishin:

1. Konceptimi i ecurisë dhe rritjes së qëndrueshme të Bashkisë si pjesë integrale në zhvillimin e rajonit;
2. Kuptimin e synimeve dhe orientimeve, që Bashkia synon të arrijë, të shpërndara sipas zonave;
3. Klasifikimet që ndikojnë pronësinë dhe vlerën e tokës nëpërmjet:
 - Pesë sistemeve territoriale bazë
 - Klasifikimit funksional;
 - Hapat dhe mënyrat e implementimit (futjes në zbatim);
 - Norma e sipërfaqes së ndërtimit dhe tipologjia e banesave që do të jenë si rezultat i mekanizmave të implementimit;
4. Kategorizimi në zonat funksionale të territorit, nisur nga situata ekzistuese, përdorimet e mundshme, dendësia e popullsisë, infrastruktura aktuale sociale dhe inxhinierike si dhe rregullat që duhet të aplikohen në rast ndryshimi të funksioneve të lejuara. Këto sipërfaqe do të përcaktohen bazuar mbi parimet aktuale të përdorimit të territorit.

Qëllimi i kësaj Analize dhe Vlerësimi të thelluar të territorit është të krijojë një bazë të dhënash për hapat e mëtejshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), të identifikojë problemet me të cilat përballët zhvillimi i qytetit dhe se si mund të zgjidhen në të mirë të komunitetit. Kuptimi i këtyre zhvillimeve të qytetit shihet i lidhur ngushtë me zhvillimet në një shkallë më të gjerë rajonale dhe kombëtare.

Zhvillimi i integruar i kësaj Bashkie nënkupton marrjen në konsideratë dhe përfshirjen në një paketë propozimesh aspektet që mbështesin dhe garantojnë ndryshimet pozitive që do të ndodhin. Në këtë pikëpamje do të përfshihen, analizohen dhe kombinohen aftësitë ekonomike, sociale, mjedisore, të planifikimit territorial, aftësitë e institucioneve publike dhe ato të sektorit privat.

Në mënyrë më të përmblodhur, studimi synon të pasqyrojë:

- Strukturën e përgjithshme organike të territorit të përvijuar nëpërmjet elementëve që përcaktojnë llojin e zhvillimit, në vecanti nga rrjetet kryesore të transportit elementët natyrore, rrjeti i infrastrukturës ekzistuese dhe sipërfaqet e rezervuara për qëllime strategjike për Bashkinë dhe rajonin.
- Përcaktimi i ndërhyrjeve për ruajtjen e aseteve bujqësore, historike dhe pejsazhistike së bashku me kufizimet në lidhje me përdorimin e tyre, si dhe elementët e dhënë nga normativat shtetërore, në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- Studim të situatave hidrologjike, gjeologjike dhe sizmike të territorit në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria e planeve të propozuara me to.
- Kufizimet mbi ndërtimet për ato territore apo zona që janë të ndjeshme në lidhje me mjedisin, pejsazhin dhe trashëgimitë kulturore e historike.
- Ruajtja e funksionalitetit të infrastrukturës dhe zonave që kanë interes publik. Mbrojtja nga rreziqet e mundshme për banorët dhe objektet vulnerabël.
- Përcaktimi i rrethanave që mund të kërkojnë një rishikim të PPV-së. Ky rishikim duhet të derivojë nga kërkesa e popullsisë dhe indeksi i rritjes, përdorimi i tokës dhe intensiteti i mbulimit të sipërfaqes së ndërtimit, si dhe nga elementët e përgjithshëm, që fillimisht kanë ndikuar klasifikimin origjinal të territorit në zonim.

PPV duhet të sigurojë gjithashtu mbështetje për çështjet të cilat janë kompetencë e Bashkisë Krujë, si:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike,
- Funksionet Social-Kulturore dhe rikrijuese,
- Zhvillimi ekonomik lokal,
- Rendi dhe siguria.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit, që do të mbështetet te instrumentat e planifikimit për të operuar me efikasitet, ka gjithashtu nevojë për një kapacitet të përshtatshëm menaxhues të stafit të Bashkisë, në veçanti për monitorimin dhe modernizimin e planeve përmes kësaj periudhe zhvillimi.

2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve

2.1 Kuadri ligjor, standardet dhe normat

Më poshtë në trajtë të pëmbledhur është dhënë i gjithë kuadri ligjor, në kontekstin e të cilit është përgatitur dokumenti i Analizës dhe Vlerësimit të Territorit të Bashkisë Krujë. Përveç akteve ligjore dhe nënligjore për planifikimin e territorit të cilët kanë qenë referenca kryesore në hartimin e këtij dokumenti, më poshtë janë dhënë disa nga ligjet dhe VKM kryesore sektoriale që janë përdorur nga ekspertët e fushave të ndryshme në procesin e analizës dhe vlerësimit.

Tabela 1: Kuadri ligjor

Ligj	Nr. 107/2014 dt. 31.7.2014	"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, Dt.Aktit: 09.07.2015)
Ligj	Nr. 115/2014 dt. 31.7.2014	"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin Nr.180/2014, Dt.Aktit:18.12.2014)
Ligj	Nr. 139/2015 dt.17.12.2015	"Për vetëqeverisjen vendore"
Ligj	Nr. 7850 dt. 29.7.1994	Kodi civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 8378 dt. 22.07.1998	Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 72/2012 dt. 28.06.2012	"Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"
Ligj	Nr. 91/2013 dt. 28.02.2013	"Për vlerësimin strategjik mjedisor"
VKM	Nr. 427 dt. 20.06.2012	Për shpalljen e zonave arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Krujës dhe miratimin e rregullores së administrimit
VKM	Nr. 408 dt.13.05.2015	"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
VKM	Nr. 671 dt. 29.7.2015	"Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
VKM	Nr. 1096 dt. 28.12.2015	Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.
VKM	Nr. 219 dt.11.03.2015	"Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".
VKM	Nr. 691 dt. 29.7.2015	"Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020"
VKM	Nr. 829 dt. 07.10.2015	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor në Shqipëri" tema - Hidrografia
VKM	Nr. 942 dt. 18.11.2015	Për miratimin e rregullores "Për planifikimin dhe realizimin e fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë"

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

VKM	Nr. 1077 dt. 23.12.2015	Për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë"
VKM	Nr. 1078 dt. 23.12.2015	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësor në Shqipëri", tema - Kufijtë e Njësive Administrative
VKM	Nr. 153 dt. 7.4.2000	"Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar)

2.2 Rishikimi i gjithë inventarit të të dhënave teknike

Nga AKPT për territorin e Bashkisë Krujë informacioni i dhënë në trajtë elektronike (soft copy) përmban të dhëna për:

- Territorin në përgjithësi (reliev, gjeologji, hidrologji, etj.);
- Ndërtesat dhe disa shërbime publike (shkolla dhe kopshte);
- Sistemet bazë (urban, bujqësi, natyrë, ujë dhe infrastrukturë);
- PPV Fushë Krujë (miratuar me Vendim KKT Nr.11, dt 07.03.2014);

Nga kontrolli i kësaj databaze mjaft të vlefshme konstatojmë që:

Sistemi urban është bazuar në Vendim KKT nr.5, dt. 29.12.2014 për bashkinë Krujë. Në bashkëpunim me ekspertin GIS dhe me grupe pune në terren janë evidentuar ndërtesat që janë jashtë kufirit të përcaktuar në këtë vendim. I gjithë informacioni për këto ndërtesa do vihet në dispozicion të ekspertëve urbanist, të cilët, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin e AKPT do vendosin për parashikimet e nevojshme që do merren në procesin e planifikimit.

Sistemi urban është përditësuar duke shtuar informacionin mbi ndërtesat që mungonin në territor. Gjithashtu janë përditësuar edhe informacione mbi përdorimin e hapësirës urbane dhe funksionet e ndërtesave publike.

Përsa i përket sistemeve ujqor, bujqësor dhe natyror (të dhëna sipas Corine Land Cover) konstatohet që ato kanë pasaktësi në përcaktimin e kufijve përkatës dhe në bazë të një vlerësimi të detajuar mbi informacionet bazë (si ortofoto 2007) dhe të dhëna institucionet lokale do bëhen saktësime e nevojshme.

Gjithashtu sistemi infrastrukturor, kryesisht përsa i përket atij rrugor, është saktësuar dhe kategorizuar në bazë të kushteve të dhëna nga Kodi Rrugor. Informacioni i vënë në dispozicion për këtë infrastrukturë ishte marrë nga Instituti i Transportit dhe adresari. Fillimisht nga ekspertët GIS dhe inxhinierët e transportit u punua për ndarjen e akseve kombëtare nga rrugët lokale dhe pastaj u kalua në kategorizimin e tyre bazuar edhe në informacionet e marra nga ARRS. Për këtë qëllim është organizuar dhe një takim me ekspertët e ARRS të cilët ofruan asistencën e tyre për të paraqitur sa më realisht gjendjen ekzistuese dhe kategoritë e akseve kombëtare.

Përsa i përket PPV të njësisë administrative Fushë Krujë konstatohet që mungojnë të dhënat në sistemin GIS përsa i përket materialit hartografik.

Gjithashtu, material kryesor referues, për të gjithë procesin e hartimit të PPV-së për bashkinë Krujë janë dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Ndërsektoriale të vëna në dispozicion në versionin draft në faqen zyrtare të AKPT (planifikimi.gov.al).

Gjatë fazës së parë janë siguruar edhe dokumente të tjerë që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin ndër vite të zonave urbane në territorin e Bashkisë Krujë. Një përmbledhje më e hollësishme e dokumenteve të planifikimit paraqitet në vijim.

2.3 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme

Siç u trajtua më sipër Bashkia Krujë është e përbërë nga 6 njësi administrative, nga të cilat vetëm njëra (Njësia Administrative Fushë Krujë) ka të hartuar dhe të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor.

Në vijim paraqitet një listë e Vendimeve të KRRTRSH dhe KKT në territorin e Bashkisë Krujë.

Tabela 2: Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Krujë

Nr. 16 dt. 22.12.1993	Për shesh për materiale ndërtimi në lumin Tapizë. Miratuar
Nr. 10 dt. 06.04.1994	Për studimin pjesor të zonës industriale, biznesi e administrative në zonën suburbane të Tiranës. Miratuar
Nr. 26 dt. 02.06.1995	Për shesh dhe leje ndërtimi për fabrikë prodhimi tjegullash betoni në Tapizë-Krujë Miratuar
Nr. 73 dt. 09.05.1997	Për studim urbanistik të zonës Krastë – Krujë Nuk miratohet studimi në zonën e mbrojtur
Nr. 4 dt. 11.08.1999	Për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Krujës. Miratuar
Nr. 4 dt. 30.10.2002	Për shesh dhe leje ndërtimit për rehabilitimin e rrugës Tapizë – Fushë Krujë. Miratuar
Nr. 8 dt. 31.01.2004	Për shfuqizimin e vendimeve të KRRT të ish rrethit Krujë dhe vendimeve të KRRT të qarkut Durrës për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit të dy objekteve në hyrje të Aeroportit “Nënë Tereza”, si dhe prishjen e këtyre objekteve
Nr. 7 dt. 21.07.2009	Studim Urbanistik dhe Shesh Ndërtimi për objektin Kompleks Industrial për Prodhimin e Cimentos dhe Tullave të Lehtësuara, në Fushe Kruje dhe Nikel, me investitor Shoqëri “Gener 2 sh.p.k.” Miratuar
Nr. 3 dt. 07.03.2014	Për miratimin e lejes zhvillimore komplekse për ndërtimin e qendres së prodhimit të industrisë farmaceutike, komuna Bubq, qarku Durrës. Miratuar
Nr. 11 dt. 07.03.2014	Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fushë-Krujë Miratuar
Nr. 05 dt. 29.12.2014	Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban

Analiza e dokumenteve

Kjo analizë merr në konsideratë këto dokumente ekzistuese për territorin si më poshtë:

- Plani i Përgjithshëm Rregullues i Qytetit të Krujës 1998 (hartuar nga Bashkia Krujë)
- Projekt pilot për zhvillimin e ri rezidencial në Krujë
- Studim Urbanistik për zonën “Krastë” 1996
- Plan Rregullues Bashkia Krujë 1983
- Plani i Përgjithshëm Vendor për bashkinë e Fushë Krujës 2014 (hartuar nga Bashkia Fushë Krujë)
- Plani Rregullues i bashkisë Fushë Krujë 1976

Studimi i këtyre dokumenteve bëhet për të kuptuar kontekstin ekzistues, për marrjen e të dhënave të cilat mund të jenë të ri-përdorshme në lidhje me territorin nën studim, por mbi të gjitha për të analizuar vizionet e mëparshme të zhvillimit.

Kjo analizë do të ndihmojë në propozimin e skenarëve më të qëndrueshëm në raport me territorin e bashkisë në fjalë.

Autoritetet lokale të qytetit të Krujës më 1998 kanë hartuar një Plan të Përgjithshëm Rregullues për qytetin, ku përshkruhet në disa zëra gjendja ekzistuese dhe ndërkohë, propozohet edhe një layout i detajuar funksional i zhvillimit të qytetit. Pavarësisht shkallës së mirë të detajimit që ky dokument ofron për gjendjen ekzistuese, **kërkohej një përditësim** i të dhënave demografike e që lidhen me lëvizjen e popullsisë, pasi parashikimi i tij ndalet deri në vitin 2000.

Në kontekstin e analizimit të demografisë, si një nga parametrat kryesorë që kushtëzon skenarët ekonomikë, infrastrukturorë e ndërtimorë, dokumenti i Projektit pilot për zhvillimin e ri rezidencial në Krujë jep një panoramë më të qartë të lëvizjeve demografike në territorin e qytetit.

Qyteti Krujë, si qendër administrative e rrethit Krujë, në vitin e hartimit të këtij dokumenti (Projektit pilot për zhvillimin e ri rezidencial në Krujë), shënonte një popullsi prej 15000 banorësh, ndërsa i gjithë rrethi ishte rreth 70.000 banorë.

Pavarësisht se pas vitet '90 shoqërohen me një rritje popullate prej 7% në vit në zonat urbane fqinje të Krujës, (Tirana dhe Fushë Kruja), rasti i Krujës shënon një rritje që nuk i kalon 2% në vit e kjo vlerë kryesisht i atribuohet rritjes natyrore.

Në mënyrë më të detajuar, rritja totale është një arsyetim mbi atë natyrore dhe atë mekanike; rritja natyrore ka tendencën të bjerë në rastin e qytetit të Krujës, duke shënuar vlerën më të ulët rreth 0.8% në 1997 sipas këtij studimi, ndërsa ajo mekanike mbetet e paqëndrueshme dhe vështirësish e parashikueshme.

Nëse i referohemi lëvizjeve mekanike të popullsisë ky studim përmend këto etapa:

- 1985-1989. Popullsia e qytetit u rrit. Shumë banorë të qendrave fqinje urbane u punësuan (shpesh pa pëlqimin e tyre) në Krujë. Ky u konsiderua ose si i detyrueshëm (ndëshkim), ose si punësim i përkohshëm.
- 1990. Bashkë me ndryshimet politike, u fut liria e lëvizjes. Popullsia e qytetit u zvogëluar relativisht pasi kategoria e mësipërme e njerëzve lanë masivisht Krujën duke u kthyer në qytetet e tyre.

- 1991-1992. Popullsia e Krujës u rrit si pasojë e mbërritjes së emigrantëve të rinj kryesisht nga zonat veriore urbane e rurale
- 1993-1994. Rritja e popullsisë vazhdoi, por tashmë u zvogëlua në vlerë absolute, pasi zona të tjera urbane si Tirana dhe Durrësi ishin më tërheqëse për njerëzit.
- 1995-1998. Për herë të parë numri i njerëzve që hynin ishte më i vogël se ata që linin Krujën. Kjo do të thotë se popullsia e Krujës aktualisht po zvogëlohet. Gjithsesi kjo balancohet nga rritja natyrore e popullsisë

Përfundimi mbi demografinë, i dokumentit të Planit Pilot për zonat e reja rezidenciale, mbetet që Kruja është një qendër urbane me një popullsi **konstante**.

Ky dokument përmend dy skenarë të mundshëm që do të ndikonin popullatën:

- a. Në rastin e një zhvillimi apo rritjeje ekonomike, popullsia mbetet e njëjtë ose pëson një rritje të lehtë
- b. Në rastin e një regresioni ekonomik popullata ka prirjen të tkurret e të zhvendoset në qendra me aktivitete më të lartë ekonomik

Këto përfundime mbeten për tu shqyrtuar në hartimin e skenarëve të rinj për Bashkinë Krujë.

Duke iu rikthyer Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Krujës, koncepti i zhvillimit hapësinor është mbështetur mbi zonimin funksional. Nëpërmjet dokumentit të Rregullores së Zbërthimit dhe Zbatimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Krujës sanksionohen funksionet bazë të çdo zone dhe rregullat e përgjithshme tekniko-urbane që duhet të zbatohet çdo studim pjesor (Koncepti i zhvillimit të atyre viteve i referohet studimeve pjesore)

Ndërkohë skenarët e zhvillimit të qytetit bazohen në zhvillim zonal ku paraqiten këto zona kryesore:

Zona Banimi

Në përputhje me parashikimin e skenarëve të popullsisë, për të përballuar kërkesat për strehim janë propozuar këto tipe:

- a. Pesë zonat e zgjerimit të brendshëm
- b. Tre zona të rikuperimit arkitektonik e urban
- c. Pesë zonat e restaurimeve
- d. Zona e re e banimit
- e. Zona e ndalimit të ndërtimeve
- f. Zona banimi të tjera (nuk janë përcaktuar kufi për studime urbanistike pjesore)

Zona e qendrës historike

Ky dokument parashikon zgjerimin e vijës së qendrës duke propozuar dy tipe:

- a. Zona e qendrës e re
- b. Zona historike

Zona për transformim të strukturës urbane

Zonë turistike

Zonë ekonomike

Interes paraqet qëndrimi i këtij dokumenti në raport me trajtimin e zonave ekonomike. Në këtë kontekst propozohen këto tipe zonash:

- Zona ekonomike ne funksionim
- Zona ekonomike për tu ricikluar

Zonë e gjelbër

Zonë sportive

Zonë e fidanishteve

Zonë administrative

Zonë e varrezave

Zonë për grumbullim mbeturinash

Zonë për rikuperim ambiental

Zonë e mbrojtjes së peizazhit




Fig. 3: Plani i zhvillimit te bashkisë se Krujës/Zonim funksional (1998)

Ky dokument ekzistues, pavarësisht faktit që kërkon përditësim të skenarit të zhvillimit, rezulton një e dhënë me rëndësi për të mirë-orientuar zgjidhjet në shkallë të vogël. Në terma të përgjithshëm ky dokument ekzistues përforcon karakterin turistik të qytetit, por nuk jep direktiva të qarta në lidhje me zhvillimin ekonomik. Duke qenë se ndërhyrja përqendrohet në shkallë qyteti, nuk ka një lidhje të integruar me një vizion më të gjerë, më rajonal. Në këtë sens, nga ky dokumentacion mbetet për tu referuar një pjesë e analizave të gjendjes ekzistuese dhe duhet ri-vlerësuar qëndrimi mbi qendrat ekonomike apo potencialin turistik. Duhet sqaruar cilët mund të jenë sektorët kryesorë e sekondare të zhvillimit ekonomik e për më tepër të integruar me gjithë territorin e bashkisë.

Më 1996 është hartuar një studim urbanistik për zonën Krastë, duke parë mundësitë e kësaj zone me resurse turistike e potencial për zhvillim ekonomik.

Me tepër se të dhënat që mund të nxirren në terma të metodologjisë apo parametrave të zhvillimit, ky dokument mbetet një shembull që dëshmon një ndërhyrje që demonstroi një shkallë ndjeshmërie përkundrejt kontekstit natyror. Në këtë sens ky qëndrim mund të riciklohet edhe në skenarët që do të propozohen për zona me potencial natyror e turistik, gjithmonë në kuadrin e parimit të një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky studim nuk u miratua nga KRRTRSH për shkak se cenonte zonën e mbrojtur të pyllit të pishave.




Fig. 4: Plani i zhvillimit të zonës se Krastës (1996)

Në vitin 2014 është hartuar Plani i Përgjithshëm Vendor për bashkinë Fushë-Krujë nga njësia administrative lokale (Vendim KKT Nr.11, dt 07.03.2014).

Më konkretisht janë prodhuar tre dokumente; Politika e zhvillimit të territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planifikimit.

Ky dokumentacion paraqitet shumë më i plotë sidomos në terma të analizave dhe të leximit të gjendjes ekzistuese të territorit. Analiza përfshin:

Analiza socio-ekonomike

Analiza demografike

Analiza mjedisore

Analiza kulturore dhe historike

Analiza e influencësve territorialë

Analiza e strukturimit hapësinor

Analiza e programeve politike ekzistuese dhe studimeve që kanë orientuar zhvillimin urban të qytetit

Në mënyrë të përmblodhur, ky dokument pohon se gjetjet kryesore të analizës së gjendjes ekzistuese që kanë ndikuar strategjitë apo skenarët e zhvillimit janë këto:

- Papunësia 31%
- Profil ekonomik i diversifikuar por ku mbizotëron sektori i industrisë së prodhimeve minerare.
- Bujqësia sektori i dytë i rëndësishëm
- Në variantin maksimal të rritjes së popullsisë së Bashkisë Fushë Krujë do të shtohen 7400 banorë
- Problemet mjedisore kryesore:
 - Dëmtimi i pyjeve dhe kullotave
 - Shfrytëzim intensiv dhe informal i burimeve minerare
 - Ndotja e ajrit
 - Dëmtimi i ekosistemeve

Po të krahasojmë parashikimin për qendrën e Krujës ku popullsia ka mbetur konstante (15,000 banorë) me propozimin e këtushëm shohim se kemi një rritje të popullsisë me 7400 banorë

Në aspektin e potencialeve të territorit:

- Territori mbart vlera peizazhistike, burime pyjore, ullishte, burime ujore, burime termale, zona historike ende të pazbuluara
- Porta hyrëse e korridoreve Veri-Jug dhe Durrës-Kukës në rajonin Tiranë-Durrës




Fig. 5: Gjendje ekzistuese e bashkisë Fushë Krujë (PPV Fushë Krujë 2014)

Në hartën e mëposhtme analitike listohen influencuesit kryesorë të territorit të cilët kanë karakterin e akseve me rëndësi kombëtare, elementeve natyrore, akseve rajonale që nxisin zhvillimin e korridoreve industriale, qendrat urbane dhe aktivitetet e tjera. Nga pozicionimi që ka në raport me akset e lëvizjes, kufizuesit territoriale e asetet natyrore, kuptohet intensiteti më i lartë në terma zhvillimi që qyteti i Fushë Krujës ka pasur në raport me atë të Krujës.




Fig. 6: Influencuesit e qytetit (PPV Fushë Krujë 2014)

Përveç analizës makro në terma të influencuesve territoriale, bëhet edhe një analizë sektoriale në shkallë të bashkisë së Fushë Krujës duke evidentuar në sektorë specifike marrëdhëniet morfologjike e funksionale të zonave të caktuara.




Fig. 7: Gjendje ekzistuese e sektorëve të qytetit (PPV Fushë Krujë 2014)

Harta e mëposhtme jep propozimin për bashkinë e Fushë Krujës nga plani rregullues i hartuar më 1976 duke e krahasuar me zhvillimin real hapësinor të ndodhur në 4 dekada.




Fig. 8: Analizë e Planit Rregullues të vitit 1976 (shkëputur nga analiza e PPV Fushë Krujë 2014)




Fig. 9: Zhvillimi real nga 1976 deri me 2007 (shkëputur nga analiza e PPV Fushë Krujë 2014)

Ndërkohë nga kërkesat e sotme të autoriteteve lokale për një vizion zhvillimi të territorit mund të citohet se:

“ Bashkia Fushë Krujë si një qendër e rëndësishme në rritje në konfiguracionin Rajonal Tiranë - Durrës, me hapësira cilësore akomoduese për banorët, me shërbime dhe infrastruktura cilësore, me mundësi punësimi dhe zhvillimi në raport me potencialet natyrore, territoriale dhe humane që ajo disponon. Bashkia e Fushë Krujës me një mjedis natyror cilësor, ku ndërthuren vlerat e natyrës, trashëgimia historike dhe nevoja për një identitet të qartë dhe unik për vendin dhe banorët e tij.”



Fig. 10: Harta e skenarëve strategjikë të zhvillimit të bashkisë Fushë Krujë (PPV Fushë Krujë 2014)

Nga analiza e territorit të gjendjes ekzistuese ky Plan i Përgjithshëm Vendor ka vendosur këto objektiva strategjike:

- Rritja ekonomike në Bashkinë Fushë Krujë nëpërmjet fuqizimit të sektorit privat me fokus kryesor industrinë e rëndë të materialeve të ndërtimit, magazinimin dhe tregtinë rajonale;
- Rivlerësimi i formave aktuale të menaxhimit të territorit në Bashkinë Fushë Krujë bazuar në pjesëmarrjen demokratike dhe transparente të gjithë aktorëve të fushës së zhvillimit
- Rivlerësimi dhe përmirësimi i proceseve të punës së administratës së Bashkisë duke u fokusuar në rritjen e kualitetit të shërbimeve ndaj qytetarit
- Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkisë Fushë Krujë;
- Përmirësimi i kualitetit të sistemit arsimor të të gjitha niveleve, i konceptuar si komponenti më i domosdoshëm për rritjen e kapaciteteve të komunitetit në Bashkinë Fushë Krujë si dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale
- Përmirësimi i kualitetit të banimit nëpërmjet përmirësimit të hapësirave urbane dhe natyrore në të gjithë territorin e Bashkisë Fushë Krujë

Në një interpretim të përgjithshëm të kësaj harte vërehet skenari për konsolidimin e strukturave urbane të banimit dhe zhvillimin e korridoreve ekonomike përgjatë aksit inter-urban Shkodër-Tiranë. Sistemi Urban dhe zonat rekreative Urbane do të rrethohen nga sistemi bujqësor (zonat agrare) me tendencën për te mbrojtur këto të fundit. Në pjesën veri-lindore propozohen dy breza filtër që ndajnë zonat industriale nga sistemi urban i banimit. Këto breza kompozohen nga një zonë e mbrojtur pyjore dhe një agrare.

I mëshohet parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm duke përmendur:

- Koncepti i të ardhmes
- Mjedisi
- Barazia
- Pjesëmarrja

Ndërkohë në aspektin e zhvillimit territorial të kalimit nga zona urbane në atë rurale është përdorur koncepti i transektit.




Fig. 11: Kalimi i integruar nga zona urbane në atë rurale (PPV Fushë Krujë 2014)

Duke kaluar në terma më konkrete ky dokument ka prodhuar këtë layout të kategorisë së përdorimit të tokës:




Fig. 12: Harta e kategorive të përdorimit të tokës (PPV Fushë Krujë 2014)

Ndërkohë skenarët e zhvillimit të banimit dhe të korridoreve e zonave ekonomike jepen në hartat e mëposhtme:




Fig. 13: Skenarë të zhvillimit të sektorëve ekonomike e të banimit (PPV Fushë Krujë 2014)

Dokumentet ekzistues për të dy qendrat urbane (sot pjesë e një njësie territoriale) paraqiten relativisht të plotë por të konceptuar në mënyrë të pa-integruar me njeri-

tjetrin apo me një dokument që orienton zhvillimin në një shkallë më të madhe. Në terma të përgjithshëm, dalin të vlerësuar, resursi turistik e natyror për qytetin e Krujës dhe ai industrial e ekonomik për atë të Fushë Krujës. Mbetet për tu ri-parë skenari i zhvillimit ekonomik në funksion të një analize të integruar të demografisë, dhe analizës nën optikën e një qendre Motor të zhvillimit.

Mbetet për tu trajtuar çështja e ndërlidhjes hapësinore e infrastrukture dhe trajtimi çështjeve mjedisore.

Zhvillimi i aktivitetit ekonomik në dy anët e rrugës interurbane Tiranë – Shkodër është një vendim i planeve të mëparshëm që meriton një vlerësim të kujdesshëm kundrejt efikasitetit dhe sigurisë të lëvizjes pa cenuar potencialet ekonomike.

Gjithashtu deri më sot, instrumentet e planifikimit kanë rezultuar jo efikase në ruajtjen e ambientit natyror, peizazhit urban dhe zonave historike. Në këtë drejtim mbetet ende shumë për tu bërë në kuadër të PPV të ri.

2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale

2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Për identifikimin e zonave me rëndësi kombëtare brenda territorit të bashkisë Krujë janë konsultuar materialet e vëna në dispozicion të draft PPK si “Politikat, Objektivat, Vizioni” apo “Draft Hartat e PPK” si edhe të dhënat që janë marrë nga nisma e pushtetit vendor.

Duke iu referuar kryesisht dokumenteve të mësipërm, në këtë pikë analizohet pozicioni i bashkisë Krujë në raport me të gjithë territorin e vendit në një këndvështrim të strukturuar sipas sektorëve apo sistemeve të propozuara në Draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar.

Kjo analizë konsideron edhe inputet e marra nga kërkesa e njësive administrative lokale për hartimin e një dokumenti që kontrollon zhvillimin e territorit, ku artikulohen disa pika të gjendjes ekzistuese që kërkojnë përgjigje në dokumentet që do të hartohen për skenarët e zhvillimit të bashkisë.

Në mënyrë të përmbledhur, në kërkesën e hartuar nga bashkia Krujë për hartimin e një dokumenti që kontrollon zhvillimin e territorit artikulohen këto observime specifike të gjendjes ekzistuese:

- Zhvillimi kaotik dhe përdorim jo racional i tokës dhe burimeve natyrore
- Mungesa dhe amortizimi i infrastrukurës rrugore dhe shërbimeve të tjera publike
- Nivel i ulët i investimeve të huaja
- Sektorë të pazhvilluar përkundër potencialit të lartë: turizëm, ekonomi, bujqësi etj.
- Sipërfaqe toke të lëna djerrë
- Të ardhura vendore relativisht të kufizuara nga mungesa e aktiviteteve prodhuese
- Infrastrukturë e dobët për promovimin e turizmit
- Nivel shumë i ulët i zhvillimit të agro - përpunimit

- Zona ekonomike nuk ka kushtet e nevojshme si në akses dhe në infrastrukturë.
- Mungon transporti publik dhe transporti ndërqytetës, nuk ka zona të përcaktuara dhe studiuar qartë
- Kthimi i tokës bujqësore në truall urban dhe dëmtimi i sistemit të vaditjes
- Papunësi dhe mospërputhje e profesioneve të ofruara me ato të lëvizjeve demografike emigruese të shumta të rinisë dhe kapaciteteve të shkolluara të kërkuara nga tregu i punës
- Ekzistenca e zonave informale në hapësirën urbane të qytetit dhe rrethinave.
- Zhvillim i pa orientuar që nuk sjell asnjë avantazh konkurrues
- Mirëmbajtje e dobët e rrjetit rrugor dhe hapësirave të gjelbra.
- Infrastrukturë rrugore e papërfunduar që të çon te zonat turistike
- Rrjeti aktual i kanalizimeve është i pamjaftueshëm dhe nuk ka një impiant trajtimi të ujërave të zeza.
- Mungesë aktiviteti në masat e mbrojtjes së mjedisit (menaxhimi i mbetjeve, ujërave të përdorura)
- Probleme të mjedisit; mbeturina urbane dhe kanalizime të papërshtatshme të ujërave të zeza të cilat ndikojnë tek turizmi
- Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë të pijshëm me pasoja për biznesin, turizmin dhe bujqësinë.

Është kuptuar nga autoritetet lokale që faktori kryesor që pengon zhvillimin e bashkisë mbetet mungesa e një vizioni të strukturuar; problemet ekonomike luhaten që nga mungesa e investimeve të huaja e deri tek problemet që ka shkaktuar largimi i kapaciteteve të shkolluara duke krijuar mospërputhje në tregun e punës. Po aq rëndësi paraqesin çështjet e potencialeve turistike natyrore e historike, ato mjedisore e hapësinore. Në mënyrë të përmblodhur këto pika konvergjojnë në nevojën për kristalizimin e vektorëve të zhvillimit ekonomik, çështjeve të turizmit dhe ato mjedisore.




Fig. 14: Draft PPK. Rajonet ekonomike. Pozicioni i territorit të Krujës

Nëse shqyrtohet dokumentacioni i Draft Planit të Përgjithshëm Kombëtar vërehet se:

Së pari, sipas Draft-PPK, duke u pozicionuar në brendësi të territorit të vendit, Bashkia Krujë është pjesë integrale e Motorit Qendror apo ndryshe rajonit ekonomik Tiranë - Durrës. Ky dokument parashikon këtë profil mbizotërues për rajonin: Shërbime, Tregti (shkëmbim përpunim)-Energji-Turizëm-Agrobiznes - lidhje e fortë bashkëpunimi ndërkombëtar.

Të qenit pjesë e Rajonit ekonomik Motor Qendror e bën këtë bashki të jetë e lidhur me atraktore ekonomike si qendrat e inovacionit, hub-et logjistike, infrastrukturë gazsjellës, apo aeroport kombëtar kryesisht të vendosura në dy qendrat e tjera të rajonit. Duke kaluar në një shkallë më të vogël analize të territorit, në këtë Draft PPK, qendra e specializuar e Krujës karakterizohet nga prezenca e Turizmit (Zonë me rëndësi kombëtare) dhe e zonës me aktivitet ekonomik të Fushë Krujës si atraktoret kryesorë të zhvillimit ekonomik.

Në hartën e Energjisë dhe Industrisë kemi prezencën e nënstacioneve dhe afërsinë e territorit me një rrjet të dendur linjash transmisioni dhe asaj të TAP-it.

Sipas Draft-PPK, duke iu referuar dokumentit që hierarkizon qendrat urbane, bashkia Krujë parashikohet si një qendër urbane e specializuar.




Fig. 15: Draft PPK. Hierarkia e propozuar e qendrave urbane

Në aspektin e ndërlidhjes hapësinore dokumenti parashikon lidhjen me qendrat e specializuara të Lezhës dhe Kamzës, ndërkohë, lidhja me qendrën kryesore të Durrësit dhe metropolit Tiranë realizohet nëpërmjet Vorës.

Në aspektin e ndërlidhjes infrastrukture territori i bashkisë Krujë është pranë akseve me rëndësi kombëtare si:

- Boshti Qendror (Elbasan - Berat - Gjirokastrë)
- Rruga e Arbrit (Tiranë Dibër-Maqedoni) si degëzim i Korridorit VIII
- Rruga e Kombit (Durrës-Kukës-Prishtinë-Nish) si një nga korridoret me ndikimin më të lartë në rajon për shkak të lidhjes përmes Prishtinës me korridorin X dhe Serbinë




Fig. 16: Draft PPK. Ndërlidhja hapësinore e qendrave sipas hierarkizimit të propozuar

Afërsia me motorët qendrorë ekonomikë bën që bashkia Krujë të jetë pranë akseve kryesore me rëndësi kombëtare.

Sipas Draft-PPK, në aspektin mjedisor kjo zonë kufizohet nga një zone e mbrojtur dhe me prirje të zhvillimit të turizmit (zonë natyrore dhe parqet kombëtare në lindje të territorit).

Sipas Draft-PPK, bashkia Krujë pozicionohet pranë hubeve multimodale të Tiranës e atyre 5 modale të Durrësit e të Lezhës. Lidhja e qytetit Krujë me atë të Fushë Krujës bëhet nëpërmjet transportit publik, të automjeteve dhe atij të gjelbër (green). Qyteti i Fushë Krujës realizon lidhjen e qytetit të Krujës me aksin Lezhë-Tiranë.



Fig. 17: Draft PPK. Ndërlidhja hapësinore infrastrukture. Pozicionimi me Hub-et e lëvizjes

Duke kaluar në një këndvështrim më të limituar për të identifikuar kufizime që burojnë prej ligjeve sektoriale (monumente të kulturës apo të natyrës) një vëmendje të veçantë kërkon zona historike e Kalasë së Krujës dhe e Pazarit të Vjetër (Qyteti i Krujës),

Kalaja në fshatin Zgërdhesh (Albanopolis), si dhe një sërë monumentesh të tjera me vlera të spikatura dhe potencial të lartë turistik.

Gjatë hartimit të dokumenteve të zhvillimit të territorit që kontrollojnë shkallë më të vogla territori, këto zona do të kenë trajtim të veçantë për sa i takon parametrave zhvillimorë duke vlerësuar peshën e tyre në shkallë vendi e rajoni.

Për sa i takon monumenteve të natyrës Parku Kombëtar i Qafështamës paraqitet si një zonë e mbrojtur me rëndësi kombëtare.

Të tjera monumente natyrore (të një shkalle më rajonale) përmenden Sarisalltiku, Gryka e Vajës ose Shkëmbi i Vajës, Gryka e Zezë, Selvia e teqesë, Rrapi i Buranit, Pisha e Zezë, Kroi i Nenës Mbretëreshë, Rrapi i Cinarit, Rrapi i Ballabanecit, Rrapi i Taslloit, Rrepet e Arramerasit.

Në terma të sektorit të ekonomisë, në territorin e bashkisë Krujë ndodhen dy fabrika të prodhimit të çimentos, prodhimit të gurit gëlqeror si edhe lexohet një prezencë e fortë e industrisë fasone. Po në këtë kuadër përmendet edhe korridori ekonomik i Nikël-it ku është e zhvilluar industria e mobilierisë së drurit.

Nga kjo analizë e përgjithshme sektoriale, detyrimi i parë që lind është gjetja e **ekuilibrit** mes potencialit turistik dhe hotspot-eve mjedisore që krijohen prej zonave të industrisë së prodhimit të çimentos apo të gurit gëlqeror. Skenarët e mundshëm të zhvillimit ekonomik duhet të pasqyrojnë analiza të cilat argumentojnë avantazhet e favorizimit të secilit sektor.

2.4.2 Planet ndërsektoriale

Një këndvështrim më të detajuar për territorin e bashkisë Krujë japin dy dokumente me karakter ndër-sektorial e që fokusohen në një shkallë më të vogël territori se ajo kombëtare. Më konkretisht, Draft Plani i Integruar Ndër-sektorial i Bregdetit dhe Draft Plani i Integruar Ndër-sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.

Duke iu referuar kategorizimit të bregdetit shqiptar në brezat që ky draft dokument propozon, territori i bashkisë Krujë ndodhen në brezin C.

Karakteristikat për këtë brez janë si më poshtë:

Brezi C TRASHEGIMI KULTURORE (KULTURE DHE HISTORI) - karakterizohet nga vlerat historike, kulturore dhe monumentale që ky territor ka, me qytetet si Shkodër, Lezhë, Krujë, Tiranë, Elbasan, me vlerë kombëtare, Berat, Gjirokastrë, Butrint, (me vlerë ndërkombëtare, të cilat mbrohen nga UNESCO).

Po duke iu referuar këtij dokumenti, një tjetër nënndarje e fashave territoriale që mbështjellin bregdetin bëhet duke iu referuar sektorëve kryesorë që do të zhvillohen në to. Në këtë zonim të territorit të bregdetit, bashkia Krujë pjesërisht pozicionohet në rajonin ekonomik e pjesërisht në atë natyror.



Fig. 18: Draft PINB. Pozicionimi i bashkisë Krujë në rajonet e bregdetit.



Fig. 19: Draft PINB. Potencialet agrikulturore

Në këto draft harta, Kruja paraqitet si qendër e specializuar, ndërkohë që rrethohet nga territore të konsiderueshme me zona agrikulture, ullishte, frutore e pyjore. Pranë Shijakut dhe Bubqit propozohen dy markete bujqësore, ndërkohë vihet re një prezencë e lartë e lokaliteteve turistike.

Koncepti i zhvillimit ekonomik të kësaj fashe i referohet atij të diversifikimit dhe qasjeve të integruara ndër-sektoriale.

Në mënyrë të përmbledhur ky dokument specifikon se vizioni i zhvillimit për territorin duhet të arrihet:

1. Duke mundësuar diversifikimin e ekonomisë: turizëm detar, agrikulturë, kulturë, trashëgimi kulturore.
2. Duke i lidhur këto sektorë të ndryshëm të ekonomisë me njëri-tjetrin, në një zinxhir të vazhdueshëm, ku secili ndikon tek tjetri. Të 4 këta sektorë janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin e ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së turizmit.

3. Duke përmirësuar dhe krijuar infrastrukturë transporti për të aksesuar çdo vlerë të territorit (monumente historike, kulturore, natyrore, vlera natyrore, etj)
4. Duke u informuar në lidhje me këto vlera (plane menaxhimi) dhe duke promovuar lokalitetet
5. Duke promovuar produktet tipike, karakteristike dhe tradicionale lokale.
6. Duke ofruar shumëllojshmëri akses, publik dhe privat, nga deti dhe toka.
7. Duke përcaktuar zonat me vlerë për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit nga ndërtimet apo zhvillimet e së ardhmes.

Duke gjykuar në raport me pozicionimin e territorit të bashkisë Krujë në raport me bregdetin, mund të thuhet se një qasje ndër-sektoriale që mund të sjellë zhvillim të qëndrueshëm është ajo mes **turizmit agro-kulturor dhe atij historik**. Ky vektor mund të zhvillohet në pjesën më në brendësi të territorit, ndërkohë në pjesën e Fushë Krujës që ndodhet edhe më pranë akseve të lëvizjeve të nivelit kombëtar motor kryesor i ekonomisë do të mbetet **industria e bujqësisë**.

Të tjera inpute të rëndësishme për orientimin e skenarëve të zhvillimit jep plani i integruar ndër-sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.

Sipas këtij Draft dokumenti rajoni i Duranës trajtohet si motori më i rëndësishëm ekonomik i vendit, kjo për shkak të densitetit të lartë të popullatës dhe përqendrimit të lartë të aktiviteteve ekonomike me rëndësi kombëtare.

Rajoni Durrës-Tiranë është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapësirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e "Korridorit 8". Ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e rajonit luajnë dhe portat logjistike të pozicionuara në të, Porti Durrësit dhe Aeroporti "Nënë Tereza", Parqet logjistike dhe Parqet Energjetike Spitallë (Durrës) dhe Parku logjistik Laknas.

Rajoni "Durrës-Tiranë" është kontribuesi kryesor i zhvillimit ekonomik në rang kombëtar, si në numër biznesesh po njësoj dhe në shumëllojshmërinë e tyre, kjo falë prezencës së lartë në numër të institucioneve dhe numrit të lartë të dendësisë së banorëve në rajon si dhe pozicionimit të favorshëm gjeografik.

Numri i bizneseve në rajon është 53640 njësi (INSTAT, 2012). Ky numër është i përbërë nga bizneset e rretheve të Durrësit dhe Tiranës.

Përqendrimi i kapitalit të Sh.A.-ve në nivel vendor është 76.4% në Tiranë dhe 3.7% në Durrës. Përqendrimi i bizneseve në rajon është kryesisht i fokusuar në këto zona funksionale :

Zona funksionale primare:

Tiranë, Tiranë - Vorë, Tiranë - Kamëz ,

Durrës - Shkozë, Durrës - Shijak - Xhafzotaj.

Shijak - Xhafzotaj - Sukth.

Zonat funksionale sekondare janë :

Kamëz- Nikël, Kamëz - Paskuqan, Kashar - Tiranë ,
Vore - Berxull - Marqinet - Maminas
Shijak - Manëz

Sektorët ndërveprues në rajon janë :

- 1) Shërbime - Rekreacion
- 2) Ndërtim
- 3) Industri
- 4) Turizëm

Skenari i zhvillimit të korridorit ekonomik të Duranës mbështetet mbi parimin e policentrizmit dhe krijimit të një Cluster-i ekonomik, i cili mbështetet mbi sektorë si inovacion, ndërtim, prodhim, përpunim.

Ky dokument propozon Dendësimin e Diversitetit që kërkon të ruhet dhe shtohet shumëllojshmëria e bizneseve në këtë zonë duke incentivuar ndërlidhjen e tyre. Të nxiten “cluster-at” ekonomike të cilat mbështesin në formë ciklike njëra tjetrën, për ndërtimin e një ekonomie qarkulluese – “Circular Economy”.

Në këtë sens, propozohet ky hierarkizim i qendrave urbane e rajoneve si në hartë. Vërehet pozicioni specifik që zësidomos zona e Nikël-Bubq-it në këtë skenar ku konsiderohet si një pol kompetitiv për shkak të industrisë së përpunimit të drurit. Në skenarin e zhvillimit propozohet përforcimi i këtij karakteri duke propozuar një cluster ekonomike te bazuar në ndërlidhjen e sektorëve të prodhimit e përpunimit të drurit me bujqësinë e transportet.




Fig. 20: Draft PIN Durana. Hierarkizimi dhe specializimi i qendrave urbane te rajonit.

Në kuadër hartimit të politikave të turizmit prej këtij dokumenti, bashkia Krujë kalon në një plan primar. Në këtë dokument theksohet se ndërlidhja e sektorëve të shërbimeve në ndikim të turizmit, nuk ka qenë e fokusuar në një strategji unifikuese për të brendashkruar: Natyrën - Historinë - Kulturën – Identitetin. Në këtë draft hartë jepen shërbimet e ofruara nga ky rajon dhe ndërlidhjet mes Krujës dhe Elbasanit, si dy qendra me ndikim të lartë në turizëm me të gjitha qendrat e tjera të rajonit.




Fig. 21: Draft PIN Durana. Zhvillimi i Cluster-ave të kulturës e të turizmit.

Ky dokument rekomandon që të synohet zhvillimi i Cluster-ave të kulturës përmes nxitjes së bashkëpunimit mes:

Drejtorive sektoriale të kulturës në rajonin Durana, linjës së Muzeve, agjencie turistike, hoteleve, restoranteve, zhvillimit të zejtarisë dhe artizanatit, komunitetit lokal që mbart vlera të kulturës jo materiale dhe të trashëgimisë së paprekshme, organizuesve të sporteve të aventurës apo organizatave të ngjitjeve në mal dhe alpinizëm, për një rrjet të përbashkët të promovimit të turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit ekonomik.

Shembull i një potenciali të tillë zhvillimi mund të jetë Kruja me kalanë, me ansamblin e pazarit, zhvillimit të artizanatit dhe zejtarisë, linjës së muzeve, etnografik dhe historik, linjës së restoranteve, mundësi të zhvillimit të hoteleve, agjencie turistike apo sporteve të aventurës dhe eksplorimit të natyrës.

Lidhja e këtyre Cluster-ave me njëra tjetrën dhe me mundësi ndërlidhjeje me rajonin përreth, shfrytëzimi i potencialeve që ofron inovacioni i teknologjisë së informacionit përmes promovimit nga websit-et dhe aplikacioneve në “smartphone”.




Fig. 22: Draft PIN Durana. Networku i qendrave të sistemit Urban-Rural

Tokat bujqësore në rajonin e DURANES, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzetë viteve të fundit ,si pasojë e aktivitetit njerëzor të pakontrolluar.

Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementët përbërës të tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në tërësi si dhe mbi jetën njerëzore. Politikat territoriale të deritanishme nuk mundën të ruanin një zhvillim të qëndrueshëm në Sistemin e Urbanizimit Urban - Rural si pasojë e kërkesës për zhvillim në hapësira shërbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes së tokave bujqësore dhe sistemi i rezervuarëve të rajonit si dhe ndërlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore janë dëmtuar rëndë nga mungesa e mirëmbajtjes si dhe nga dëmtimet njerëzore.

Sistemi i magazinimit, përpunimit dhe ndërlidhjes të tregjeve rajonale është inekzistent si pasojë e zhvillimit të pakontrolluar dhe ndryshimit të destinacionit të përdorimit të godinave pas privatizimit të tyre në vitet 1990 . Sipërfaqet e tokave bujqësore në rajon u dëmtuan rëndë nga ndërtimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficiencën e tyre në shfrytëzim dhe përdorim si dhe duke ndryshuar statusin e përdorimit të tokës.

Nëpërmjet një qasjeje që synon konsolidimin e zonave urbane, kontrollimin e densiteteve e funksioneve, ky dokument tenton rikuperimin e sistemit bujqësor.




Fig. 23: Draft PIN Durana. Analizë e zonave të gjelbra të territorit

Ndërkohë, afërsia me zonat e mbrojtura e brezat pyjore shkon në favor të forcimit të zhvillimit të integruar turizëm-natyrë-agrobiznes.

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se nga analiza e dokumentacionit në nivel kombëtar e sektorial ka përgjithësisht një koherencë në skenarët e zhvillimit. Megjithatë Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë Krujë do të koordinojë e më pas do të pasqyrojë në nivel më të detajuar direktivat e përgjithshme që jepen në këto dokumente.

2.5 Zbatueshmëria e dokumenteve strategjik dhe planifikues

Siç konstatohet, për territorin e Bashkisë Krujë në vitet e fundit janë hartuar disa dokumente planifikimi që pasqyrojnë mundësitë e zhvillimit ekonomik në kontekstin lokal dhe rajonal. Këto dokumente gjykohen mjaft të vlefshme për t'u marrë në konsideratë kryesisht në fazën e dytë të hartimit të PPV që ka lidhje me përcaktimin e vizionit dhe objektivave të zhvillimit. Duke konsideruar edhe faktin që mjaft prej këtyre dokumente kanë kaluar në procese të gjëra konsultimesh në nivel lokal dhe qendror tregon një vlerë të shtuar të tyre në lidhje me marrjen në konsideratë të mjaft gjykimëve dhe vlerësimeve të ekspertëve të ndryshëm dhe të grupeve të interesit. Sa më sipër vlen të theksohet që të gjithë këto dokumente do jenë në fokusin tonë, për përfshirjen e tyre kryesisht gjatë procesit të hartimit të Strategjisë të zhvillimit territorial të Bashkisë Krujë pjesë integrale e PPV-së

Në lidhje Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fushë Krujë (miratuar në 2014) disa nga aspektet kryesore të analizës me fokus zhvillimin urban janë paraqitur në paragrafin 2.3. Gjithsesi zbatueshmëria dhe integrimi i propozimeve këtij plani në PPV të Bashkisë Lezhë do shikohen edhe në kontekstin e përputhjes me parashikimet dhe

direktivat e Instrumentave Kombëtar të Planifikimit (PPK, PINS për Bregdetin dhe për rajonin Tiranë Durrës) që janë në proces miratimi tashmë. Edhe përsa i përket Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Krujë (1998), megjithëse koha e hartimit të dokumentit është relativisht e largët, do të vlerësohet mundësia e integritetit të qasjeve kryesore me strategjetë dhe vizionin e PPV. Zbatueshmëria e këtij plani do të shikohet edhe në kontekstin e përputhjes me Instrumentat Kombëtar të Planifikimit dhe përputhjes me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Në përmbyllje të këtij paragrafi, vlen të theksohet që e gjithë baza e të dhënave teknike, hartografike dhe analizat karakterit social dhe ekonomik që këto dokumente planifikimi përmbajnë, kanë qenë shumë me vlerë dhe janë referuar në mjaft raste në këtë fazë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese për këto njësi administrative.

2.6 Çështje dhe zonat e rëndësisë kombëtare

2.6.1 Të përgjithshme

Bazuar në kuadrin ligjor për planifikimin e territorit, “çështje, zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit” janë ato çështje, zona dhe objekte që njësohen ose lidhen me interesa shtetërore ose kombëtarë. Zakonisht, për zonat me rëndësi kombëtare, ka akte të miratuara për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre, nga organet qendrore (ministritë dhe agjencitë) që mbulojnë sektorët përkatës.

Nga analiza territoriale e bashkisë Krujë rezulton që çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit janë:

- Infrastruktura kombëtare e transportit (rrugore, hekurudhore dhe ajrore)
- Zonat me vlera të veçanta natyrore dhe mjedisore
- Zona me vlera të veçanta arkeologjike, historike dhe të trashëgimisë kulturore

Ndër elementët më të rëndësishëm mund të përmendim:

Infrastruktura: Aeroporti Nënë Tereza, Aksi Nacional Tiranë – Shkodër (përfshirë fragmentin e Rrugës së Kombit Durrës – Morinë), hekurudha Tiranë – Shkodër.

Zonat natyrore: Parku Kombëtar i Qafë Shtamës, Kodrat e Krastës, Mali i Krujës, Monumentet e Natyrës (përshkruar në 3.2.2), Zonat natyrore kufitare si Parku i Dajtit dhe Laguna e Patokut.

Zonat historike dhe arkeologjike: Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis), Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër, Monumentet e Kulturës (përshkruar në 3.1.6.).

Në vijim të këtij materiali janë paraqitur në formë të detajuar përshkrimet për secilin nga grupimet e paraqitura më sipër të zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare shoqëruar dhe me bazën ligjore përkatëse. Gjithashtu në aneksin e hartave jepen të paraqitura grafikiisht dhe të gjeoreferencuara gjithë zonat dhe objektet të rëndësisë kombëtare për territorin e bashkisë Krujë.

Duhet patur parasysh që përveç bazës ligjore sipas së cilës mbrohen dhe menaxhohen këto zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare edhe KKT, duke

vlerësuar gjendjen ekzistuese të zhvillimeve urbane kaotike gjatë viteve të fundit, ka patur një seri vendimarrjesh për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese të tyre. Kjo me qëllim kontrollin e zhvillimit në afërsi të tyre nga pushteti lokal dhe ministrinë e linjës. Në vijim disa prej vendimeve të KKT-së:

- Vendim KKT Nr.1, dt. 8.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për brezin bregdetar”
- Vendim KKT Nr.3, dt. 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të vecantë të kurorës së Tiranës”
- Vendim KKT Nr.4 dt. 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonat me rëndësi kombëtare mjedisore”
- Vendim KKT Nr.5 dt. 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”
- Vendim KKT Nr.3 dt. 22.08.2014 “Për miratimin e nismës për përcaktimin e disa çështjeve / zonave të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”
- Vendim KKT Nr.1 dt. 9.9.2015 “Për përcaktimin dhe shpalljen si zona të rëndësisë kombëtare në planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të ministrit të kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”

2.6.2 Analiza e elementeve përjashtuese

Analiza e elementeve përjashtues merr në shqyrtim elementet që ndikojnë ose pengojnë zhvillime të caktuara në zona të ndryshme të territorit (kryesisht ndërtimin).

Për infrastrukturën, zonat e mbrojtura, elementet hidrografike etj., legjislacioni në fuqi dhe instrumentat kombëtar të planifikimit (PPK, PINS Bregdeti dhe i rajonit Tiranë-Durrës) përcaktojnë zonat përreth apo përgjatë tyre ku nuk lejohen ndërtimet e reja ose ku ndërtimet duhet të respektojnë limite të ndryshme lartësie etj.

Në vijim është bërë një përshkrim i detajuar i gjithë elementëve kryesor përjashtues bazuar në legjislacionin përkatës dhe gjithashtu në aneksin e hartave (në një hartë të veçantë), do gjeni të paraqitur grafikisht të gjithë këto parashikime që ndikojnë në zhvillimin urban përmes fashave mbrojtëse të infrastrukturave kryesore apo zonave buferike për element të veçantë territorial.

Bregdeti

Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin për të cilin, në vijim do trajtojmë në formë të detajuar synimet dhe objektivat kryesore që imaktojnë në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm zhvillimor, jep mjaft përcaktimeve për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij asemi mjaft me vlerë për vendin tonë, kryesisht në zhvillimin e turizmit. Sipas këtij instrumenti bëhet një ndarje horizontale dhe vertikale e zonës bregdetare (përcaktimi

i fashave me karakter të ndryshëm zhvillimor) dhe për secilën prej tyre jepen orientimet dhe përcaktimet bazë që duhen marrë në konsideratë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Ky instrument planifikimi shoqërohet me rregulloren përkatëse sipas të cilës parashikohet që limiti i ndërtimeve permanente nga bregdeti të jete 200 m.

Brigjet e lumenjëve dhe liqeneve

Ligji Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore (neni 4, pika 8), përcakton gjerësitë e brigjeve të deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave, pellgjeve dhe lumenjve si rripat anësorë të tokës përgjatë, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.

Infrastruktura hekurudhore

Kodi Hekurudhor, miratuar me ligjin nr.9317, dt. 18.11.2004, në përcaktimet e tij (neni 3, pika 11) përkufizon "Brezin e vijës hekurudhore" si toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese. Në vazhdim (pika 12, në po të njëjtin nen), përcakton "Brezin mbrojtës të vijës hekurudhore" si brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit hekurudhor.

Infrastruktura rrugore

Sipas VKM nr.153 date 07/04/2000 "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se, sipas kategorive të ndryshme të rrugëve, brezat e rezervuara jashtë qendrave të banuara që duhen respektuar për ndërtimet e reja apo zgjerimet e zonave urbane, nuk mund të jene me pak se:

- a) 60 m për rrugët e tipit A
- b) 40 m për rrugët e tipit B
- c) 30 m për rrugët e tipit C
- d) 20 m për rrugët e tipit F

Ndërsa largësitë nga kufiri rrugor në brendësi të qendrave të banuara që duhen respektuar për ndërtimet e reja, në rindërtimet apo në zgjerimet përballë rrugës, nuk mund të jene me pak se:

- a) 30 m për rrugët e tipit A
- b) 20 m për rrugët e tipit D

Infrastruktura e energjisë elektrike

Infrastruktura e energjisë elektrike dhe kryesisht linjat e tensionit të lartë janë një tjetër element përjashtues që duhet marrë në konsideratë pasi gjatë ndërtimit të banesave apo zgjerimit të zonave urbane duhet ruajtur doemos një distancë sigurie. Kjo distance përcaktohet me VKM të vitit 1978, në "Normat Teknike të Projektimit" ne librin "VI KTP 17, 18, 19" – 1978.

Në pikën 11.2 parashikohen largësitë horizontale nga përcjellësit anësorë të linjës ajrore (ne pozicionin e pamënjanuar) deri në pjesët e dala të godinave të veçuara, jo më të vogla se:

- 10m – për linjat 6-10 KV
- 15m – për linjat 35 KV
- 20m – për linjat 110 KV
- 25m – për linjat 150-220 KV
- 30m – për linjat 330 KV

Ne pikën 12.6 parashikohen largësitë horizontale nga përcjellësit anësorë të linjës ajrore, jo me të vogla se:

- 2m – për linjat 6-10 KV
- 4m – për linjat 35 KV
- 5m – për linjat 110 KV
- 6m – për linjat 150-220 KV
- 8m – për linjat 330 KV

Përsa i përket linjës së inter-koneksionit Tiranë Podgoricë (400kV) duhet të themi që gjatë procesit të ndërtimit të saj, gradualisht qeveria shqiptare ka bërë edhe shpronësimet përkatëse duke formuar kështu një fashë të rezervuar për kalimin e saj. Gjithashtu, duke patur parasysh që tashmë rrjeti kombëtar i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike është lidhur dhe është pjesë e një rrjeti më të gjërë ballkanik-rajonar dhe si rrejdhim përveç kësaj rregulloreje duhen respektuar edhe parashikimet e normave ndërkombëtare në këtë aspekt.

Varrezat

Sipas VKM Nr. 712, dt. 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"" jepen normat dhe rregullat e projektimit, të çdo elementi përbërës të varrezave, për ndërtimin dhe funksionimin e tyre. Sipa percaktimeve të kësaj rregulloreje, territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Zona e rezervuar përcakton distancën minimale nga kufiri i fushës së varrimit deri tek kufiri i

zonës së banuar ekzistuese, ose të planifikuar në planet e përgjithshme vendore të bashkive përkatëse. Zona e rezervuar konsiston në një sipërfaqe të mbjellë me drurë dhe gjelbërime, ku nuk lejohet ndërtimi i objekteve të reja, apo zgjerimi i atyre ekzistuese. Në të mund të parashikohet vetëm ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Distancat që duhen respektuar janë:

- për qendrat e banuara, me popullsi > 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100m,
- për qendrat e banuara me popullsi < 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 m.

Gjithashtu në VKM nr.671, date 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Kreu IV - Standarde dhe tregues planifikimi, (seksioni 2 dhe 3), parashikohen një seri rregullash dhe specifikimesh për përcaktimin e fashëve dhe zonave buferike për element të ndryshëm territorial. Këto norma dhe përcaktime, pavarësisht se nuk janë paraqitur këtu, do konsiderohen rigorozisht në procesin hartimit të PPV-së bashkisë Krujë.

Në këtë dokument të analizës së territorit të bashkisë Krujë, janë trajtuar edhe disa nga rreziqet kryesore (natyrore) të cilat ndikojnë si në gjendjen ekzistuese të zonave urbane ashtu edhe në procesin e planifikimit. Ndër ato më me ndikim përmendim, rreziku hidrologjik (përmytjet), aktiviteti sizmik (tërmetet), rrëshqitjet e tokave etj. Harta të veçanta “tematike” janë përgatitur për secilin nga këto rreziqe natyrore të cilat direkt ose indirekt përfaqësojnë element përjashtues të zhvillimit urban. Gjithsesi duhet theksuar që zhvillimi në këto zona nuk është i pamundur por kostoja e ndërtimeve dhe e urbanizimit rritet ndjeshëm duke patur parasysh faktin që gjatë projektimit dhe procesit të ndërtimit duhen marrë masa shtesë për zbutjen e rrezikut përkatës që cënon cilësinë e jetës së banorëve dhe shërbimet bazë të nevojshme.

3 Skanimi i territorit dhe vlerësimi

3.1 Vështrim i përgjithshëm

Bashkia e Krujës gjendet në pjesën veriore të Shqipërisë së mesme. Shtrihet midis kodrave të Ishmit, fushave të Kamzës, malit të Dajtit, zonës së Mnerit, Qafë-Shtamës, malit Skënderbej dhe zones së Kurbinit. Kufizohet me bashkinë Kurbin, Durrës, Vorë, Kamëz, Tiranë edhe Mat. Relievi i zonës paraqet një mozaik formash dhe tipologjish me lartësi që zbresin gradualisht në drejtimin lindje-perëndim. Zona fushore shtrihet në perëndim midis kodrave të Ishmit e Prezës, Tapizës, Krastës dhe Krujës. Zona kodrinore ka një lartësi 100-300 m lartësi mbi nivelin e detit. Zona malore përbëhet nga dy vargje paralele me drejtim veri-perëndim dhe jug-lindje. Vargu Krujë-Dajt dhe vargu Skenderbej (maja e Liqenit që është dhe maja më e lartë e bashkisë Krujë). Bashkia ka si qendër qytetin Krujë që shtrihet në faqen perëndimore të malit të Krujës me një lartësi 600 m mbi nivelin e detit. Mali i Krujës ka lartësinë 1127 m.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Në territorin e bashkisë Krujë gjenden dy qytete (Krujë dhe Fushë-Krujë) dhe 50 fshatra. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Krujë të Qarkut Durrës.

Tabela 3: Njësiti administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara

Bashkia	Njësiti administrative	Nr. Zonave urbane	Qytetet dhe Fshatrat
Bashkia Krujë	Krujë	(1) Qytet (3) Fshatra	Qytet: Krujë Fshatrat: Barkanesh, Picërragë, Brret
	Fushë - Krujë	(1) Qytet (11) Fshatra	Qytet: Fushë Krujë Fshatrat: Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2
	Bubq	(7) Fshatra	Fshatrat: Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë – Madhe, Mazhë – Vogël, Mallkuç, Murqinë
	Nikël	(9) Fshatra	Fshatrat: Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
	Thumanë	(10) Fshatra	Fshatrat: Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër
	Cudhi	(10) Fshatra	Fshatrat: Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi –Kant, Kroj Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë
Total	6 Njësi administrative	52 zona urbane	

Gjeografikisht Bashkia Krujë, pas reformës territoriale, kufizohet në veri me Bashkinë e Kurbinit, në perëndim me Bashkinë Durrës, në lindje me Bashkitë e Mat dhe Klos dhe në jug me Bashkitë Kamëz dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krujës. Sipërfaqja e territorit të bashkisë është 339.02 km².



Fig. 24: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Krujë

Bazuar në të dhënat e Regjistrimit Civil, kjo bashki ka një popullsi 79.608 banorë. Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Bashkinë Krujë rezulton 59.814 banorë. Kryesisht pjesa e ultësirës së bashkisë Krujë në 20 vitet e fundit ka pasur një tendencë rritje, kryesisht nga levizjet mekanike, popullsi e ardhur nga zonat e thella e veri-perendimore të vendit. Sa më sipër densiteti i popullsisë në tërësi për territorin e Bashkisë Krujë rezulton 234.81 banorë/km².

Më poshtë janë treguar distancat e qytetit të Krujës nga qendrat administrative kryesore të vendit dhe rajonit:

- 31 km nga Tirana
- 18 km nga Aeroporti Rinasit (brenda territorit të Bashkisë Krujë)
- 44 km nga Durrësi (Porti i Durrësit)
- 140 km nga Podgorica
- 233 km nga Prishtina
- 48 km nga Porti i Shëngjinit
- 155 km nga Porti i Vloës




Fig. 25: Njësitë administrative të Bashkisë Krujë

Bashkia Krujë shtrihet në një terren të përzierë fushor dhe malor. Ajo shtrihet në Ultësirën Perëndimore jo larg bregdetit dhe ndodhet në një pozitë të favorshme në pjesën qendrore të vendit, shumë afër kryeqytetit. Pozita gjeografike rajonale e Krujës është mjaft e favorshme për zhvillimet ekonomiko-shoqërore. Territori përshkohet nga tre arterie të rëndësishme komunikacioni: korridori Veri – Jug, që lidh Shkodrën me Tiranën dhe me Gjirokastrën, korridorin Durrës – Kukës si dhe linja hekurudhore Durrës – Shkodër.

Në zonën fushore disponon rezerva të konsiderueshme të gurit gëlqeror, gjë që ka sjellë ndërtimin e disa fabrikave të çimentos si dhe shumë punishteve të prodhimit të gëlqeres, industri të cilat kanë ndikim të madh negativ në mjedis duke qenë ndër industritë më ndotëse në vend.

Ndryshe nga zona fushore, qyteti i Krujës, Mali i Krujës dhe Parku Kombëtar i Qafë Shtamës ofrojnë resurse të konsiderueshme të turizmit kulturor, malor, fetar dhe shëndetësor, (Ilixhat në fshatin Bilaj).

Qyteti i Krujës me kështjellën mesjetare, pazarin e vjetër, muzeun etnografik dhe muzeun kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” është ndoshta vendi më i vizituar turistik në Shqipëri ndërsa turizmi ka sjellë edhe ruajtjen e traditës së artizanatit në disa zeje të kufizuara në Pazarin e Krujës.

Statistika të sakta mbi vizitorët e qytetit nuk ka, por ajo çka është e dukshme, bazuar edhe në atë çka tregtarët e Pazarit të Vjetër thonë, numri shkon në qindra mijëra turistë

në vit. Shifrat zyrtare të marra nga Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastriot Skënderbeu” vitin e shkuar, flasin për rreth 25.100 vizitorë. Ky fluks është më i madh gjatë periudhës maj-qershor me rreth 15.000 vizitorë.

Një vend mjaft i frekuentuar është edhe Mali i Krujës me teqenë e Sari Salltëkut. Ky vend i shenjtë i besimit bektashi vizitohet nga shumë besimtarë nga e gjithë Shqipëria, po ashtu dhe nga turistë të huaj. Kulmi i vizitorëve dhe pelegrinëve arrin në ditën e Hashures, ditën e Sulltan Nevruzit me 22 mars dhe ditën e Malit më 25 gusht të çdo viti, ku mijëra pelegrinë dhe turistë vizitojnë këtë vend të shenjtë. Mendohet se ky vend vizitohet nga rreth 200 000 turistë dhe besimtarë në vit.

Të dyja qytetet, Kruja dhe Fushë-Kruja, kanë si burime kryesore punësimi industrinë e veshjeve dhe këpucëve ndërsa qyteti i Fushë-Krujës siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave edhe nga fabrika e çimentos dhe shfrytëzimi i gurit gëlqeror. Zona e Niklës gjithashtu është e njohur për zhvillimin e industrisë të drurit dhe mobilerisë.

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve të qytetit të Krujës është ndërtuar disa vite më parë, përfshirë kanalet kulluese për shirat e furishëm që përplasen herë pas here në Malin e Krujës. Situata është krejt e kundërta në qytetin e Fushë-Krujës si dhe në zonat rurale.

Furnizimi me ujë është me orar të reduktuar, ndërsa zona bujqësore është e rrezikuar vazhdimisht nga përmytjet dhe ka nevojë për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese e vaditëse.



Fig. 26: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Krujë

3.1.1 Topografia dhe klima;

Bashkia Krujë shtrihet në koordinata gjeografike: gjerësi gjeografike 41°35'35" në Veri, 41°24'00" në Jug, gjatësi gjeografike 41°24'00" në Lindje 19°55'09" dhe 19°35'45" në perendim. Pozita gjeografike rajonale është mjaft e favorshme për zhvillimet ekonomiko-shoqërore. Përshkohet nga tre arterie të rëndësishme komunikacioni: korridori Veri – Jug, që lidh Shkodrën me Tiranën dhe me Gjirokastrën, korridorin Durrës – Kukës si dhe linja hekurudhore Durrës – Shkodër. Bashkia Krujë ka 52 qendra të banuara të organizuara në 6 njësi administrative. Dy vendbanimet kryesore janë qyteti i Fushë Krujës dhe ai i Krujës.

Në qendër të territorit të bashkisë ndodhet qyteti i Fushë Krujës i cili ndodhet në Lindje të fushës Lezhë-Tiranë në një lartësi 30 m mbi nivelin e detit. Në VL dhe L jo shumë larg qytetit janë kodrat e Krastës që shfrytëzohen prej vitesh nga qyteti si gurore. Kodrat ngrihen gradualisht në lartësi deri në qytetin e Krujës dhe në vargmalet e Skënderbeut. Në J dhe P shtrihen fushat bujqësore të luginës së lumit Ishëm. Fushë Kruja ndodhet në kryqëzimin e korridorit të komunikimit Veri – Jug, një korridor që ka ekzistuar historikisht, me rrugën që lidh Krujën me Durrësin dhe Tiranën.

Nga pikepamja morfologjike, rajoni i studimit ndahet në tre zona, lehtësisht të dallueshme si në terren ashtu edhe në hartën topografike.

- a. Zona fushore
- b. Zona kodrinore
- c. Zona Malore

a – Zona fushore zë gjysmën e territorit të studiuar. Ajo gjendet në pjesën qendrore dhe perëndimore të rajonit, duke filluar që nga kufiri perëndimor i rajonit të studimit (lumi i Gjoles) e deri në lagjen Loc të fshatit Arameras dhe lagjen Tale të Fushë Krujës. Kjo fushë është modeluar nga veprimtaria gjeologjike e lumit të Zezës dhe e lumit të Gjoles.

b – Zona kodrinore zë pjesën qendrore të territorit të bashkisë dhe fillon që nga lagja Loc e fshatit Arameras dhe lagja Tale e Fushë Krujës e për të vazhduar më në lindje ne drejtim të Makareshit, Zgërdheshit dhe fshatit Zezë. Këto ngritje kodrinore kanë forma të rumbullakuara dhe janë pjesa më panoramike e zonës së studimit. Ato ngrihen në formë ballkonesh natyrore mbi zonën fushore dhe kanë si sfond ngritjet e menjehershme të terrenit, në drejtim të lindjes. Kuotat e kësaj zone luhaten nga 50 deri 400 m mbi nivelin e detit. Shpatet e këtyre kodrave bien në drejtime të ndryshme, kjo në varësi të drejtimit të rrjedhes së përrrenjve mbi të cilët ato ngrihen. Këndet e rënies së shpateve kanë vlera 5 deri 100.

b – Zona malore shtrihet në lindje të qytetit të Krujës dhe përbëhet nga terren malor me zona peizazhistike. Pjesë e kësaj zone është edhe parku kombëtar i Qafë Shtamës. Kjo zonë shtrihet në një lartësi nga 400 deri në 1400 m mbi nivelin e detit. Mali i Skënderbeut ndodhet në kufirin midis rrethit të Krujës dhe atij të Matit me lartësinë më të madhe 1724 m (Maja e Liqenit). Shtrihet nga lugina e lumit të Matit në

veri dhe deri te Qafa e Shtamës në jug, me gjatësi 22 km e gjerësi 2-5 km. Bën pjesë në Vargmalet Perëndimore. Relievi është shumë i copëtuar nga përrenjtë, degë të lumit të Matit dhe të Ishmit. Shpatet janë të rrëpirëta, kurse relievi i valëzuar, vende-vende me forma akullnajore e karstike. Në anën verilindore, rreth 200 m poshtë majës më të lartë gjenden dy liqene të vogla akullnajore, që i kanë dhënë emrin edhe majës. Mali është i veshur me bimësi të dendur.

Zona e Krujës përfshihet në nënzonën Klimatike Mesdhetare Fushore Qëndrore dhe në atë Mesdhetare Kodrinore Qëndrore. Në këtë nënzonë reshjet vjetore kanë vlera që lëkundën ndërmjet 950 dhe 1200mm.

Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vëroqtohen temperatura më të ulta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 në vit, gjatë të cilave vlera e temperaturës minimale mund të bjerë nën 0°C. Erërat, në përgjithësi fryjnë nga dy drejtime. Gjatë stinës së ftohtë mbizotërojnë erërat nga juglindja dhe veriu ndërsa gjatë periudhës së ngrohtë ato që vijnë nga drejtimi veriperëndim. Shpejtësitë maksimale të erës në këtë zonë gjatë stinës së ngrohtë marrin vlera nga 10 deri 15 m/s dhe gjatë stinës së ftohtë prej 25 deri 30m/s.




Fig. 27: Harta e zonave klimatike

Diellzimi

Në vijim jepen vlerat e diellzimit mesatar mujor në orë për stacionin e Krujës. Nga këto të dhëna duket se vlerat maksimale të diellzimit vëroqtohen në muajin Korrik ndërsa ato më të ulta në Dhjetor. Vlera mesatare vjetore e diellzimit është 2613 ore, vlerë kjo mjaft e lartë për rajonin tonë.




Fig. 28: Diellzimi mujor në orë

Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit është një element i rëndësishëm klimatik i cili shpreh madhësinë e energjisë diellore në afërsi të tokës. Në vijim jepen temperaturat mesare mujore dhe shpërndarja e tyre brenda vjetore. Nga këto të dhëna mund të konstatohet se vlerat me të larta të temperaturës mesatare mujore arrihen në Korrik (23.4 °C) dhe vlera me ulët në muajin Janar (6.5 °C). Vlera mesatare vjetore është 14.9 °C.

Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vërehen temperatura më të ulta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 në vit, gjatë të cilave vlera e temperaturës minimale mund të bjerë nën 0°C.

Për sa i përket temperaturave maksimale absolute vlerat e tyre rrallë herë e kalojnë vlerën 35-36 0°C. Vlera me e lartë e temperaturës maksimale absolute është 39. 0°C.

Temp °C




Fig. 29: Temperaturat mesatare mujore. Stacioni Krujë




Fig. 30: Harta e temperaturave mesatare vjetore

Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë një element tjetër klimatik i rëndësishëm. Në vijim jepen vlerat e sasive mesatare mujore të shirave për një vit mesatar dhe paraqitja grafike e shpërndarjes së tyre gjatë vitit. Nga këto të dhëna mund të shihet se vlerat mesatare më të larta arrihen në muajt e dimrit ndërsa më të ulta në muajin Korrik. Sasia mesatare e reshjeve vjetore ka vlerën 1802 mm.

Numri i ditëve me reshje më të mëdha se 0.1 mm lëkundet ndërmjet 87 dhe 103 ditëve. Në përgjithësi reshjet maksimale në këtë zonë rrallë herë bien në formë rrebeshi.

Shtresa maksimale e borës arin vlerën 10-20 cm dhe shumë rrallë 25-35 cm, dhe këto të paqëndrueshme.




Fig. 31: Reshjet mesatare mujore. Stacioni Krujë

Lagështia e ajrit

Lagështia e ajrit është gjithashtu një element i rëndësishëm klimatik. Në vijim jepen vlerat mesatare mujore të lagështisë relative të ajrit. Nga të dhënat vërehet se vlerat më të larta të lagështisë relative të ajrit vërohen në muajt e dimrit (78-79%), ndërsa vlerat minimale në stinën e verës (73-74 %).




Fig. 32: Lagështia mesatare mujore. Krujë

Era

Era në zonën në studim fryn përgjithësisht nga dy drejtime. Gjatë gjysmës së ftohtë mbizotëron veriperëndimi dhe në gjysmën e ngrohtë mbizotëron jugperëndimi. Shpejtësitë e erës në zonën në studim kanë vlera mesatare.

Në vijim jepen shpejtësitë mesatare të erës për çdo drejtim dhe harta e trëndafilave të erërave që jep pikërisht paraqitjen grafike të shpërndarjes së erërave sipas drejtimeve. Vihet re se shpejtësitë më të mëdha të erës i takojnë drejtimeve V, J dhe JL.




Fig. 33: Harta e trëndafilave të erës

Tabela 4: Shpejtësitë mesatare të erës sipas drejtimeve

Drejtimi	Qetësi	V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
Rastisja(%)	51.8	14.5	5.6	4.1	14.2	6.8	5.1	1.7	6.8

Për sa i përket shpejtësisë maksimale të vërtetuar të erës në këtë zonë ajo merr vlera nga 24-28 m/s.

3.1.2 Gjeologjia inxhinierike;

Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre

Territori i Bashkisë Krujë ndërtohet nga shkëmbinj dhe dhera të moshave gjeologjike nga Triasiku deri në Kuaternar që i përkasin zonës tektono faciale “Mirdita”, Nenzonës “Krasta”, zonës “Kruja” dhe “Ultësirës Pranë Adriatike”(UPA).

Klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierike jepet në tabelen 5 dhe është bërë sipas Prof.Dr. N. Konomi me adoptime të inxh. I. Gjeta (2002) dhe plotësime të inxh. M. Lamaj (2014).

Në këtë klasifikim shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

1. shkëmbinj të fortë;
2. shkëmbinj mesatare;
3. shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (R_{sh}).

Ndërsa dherat janë klasifikuar në tre grupe:

1. dhera pa lidhje kohezionale
2. dhera me lidhje kohezionale
3. dhera me veti të veçanta

Kriteret e ndarjes së dherave, janë: kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm (ϕ).

Më poshtë për secilën kategori (të shkëmbinjeve dhe dhereve) është bërë një përshkrim i shkurtër mbi pozicionin e tyre në lidhje me zonat tektoniko – faciale të përmendura më sipër dhe karakteristikat bazë fiziko mekanike.

A - Shkëmbinjtë e fortë. Rezistenca në shtypje një boshtore (R_{sh}) >500 bar. Në hartë janë paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Në këtë grup hyjnë :

Gëlqeroret (G). Gjejnë përhapje në zonat tektoniko - faciale “Mirdita”, N/z. “Krasta” dhe zona “Kruja” nga Triasiku i mesëm deri Eocen.

Në zonën “Mirdita” takohen: depozitimet karbonatike ($T_3 - J_1$) dhe ato të Cr_1 e Cr_2 .

Depozitimet ($T_3 - J_1$) përhapen në perëndim të Rubikut, në Velën e Vendit -Qafe-Kinxhël. Janë facie gëlqerorësh neritike algore, shtresë trashë deri masivë, kryesisht ngjyrë gri, gri të bardhë. Në Lisnë e Spitën në kreun e prerjes, mbi gëlqeroret me megalodonte takohet një pako 30-50 m e trashë e gëlqerorëve biomikritike krinoidale, shtresë mesëm, hiri dhe rozë, që përmbajnë dhe mjaft foraminifere (Shtjefanaku D etj, 2005).

Gëlqerorët e Cr_1 e Cr_2 përhapen në sektorët lindore nga Lufajt deri në Xhuxhë dhe ndërtojnë kuotat më të larta të relievit si Mali i Valmorit, Mali i Shenjtit, Maja e Zebës

etj. Janë gëlqerorë shtresëhollë - trashë deri masivë. Në sipërfaqe janë të copëtuar e me çarje në trajtë blloqesh. Fenomeni i karstit është shumë i përhapur në to, në sipërfaqe vërehen hinka e gropa karstike, ndërsa përgjate shpateve të thepisura të tyre takohen shpella karstike.

Në N/zonën “Kраста” depozitimet e Kretakut të sipërm (Cr2) përhapen në trajtën e dy pakove gëlqerore: ajo e poshtëme kryesisht pelitomorfe shtresë trashë dhe e sipërme shtrese hollë. Janë me ngjyrë gri, gri të çelët në rozë, me trashësi 45 - 50 cm. Takohen në lindje të Raboshtes (m. Mërqies), Manati, (m. Fecores), Pllanë, Milot, M. Shëngjergjit.

Në zonën “Kruja” përfaqësohen nga depozitimet e Kretakut të sipërm (Cr2) dhe të Eocenit (Pg2). Depozitimet e (Cr2) takohen veriperëndim të territorit, në malin e Kakarriqit dhe atë të Rencit, në jug në afërsi të Mamurrasit dhe në lindje të Laçit (në formën e një brezi nga Miloti deri në lindje të Mamurrasit). Përfaqësohen nga gëlqerorë, gëlqerorë të dolomitizuar dhe dolomite të mirefillta.

Depozitimet karbonatike të Eocenit (Pg2). Shtrihen në formën e një brezi që markon gëlqerorët e Kretakut të sipërm, në verilindje të kurrizores së Rencit, në të dy krahët e kurrizores së Kakarriqit dhe në lindje të Mamurrasit. Ndërtohen nga dy pako gëlqerorësh: pakoja e gëlqerorëve miliolidike dhe pakoja e gëlqerorëve me numulites e diskociklina.

Gëlqerorët silicore (Gsi). Gjejnë përhapje në zonën tektono - faciale “Mirdita” dhe N/zonën “Kраста”. Në zonën “Mirdita” përfaqësohen nga seria karbonato-silicore (T₂) gëlqerorë të kuq nyjorë, gëlqerorë pllakorë me silicorë. Takohen në trajtë bllokore nga përroji i Katundit të vjetër deri në majën e Drenit dhe në Ferr-Shkopet. Në N/zonën “Kраста” përfaqësohen nga depozitimet karbonatike Jurasike (J), gëlqerorë masive kristalinë e pelitomor ngjyrë gri e deri në rozë të çelur. Janë shkëmbinj mikritikë me damarë kalciti dhe me stiliotite. Trashësia e tyre shkon 25-30 m. Takohen në daljen e Spitën Zejmenit.

Formacioni ofiolitik i Mirditës (J₂), ku marrin pjesë: shkëmbinjtë intruzivë magmatikë ultrabazikë (lu), shkëmbinjtë magmatikë bazikë (lb), shkëmbinjtë magmatikë mesataroacidë (lma), shkëmbinjtë efuzivë magmatikë bazikë (Eb), shkëmbinjtë efuzivë magmatikë mesataroacidë (Ema). Skaj më perëndimor i përhapjes së ofioliteve është nga Krajani(m. Pilinardes) , maja e Potit, Reja e Velës, Qafë Sul, Fang deri në Ferr- Shkopet, ndërsa në lindje nga Thirra (m. e Runës) në Përlat i Epër dhe përrojin e Urakës në veri të fshatit Prell.

Shkëmbinjtë metamorfike rreshpore (Rm). Përfaqësohen nga shtroja metamorfike (μ_sJ₂) (amfibolite, paragnejse, rreshpe kuarc-mikore). Kanë përhapje mjaft të kufizuar në trajtën e daljeve të vogla në kontaktin e serisë efuzivo sedimentare me shkëmbinjtë ultrabazikë e më pak me pakon argjilite me copa. Takohen në zonën ndërmjet Kallmetit të Madh dhe Fregën si dhe në veri të Rejës së Velës.

Tabela 5: Klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierike i shkëmbinjëve dhe dherave

60

B - Shkëmbinjtë mesatare. Rsh 50 - 500 bar. Në hartë ngjyrosen me ngjyrë manushaqe.

Shkëmbinjtë flishore dhe ato me pamje flishore (F1) në zonën “Mirdita” përfaqësohen nga Melanzhi Mirdita “bloqe në matriks” (J_3), depozitimet terrigjene karbonatike të flishit të hershëm (J_{3t} - Cr_{1v}).

Melanzhi Mirdita “bloqe në matriks” është njësi litostratigrafike me përbërje mjaft heterogjene. Zhvillohet thujse në të gjithë rajonin duke mbushur depresionet erozionalo-tektonike nga Fangu - Qafë-Munaz - Velë - Qafë - Kinxhël, Gëziq-Shtanë - Rreshen, Tarazh-Perlat i Epër - Lëkundë-Bardhaj, Malaj - Kullaxhi- Blinisht, Kodër Spaç, Gurth-Mushtë, Simon etj. Ndërtohet nga rreshpe argjilitesh, argjilo silicore si dhe copra apo bloqe gëlqerorësh, ofikalcitesh, ranorësh, ofiolitesh (vulkanitesh) etj. Matriksi argjilor ka ngjyrë gri, gri të gjelbër, gri të errët. Copat përfaqësohen kryesisht nga ranorë arkozike, grauvake, silicorë radiolaritike dhe bazalte.

Në depozitimet e flishit të hershëm (J_{3t} - Cr_{1v}) veçohen dy trashësi litofaciale: a - konglobrekçiet ofiolitike dhe b - flishi i hershëm në bashkëshoqërim në përhapje dhe ekuivalence moshore me njëra tjetrën:

a - konglobrekçiet ofiolitike përhapen në Kurbnesh (Kumbull, Bisakë, Xhuxhë, Munellë) etj, në përbërje të tyre mbizotërojnë përbërësit ofiolitike. Përveç tyre takohen edhe copra e thjerza silicori radiolaritik, gëlqerorë biomikritik etj.

b - flishi i hershëm përhapet në Katundin e Vjetër, Derven, Kurbnesh dhe dalje më të kufizuara takohen në Tarazh dhe Perlat (Lekgegaj). Ai ndërtohet nga ndërshtresa mergelore, reshpe argjilo silicore, gëlqerorë e konglomerate.

N/ zona Krasta përfaqësohet nga depozitimet flishore të aptian-albianit (Cr_1), (Pg_{1-2}), (Cr_{2m}) dhe (Cr_{2m} - Pg_{1-2}).

Depozitimet flishore të aptian-albianit (Cr_1) takohen me dy pako: paketa e flishit gri alevrolito - mergelore - gëlqerorë - ranorë dhe paketa e flishit të kuq alevrolito - mergelore. E para përbëhet nga gëlqerorë pllakorë, mergele alevrolite e ranorë kompakt. Flishi me ngjyrë të kuqe përfaqësohet nga një ndërthurje ritëmhollë alevrolito-mergelore - gëlqerore. Takohet në rajonin Fang - Katund i Vjetër.

Depozitimet flishore të (Cr_{2m}), në pjesën e poshtme përfaqësohen nga ndërthurje gëlqerorësh mikritikë, kristalikë e rrallë copëzorë, mergelesh, alevrolitesh, rrallë ranorë, më lart prerja bëhet ranoro - alevrolitore me shtresa mergelesh, me ndonjë shtresë të rrallë gëlqerori. Trashësia, disa metra deri 15 - 20 m. Takohen në Kallmet, Manati, Zejmen, Bërzanë, Milot, Selitë deri në Mafsheq, gjithkund në kontakt me depozitimet e (Pg_{1-2}).

Depozitimet flishore të (Cr_{2m} - Pg_{1-2}), janë kryesisht ndërthurje flishore alevrolite-ranore me horizonte vithithëse konglomeratike. Këto të fundit kanë ndërtim të çrregullt ku masa kryesore përbëhet nga alevrolite e ranorë. Formacionet e kësaj nënzona takohen në pjesën jugperëndimore e perëndimore të Mirditës nga Vinjolli, Gallata, Skuraj, Rrasfiku, Katundi i Vjetër e Kallmeti në veriperëndim.

Depozitimet flishore të Paleocen-Eocenit (Pg_{1-2}) përfaqësojnë një trashësi flishore potente me ndërthurje alevrolitesh e ranorësh midis të cilave gjenden horizonte vithithëse me olistolite e konglomerate. Mergelet janë të rralla në prerje e kanë natyrë linzore e rrallë shtresore, ngjyrë rozë dhe thyerje karakteristike guackore. Gëlqerorët copëzorë janë të rrallë dhe paraqiten mjaft kompakt të ndërtuara nga copra karbonatesh me madhësi të ndryshme e matriks të së njëjtës përbërje. Horizontet vithithëse kanë ndryshim litologjik gjatë shtrirjes (ndërtim të çrregullt), ku masa kryesore është alevrolito - ranorike. Në nivelet më të sipërme të prerjes gjenden horizonte potente konglomeratesh. Takohen nga Fishta në veri e deri në Mafsheq në jug, në trajtën e një brezi me gjerësi mbi 2 km në zonën qendrore të perhapjes (Rasfik - Skuraj) dhe me ngushtime drejt Fishtës e Mafsheqit.

Në zonën “Kruja” përfaqësohen nga depozitimet flishore të Oligocenit të Poshtëm (Pg_{31}). Depozitimet flishore (Pg_{31}), në zonën e studimit përfaqësohen me dy pako:

- Paketa e flishit ranoro - argjilor (Pg_{31b}) ndërthurje ranorësh shtresëtrashë deri në masivë gravelitikë me ndërshtresa argjilore
- Paketa argjilore me ndërshtresa të ralla ranore (Pg_{31c}) Ajo përbën bërthamën e strukturës sinklinale të “Krujës”.

Ato përhapen në pjesën veriperëndimore, në afërsi të ranës së hedhur, në jugperëndim të kurrizores së Rencit dhe pranë fshatit Torovicë. Në zonën e Milot - Laç - Mamurrasit, këto depozitime takohen në dy breza : brezi lindor shtrihet në jug të Malit të Bardhë, Delbnisht (Kamera), Lester, Mafsheq (Shezë) deri në përrojin e Grykë Shkozës ; brezi perëndimor shtrihet nga Laçi, Gjomëni, Shëmria deri në afërsi të lumit të Drojës (Picrragë), (Lamaj M etj.2009).

Seria efuzivo - sedimentare (Es) përfaqësohet nga depozitimet e (T_2-J_1) në zonën “Mirdita”, ku bazaltet janë përfaqësuesit kryesorë të trashësisë vullkanogjene, më pak ndeshen hialobazaltet e variolitet. Brenda kësaj trashësie zhvillohen rreshtet argjilore, argjilo-silcore, tufet, radiolaritet, gëlqerorët biomikritik e linza ranorësh. Shtrihen nga Munazi, Rubiku ,Vela e më në veri deri në Qaf - Kingjël, në veri të Rrejës - Fregën-Rrasi i butë.

Mollasa argjilore (Ma) këtu përfshihen formacionet e zonës “Kruja” me depozitimet e Pliocenit, suita “Helmësi”(N_{21h}).

Depozitimet e kësaj suite përfaqësohen në prerje nga ndërthurje ranorësh gravelitikë me ranoro - alevrolitorë dhe më sipër vendosen alevrolito - argjilat tipike të kësaj suite me ngjyrë të kaltër e masive. Brënda zonës sonë të studimit kanë trashësi deri 40 m (Shullaz). Kanë përhapje të kufizuar. Ndeshen në vendin e quajtur kodra e Shullazit dhe në perëndim (Laç - Gurra), në kodrat e Mamurrasit, në Shpërdhet dhe kordat përreth. Mbivendosen në menyre transgresive mbi gëlqerorët e Kretakut të sipërm dhe flishin Kruja (Lamaj M etj.2009).

Mollasat ranoro-konglomeratike (Mrk), përfshihen depozitimet Mollasike të Tortonianit (N_{13}), të Pliocenit (N_2), e ato të Pliocen - Pleistocenit ($N_2 - Qp$).

Depozitimet mollasike të (N_{13}). Në bazament takohen konglomeratët bazalë kokërr trashë që zbulohen në sipërfaqe me trashësi deri 20 m. Coprat konglomeratike janë të përbërjes gëlqerore, ranore dhe magmatike.

Duke ja lënë vendin më sipër në prerje konglomerateve më kokërrimët deri sa kalohet në ranorë kuarcorë kokër imët deri kokër mesëm. Kjo prerje e depozitimeve Tortoniane në kodrën e Kullës arrin trashësinë deri 60 m. Vazhdimi në shtrirje e rënie nuk vërehet për arsye të proçeseve errozivo - denuduese, dhe akoma më në perëndim është e mbuluar nga depozitimet mbulesore të Kuaternarit. Në sipërfaqe dalin në formë pulle transgresive në vendin e quajtur kodra e Kullës në lindje të ish kombinatit Kimiko – metalugjik (Laç), në Selitë (Kuqni) në kontaktin e depozitimeve karbonatike të Cr_2 me flishin e Oligocenit (Pg_{31}).

Depozitimet mollasike të Pliocenit (N_2). Përfaqësojnë vazhdimin VP depozitimeve të gropës së Burrelit (pjesa e sipërme e prerjes). Vendosen transgresivisht mbi melanzhin “blloqe në matriks” dhe përfaqësohen nga ndërthurje ranorësh me argjila e ndërshtresa konglomeratesh. Kanë trajtë shtresore-linzore me rënie të butë deri 20° dhe karakterizohen nga ndryshime faciale. Përbërësit copëzore janë copa gabrosh, ultrabazikësh, vullkanitesh, kuarcitesh, gëlqerorë e silicorë. Shkalla e çimentimit është e ndryshueshme nga e dobët deri e lartë. Trashësia e këtyre formacioneve në qendër të tyre shkon deri në 150 m. Takohen në pjesën qendrore- jugore të rajonit të qarkut, si në Ujëstrez, Prosek, Përlat Qendër, Tarazh, Rrëshen deri në Ndërfushaz.

Depozitimet mollasike të Pliocen-Kuaternarit (N_2-Qp). Takohen në pjesën qendrore-veriperëndimore të qarkut, në Rasin e Butë (VP i Ungrejtë dhe JL të Kalivaçit). Vendosen në pjesët e ulëta të relievit, në mënyrë transgresive mbi vullkanitet, gabrot e ultrabazikët. Përfaqësohen nga ndërthurje konglomeratesh e ranorësh me ndërshtresa argjilore, me shkallë relativisht të ulët çimentimi. Përbërja e copave është kryesisht ofiolitike (vullkanite, gabro, ultrabazike), më pak takohen copa gëlqerorësh, silicorësh etj. Trashësia e tyre në qendër të strukturës shkon deri 70 m.

C - Shkëmbinj të dobët me rezistencë në shtypje njëboshtore me pak se 50 bar. Në këtë grup kemi klasifikuar depozitimet e përziera të shpatit.

Depozitime të vietra të Kuaternarit të padiagjenizuara (De). Gjejnë përhapje në disa zona tektono - faciale, zonën “Mirdita”, N/zonën “Krasta”, dhe zonën “Kruja”. Përfaqësohen nga depozitime të përziera deluvialo - koluviale c,d,p Qp_3-h . Janë kryesisht brekçie shpati me trashësi të madhe dhe çimentim argjilo - alevrolitor të dobët deri mesatar. Takohen përgjatë vargmaleve gëlqerore, flishore apo ofiolitike.

D - Dherat pa lidhje kohezionale ($c=0$). Në këtë grup përfshihen: (R) depozitimet detare Qh dhe (P) depozitimet e shtratit të sotëm të lumit Qh. Në hartat e shkallëve më të mëdha kanë simbole moshore depozitimet detare (dQh_2) dhe ato të shtratit të sotëm të lumit (al Qh_2).

Depozitimet e shtratit të lumit (P) përhapen në rrjedhën e sipërme dhe të mesme të lumenjve, janë kryesisht zhavorre kokërrmesëm-të trashë deri popla me rrumbullakësim jo të mirë deri të rrumbullakosura, me zaje gëlqerori, gabrosh, ultrabazikë, silicorë e ranorë. Trashësia e këtyre depozitimeve varet nga pozicioni i

rrjedhës së lumit. Në rrjedhën e sipërme trashësia e zhavorreve mund të jetë deri 2m, por mund të shkojë deri 3-4m. Me kalimin nga rrjedha e sipërme në atë të mesme trashësia e depozitimeve të shtratit rritet (10 - 15 metra), por dhe gjerësia e shtratit rritet, nga disa metra në dhjetra metra, e në ndonjë rast rreth 150 -200m.

E - Dherat me lidhje kohezionale (c≠0)

Suargjila të vendosura mbi zhavorret (Szh), janë depozitimet në tarracat lumore (Qh), janë shënuar me simbolin moshor (al Qh1).

Ato formojnë relievin fushor të zonës nga Shliza në jug, Fushë Milot - Gurëz deri në rrjedhën e lumit Drin (fusha e Gramshit). Suargjilat janë me origjinë aluvale, kanë trashësi nga 2.0m deri në 8.0m dhe vendosen po mbi depozitimet aluviale të perfaqesuara kryesisht nga zhavorre. Trashësia e zhavorreve mund të shkojë 20 - 30 m. Shpesh herë këto depozitime ndërthuren me depozitimet kënetore të formuara në të dy anët e shtratit të lumit (Allkja S. 2001).

F - Dherat me veti speciale (LAKr)

Në këtë grup dherash janë klasifikuar depozitimet kënetore ligenore të cilët në hartën përkatëse kanë simbolin IQh₂. Ato kanë veti fiziko - mekanike të dobëta dhe janë kryesisht në prezencën e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Takohen në zonën tektono faciale "Kruja", në pjesën fushore ndërmjet malit të Kakariqit dhe të Rencit dhe në UPA nga Ishull Shëngjini deri në gryk-derdhjen e lumit Ishëm. Zgjerohet drejt lindjes duke përfshirë fushën e Barbullosë, fushën e Rrilës dhe të Spitenit deri në afërsi të Shënkollit, Grykës së Lumit deri në Tale 2, vazhdon në jug të Fushë Kuqes (Alku) deri në grykderdhjen e lumit Ishëm, ndërmjet fushës së Gjollit të Zi dhe fushe Gjonëmit.

Vetitë fiziko - mekanike (gjeoteknike)

Të dhënat gjeoteknike janë nxjerrë nga literatura e studimeve gjeologo - inxhinierike të realizuara në territorin e Krujës si dhe nga literatura (Myrto R. etj.1991, Allkja S. 1995, Demi n. 1995, Gjovreku L. 2006).

Më poshtë po japim vetitë e 6 grupimeve të ndryshme litologjike:

- Shkëmbinj të fortë
- Shkëmbinj mesatar
- Shkëmbinj të dobët
- Dhera pa kohëzion
- Dhera me kohëzion
- Dhera me veti speciale

Shkëmbinjtë e fortë kanë rezistencë në shtypje > 500 kg/cm². Këta shkëmbinj, në shumë raste janë të shkatërruar nga fenomenet e ndrydhjeve tektonike dhe paraqiten me shumë çarje. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Gëlqerorët (G): Janë shkëmbinj kompakt, masivë deri pllakorë, shpesh të karstezuar, me sisteme të zhvilluara çarjesh kryesisht në drejtimin vertikal dhe me mbushje të çarjeve me material kryesisht çimento karbonatike, më pak material argjiloro - humusor. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Pesha volumore	$\gamma = 2.45 - 2.70 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 0.1 - 5.0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^5 - 3 \cdot 10^5 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0.1 - 0.2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët silicorë (Gsi): Janë shkëmbinj kompakt, kryesisht shtresorë - pllakorë me ndërthurje shtresash silicore ose silicorë në formë linzash që shfaqen brenda gëlqerorëve. Në këta shkëmbinj, në përgjithësi nuk gjen përhapje fenomeni i karstëzimit. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.6 - 2.75 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 0.1 - 2.0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1000 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^5 - 3 \cdot 10^5 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0.1 - 0.15$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë (lu) në rajon përfaqësohen nga harzburgite, peridotite, dunitë e lercolite plagjikalzike. Janë përgjithësisht me çarshmeri intensive dhe me kore tjetërsimi në pjesën e sipërme, me trashësi të vogël.

Parametrat fiziko-mekanike të shkëmbinjve ultrabazikë janë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.7 - 3.2 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 1 - 5 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 700 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 3 \cdot 10^4 - 2 \cdot 10^6 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0.1 - 0.15$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Poroziteti i shkëmbinjve ultrabazikë luhetet nga 1 % në shkëmbinjtë e freskët në 5% për shkëmbinjtë e shkatërruar tektonikisht. Luginat lumore kanë gryka të ngushta në formën e gërmës "V". Sjellja mekanike e këtyre shkëmbinjve është në përgjithësi elastike. Vetitë fiziko-mekanike të tyre varen nga dendësia e çarjeve dhe nga shkalla e tjetërsimit të tyre.

Punimet minerare n/toksore nuk japin prurje të mëdha uji. Në shpate me lartësi jo të madhe këta shkëmbinj mund të qendrojnë vertikalisht.

Shkëmbinjtë magmatikë intruziv bazikë (lb), përfaqësohen nga gabro, gabronorite dhe lloje të tjera petrografike. Ata janë shkëmbinj kompakt shpesh të kloritizuar dhe të epidotizuar. Në pjesën e sipërme formojnë kore tjetërsimi me trashësi deri në 10 m.

Produktet eluviale-deluviale zhvendosen sipas një plani kontaktues me shkëmbinjtë e freskët. Sjellja mekanike e këtyre shkëmbinjve është pothuajse elastike (në varësi të shkallës së kloritizimit të tyre). Në skarpatë, në gjendje natyrale mund të qëndrojnë vertikalisht për lartësi qindra metra. Për shkak të përbërjes petrografike të tyre këta shkëmbinj nuk përdoren si material ndertimi. Parametrat fiziko-mekanike të tyre janë :

Pesha volumore	$\gamma = 2.2 - 2.6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2 - 12 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 600 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 3 \cdot 10^4 - 3 \cdot 10^6 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,1 - 0,15$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë intruziv mesatarë dhe acid (I_{ma}) formojnë masivë të rëndësishëm plagjiogranitësh, dioritësh kuarcore etj. Ato janë shkëmbinj kompakt dhe me shpesh të kaolinizuar. Në rajon kanë përhapje shumë të kufizuar. Në pjesën e sipërme krijojnë kore tjetërsimi me trashësi deri 10 m. Kjo është karakteristike sidomos në zonat e kontakteve tektonike të plagjiograniteve. Ato konsiderohen praktikisht të papërshkueshem nga uji dhe ato pak burime që dalin nga çarjet e tyre, kanë debite të rendit 0.1 - 0.2 l/sek. Sjellja mekanike e tyre është pothuajse elastike (në varësi nga shkalla e kaolinizimit). Luginat lumore që kalojnë në këta shkëmbinj kanë formën e germës “V”. Parametrat gjeoteknike janë si më poshtë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.66 - 2.7 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2 - 4 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 600 ÷ 800 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 2 \cdot 10^5 \div 3 \cdot 10^6 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,1$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 15 \div 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë magmatik efuziv-bazikë (E_b) në rajon përfaqësohen nga llava diabazike, aglomeratike e tipe të tjera petrografike të tyre. Ata janë kompakt dhe me më pak çarje se shkëmbinjtë magmatikë intruziv. Në sektorët e zonave tektonike janë të kloritizuar, epidotizuar dhe kaolinizuar. Në pjesën e sipërme krijojnë kore tjetërsimi me trashësi të vogël. Në sektorët periferikë të zonës “Mirdita” shkëmbinjtë efuziv bazikë janë të shkatërruar tektonikisht dhe të transformuar nga tretësirat hidrotermale duke krijuar kore tjetërsimi me trashësi të madhe. Në zonat me çarje takohen burime të rralla uji me debit të vogël dhe me regjim të përkohshëm (sezonal). Nuk mungojnë dhe burime që dalin nga thyerjet tektonike me debit disa l/sek.

Luginat lumore në këta shkëmbinj kanë në formën e germës “V” të mbyllur dhe formojnë shpate me pjerrësi mbi 70° dhe lartësi vertikale mbi 100 m. Ato përbëjnë zona të favorshme për vendosjen e digave të larta. Sjellja mekanike e këtyre shkëmbinjve është elastike. Punimet minerare nëntokësore (tunele, galeri etj.) dhe

trase rrugore të hapura në këta shkëmbinj janë me qendrueshmëri të mirë. Ato mund të përdoren si material ndërtimi, sidomos për shtrimin e rrugëve. Parametrat gjeoteknike janë si më poshtë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.5 \div 2.7 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 5 - 7 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1200 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 1 \cdot 10^5 \div 4 \cdot 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0.1$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \div 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë magmatikë efuziv mesataro-acid (Ema) ndërtojnë trashësi hialoandezitesh, keratofiresh kuarcore dhe tipe të tjera petrografike. Ata janë shkëmbinj kompakt, pjesërisht të kaolinizuar, kloritizuar dhe epidotizuar. Në pjesën e sipërme krijojnë kore tjetërsimi me trashësi të vogël. Luginat lumore që përshkojnë këta shkëmbinj janë të tipit kanion ose germës "V" të mbyllur me shpate shumë të pjerrëta dhe të përshtatëshme për vendosjen e digave të larta. Konsiderohen praktikisht të papërshkueshëm ($k < 10^{-8} \text{ m / sek}$). Burime të rralla të ujit që dalin nga çarjet tektonike kanë debite të vogla të rendit 0.2 - 0.4 l/sek dhe me regjim të përkohshëm sezonal. Sjellja mekanike e këtyre shkëmbinjve është elastike. Qëndrueshmëria e tyre gjatë hapjes së punimeve minerare nëntokësore (pa armature) është e mirë.

Parametrat gjeoteknike janë si më poshtë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.5 \div 2.6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 10 - 12 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 600 ÷ 900 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^3 \div 2 \cdot 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,1$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 - 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë metamorfik rreshporë (Rm): Janë shkëmbinj të përbërjeve litologjike të larmishme. Brenda tyre ekzistojnë shkëmbinj shumë të fortë dhe të fortë, por që shpesh janë të copëtuar dhe të ndrydhur tektonikisht. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.3 \div 2.6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2.0 - 8.0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 ÷ 700 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^5 \div 5 \cdot 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0.2 - 0.3$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë mesatarë kanë rezistencë në shtypje 50 - 500 kg/cm². Mund të jenë masiv ose kombinime shtresash me veti gjeoteknike krejt të ndryshme. Për këtë arësye vetitë e tyre janë jo stabile dhe të ndryshueshme në sipërfaqe edhe në distanca shumë të vogla. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Shkëmbinjtë flishorë dhe me pamje flishore (FI): Flish ritëm hollë argjilo-ranor dhe vende vende i rrudhosur, me shtresa gëlqerorësh turbitik. Parametrat gjeoteknikë janë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.5 \div 2.6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 3.0 - 7.0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 100 ÷ 300 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^4 \div 10^5 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 5.0 \text{ kg/cm}^2$

Mollasat argjilore (Ma): Janë shkëmbinjtë argjilorë me veti plastike, me ndërthurje alevrolitesh. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\gamma = 1.8 \div 2.0 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 20 - 85 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 50 ÷ 100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^3 \div 5 \cdot 10^3 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 2.5 - 5.0 \text{ kg/cm}^2$

Mollasat ranoro konglomeratike (Mrk): ranorë e konglomerate me ngjyrë bezhë në gri, me çimentim të dobët deri mesatar ranoro- alevrolitor e argjilor. Shpesh janë të çimentuar mirë. Vetite fiziko - mekanike të këtij formacioni varen nga shkalla e çimentimit dhe e predominimit të komponentit konglomeratik. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\gamma = 2.2 \div 2.5 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 10 - 25 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 50 ÷ 500 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 10^3 \div 10^4 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 5 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë e dobët kanë rezistencë në shtypje <50 kg/cm². Janë depozitime copëzore të pa diagjenizuara, ose me shkallë diagjenizimi të ulët. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Depozitime të vjetra Kuaternare të pa diagjenizuara (De): Janë kryesisht brekçie shpati me trashësi të madhe dhe çimentim argjilo - alevrolitor të dobët deri mesatar.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\gamma = 1.75 - 1.95 \text{ gr/cm}^3$
----------------	--

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Poroziteti	$n = 20 - 50 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} < 50 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 100 - 200 \text{ bar}$
Këndi i fërkimit të brendshëm	$\varphi = 14^\circ - 18^\circ$
Kohezioni	$c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1.80 - 2.0 \text{ kg/cm}^2$

Dherat pa kohezion ($c=0$).

Zhavorre e popla me origjinë aluviale dhe proluviale (P): Përfaqësohen nga zhavorre, zhure e popla të përpunuara e gjysëm të përpunuara, me përbërje heterogjene (gëlqerore, ultrabazike, gabro, silicorë etj), me ujë deri të ngopura me ujë, mesatarisht deri të ngjeshur. Kanë veti të larta filtruese duke formuar pellgje të fuqishme të ujrave nëntokësore. Madhësia e zajeve dhe poplave është tepër heterogjene. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\gamma = 1.6 - 2.1 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 30 - 85 \%$
Këndi i fërkimit të brendshëm	$\varphi = 28^\circ - 38^\circ$
Kohëzioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 200 - 300 \text{ kg/cm}^2$
Koeficienti i filtrimit	$K > 50 \text{ litër/24orë}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 2.0 - 4.0 \text{ kg/cm}^2$

Rërat (R): Përfaqësohen nga rërat e plazheve, janë rëra me ngjyrë bezhë deri gri, kokërrimëta deri kokërrmëdha, me lagështi, mesatarisht të ngjeshura. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\gamma = 1.65 - 1.85 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 30 - 75 \%$
Këndi i fërkimit të brendshëm	$\varphi = 22^\circ - 36^\circ$
Kohëzioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
Koeficienti i filtrimit	$K > 50 \text{ litër/24orë}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1.8 - 3.0 \text{ kg/cm}^2$

Dherat me kohezion

Suargjila të vendosura mbi zhavorre (Szh): Suargjila të lehta deri të renda pluhurore me pak deri me lagështi, plastike, pak deri mesatarisht të ngjeshura. Janë të origjinës aluviale deluviale. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Kufiri i sipërm i plasticitetit	$W_r = 25 - 40 \%$
---------------------------------	--------------------

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Kufiri i poshtëm i plasticitetit	$W_p = 18 - 25 \%$
Numri i plasticitetit	$I_p = 7 - 15$
Lagështia natyrale	$W_n = 10 - 35\%$
Pesha volumore në gjendje natyrale	$\gamma = 1.75 - 1.95 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 35 - 75 \%$
Koeficienti i porozitetit	$e = 0.5 - 0.85$
Konsistenca	$B = 0.1 - 0.4$
Grada e lagështisë	$G = 0.6 - 0.8$
Këndi i fërkimit të brëndshëm	$\varphi = 12^\circ - 22^\circ$
Kohëzioni	$c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$
Koeficienti i filtrimit	$K < 1 \text{ litër/24orë}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1.6 - 2.2 \text{ kg/cm}^2$

Dhera me veti speciale

Lyme dhe argjila lymore te kripura (LAKr) me ngjyrë hiri dhe me shumë lagështi, plastike e butë deri plastike e rrjedhëshme.

Fraksioni argjilor me dimensione 0.002mm	30 - 28.1%
Fraksioni pluhuror me dimensione 0.002-0.05	55 - 60 %
Fraksioni ranorë me dimensione 0.05 - 2mm	15 - 11.9%
Lagështia natyrale	$W_n = 45.6\%$
Pasticiteti	
Kufiri i sipërm i plasticitetit	$W_s = 48.1\%$
Kufiri i poshtëm i plasticitetit	$W_p = 34.9\%$
Numri i plasticitetit	$F = 10 - 13.2$
Pesha vellimore në gjendje natyrale	$\gamma = 1.8 - 1.9 \text{ T/m}^3$
Poroziteti	$n = 45 - 55\%$
Koeficienti i porozitetit	$\varepsilon = 0.95 - 1.10$
Grada e lagështisë	$G = 0.80 - 0.96$
Moduli i deformacionit	$E_{1-3} = 30 - 40 \text{ kg/cm}^2$
Këndi i fërkimit të brëndshëm	$\varphi = 10^\circ - 12^\circ$
Kohezioni	$c = 0.02 - 0.05 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 0.8 - 1.2 \text{ kg/cm}^2$

një shtresë të vetme ujëmbajtëse, që në disa sektorë të veçantë në veri-perëndim ka 2 e më shumë ndërshtresa -horizonte ujëmbajtëse. Shtresat ujëmbajtëse zhavorore kanë trashësi të madhe nga 4-5-23m deri 60m, të cilat janë ndarë nga ndërshtresa argjilore duke krijuar disa horizonte ujëmbajtëse. Shtresa ujëmbajtëse mbulohet nga një shtresë subargjilore e argjilore me trashësi 10m në fashtin Hasan, rreth 20m në Larsuhk deri 25m në zonën Ura e Gjoles. Ky akuifer ka një ujëpërcjellshmëri të lartë. Prurja specifike ka vlera $q = 5\text{ l/s/m}$ deri $10-16\text{ l/s/m}$. Në shpimet e shfrytëzimit të Fushë Krujës prurja specifike ka vlera $q = 16.24\text{ l/s/m}$, me prurje $Q = 33.3\text{ l/s}$, koeficienti i filtrimit $K = 147.3\text{ m/ditë}$, ndërsa ujëpërcjellshmëria varion $T = 1000-1473\text{ m}^2\text{/ditë}$. Për furnizimin me ujë të Fushë Krujës rekomandohet të shfrytëzohet resurset ujore $Q = 150\text{ l/s}$. Aktualisht nga ky stacion shfrytëzohet sasia e ujit $Q = 80-100\text{ l/s}$. Në stacionin e pompimit Ura e Gjoles-Ujësjelesi i Shijakut shfrytëzohet sasia e ujit $200-250\text{ l/s}$. Mineralizimi i përgjithshëm në zonën Ura e Gjoles - Fushë Krujë, $MP = 14.84-27.64$ gradë gjermane. Ujërat nëntokësorë kanë veti fiziko-kimike të mira në pjesën më të madhe të akuiferit, janë me fortësi mesatare deri të fortë.

Në këtë akuifer takohen ujra me presion dhe me vetëderdhje në drejtim të Gramzës. Amplituda e luhatjes së nivelit është 5.55m . Ushqimi kryesor i akuiferit bëhet nëpërmjet infiltrimeve të reshjeve atmosferike, filtrimeve nga lumenjtë, nga formacionet rrënjësore dhe drenimet nëntokësorë nga akuiferi i Tiranës. Ushqimi nga lumi i Drojes natyrisht është shumë i më vogël. Në pjesën më të madhe të zallishtores me gjatësi 3km zhavorret e varrosura kontaktojnë me zhavorret e shtratit të lumit. Lumi i Drojes në periudhën minimale jep disa dhjetëra l/s .

Në këtë akuifer janë kryer e vënë në shfrytëzim një numër shpimesh për furnizimin me ujë të pijshëm si stacioni Ura e Gjoles, Fushë Kruja, Gramëz, Thumanë. Një numër shpimesh shfrytëzohen për ujë teknologjik dhe ujitje.

Ndikimi i intruzionit të ujit të detit në akuiferët bregdetarë

Ndikimi dhe dinamika e intruzionit të ujit të detit është i pranishëm edhe në akuiferët bregdetarë të zonës fushore të Bashkisë së Krujës.

Intruzioni i ujit të detit lidhet kryesisht me kushtet hidrodinamike; kur lartësia është e pamjaftueshme, presioni i ujit të ëmbël nuk e përballon dot intruzionin e ujit të detit drejt akuiferit. Kështu, zonat që ndodhen larg bazës së ushqimit, janë më të prekura nga intruzioni i ujit të detit.

Intruzioni i ujit të detit ndodh edhe për shkak të mbishfrytëzimit të ujërave nëntokësorë, çka është vërtetuar në mënyrë tipike në akuiferin e Fushë Kuqes.

Për të shmangur ndikimin e intruzionit të ujit të detit shumica e puseve të shfrytëzimit për ujë të pijshëm janë vendosur larg bregut të detit, pranë shtretërve të lumenjve.

Në disa raste këto shpime janë kryer shumë afër shtratit të lumenjve duke u rrezikuar nga ndotja që mbartin lumenjtë e Tiranës dhe Lanës dhe Lumit të Tiranës që derdhen në Lumin e Gjoles. Një rast i tillë është vërtetuar në një shpim disa metra larg shtratit të lumit Gjole i cili shfrytëzohet për furnizimin me ujë të qytetit të Vorës.

Evidentimi i problematikave mbi erozionin dhe impaktet e tjera mbi mjedisin.

Në një studim të kryer nga Shërbimi Gjeologjik Kombëtar, mbi bazën e matjeve të kryera në profilet e rrrjedhës të Lumit Ishëm, janë evidentuar problemet e mëposhtme:

- Ulje e shtratit të lumit për shkak të erozionit fundor dhe shfrytëzimit pa kriter të inerteve në degët e lumit.
- Erozioni i tokës bujqësore pothuajse se në të gjithë gjatësinë e shtratit.
- Rrezikimi i objekteve inxhinierike (ura, rrugë etj).
- Ndotja e madhe e ujrave nëntoksore në të gjithë pellgun ujëmbajtës të Tiranës dhe dalje jashtë funksionit të puseve (Ura e Brrarit, Zallherr, Cerkezë, Tapizë etj.)
- Kënetizim i shtratit të lumit në pjesën e poshtme (foto. 2)



Fig. 35: Deformime shtratore, erozion i brigjeve dhe rrezikim i objekteve inxhinierike

Masa për rehabilitimin e shtratit të lumit dhe zonave të tjera përreth tij

Disa nga masat urgjente që duhen marrë për këtë qëllim janë :

- Ndërrerja e menjëhershme e shfrytëzimit të inerteve dhe largimi i impianteve të inerteve nga shtrati i lumit dhe teracat lumore.
- Ndalimi urgjent i hedhjes të mbeturinave të çdo lloji origjine: teknologjike, ndërtimit hedhurina, plehta etj.

Ndërtimi i veprave tërthore për shuarjen e energjisë së lumit, sidomos në kohën e ploatve për të penguar erozionin e mëtejshëm dhe rehabilitimin e zonave të dëmtuara si dhe mbrojtja e objekteve inxhinierike.

Plotat dhe përmytjet në territorin e Bashkisë së Krujës

Plotat dhe përmytjet e lumenjve në territorin e Bashkisë së Krujës , ashtu si edhe në zona të tjera të vendit, janë një fenomen natyror për shkak të regjimit mesdhetar të reshjeve atmosferike, të cilat janë të shumta përgjithësisht gjatë periudhës së dimrit por shpesh herë edhe gjatë vjeshtës e pranverës. Vërshimet shkaktohen prej rritjes së nivelit të ujit në lumë mbi kuotën më të lartë të brigjeve të tij. Zona e vërshimit përfaqëson një zgjatim natyror të shtratit lumor. Pavarësisht nga rreziku potencial i përmytjes njerëzit i tërheq instalimi në këto zona për arsye të shumë përfitimeve që ata kanë prej saj. Kështu, përveç ujit që sigurohet aty për ujë të pijshëm dhe për përdorime të tjera, lumi është burim i sigurimit të ushqimit dhe përdoret edhe për transport. Po ashtu brigjet e luginës së lumit përbejnë vende shumë të pëlqyeshme për ndërtimin e banesave, sepse aty kushton më lirë për të ndërtuar dhe për të kryer shërbime të tjera të nevojshme.

Për fat të keq, zhvillimi në këto zona bie në konflikt me shumë procese ekologjike. Kështu, kënetat dhe ligatinat e tjera, të cilat thahen për t'u përdorur për zhvillimin e zonës, përbejnë habitate shumë të kërkuara për shumë lloje specimesh të botës së gjallë. Ato janë jo vetëm filtra të sistemit lumor por edhe shërbejnë për furnizimin me ujëra të shtresave ujëmbajtëse nëntoksore.

Nga të gjitha përmbytjet që kanë ndodhur në territorin fushor të Bashkisë së Krujës (Fushë Krujë, Thumanë etj.) gjatë shekullit të 20-të e deri sot, përmbytjet e periudhës nëntor 1962 - shkurt 1963, konsiderohen si më të mëdhatë.

Konkretisht për këtë zonë, nga ujërat e lumenjve Zezë, Gjole e Ishmëm përmbysten fushat dhe qytetin e Fushë Krujës dhe fushat në të dy anët e lumenjve Gjole e Ishëm.

Nga ujërat e mëdha u përmbysten qytetet dhe toka bujqësore të Fushë Krujës, Thumanës etj. Ndërpritet në shumë vende trafiku rrugor, shkaktohen dëme të mëdha në bujqësi, komunikacion etj.

Gjatë rrebesheve të forta ka pasur gërryerje tokash dhe rrëshqitje në shumë zona. Ujërat e lumenjve kanë bartur me vëhte shumë materiale të ngurta si rezultat i erozionit të madh të shpateve të zhveshur.

Për shkak të ujërave të shumta që zbriten në fushë, të erërave të forta dhe të shirave të mëdha, në lagunat bregdetare, u fut një sasi e madhe e ujërave detare që solli ndryshime të theksuara në kripshmërinë, depozitim, përmbajtjen e oksigjenit, qartësinë e ujit etj.

Përmbytje të mëdha kanë ndodhur edhe në dimrat e viteve 2010, 2011 të cilat shkaktuan dëmtime të konsiderueshme ekonomike.

Këtu duhet përmendur edhe përmbytja e këtij viti gjatë të cilës lumi Ishëm doli nga shtrati dhe përmbyti zonat fushore poshtë autostradës e deri pranë zonës bregdetare.

Masat për zvogëlimin e pasojave të përmbytjeve

Siç dihet masat për zvogëlimin e pasojave të përmbytjeve klasifikohen në masa strukturore dhe në masa jo strukturore. Të parat kanë të bëjnë me ndërtimin e strukturave mbrojtëse si argjinatura, penda etj. Masat strukturore konsistojnë në ndërtimin e konstruksioneve të strukturave mbrojtëse si argjinatura, rezervuare për kontrollin e plotave, përmirësime të shtratit të lumit etj.

Masat jo strukturore janë masa të karakterit parandalues dhe kryesisht konsistojnë në menaxhimin më të mirë të zonave të rrezikuara nga përmbytjet me anë të hartografimit të këtyre zonave, paralajmërimit dhe parashikimit të plotave etj.

Duhet thënë se koncepti i sotëm për mbrojtjen nga përmbytjet, në krahasim me konceptin e viteve 1950, ka ndryshuar. Në shekullin e ri, krahas masave për zvogëlimin e humbjeve nga përmbytjet, vëmendje e duhur i kushtohet edhe hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të vërshimit, për të nxjerre përfitimet e mundshme prej tyre.

Prej kohësh në Shqipëri është synuar të pengohen përmbytjet e tokave të ulta, duke ndërtuar argjinatura gjatë lumenjve kryesore të vendit. Njëkohësisht, rezervuarët e mëdhenj mbi lumin Drin dhe Mat, si dhe rezervuarët artificiale për qëllime ujitjeje, kanë luajtur një rol pozitiv në zvogëlimin e përmbytjeve. Po ashtu janë marrë masa të ndryshme për të ndihmuar komunitetet nga katastrofat natyrore.

Megjithatë shumë nga këto masa janë të dobishme, ato gjithashtu inkurajojnë zhvillimin e mëtejshëm të zonave të vërshimit, gjë që çon në rritjen e mundësisë së dëmtimeve prej plotave dhe në këtë mënyrë kërkon nivele më të larta mbajtjeje. Me fjalë të tjera zgjidhja strukturore është vetëm një zgjidhje e pjesshme. E vetmja zgjidhje

afat-gjate konsiston në kufizimin e zhvillimeve social-ekonomike që mund të preken nga përmbytjet në zonat e vërshimit.




Fig. 36: Zona me rrezik për përmbytjeje

Ky konceptim jo-strukturor është pranuar gjerësisht, sepse ai zvogëlon nevojën për ndërtimin e strukturave të shtrenjta për kontrollin e plotave si dhe kërkesën për financimin e zhdëmtimeve nga katastrofat.

Siç u përmend edhe më sipër plotat janë një dukuri e natyrshme në kushtet fiziko-gjeografike të vendit tonë që karakterizohet prej një relievi shumë malor, prej rrebeshesh e shirash me intensitet shumë të lartë, me lumenj me shpate shumë të pjerrët etj. Në këto kushte mund të merren masa vetëm për zvogëlimin e pasojave të dëmshme të shkaktuara nga përmbytjet e plotave.

Këto masa mund të klasifikohen në dy lloje: masa afat-shkurtra dhe masa afat-gjata.

Masa afat-shkurtra

Masat afat-shkurtra janë masa që konsistojnë në punime të karakterit lokal, me kosto relativisht të vogël dhe që mund të kryhen brenda një stine apo viti. Ato konsistojnë në punime mirëmbajtjeje si dhe në masa organizative që synojnë të paralajmërojnë organet përkatëse dhe popullsinë sa më parë të jetë e mundur. Në mënyrë të përmblodhur këto masa janë:

- Masa për përmirësimin e punës të sistemit të kanaleve, sidomos atyre të ujërave të larta dhe hidrovorëve.
- Organizimi i Shërbimit të Paralajmërimit të përmbytjeve, nëpërmjet ngritjes së një rrjeti minimal hidrometeorologjik, që do të informojë në mënyrë të rregullt organet shtetërore mbi reshjet dhe gjendjen e lumenjve në raste përmbytjesh.

Masa afatgjata

Këto masa kanë të bëjnë në radhë të parë me hartimin e një Strategjie Kombëtare për Menaxhimin e Zonave me Rrezik të Lartë Përmblytjeje. Kjo strategji bazohet mbi ligjin përkatës mbi emergjencat, i cili ngarkon institucionet përkatëse të hartojnë Plane Kombëtare apo Rajonale për menaxhimin e këtyre zonave si psh.:

- Përcaktimi i zonave me rrezik të lartë përmblytjeje dhe i dëmeve që shkaktohen nga përmblytjet me madhësi të ndryshme
- Organizimi i fushatave për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës dhe organizatave publike për dëmet nga përmblytjet
- Evidentimi i gjendjes së argjinaturave dhe marrja e masave të nevojshme për rehabilitimin dhe eventualisht ndërtimin e argjinaturave në të dy brigjet e lumenjve, ku ende ato nuk janë ndërtuar plotësisht (pjesërisht në Ishëm).
- Mbrojtja e zonave me erozion të theksuar qoftë me prita malore, qoftë me pyllëzime, ndërtimi i rezervuarëve në pjesën e sipërme të lumenjve, masa këto që do të ndikojnë në zvogëlimin e plotave në lumenjtë.
- Studimi i normave ekzistuese të modulit të kullimit të tokave me synim rillogaritjen e tyre dhe rritjen e kapacitetit të hidrovorëve.

3.1.4 Zonimi makrosizmik dhe në varësi të rëndësisë, zonimi mikrosizmik;

Vlerësimi i rrezikut sizmik të rajoneve të ndryshme të prekura nga tërmetet, është bërë një drejtim i preferuar i sizmologjisë kryesisht gjatë tre-katër dekadave të fundit. Në vitin 1979, pas një pune relativisht të gjatë u realizua studimi “Rajonizimi Sizmik i Republikës së Shqipërisë” së bashku me hartën përkatëse në shkallën 1:500.000 (Sulstarova, Koçiaj, Aliaj, 1980), e cila u miratua me VKM Nr.371 dt. 20.12.1979. Që nga ajo kohë e në vazhdim Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë në shkallën 1:500.000 është pjesë integrale e Kushteve Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit Antisizmike – KTP N2-1989.

Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë paraqet efektin maksimal sipërfaqësor të pritshëm për kushte mesatare trualli, të shprehur në intensitetin bazë të përcaktuar sipas shkallës MSK-1964. Intensiteti bazë është konsideruar si intensiteti maksimal i vërtetueshëm në një pikë të dhënë për një periudhë kohore të caktuar në të ardhmen.

Në Hartën e Rajonizimit Sizmik të Shqipërisë janë dalluar tre kategori zonash: zonat me intensitet bazë të lëkundjeve VIII, VII e VI ballë; brenda zonave VIII ballëshe për kushte të këqia trualli, të përmendura më lart, janë dalluar zona me intensitet të pritshëm IX ballë si në Vlorë, në afërsi të Lushnjës, në Durrës, në Korçë, në Pogradec, në Gollubordë e në Shkodër (kufijtë e këtyre zonave paraqiten me izovija të ndërprera).

Në vitet ‘90, me zhvillimin teorik të analizës së rrezikut sizmik dhe mundësitë kompjuterike, në Shqipëri u realizuan një sërë analizash të rrezikut sizmik duke përdorur si përqasjen deterministike ashtu dhe atë probabilitare.

Në vitet 1998-2003, në kuadrin e projektit të NATO-s “Sizmotektonika dhe rreziku sizmik i Shqipërisë”, në bashkëpunim me Departamentin e Gjeofizikës të Universitetit Aristotel të Selanikut, u realizua për herë të parë një analizë e plotë e rrezikut sizmik të vendit duke përdorur metodën probabilitare.

Ka pak vite që doli në qarkullim materiali teknik “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri”¹, në të cilin përfshihet përvoja mbi 40 vjeçare e studimeve në fushën e sizmologjisë, jepen përfundime të arritura nëpërmjet debatit shkencor e hulumtimit të thellë dhe kulmohet me formën më të plotë të rrezikut sizmik të vendit, një dokumentacion me rëndësi praktike për ndërtimet në Shqipëri. Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë (2010) duhet të shërbejë si bazë për kodin e ri antisizmik të ndërtimeve në vendin tonë.

Për vlerësimin e potencialit sizmik të territorit të Bashkisë të Krujës është përdorur metoda probabilitare. Për llogaritjen probabilitare të rrezikut sizmik të Shqipërisë kemi aplikuar metodologjinë Cornell-McGuire (McGuire, 1993)². Sizmiciteti i vendit tonë është karakterizuar nëpërmjet modelit të zonave të burimeve sizmike.

Sipas EC 8, strukturat në rajonet sizmike duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të kënaqin këto dy kërkesa themelore:

1. Kërkesa e mos-shëmbjes, dhe
2. Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve.

Pra, për të plotësuar këto dy kërkesa të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisë janë kryer për dy nivele probabiliteti:

- 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 475 vjet, dhe
- 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 95 vjet.

Pra, në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal i truallit - PGA si dhe shpejtimet spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Krujës që paraqitet në vijim.

Sizmiciteti i Shqipërisë dhe veçanërisht i territorit të bashkisë të Krujës

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vend në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktive në botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43° N; 18-30° E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1989).

¹ “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” Sh. Aliaj, S. Koçiu, Betim Muço, Eduard Sulstarova, 2010, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë


² Për këtë qëllim është përdorur softi EZ-FRISK 7.12, produkt i Risk Engineering Inc. Colorado, USA

Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktivë në Evropë. Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmikë mirë të përcaktuar, si vijon:

- Brezi tërmetor Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikropllakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje;
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi tërmetor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore³.

Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive⁴

Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.



Territori i Bashkisë të Krujës zë vend në shtrirje përgjatë brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishëm të të cilit kanë kushtezuar potencilain sizmik të saj. Më posht po japim prshkrime të shkurtëra për disa nga tërmetet më të fortë që kanë goditur Shqipërinë nga rajoni i Durrësit deri në Shkodër e nga deti Adriatik në kufirin lindor; tërmetet që kanë influencë më të drejtpërdrejtë me Bashkinë e Krujës.

Tërmetet e vitit 1905 (Tërmetet e Shkodrës)

Përfaqësojnë një nga seritë më të mëdha të tërmeteve të fortë të zonës së Shkodrës. Intensiteti i lartë, numri i madh i pasgoditjeve, pasojat e goditjes kryesore dhe pasgoditjeve më të forta kanë qënë objekt i shumë studimeve sizmologjike⁶

Goditja më e fortë ka ndodhur në 1 qershor 1905. Magnituda e këtij tërmeti është përcaktuar $M_S=6.6$; dhe intensitet mbi 9 balle; shkaktoi dëmtime të rënda në njerëz dhe pasuri në Shkodër dhe fshatrat përreth (veçanërisht në fshatrat në jug-perëndim të Shkodrës). Janë shkatëruar plotësisht rreth 1500 shtëpi banimi vetëm në qytetin e Shkodrës; të gjitha shtëpitë e tjera të këtij qyteti u dëmtuan rëndë; u demtua edhe kalaja e Rozafes.




Fig. 38: Harta e izoseisteve të tërmetit të 1 Qershorit 1905

Ky tërmet shkaktoi rreth 200 të vdekur dhe 500 të plagosur. Lëkundjet e këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Krujës janë vlerësuar me intensitet 8 ballë.

Tërmeti i 18 Dhjetorit 1926

⁶ S. Koçiaj e E.Sulstarova, 1980

Në dhjetor të vitit 1926 Durrësi dhe rajonet rreth tij u goditën nga një seri tërmetesh shumë të fortë. Goditja e parë e fortë ndodhi më 16 dhjetor; ajo u pasua nga goditje të tjera të forta më 17 dhjetor. Më 17 dhjetor, ndodhi një goditje e fortë, e cila u pasua nga një goditje më e fuqishme që demtoi Durrësin, Shijakun e Ishmin; u shkatërruan dhe u dëmtuan shumë shtëpi. Kjo goditje kishte magnitudë $M_s=5.8$; ajo u shoqërua me shumë goditje të tjera. Me 18 dhjetor u regjistrua një goditje tjetër me magnitudë $M_s=6.2$. Kjo goditje shkatërroi e dëmtoi shumë rëndë shumë godina në Durrës, Kavajë e Shijak se dhe në fshatrat rreth tyre. Në shkallën e dëmtimit padyshim kanë influencuar dhe goditjet e forta që paraprinë atë. Në Kavajë u dëmtuan rëndë të gjitha shtëpitë dhe u këputën minaret e xhamive. Midis Durrësit e Shijakut pati dukuri të lëngëzimit të truallit të shfaqura me shatërvane me ujë të nxehtë e sulfur dhe pseudovullkane balte, rere e ujë.

Tërmeti u ndje shumë fort në Tiranë ku populli doli në panik nga shtëpitë; u ndje fort në Shkoder, Berat, Lushnjë, Elbasan. Në Itali u ndje 5 ballë në Pulje; ndërsa në Greqi 4 ballë në Janinë e Korfuz. Intensiteti i tërmetit është vlerësuar 9 ballë të shkallës MSK-1964, Ky tërmet është shoqëruar nga shumë pasgoditje të cilat vazhuan edhe gjatë vitit 1927.

Intensiteti i këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Krujës ka qenë deri 7 ballë të shkallës MSK-1964.




Fig. 39: Harta e izosejsteve të tërmetit të 17 dhjetorit 1926

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967 pati një magnitudë $MS=6.6$ dhe intensitet 9 balles dhe dëmtoi rëndë rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit si dhe një pjesë të territorit të Maqedonisë perëndimore. Në rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit nga ky tërmet u prekën 13 lokalitete me 177 fshatra, vdiqën 12 veta dhe u plagosën 174 të tjerë.




Fig. 40: Harta e izoseisteve të tërmetit të 30 Nëntorit 1967

Viktima në njerëz pati edhe në territorin e Maqedonisë Perendimore. Ky tërmet është shoqëruar nga më shumë se 1200 pasgoditje. Ky tërmet është ndjerë në zonën e Bashkisë të Krujës si një lëkundje 5-6 ballëshe⁷.

Tërmeti i 15 Prillit 1979

Tërmeti i 15 Prillit 1979 (tërmeti i zones kufitare Shqiperi-Mali i Zi), është një nga më të fortët që ka goditur gadishullin e Ballkanit gjatë shekullit të XX-të. Magnituda e tij është llogaritur $M_s=7.2$ dhe intensiteti në epiqendër është vlerësuar 9-10 ballë të shkallës MSK-1964. Epiqendra e këtij tërmeti është në bregdetin Adriatik, pranë Petrovacit, në Mal të Zi. Shumë paragoditje e kanë paraprirë këtë tërmet rreth dy javë para goditjes kryesore të 15 Prillit, kurse pasgoditjet vazhduan për rreth 9 muaj. Pasgoditja më e fortë është ajo e 24 Majit 1979, me magnitudë $M_s=6.3$. Intensiteti i këtij tërmeti në epiqendër është 8 ballë (MSK-64). Goditja kryesore e 15 Prillit

⁷ E.Sulstarova, S. Koçiaj, 1975, 1980

shkaktoi 35 të vdekur dhe 382 të plagosur në Shqipëri. Më shumë se 100.000 banorë mbetën pa shtëpi. U shkatëruan pothuajse plotësisht 17.122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Dëmet më të mëdha në njerëz dhe të mira materiale u shkaktuan në bregdetin Malazez. Tërmeti i 15 Prillit 1979 u ndie fort në të gjithë territorin e Shqipërisë. Lëkundjet e këtij tërmeti shkaktuan dëmtime edhe në rrethin e Krujës; intensiteti i lëkundjeve në Bashkinë e Krujës ka arritur 8 ballë⁸.



Fig. 41: Harta e izoseistëve të tërmetit të 15 Prillit 1979

Vendosja gjeologjike e neotektonike krahinore

Orogjeni shqiptar, pjesa më jug-perendimore e pllakës Euroaziatike, konvergjent me mikropllakën e Adrias, ndahet në dy treva me regjim tektonik ndryshëm: treva e jashtme me regjim shtypës, që përfshin pjesën bregdetare të tij, ku zë vend zona e Bashkisë të Krujës, dhe treva e brendëshme me regjim zgjerues, që zë vend në brendësi të vendit.

Katër njësitë e mëdha neotektonike janë shënuar në hartë me numra: 1. Njësia e brendëshme, 2. Njësia e jashtme (02: sektorët detar të saj), 3. Ultësira anësore Pranadriatike (03: sektori detar i saj), 04. Platforma në detet Adriatik e Jon (04a: Platforma Apuliane, 04b: Baseni Shqiptar).

⁸ E. Sulstarova, B. Muço, 1980




Fig. 42: Harta e zonimit neotektonik (Pliocen-Kuaternar) të Shqipërisë⁹

Si periudhë neotektonike është pranuar ajo Pliocen-Kuaternare që i korrespondon ngritjes së fuqishme e progresive në rajonin Mesdhetar në përgjithësi, dhe në Shqipëri në veçanti¹⁰. Fillimi i periudhës neotektonike shënohet qysh në Pliocen me tektonikën në zgjerim që kapi trevën e brendëshme dhe krijoi atje struktura horst-grabenore. Fusha e sotme e sforcimeve tektonike është studjuar mirë nëpërmjet aplikimit të metodës mikrotektonike¹¹ dhe zgjidhjeve të mekanizmit fokal të tërmeteve¹². Boshti mesatar i shtypjes në trevën e jashtme ka orientim VL-JP (azimut mesatar 225°), ndërsa boshti mesatar i tërheqjes në trevën e brendëshme është VVP-JJL (azimut mesatar 340°)¹³. Balli i orogjenit Shqiptar pritet e spostohet, nga jugu në veri, nga shkëputjet e tipit shtytës Ishulli Othon-Dhërmi (α), Gjiri i Ariut-Dukat (β), veriu i Ishullit të Sazanit (γ), dhe Gjiri i Drinit-Lezhë (δ).

⁹ Sh. Aliaj 2000

¹⁰ Sh. Aliaj 1994

¹¹ Aliaj, 1988; Tagari, 1993

¹² E. Sulstarova, 1986; B. Muço, 1994

¹³ Sh. Aliaj, 1988; E. Sulstarova, 1986

Zona sizmoaktive joniko-adriatike ku zë vend bashkia e Krujës

Sizmotektonika analizon lidhjen midis shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive dhe tërmeteve të gjeneruar prej tyre. Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive (Aliaj, 1988).

Në hartën sizmotektonike të Shqipërisë janë paraqitur shkëputjet aktive me tipin e deformacionit dhe kronologjinë e aktivitetit të tyre, epiqendrat e tërmeteve sipas magnitudës, si dhe izovijat e intensiteteve maksimale të vrojtuar.

Dy zona gjatësore dhe dy zona tërthore të shkëputjeve aktive evidentohen mire në orogjenin Shqiptar, si vijon:

1. Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse me shtrirje VP deri afersisht VVP,
2. Zona Peshkopi-Korçë e shkëputjeve normale grabenore me shtrirje V-J,
3. Zona Shkodër-Tropojë e shkëputjeve normale me shtrirje VL,
4. Zona Elbasan-Dibër e shkëputjeve normale me shtrirje VL.

Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse ku zë vend Bashkia e Krujës është zona më e gjatë, që ndiqet për shumë qindra km përgjatë bregdetit Adriatik e Jonian, edhe jasht territorit tonë, dhe ndahet në tre segmente nëpërmjet tërthoreve Shkodër-Pejë dhe Vlorë-Tepelenë, si vijon:

- a) Segmenti verior me shtrirje perendimore-veriperendimore përmban shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër të zonës Kruja (Dalmate).
- b) Segmenti qendror me shtrirje veriore deri veri-veriperendimore përbëhet nga shkëputje pas-Pliocenike mbihipëse në shtypje oblike të Ultësirës Pranadriatike dhe të zonës Kruja.
- c) Segmenti jugor me shtrirje VP përbëhet nga shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër kryesisht të zonës Jonike.

Zonat e shkëputjeve aktive janë pikërisht zonat sizmoaktive (zonat ku gjenerohen herë pas here tërmetet), të konfirmuara nga fakti se epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive.




Fig. 43: Harta sizmotektonike e Shqipërisë në shkallë 1: 500.000

Në hartën sizmotektonike përvijohen qartë zonat e shkëputjeve kryesore sizmoaktive në Shqipëri me potencialin e pritshëm sizmik. Dy nga zonat e shkëputjeve sizmoaktive gjatësore: Joniko-Adriatike dhe Peshkopi-Korçë (zona sizmoaktive e Drinit, siç quhet ndryshe), dhe zona e shkëputjeve tërthore Lushnjë-Elbasan-Dibër paraqesin zonat sizmoaktive me potencialin sizmik më të lartë.

Zona e Bashkisë të Krujës, që bën pjesë në zonën sizmoaktive Joniko-Adriatike, vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës të bashkisë të Krujës

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës ku zë vend Bashkia e Krujës është bazuar në studimin e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë, i botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2011¹⁴

¹⁴ Ky studim është përgatitur nga Prof. Sh. Aliaj, S. Koçiu, B. Muço dhe E. Sulstarova (Aliaj etj., 2010).

Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA dhe të shpejtimit spektral - SA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti:

- 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet
- 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet

(koha e ekspozimit ose e jetëgjatësisë ekonomike), që u korespondojnë dy periodave të përsëritjes të tërmeteve: 95 vjet dhe 475 vjet, në përputhje të plotë me EC 8).




Fig. 44: Harta e PGA për Shqipërinë në truall shkëmbor, me RP 475 vjet

Rezultatet e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë janë llogaritur me relacionin e shuarjes të lëkundjeve të forta të Sadigh etj., për zonat perendimore të burimeve sizmike me rregjim shtypës dhe me relacionin e Spudich etj., për zonat lindore me rregjim zgjerues, dhe janë paraqitur në hartat e rrezikut sizmik.

Në Hartën e Rrezikut Sizmik probabilitar për periodë përsëritje 475 vjet, vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA shkojnë nga 0.24g në jug të Shqipërisë, në 0.25-0.30g nga Vlora në Lezhë, ndërsa në Shqipërinë lindore shkojnë nga 0.20-0.22g nga Leskoviku në Korçë e Ohër dhe nga Kukësi në Peshkopi, në 0.20-0.29g gjatë tërthores nga Elbasani në Dibër-Tetovë e Gostivar, dhe në 0.20-0.30 g gjatë tërthores nga Tropoja drejt Shkodrës. Vlerat më të ulëta të PGA 0.12-0.15 g janë marrë në zonën

e Mokrës dhe në Mat-Mirditë e Has-Gjakovë, dhe në vlera nga 0.07-0.15 g në skajin më verior të vendit, nga Vermoshi drejt Dukagjinit.

Siç shihet nga harta e rrezikut sizmik probabilitar për periodë përsëritje 475 vjet, vlerat më të larta të shpejtimit maksimal të truallit - PGA janë në pjesën bregdetare perendimore të vendit, ku balli i orogjenit në regjim shtypës kolizon me mikroplakën e Adrias, si dhe gjatë tërthoreve Elbasan-Dibër-Tetovë dhe Shkodër-Tropojë.

Përfundime dhe rekomandime

Nga studimi për vlerësimin e rrezikut sizmik të Bashkisë të Krujës, nxjerrim këto përfundime dhe rekomandime:

- Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës të Bashkisë të Krujës, është kryer duke u bazuar në metodologjinë probabilitare të rrezikut sizmik për Shqipërinë, që jepet në punimin shkencor “Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vlerësimi i rrezikut Sizmik në Shqipëri”, i botuar në vitin 2010 nga Akademia e Shkencave e Shqiperise dhe i përgatitur nga Profs. Shyqyri Aliaj, Siasi Koçiu, Betim Muço e Eduard Sulstarova. Vlerat e shpejtimit (akseleracionit) maksimal horizontal të truallit - PGA dhe të shpejtimit spektral - SA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti: 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet dhe 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet (koha e ekspozimit ose e jetëgjatësisë ekonomike), që u korespondojnë dy periodave të përsëritjes të tërmeteve: 95 vjet dhe 475 vjet, në përputhje të plotë me Eurokodin 8.
- Për Bashkinë e Krujës, si kudo në Shqipëri, rekomandohet të merren në konsideratë rezultatet e parametrave të rrezikut sizmik për probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje të tërmeteve, çka dëshmohet nga studimet për rrezikun nga tërmetet në Shqipëri, ku një tërmet me magnitudë 7.0 ballë shkalla Rihter (tërmeti më i fortë i mundshëm në Shqipëri) mund të përsëritet çdo 500 vjet.
- Zona e Bashkisë të Krujës edhe në të ardhmen pritet të preket nga tërmete të fortë me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.
- Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit – PGA për periodë përsëritje 475 vjet në truall shkëmbor në territorin e Bashkisë të Krujës variojnë nga 0.208 g, deri 0.373g.
- Vlerat e parametrave të rrezikut sizmik kanë rëndësi praktike për ndërtimet në Bashkinë e Krujës, dhe duhet të merren në konsideratë për zhvillimin urban të saj, në veçanti për ndërtimet e ardhshme sepse:
Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA dhe të shpejtimit spektral - SA për perioda 0.2-0.5 sekonda u korespondojnë energjisë periudhë-shkurtër, e cila do të ketë efektin më të madh mbi strukturat periudhë-shkurtër, në ndërtimet deri afër 7 kate të lartë, ndërtimet më të zakonëshme sot në botë. Hartat e shpejtimit spektral periudhë-gjatë: 1.0 sek., 2.0 sek. etj. paraqesin nivelin e lëkundjes të truallit që do të ketë efektin më të madh në strukturat më periudhë-gjata, në ndërtimet 10 kate të lartë e më tepër, në urat etj.

- Duke qenë se rreziku sizmik është llogaritur për truall shkëmbor, për ndërtimet në truall shkëmbor duhet eliminuar pjesa e sipërme rreth 5-6 m e depozitimeve të shkriфта deluvialo-eluviale që mbulojnë shkëmbijtë rrënjësorë. Ndërsa për ndërtimet në troje të butë, mbi depozitimet Kuaternare (Holocene), kërkohet kryerja më parë e studimeve gjeologo-inxhinierike për saktësimin e modelit gjeoteknik dhe mandej vlerësimi i rrezikut sizmik për çdo zonë që do t'i nënshtrohet zhvillimit të ri perspektiv si dhe për fshatrat turistike në bregdet.

3.1.5 Pjelloria e tokës

Toka bujqësore në bashkinë Krujë vlerësohet sipas pjellorisë dhe pozicionit të saj në territorin e bashkisë. Në vijim jepet një panoramë e vlerave të tokës. Vihet re se në fshatrat Arrameras, Bubq, Bushnesh, Derven, Gramez, Halil, Hasan, Kurcaj, Rinas dhe Tapizë gjenden vlerat maksimale të tokës sipas AKKP. Siç vihet re, këto territore janë zonuar kryesisht në pjesën jugore dhe perëndimore të bashkisë, aty ku terreni është më fushor, burimet hidrike dhe infrastruktura më të aksesueshme dhe pozicioni gjeografik më i favorshëm.




Fig. 45: Vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë bujqësore, livadhe kullota dhe pyjore për rrethin Krujë (AKKP, 2013)

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Tabela 6: Vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë bujqësore, livadhe kullota dhe pyjore për rrethin Krujë (AKKP, 2013)

NR.	LAGJA, FSHATI	ZONA KADASTRALE	TOKE BUJQËSORE (leke/m ²)	LIVADHE, KULLOTA (leke/m ²)	TOKE PYJORE (leke/m ²)
1	ARRAMERAS	1042	440	114	85
2	BARKANESH	1118	151	83	85
3	BILAJ	1185	151	114	85
4	BORIZANE	1247	151	114	85
5	BRRET	8622	151	83	85
6	BRUZ MAL	1290	151	83	85
7	BRUZ ZALL	1291	151	83	85
8	BUBQ	1294	360	114	85
9	BUDULL	1299	151	114	85
10	BURAN	1318	151	114	85
11	BUSHNESH	1332	360	114	85
12	CUDHI KAMIT	1425	151	83	85
13	CUDHI ZALL	1426	151	83	85
14	DERVEN	1475	360	114	85
15	DUKAGJIN I RI	1562	309	114	85
16	FUSHE KRUJË (FSHAT)	1665	151	114	85
17	GRAMEZ	1840	360	114	85
18	HALIL	1921	360	114	85
19	HASAN	1934	360	114	85
20	KODER THUMANË	2182	304	114	85
21	KROI I MADH	1425 1426	151	83	85
22	KURCAJ	2333	360	114	85
23	LARUSHK	2385	491	114	85
24	LUZ	2537	151	114	85
25	MAFSHEQ	2547	151	83	85
26	MALLKUÇ	2577	151	114	85
27	MAZHE E MADHE	2621	151	114	85
28	MAZHE E VOGEL	2622	151	114	85
29	MILISKA	3599	151	83	85
30	MUKJE	2734	151	114	85
31	MURQINE	2742	151	114	85
32	NIKEL	2795	151	114	85
33	NOJE	2809	151	83	85
34	PICRRAGE	2957	151	83	85
35	QEREKE	3096	151	114	85
36	RINAS	3183	360	114	85
37	RRANZE	3218	151	83	85
38	SHKRETE	3398	151	83	85
39	SHQEZE	1425 1426	151	83	85
40	SUKTH VENDAS	3543	151	114	85
41	TAPIZE	3562	360	114	85
42	THUMANË	3599	151	114	85
43	VIRJON	3783	151	114	85
44	ZEZE	3908	151	114	85

Informacioni që disponohet për pjellorinë e tokës është i pjesshëm dhe i referohet të dhënave për njësinë administrative Fushë Krujë.

Tabela 7: Sasia e tokës bujqësore dhe cilësia e saj.

Emërtimi i fshatit	Sasia e tokës	Cilësia e tokës
Hasan	170	II
Luz	391	II
Arameras	496	I
Larushk	434	I
Fushë Krujë	446	I – II
Halil Zgerdhesh	222	II
Ish NB Previzë	186	I – II
Ish NB Larushk	63.9	I
TOTALI	2408.9	-

3.1.6 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike

Territori i Bashkisë Krujë është mjaft i pasur me monumente kulturore dhe historike me rëndësi të veçantë në rang kombëtar. Gjithashtu Kruja është edhe një nga qendrat më aktive të turizmit kulturor në vend. Në vijim paraqitet një evidentim i trashëgimisë materiale të mbrojtur në këtë qytet.

Tabela 8: Monumentet në territorin e Bashkisë Krujë

Nr.	Përshkrimi	Fshati	Nj.Adm.	Kat.	Institucioni i shpalljes	Nr. Vendim	Data e shpalljes
1	KALAJA E KRUJES. Ne qytetin e Krujës, ne kuoten 608 m, i gjithë muri i rrethimit, duke përfshire pyrgjet dhe galerinë qe lidh kalanë me burimin e tashlojt, pjesët e mureve qe e rrethojnë këtë burim si dhe portën kryesore bashkë me kalldrëmin. Përfshihet edhe kulla e sahatit.		Krujë	I	Aprov.Ligj. Nr. 609, dt, 24.05.1948	568 e 4874	17.03.1948 23.09.1971
2	KALAJA E ZGERDHESHIT në fshatin Zgërdhesh në Lindje të Urës së Zezë, në Jugperëndim të fshatit Zgërdhesh, ne kuotën 252 m, muret dhe gjithë kodra e kufizuar nga veriu e jugu me 2 përrenjtë, nga lindja me qafen dhe nga perëndimi në arat e lagjes Kakariq.	Zgërdhesh	Fushë Krujë	I	Aprov.Ligj. Nr. 609, dt, 24.05.1948	568 e 4874	17.03.1948 23.09.1971
3	VARREZA E LASHTË ne qytetin e Krujës		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
4	URA NE LAGJEN EMIRAJ në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
5	URA E ABDYL AGES në fshatin Shkallë e Zezë	Shkallë e Zezë	Nikël	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
6	URA E KURCAJT MBI LUMIN E ZEZE në fshatin Kurçaj	Kurçaj	Nikël	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	786/1	15.11.1984
7	TERMAT ANTIKE NE FSHATIN, Burizanë	Burizanë	Thumanë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	266/1	16.02.1979
8	KALLDREMI NE LAGJEN MECE në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
9	PJESE E KALLDREMIT TE VJETER NE RRUGEN E DROJES NE INTERVALIN KROI I KRYESHKOZES - URA E DROJES, Krujë		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	2854	08.08.1980

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

10	PJESE E KALLDREMIT TE VJETER NE RRUGEN E GRYKES SE SHKALLES ZEZE, NDERTIMET FSHATARE, BUSHNESH DHE URES SE ABDYL AGES, Krujë		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	2854	08.08.1980
11	TEQEJA E DOLLMES në lagjen Kala të qytetit te Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
12	HAMAMI I VJETER NE KALA		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
13	MONUMENTI I SKENDERBEUT në qytetin e Krujës		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
14	PAZARI I VJETER në qytetin e Krujës		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
15	BANESA E XHEMAL BELEGUT, lagjja "Xak Pengili", në qytetin e Krujës		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
16	BANESA E GOCAJVE - LAGJA SESERAJ në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
17	BANESA E SHEQERE TETES - LAGJA SESERAJ në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
18	BANESA E HAXHI AGICIT - LAGJA EMIRAJ në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
19	BANESA E LYTFI MECES - LAGJA MECAJ në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
20	BANESA E MUHARREM HOXHES ne fshatin Rranxe	Rranxe	Cudhi	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	Urdhër.	08.01.1977
21	BANESA E SELMAN TARES në fshatin Shkrete	Shkrete	Cudhi	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	Urdhër.	08.01.1977
22	BANESA E XHEMAL TOPÇIUT në qytetin e Krujës		Krujë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973
23	BANESA E IBRAHIM, HAMZA E BAJRAM GJONIT në fshatin Bubull	Budulli	Bubq	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	Urdhër.	08.01.1977
24	KULLA E TAFE BASHES ne fshatin Mafsheq	Mafsheq	Cudhi	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1886	10.06.1973

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

25	BANESA E HAMIT KALASE (NDERTESA E MUZEUT ETNOGRAFIK), lagja "Mustafa Kacaci", në qytetin e Krujës		Krujë	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
26	ANSAMBLI ZEJTAR ne Kryeshkozë te Krujës. Ansambli i përberë nga dy mullinj drithi dhe një punishte per regjie lëkure.	Krye - Shkozë	Krujë	I	Komiteti i kulturës dhe arteve	8	18.12.1987
27	KISHA E GJON PAGËZORIT DHE KUFIJTË E ZONËS MBROJTËSE	Derven	Krujë	I	M.T.K.R.S.	945	07.11.2008
28	ZONA ARKEOLOGJIKE "A"DHE "B"		Krujë		Këshilli i Ministrave	427	20.06.2012

Përshkrimi i disa prej monumenteve më të rëndësishme në territorin e Bashkisë Krujë.

Kalaja e Krujës. Qyteti i Krujës.



Fig. 46: Pamje e Kalasë

Kalaja e Krujës është shembull i në kalaje mesjetare, për nga mbrojtja natyrore dhe furnizimi me ujë; që ishin dy nga faktorët më të rëndësishëm në mesjetë për të siguruar një mbrojtje të fuqishme dhe të gjatë. Në burimet historike Kruja përmendet për herë të parë në aktet kishtarë të shek. IX si qendër peshkopate dhe si vendbanim i fortifikuar del vetëm nga mesi I shek. XIII. Kalaja e Krujës është ndërtuar mbi një kreshtë shkëmbore të shkëputur nga mali i Sarisalltëkut dhe nga formacionet kodrinore përreth. Përveç zonës së hyrjes kryesore për në kala, anët e tjera janë shkëmbinj të thepisur. Një nga veçoritë e kësaj kalaje është mënyra e furnizimit me ujë , ku brenda territorit të saj, rrjedh një burim nëntokësor. Muret e kalasë, duke ndjekur konturet e terrenit ku është ngritur, rrethojnë një sipërfaqe eliptike rreth 800 m. Ato kanë një gjerësi prej rreth 1.5 m dhe përforcohen nga 9 kulla të rrumbullakëta ose katërkëndëshe. Në pjesën më të lartë të kodrës, është ndërtuar në shek. XIII-XIV një ndarje që shërbente si kështjellë dhe seli e feudalit. Kalaja ka dy porta, njera nga V-L që është kryesorja dhe tjetra më e vogël në skajin J-P. Janë kryer vazhdimisht punime me karakter konservues dhe restaurues.

Kalaja e Zgërdheshit. Fshati Zgërdhesh.

Qyteti në Zgërdhesh ndodhet pranë qytetit të Krujës, në cakun e takimit të Ultësirës Perëndimore me Malin e Skënderbeut. Në afërsi të qytetit kalonte rruga përgjatë bregut të Adriatikut dhe Jonit. Qyteti shtrihet mbi një pllajë trekëndëshe shkëmbore e cila zbret drejt fushës me pjerrësi të vogël. Baza e trekëndëshit ndodhet në lindje, në terren të rrafshët, ndërsa kulmi 100 m më lart në një qafë të ngushtë në anën perëndimore. Rreth shek. 6-5 p. Krishtit në pjesën e sipërme të kodrës lindi vendbanimi i fortifikuar paraurban me sipërfaqe 1,36 ha, muret e të cilit i përshtaten terrenit me vija të drejta e dhëmbëzime të cektë. Muret janë punuar me blloqe të mëdhej guri të palatuar me fuga të mëdha. Kësaj periudhe i përkethyrja në skajin JP të akropolit në trajtën e një korridori të harkuar. Qyteti në Zgërdhesh paraqet rastin e pastër të Qytetit të Shpatit me akropol të trashëguar nga periudha protourbane. Qyteti i mirëfilltë lindi në fund të shek. 4 fillim shek. 3 p. Krishtit. Sistemi urbanistik nuk ka qene i rregullt: rrugët gjatësore të gdhendura në shkëmb, vijnë të çrregullta. Fragmentet arkitektonike (shtatore e Artemisit, tjegulla dhe një geizon), pjesë të një tempulli si dhe gjurmë banesash tregojnë për ekzistencën e qytetit ku, jashtë mureve të tij gjendet nekropolime. I cili ruan traditën e varrimit me tuma. Në vitin 1969 janë kryer gërmime dhe punime anastiloze.

Varreza e lashtë. Qyteti i Krujës.

Varreza e Krujës u zbulua nga konsulli austriak Theodore Ippen në vitin 1901 gjatë punimeve për ndërtimin e një godine ushtarake. Këto varre datojnë në shek. VI-VIII dhe në to u gjetën vathë, togëza dhe fibula. Rruazat dhe fibulat tregojnë influencën bizantine, ndërsa prezenca e fibulave të sheshta dhe dy shpatave prej hekuri pasqyrojnë ndikimin sllav të ardhur përmes tregtisë. Shumë nga objektet e gjetura në varreza janë në muzeun kombëtar "Gjergj Kastriot Skenderbeu" në pavionin e mesjetës.

Ura në lagjen Emiraj. Qyteti i Krujës.

Nga gjurmët ekzistuesedhe nga burimet gojore rezulton se në Krujë që në kohë të hershme ka ekzistuar një rrjet rrugor mjaft i zhvilluar dhe me zgjidhje teknike të goditur. Ura e Emiraj në lagjen Emiraj, e ndërtuar mbi proin e Saxhës, ka shërbyer për të lidhur këtë lagje me qytetin e Krujës. Dikur këtu kalaonte dhe një variant i rrugës Fushë-Krujë-Krujë, gjurmë të së cilës ruhen ende. Në unitet me mullirin ngjitur saj si dhe me kroin e Saxhës pak më lart, kjo urë është pjesë përbërëse e një kompleksi hidraulik me interes që nuk takohet rrallë. Kjo është një urë e vogël që përbëhet vetëm prej një harku me hapësirë drite 3 m, lartësi 3.3 m dhe gjërësi 2.4 m. Paraqet interes në aspektin historik të ndërtimit të saj. Jo vetëm nga të dhënat gojore që e shtyjnë kohën e ndërtimit të saj mbi 500 vjet, por duke u bazuar dhe në teknikën e ndërtimit të saj, e ndryshme nga ajo e urave të shek. XVII-XVIII, mendohet se ura e Emirajt është ndërtuar në periudhën mesjetare, të para pushtimit turk midis shek. XII-XIV, kohë prej së cilës urat e ruajtura tek ne janë të rralla. Ballët e dukshëm të qemerit të harkut janë punuar me blloqe smërçi, që vendasit e quajnë grac, me gjërësi deri 50-60 cm e me lartësi 36 cm. Kalldrëmi mbi urë i rrafshët me gjërësi 2.4 m është ndërtuar me gurë lumi pllakë e të rrumbullakët, shtruar pa asnjë rregullsi. Kjo urë paraqet interes për vazhdimësinë kronologjike të ndërtimit të urave në vendin tonë.

Ura e Abdyl Agës. Fshati Shkallë e Zezë.

Ura e Abdyl Agës në Shkallën e Zezë e ndërtuar mbi lumin e Zezë, është nga realizimet më interesante të rrugëve. Nga burimet gojore rezulton se, kjo urë është ndërtuar nga një krutan i quajtur Abdyl Aga , i biri i Shim Keqit në çerekun e parë të shek. XIX rreth viteve 1810-1820. Kjo urë lidh Krujën si dhe fshatrat e Rranzës: Këlcunjë, Buronjë, Lukaj, Mukaj, Radhesh. Është ndërtuar në një vend piktoresk në një grykë të ngushtë mbi lumin me brinjë të larta e të thikta shkëmbore, e kufizuar në lartësi nga shpatet e maleve fqinj. Ajo të imponohet me ndërtimin e saj arkitektonik, me trajtimin racional konstruktiv. Për arsye të disnivelit të brigjeve, ura e Abdyl Agës ka një zgjidhje tipike për kohën e saj, ajo lartësohet me kurriz mbi kyçin e harkut kryesor e me pjerrësi drejt brigjeve. Ura përbëhet prej dy harkesh gjysëm rrethor, prej harkut kryesor mbi lum me hapsirë drite 7 m dhe lartësi nga uji në kalldrëm 10.5 m dhe nga një hark i vogël majtas. E ndërtuar me gurë të fortë dhe e mbështetur në brigje shkëmbore, ura e Abdyl Agës paraqitet si një object mjaft i lidhur e me një muraturë shumë rezistence. Në këtë urë ruhen gjurmë të parapetit vetëm një fragment i vogël në anën e djathtë të urës nga ana e poshtme.



Fig. 47: Pamje e urës

Ura e Kurçajt mbi lumin Zezë. Fshati Kurçaj

Ura e Kurçajt ndodhet në jug të Krujës në hyrje të fshatit Kurçaj, mbi lumin e Zezës që buron nga Qafa e Shtamës. Ura e Kurçajt i shërbente rrugës së shkurtër të karvaneve Tiranë-Krujë sipas këtij itinerari: Tiranë-Zall Herr-Radhesh-Mukaj-Buronjë-Kurçaj-Barkanesh-Krujë. Në thembrat e qemerit të madh ruhen vrimat e trarëve të poshtëm të armaturës së harkut.

Ura e Kurçajt është ndërtim i fundi i shek. XVIII-të, fillim i shek. XIX-të. Në faqet ballore ajo është e punuar me gurë pllakë të zinj vendosur shtrirë ndërsa kalldrëmi është i bërë me breza, tip shkallësh. Këto breza ngihen mbi bazën e kalldrëmit rreth 10-15 cm dhe shtrihen çdo 100-120cm.



Fig. 48: Pamje e urës

Kalldrëmi në lagje Meçe. Qyteti i Krujës.

Një rrugë e vjetër që të çonte nga Fushë-Kruja në Krujë, ka qënë rruga e Zidollit e cila dilte në lagjen në lagjen Meçe të Krujës, duke kaluar përmes lagjes. Nga kjo rrugë e herëshme që përdorej prej këmbësorëve dhe karvaneve sot ruhen disa fragmente kalldrëmi afër lagjes Meçe. Në këto gjurmë të ruajtura, rruga arrin gjërësinë 1.7-2 m. Për arësye të pjerrësisë çdo 80-90 cm, në kalldrëm janë ndërtuar breza guri tërthor në formë shkallareje të vendosur këlliq 10 cm mbi rrafshin e kalldrëmit. Pjesa qendrore është e punuar me gurë më të rregullt se pjesët anësore, ajo ka trajtën e një kanali tip kunete me seksion trekëndësh me thellësi në kulm 20-30 cm. Kjo rrugë që ka pas funksionuar për qerre, sipas të thënieve të vendasve, ka kaluar afërsisht në aksin e rrugës së sotme automobilistike, diku pranë gurores.

Pjesë e Kalldrëmit të Vjetër - Ura e Ndrojës. Qyteti i Krujës.

Rruga e vjetër që ka pas lidhë Krujën me Mamurasin e Laçin si dhe më afër me fshatrat Shënmëri e Bret, ka qënë ajo që kalonte nga ura e Drojës, në V-P të Krujës. Në intervalin kroi i Kryeshkozës- Ura e Drojës, ruhen gjurmë të kalldrëmit të vjetër të rrugës së Drojës. Në pjesën më të madhe të rrugës së Drojës, ruhen gjurmë kalldrëmi tipik të periudhës së pushtimit turk, gurë lumi të vegjël të rrumbullakët shtufi dhe gëlqeror shtruar pa rregullsi me kornizë anësore me gurë lumi më të mëdhenj. Në këtë kalldrëm, karakteristike është se, në kthesat me pjerrësi, mbi rrafshin e kalldrëmit çdo 1 m theksohen 10 cm, lartë brezash gurësh këlliq që luajnë rolin e shkallëve për të mos shkarrë gjatë ecjes mbi kalldrëmin e lagur. Nga ura e vjetër sot ruhet vetëm një fragment i mbështetjes në bregun e djathtë i ndërtuar me gurë lumi shtufor kryesisht formë pllake. Sipas dokumentit fotografik del se ura ka qënë e tipit me kurriz me një hark të madh kryesor anash të cilit qenë dy harqe të vegjël lehtësues me taban mjaft lartë shtratit të lumit. Ajo duhet të ketë qënë e shek. XVIII, kohë kur ky tip ure njihej mjaft mirë në vendin tonë.

Pjesë e Kalldrëmit të Vjetër në rrugën e Grykës së Shkallës Zezë, Ndërtimit fshatare Bushnec dhe Urës së Abdyl Agës. Qyteti i Krujës.

Rruga që ka lidhur në të kaluarën Krujën me malësinë dhe pikërisht më Bruz-Zallin, Rranxën, Cudhinë, etj. kalonte nga ana e kundërt e rrugës së sotme që lidh Krujën me Qaf-Shtamën, nga gryka e Shkallës së Zezë, majtas malit të Krujës. Nga fundi i grykës së Shkallës, rruga e kalon lumin mbi urën e Abdyl Agës dhe vazhdon lart majtas lumit për në Bruz-Zall, Rranzë, Culli etj. Pikërisht në grykën e Shkallës së Zezë, nga Barkaneshi deri tek ura, ruhen gjurmë të qarta të kalldrëmit të vjetër të kësaj rruge. Kalldrëmi këtu është punuar jo me gurë aq të mëdhenj e të shtrirë, por me gurë të mëdhenj e të çrregullt gëlqerorë me brinjë të mprehta, vendosur pa asnjë rregullsi. Fugat ndërmjet gurëve janë shumë të theksuara dhe qoshet e majat e gurëve lartësohen mjaft mbi rrafshin e kalldrëmit duke e vështirësuar ecjen.

Teqeja e Dollmës

Në hyrjen e dytë të Kështjellës së Krujës, gjendet teqja ose tyrbja e Dollmës. Ajo është e ndërtuar në vitin 1779 me gurë të gdhendur mbi rrënojat e një teqeje tjetër. Ajo është e ndërtuar dhe mirëmbajtur për shumë kohë nga fisi Dollma, fis autokton krutan.

Stili i ndërtimit është bizantin ndërsa pikturat murale që janë me origjinë të stilit barok. Afresket zënë me teper se treçerekun e sipërfaqeve të mureve, vepër e dy piktorëve anonime nga Ostreni. Në muret në pjesën veriore janë shkrime të shenjta në arabisht, osmanisht dhe persisht. Brenda teqese gjendjen varre të njerëzve të mirë që kanë shërbyer në këtë vend. Ajo është shpallur monument kulture për shkak të vlerave artistike në vitin 1973.



Fig. 49: Pamje e Teqes

Hamami i Vjetër. Lagja Kala

Banja në Kalanë e Krujës, si përgjithësisht këto ndërtime inxhinierike në periudhën e mesjetës, zinin një vend të rëndësishëm në ndërtimet me karakter shoqëror. Ajo është ndërtuar në qendër të qytetit duke marrë pjesë në qendrën administrative të qytetit. Skema funksionale, përbëhet nga salla e çveshjes sot pa mbulesa dhe që mundet të jetë shtuar më vonë, nga ambientet e djersitjes që ka pranë nyjën sanitare dhe ambientin e larjes që komunikojnë drejtpërdrejtë me të, ku ndodhet dhe depoja e ujit. Banja mbulohet me qemere dhe tre kupola mbi tambure.



Fig. 50: Pamje e Hamamit

Pazari i Vjetër. Qyteti i Krujës.

Pazari i Krujës paraqet llojin më të lashtë të ansambleve të pazareve në vendin tonë. Ai i përket shek. XVIII-XIX dhe formon një njësi më vehte me lagjet e banuara duke u cilësuar si qendra zejtaro-tregtare e qytetit. Ansambli i Pazarit të Krujës, si përgjithësisht pazaret e kësaj periudhe lidhen me zhvillimin dhe lulëzimin e ekonomisë feudale në qytet, duke qene një pjesë e mirë e dyqaneve pronë e feudalëve apo zejtarit e tregtarit. Skema urbanistike e tij, ashtu si kudo, grupet e dyqaneve në formë vargu vendosen ballazi anash një rruge të ngushtë që thuhetse mbulohet krejtësisht me strehët e gjëra që shkojnë deri 2m gjatësi. Këto strehë jo vetëm mbrojnë mallin nga agjentët atmosferike që janë ekspozuar, por dhe blerësit. Dyqanet janë përgjithësisht dy katësh, ku ndërtimi i tyre përveç balleve është prej guri. Në Pazarin e Krujës ndeshen dy teknika të vjetra të mbylljes së balleve, ajo më e lashta me taraba dhe më e vona me qepena. Dyqani ishte vendi ku përgjithësisht prodhohej e njëkohësisht shitej malli. Ai vazhdimisht është restauruar me fonde shtetërore si dhe nga KE.




Fig. 51: Majtas: Ilustrim i Pazarit; Djathtas: Pamje e Pazarit në mbrëmje

Banesa e Xhemal BELEGUT. Qyteti i Krujës.

Banesa është tre katëshe dhe ngrihet në lagjen e sipërme të qytetit. Ajo ruan mjaft mirë skemën kompozicionale tipike të zonës dhe i takon dhjetëvjeçarit të fundit të shek. XIX. Hyrja bëhet nëpërmjet një dere me hark në katin përdhe, ku sipas skemës tradicionale të kësaj zone, gjejmë shkallët e drunjtë që të nxjerrin në katin e sipërm ku ndodhen dy ambiente banimi e nyja sanitare. Në katin e sipërm ndodhet oda e miqve e pajisur me oxhak, musandër. Ajo është restauruar në vitin 1979.

Banesa e GOCAJVE. Lagja Ceceraj, në qytetin e Krujës.

Ngrihet mbi një terren të pjerrët në lagjen Seferaj në afërsi të qendrës së qytetit të Krujës. Është e tipit perpendikular me një program të thjeshtë, dy ambiente të vendosur njeri mbi tjetrin që komunikojnë me një palë shkallë të brendshme, ku në katin e sipërm ndodhet oda e miqve. Banesa ka pësuar transformime të cilat i takojnë viteve 30 të shek. XX, ku ahuri kthehet në mjedis banimi.

Banesa e Sheqere TETES. Lagja Ceceraj në qytetin e Krujës.

Banesa ngrihet në afërsi të qendrës së qytetit të Krujës. Ajo është e tipit me zhvillim perpendikular. Ajo është ndërtuar nga mesi i shek. XIX dhe fazat e mëvonshme i takojnë fillimit të shek. XX. Banesa ka pësuar transformime në kohë, ku nga një program i thjeshtë me dy mjedise njeri mbi tjetrin. Mjedisi i sipërm del në formë erkeri me punime dru të mafilit, oxhak dhe qoshk. Banesa është restauruar në vitin 1971.

Banesa e Haxhi AGICIT. Lagja Emiraj në qytetin e Krujës.

Banesa është e tipit perpendikular me një ambient në pjesën e pasme përdhese dhe tre ambiente në pjesën e përpare, dy katëshe. Në trajtimin e jashtëm arkitektonik banesa paraqitet me një volum të vetëm kompakt. Në pamjen kryesore, kati i parë prej guri trajtohet me dritare të vogla, ndërsa kati i dytë me çatma, me shumë dritare. Banesa përfaqëson tipin e zakonshëm të banesave që u ndërtuan në qytetin e Krujës, gjatë shek. XIX. Punimet e restaurimit u kryen gjatë vitit 1977-1978.

Banesa e Lutfi MECES. Lagja Meçaj në qytetin e Krujës.

Banesa gjendet në pjesën e poshtme të kodrës ku ngrihet kalaja. Ajo duhet të jete ndërtuar nga fundi i shek. XIX. Planimetria e saj është formë katrore me zhvillim në lartësi duke u emërtuar tip kullë mbasi përbëhet vetëm nga tre mjedise të mbivendosur njeri mbi tjetrin. Në katin përdhe ndodhet ahuri ku me shkallë ngjitemi në mjedisin e ndejtjes dhe në katin e sipërm ndodhet oda e miqve, ku gjenden gjurmë të erkerit karakteristik. Punimet e restaurimit kanë rikonstruktuar erkerin.

Banesa e Muharrem HOXHES. Fshati Rranzë.

Banesa është e variantit me “kullëz” dhe “qoshk”. Banesa është dykatëshe me planimetri në formë të gërmës L. Kati përdhe përbëhet nga 4 mjedise për mbajtjen e bagëtisë, ku secili mjedis ka hyrje të veçantë me jashtë. Dhe kati i sipërm kishte katër mjedise ku në njërin krah ndodhet shtëpia e zjarrit dhe oda e miqve që mbante “qoshkun” karakteristik dhe dy mjedise banimi. Restaurimi i bërë në vitin 1978 pati si qëllim sigurimin e gjendjes statike të banesës.

Banesa e Selman TARES. Fshati Shkretë.

Banesa paraqet shembullin e thjeshtë të banesës me çardak, e cila në vite është transformuar. Megjithëse banesa nuk ka tipare mbrojtëse, në muret e saj janë hapur shumë frëngji. Fillimisht kati përdhe krijohet nga hajati i hapur ku ndodhej një portë në qendër, më vonë e transformuar.

Banesa e Xhemal TOPCIUT. Qyteti Krujë.

Banesa është e tipit me zhvillim perpendikular. Ajo i përket fundit të shek. XIX. Në katin përdhe kemi katoin, ku me shkallë ngjitemi në katin e sipërm ku zhvillohet jeta familjare. Në dhomën e ndejtjes gjemë inventarin karakteristik të banesës krutane si:

oxhaku me motive floreale, tavani i kurbëzuar, dollapët e murit të dekoruar si dhe erkeri, vendi i preferuar i kryefamiljarit.

Banesa e Ibrahim, Hamza dhe Bajram GJONIT. Fshati Budull.

Banesa ngrihet në periferi të fshatit, mbi një kodër të ulët. Ndërtimi paraqet shembullin e banesës dy katëshe me çardak të mbyllur në të gjithë ballin, e ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ai është një ndërtim me volum prizmatik. Shtëpia e zjarrit zhvillohet në dy kate, e pajisur me vatër në mes dhe mafil, ballkon prej druri me parmak. Fillimisht kati I sipërm ka pasë dy mjedise, çardaku dhe oda e mdejtjes, më vonë kemi transformime. Në vitin 1981 është bërë restaurimi i pjesshëm.

Kulla e Tafë BASHES. Fshati Mafsheq.

Banesa është e tipit me gjysmë kat dhe e pajisur me “qoshk”, ambient për ndejtje. Kati përdhes i pjesës dykatëshe, ka shërbyer për strehimin e bagëtive, në katin e banuar kalohet nga një mjedis me përmasa të mëdha i cili përdorej dhe për gatim. Prej këtij kalohet te “oda e miqve” e cila është e pa suvatuar dhe pa tavan. Në pjesën veriore ndodhet qoshku karakteristik i cili del në formë konsoli. Restaurimi i banesës u krye në vitin 1985 me karakter konsolidues dhe mirëmbajtës.

Banesa e Hamit KALASE. (Muzeu Etnografik). Lagja Mustafa Karaci, qyteti Krujë.

Një nga banesat më të zhvilluara të variantit me një krah e ndodhur brenda mureve rrethuese të kalasë e cila ka si kufi më të vonë vitin 1764. Ajo ishte banesa, përfaqësuese e një familje të madhe feudale të Shqipërisë së mesme. Pranë saj ngrihej banesa e miqve. Megjithëse ndërtuar mbi truall të pjerrët, ajo ka zhvillim të barabartë vëllimor në të dy katet. Banesa meqenëse i përkiste aristokracisë feudale, paraqet tre karakteristike që e shkëpusin nga si motrat e saj. Së pari vjen në konsideratë çardaku i mbyllur me teknikën e skeletit të drurit, së dyti, zbukurimorja e kësaj banese e odës së miqve me dekoracione me ngjyrë mbi elemente e drurit vjen mjaft e pasur, së treti qenia e banjës së zhvilluar me hipokaust, është një dukuri e rrallë me këtë nivel realizimi në një banesë. Për vlerat që ka, ajo është kthyer në muze etnografik të Krujës.



Fig. 52: Pamje e banesës

Ansambli zejtar. Kryeshkozë

Ansambli zejtar përbehet nga dy mullinj drithi dhe një punishte për regjie lëkure. Përfaqëson një kompleks të rrallë që ruhet i plotë. Në të janë gërshetuar mirë vlerat arkitektonike të rrethit të Krujës me ato funksionale dhe etnografike.

Ansambli gjendet në qytetin e Krujes, në lagjen Shete, rrugës drejt lumit Droja. Sapo arrin në kroin Shkozë (ku kalon dhe rruga e vjetër me kalldrëm) gjenden dy mullinj të lidhur bashkë përmes një tuneli në të cilët bluhej drithi. Pak më poshtë kemi punishten e lekures, dëshmi e traditës së artizanatit në prodhimin e kepuçëve dhe të veshjeve.

Kisha e Gjon Pagëzorit. Fshati Derven

Kisha mesjetare e Gjon Pagëzorit, zbuluar në fshatin Derven të Krujës (dioqeza e Arbërit) perçjellin trakte afresku të çmuar me skena të Shën Mërise e cila mendohet të jetë e shekujve XIII-XIV. Afresket e kishës paraqesin Shën Palin, Shën Pjetrin, Shën Gjon Pagëzorin, si dhe Lajmërimin e Engjëllit Gabriel për virgjreshën Shën Mëri.

Gërmimi i deritanishëm tregon se kisha e Shën Gjon Pagëzorit, është një monument me vlera të veçanta arkitektonike dhe artistike. Zbulimi i plotë i saj do të ndihmojë për të hedhur bazat për një studim të dokumentuar sa më mirë për kishat e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut gjatë periudhës mesjetare.

3.2 Analiza mjedisore

3.2.1 Burimet natyrore

Flora dhe fauna

Flora dhe fauna, zënë vendin kryesor në mjedisin ku jetojmë. Duke qenë se Shqipëria ka një larmi relievi, cilësish edafike, të klimës e mikroklimës, kjo larmi ka favorizuar rritjen e një game të gjerë bimësh dhe specesh shtazore. Vlerësohet se rreth 30 % e të gjithë florës europiane është e pranishme në Shqipëri, ndërsa pyjet e larta janë strehë për komunitetet e kafshëve të egra, si dhe për komunitetet karakteristike të shpendëve të lidhur me pyjet e virgjër.

Shqipëria është një urë kalimi e rëndësishme e migracionit floristik dhe faunistik, sidomos të disa shpendëve, lakuriqëve dhe insekteve. Njohja e biodiversitetit në vendin tonë është ende e pamjaftueshme. Grupe të tëra të botës bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastuduara. Edhe për grupet e studiuara relativisht mirë, ende nuk është arritur njohja e plotë e pasurive llojore.

Territori i Bashkisë Krujë është i ndërthurur dhe është pjesë e këtij areali, ku janë të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe të florës mjaft të larmishme, për ruajtjen e të cilës duhet të kujdeset e të kontribuojë i gjithë komuniteti. Në këtë territor, takohen një sërë ekosistemesh si shkurre mesdhetare përherë të blerta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjerë e halorë dhe të përziera, livadhe e kullota.

Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit tonë. Në territorin e bashkisë Krujë, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të keqësuar apo në rrezik zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felis silvestris*).

Por përveç këtyre takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpira (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes faina* Elx.), Zardafi (*Martes martes* L.), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius* L.), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rrëqebulli (*Lynx*), etj.

Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit tonë janë: Thëllënza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Streptopelia decaocto*), Skifteri (*Accipiter nisus*), Gakthi (*Botaurus stelboris*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Butea lagopus*).

Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim, nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*), Bolla leopard (*Eiapha situla*), etj.

Mjediset pyjore

Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të territorit të Bashkisë Krujë do të jenë nën administrimin e saj. Jashtë kësaj sipërfaqeje ngelen ato zona të cilat gëzojnë statusin zonë e mbrojtur, zona këto të cilat do të jenë nën administrimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Siç dihet, pyjet dhe kullotat janë të shtrira pothuajse në të gjithë territorin e Bashkisë Krujë, por në masë më të madhe në zonat kodrinore dhe malore. Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullosor të Bashkisë Krujë është në rreth 129 km², ku brenda kësaj sipërfaqeje 98 km² janë pyje, 5.5 km² janë kullota, 10 km² janë tokë me bimësi pyjore ndërsa 15.5 km² janë sipërfaqe djerrë dhe tokë inproduktive. Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullosor e cila do të administrohet nga Bashkia Krujë shkon në rreth 90 km², ndërsa pjesa tjetër prej 39 km², të cilat janë shpallur Zona të Mbrojtura do të jenë nën administrimin e AKZM.

Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Krujë është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjorë që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga 30 e deri në lartësinë 1,800 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrale dhe të kultivuara.

Grupet kryesore të llojeve të drurëve janë:

1. Llojet halore;
2. Llojet gjethore.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

Pisha e butë (*Pinus pinea*), Pisha e egër (*Pinus halepensis*), Pisha e zezë (*Pinus nigra*), Pisha radiata (*Pinus Radiata*), Selvia (*Cupressus sempervirens*), Hartina (*Pinus sylvestris*), etj.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë:

Lisi (*Quercus pubescens*), Bunga (*Quercus Petraea*), Qarri (*Quercus cerris*), Ilqja (*Quercus ilex*), Akacia, Plepi i bardhë (*Populus alba*), Plepi i zi (*Populus nigra*), Shelgjet (*Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix fragilis*), Shkozat (*Carpinus betulus* dhe *Carpinus orientalis*), Frashëri gjethengushtë (*Fraxinus angustifolia*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), Gështenja (*Castanea sativa*), Arra (*Juglans regia*), Lajthia (*Corylus avellana*), Bliri (*Tilia ophissinalis*), Panja (*Acer platanoides*), Rrapi (*Pistacia orientalis*), Verri (*Alnus cortex*), Verri i zi (*Alnus glutinosa*), Dafina (*Laurus nobilis*), Bushi (*Buxus sempervirens*), Shqopa (*Erica arborea*), Mareja (*Arbutus unedo*), Thana (*Cornus mas*), Shqeme (*Rus coriaria*), etj.

Shpërndarja në bazë të sipërfaqes për speciet kryesore pyjore jepet në tabelën e mëposhtme (Tabela 9).

Tabela 9: Shpërndarja në bazë të sipërfaqes për speciet kryesore pyjore. Burimi: Kadastra e pyjeve dhe kullotave 2014 (Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Krujë)

Nr.	Lloji	Sipërfaqja (ha)
1.	Dushk	1,942
2.	Pisha e zezë	504
3.	Ah	713
4.	Shkozë	2,419
5.	Mare	835
6.	Pishë mesdhetare	1,215
7.	Lajthi	28
8.	Gështenjë	44
9.	Shqopë	431
10.	Panjë	303
11.	Akacie	16
12.	Frashër	155
13.	Plep	48
14.	Arrë	12
15.	Mërsinë	196
16.	Të tjera	933
Totali		9,794

Gjithashtu sipërfaqet pyjore dhe kullosore të Bashkisë Krujë janë mjaft të pasura edhe me një grup tjetër të rëndësishëm sikurse janë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere si: Trëndafili i egër (*Rosa canina*), Agulicja (*Primula veris*), Trumza (*Saturea montana*), Zhumbrica (*Thimus spergillum*), Çikorja (*Cichorium intybus*), Grami (*Cynodon dactylon*), Barpate (*Polygonum aviculare*), Thundërmushkë (*Tussilago farfara*), Luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), Netulla (*Verbascum thapsiforme*), Njëmijëfletëshi (*Aquillea miliefolium*), Lulekuqja (*Papaver rhoeas*), Sherebela (*Salvia officinalis*), Lisna (*Thymus longicaulis*), Mjedra (*Rubus idoeus*), Xina (*Pistacia lentiscus*), Bari i gjarpërit (*Teucrium chamaedrys*), Zogela (*Frangula alnus*), Shpendra (*Helleborus edours*), Gjuhënujsja (*Ononis spinosa*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Rigoni i kuq (*Origanum vulgare*), Veronika mjekësore, (*Veronica officinalis*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), Xherrokulli (*Colchicum autumnale*), Murrizi (*Crataegus monogyna*), Gjineshtra (*Spartium junceum*), Driza (*Paliuris aculeatus*), Rushkulli (*Ruscus aculeatus*), Vjeshtull lisi (*Viscum album*), Salepi (*Orchis mascula*), Bliri, Dëllinjat, Hithra (*Urtica dioica*), etj.

Mjedisi i kullotave

Kullotat natyrore përbëjnë bazën e të ushqyerit të bagëtive dhe për këtë arsye në periudhën komuniste, u ndoq një politikë shkatërruese e hapjes së tokave të reja e mishëruar në parullën “T’u qepemi kodrave e maleve e t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat”. Kjo gjë i solli një dëm të jashtëzakonshëm fondit pyjor dhe kullosor në Shqipëri, duke prekur dhe dëmtuar rëndë një ansambël të vërtetë kullosor natyror. Qindra e mijëra ha pyje, kullota, livadhe e muzha me florë shekullore të mrekullueshme u shkatërruan duke u kthyer në mënyrë krejt të papërshtatshme, në sipërfaqe të kultivuara me bimë të ndryshme bujqësore.

Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Krujë, sipas të dhënave të marra nga Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor, (Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë), kanë një

sipërfaqe të përgjithshme prej 548 ha, e cila sipas periudhës të shfrytëzimit të tyre jepet në tabelën e mëposhtme (Tabela 10).

Tabela 10: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Krujë. Burimi: Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor (Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë)

Tipi i kullotës (ha)	
Dimërore	Verore
281	267

Energjia gjeotermale

Një nga pasuritë natyrore të territorit përreth qytetit të Krujës janë burimet dhe pusët me energji gjeotermale të entalpisë së ulët, që fontanojnë ujë të nxehtë. Ato bëjnë pjesë në zonën gjeotermale të Krujës, e cila është një nga zonat me burime gjeotermale më të mëdha në Shqipëri. Ajo ka një shtrirje të përgjithshme prej 180 km dhe gjerësi 4 - 5 km. Zona fillon nga bregdeti i Adriatikut në veriperëndim të Tiranës dhe vazhdon në juglindje, në Përmet dhe në territorin grek. Kjo zonë ka burime gjeotermale të identifikuar 5.87×10^8 - 5.08×10^9 GJ dhe rezerva specifike 38.5 - 39.6 GJ/m².

Këto ujëra termale përbëjnë ende një pasuri të pashfrytëzuar. Informacion interesant kanë dhënë shpimet e naftës në strukturat e Ishmit dhe Kozanit, ku gjatë shpimit është evidentuar prania e ujërave me debite të kënaqshme dhe temperatura që luhaten në vlerat 60 - 87 °C.

Mundësia e shfrytëzimit të këtyre ujërave termale për prodhimin e energjisë, sidomos duke patur parasysh faktin se futen në grupin e burimeve natyrore të pashtershme dhe të rinovueshme, përmendet edhe në Programin Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim 2003 - 2005 dhe mbetet për t'u studjuar në detaj. Përdorimi i këtyre ujërave kurativë është i hershëm dhe dëshmohet nga rrënojat e termave romake të zbuluara në këtë territor. Megjithatë, në ditët e sotme ky përdorim për efekte kurative bëhet me metoda primitive (qendra kurative reumatizmale në Bilaj) duke qenë shumë pak atraktive.

Pasuritë minerare

Këtu bëjnë pjesë argjilat, guri gëlqeror, zallishtet e lumit, etj. Sipërfaqja aktuale e kodrave e shfrytëzuar si gur gëlqeror për fabrikat e çimentos në vitin 2007 arrin në 0.95 km². Ndërkohë rezervat e gurit gëlqeror llogariten në 942,000 ton dhe sipas ritmit të shfrytëzimit nga fabrikat prej 2,500,000 ton/vit, këto rezerva mund të zgjasin për 40 vjet. Po ashtu, edhe rezervat e argjilës janë rreth 15,000,000 ton dhe me shfrytëzimin aktual të fabrikave të çimentos prej 400,000 ton/vit, këto rezerva mund të zgjasin për 40 vjet. Shfrytëzimi aktual i kodrave për argjilë bëhet në një sipërfaqe totale prej 0.18 km² nga fabrikat e çimentos dhe tullave. Guroret në kodra dhe zallishtet e lumit shfrytëzohen si materiale ndërtimi dhe inerte.

3.2.2 Zonat e mbrojtura natyrore

Zona e mbrojtur Parku Kombëtar i Qafë Shtamës zë një sipërfaqe prej 2,000 ha. Parku Kombëtar në Qafë Shtamë prezanton një biodiversitet të lartë, duke u përfaqësuar me një shumëllojshmëri habitatesh dhe llojesh, por njëkohësisht dhe me vlera të larta turistiko-rekreative.




Fig. 53: Pamje nga Parku Kombëtar i Qafë Shtamës

Aspekti më me vlerë vegjetacional është shoqërimi bimor Forsythio-Pinion, specifik për vendin tonë, ndërkohë që Forsythia europea është specie endemike. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së këtij parku mbulohet nga pyjet e pishës dha ato të ahut. Kjo zonë është një ndër zonat më të preferuara malore të Bashkisë Krujë pasi ajo spikat vlera të larta peizazhore, estetike, shlodhëse dhe kurative. Përsa i takon gjëndjes mjedisore ajo nuk paraqitet e mirë për arsye të ndërhyrjeve negative të faktorit human.

Kufinj të dixhitalizuar përfshijnë:

- Në Veri: Kuota 1,010 m (L440360.61, V4601656.95), ndjek kurrizin ujëndarës deri te maja e Rjepës së Qetkos në kuotën 1,686.0 m (L4405648.52, V4601700.80), maja e Liqenit në kuotën 1,724.0m (L4406729.58, V4601369.05);
- Në Lindje: Maja e Liqenit në kuotën 1,724.0m (L4406729.58, V4601369.05), ndjek kurrizin që zbret në Qafë Shtamë, kalon Qafën e Shtamës deri në kuotën 1,479.0 m (L4409183.42, V4598160.18);
- Në Jug: Kuota 1,479.0 m (L4409183.42, V4598160.18), Qafa e Ljarit, në kuotën 1,228.3 m, Maja e Zethit në kuotën 1,112.0 m (L4406414.99, V4596640.59);
- Në Perëndim: Maja e Zethit në kuotën 1,112.0 m (L4406414.99, V4596640.59), ndjek përroin dhe kuotat 650.0 m, 709.0 m, 525.0 m, në krah të rrugës Ndojë - Cudhin - Qafë Shtamë, Qafën e Cudhinit, kuota 761.0 m, në krah të rrugës Cudhin - Shkretë, kuotat 749.0 m, 800.0 m 990.0 m deri në kuotën 1,010 m (L440360.61, V4601656.95).

Monumentet e natyrës

Një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike apo turistike janë dhe monumentet natyrore, të cilët sipas klasifikimit të IUCN bëjnë pjesë në kategorinë e III të zonave të mbrojtura.

Brenda territorit të Bashkisë Krujë takohet një numër i konsiderueshëm monumentesh natyrore të cilët shtrihen pothuajse në të gjithë sipërfaqen e saj, gjë kjo e cila reflektohet më poshtë.

- **Sarisalltiku dhe shpella**




Fig. 54: Pamje nga Sarisalltiku

Ndodhet në lindje të qytetit të Krujës, në pjesën më të sipërme të shpatit perëndimor të Malit të Krujës. Disa dhjetra metra poshtë pjesës së sheshtë të malit gjendet shpella e Sarisalltikut. Është formuar nga karsti në shkëmbinjtë gëlqerorë. Qysh shumë herët është përdorur si objekt kulti për besimtarët bektashianë. Është e thellë rreth 10 - 15 m dhe e lartë deri 3 - 4 m. Brenda saj ndodhet edhe një burim i vogël, vlerat e të cilit në stinën e verës janë shumë të mëdha, veçanërisht për besimtarët që ngjiten shpatit të pjerrët të malit. Tek shpella ata kryejnë ritin fetar, ndërsa uji i burimit u shuan etjen e vapës së verës. Kjo shpellë nuk ka stalaktite e stalagmite, pasi duhet të jenë dëmtuar herët nga besimtarët, sigurisht jo me qëllim. Ajo vizitohet shumë nga banorët e Krujës e zonave përreth, pavarësisht në se janë bektashinj, të krishterë, etj.

- **Gryka e Vajës ose Shkëmbi i Vajës**

Ndodhet në veri të qytetit të Krujës, në pjesën me veriore të Malit të Krujës. Në shpatin e majtë të saj kalon rruga automobilistike Krujë - Qafë Shtamë. Është grykë antecedente, e formuar nga gërryerja e lumit të Drojës, mbi shkëmbinjtë gëlqerorë prej miliona vjetësh. Gjatësia e saj kalon 1 km e gjerësia mesatare është rreth 50 m. Ka sektorë me gjerësi 5 - 6 metrat. Shpatet e grykës kanë lartësi deri në mbi 200 m e pjerrësi gati vertikale. Në to ka guva karstike, por mund të ketë edhe shpella. Në shtratin e përroit ka blloqe shkëmbore të mëdhenj, pellgje me ujë të pastër, etj.

Thuhet se pas pushtimit të Krujës me 16 qershor 1478, 90 gra e vajza krutane, për të mos rënë në duart e turqve mizorë, u kapën dorë më dorë dhe u hodhën nga shkëmbi me lartësi deri 200 m. Këtë ngjarje shumë tragjike populli i Krujës e ka përkujtuar për shumë vite. Ata hidhnin lule dhe vajtonin trimëreshat. Prej këtij vajtimi të përvitshëm mori emrin Shkëmbi i Vajës.



Fig. 55: Pamje nga Shkëmbi i Vajës

- **Gryka e Zezë**

Ndodhet në lumin e Zezës, aty ku ajo ndan Malin e Krujës në veriperëndim dhe të Brarit (Gamtit) në juglindje. Është grykë e ngushtë antecedente me gjatësi disa qindra metra (1 - 2 km) e lartësi të shpateve mbi 200 m. Ujërat e lumit të Zezës prej miliona vitesh kanë çarë shkëmbinjtë gëlqerorë. Në shtratin e lumit ka blloqe të mëdhenj shkëmbore të shkëputur nga faqet e grykës. Përgjatë shtratit ka edhe gropore dhe pragje të vegjël të formuara nga uji. Në faqet e grykës ka guva karstike, ndoshta dhe shpella. Peizazhi i këtij monumenti është shumë tërheqës, veçanërisht i përshtatshëm për piknike të grupmoshës së re. Ka vlera natyrore, gjeografike, biologjike, gjeologjike dhe estetike të karakterit vendor. Vizitohet duke marrë rrugën Tiranë ose Fushë Krujë - Gryka e Zezë.




Fig. 56: Pamje nga Gryka e Zezë

- **Selvia e Teqesë (Fushë Krujë)**

Është dru krejt i veçantë në krahasim me të tjerët e takuar në vende të ndryshme, pasi kurora dhe trugu i saj janë krejt të veçanta. Ndodhet në veri të Fushë Krujës, në të djathtë të rrugës automobilistike Fushë Krujë -Thumanë. Pranë këtij monumenti është Teqeja. Banorët e njohin edhe me emrin Qiparisi i Teqesë. Lartësia e selvisë është rreth 25 m, por kurora e saj është dëmtuar nga shkarkimet atmosferike (rrufetë). Në

lartësinë rreth 1,5 m mbi sipërfaqen e tokës trugu i saj ka perimetrin rreth 7,2 m. Këtu dalin disa degë të saj në formën e shpatullave me hulli në mes. Me të vërtetë ajo është mahnitëse për çdo vizitor. Moshë e saj mund të jetë mbi 500 vjeçare.



Fig. 57: Pamje nga Selvia e Teqesë

- **Rrapi i Buranit**

Ndodhet në Buran, Njësia Administrative Nikël, 500 m mbi nivelin e detit. Përbën një dru me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 1,5 m dhe moshë mbi 400 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohet duke marrë rrugën automobilistike Krujë - Nikël - Buran.



Fig. 58: Rrapi i Buranit

- **Pisha e Zezë në Qafë Shtamë**

Ndodhet në brendësi të territorit të Parkut Kombëtar të Qafë Shtamës, Njësia Administrative Cudhin, në lartësinë nga 1,150 m në 1,220 m mbi nivelin e detit. Përbën një pyll pishe të zezë me lartësi mesatare të drurëve 13 m, diametër të trungut 30 - 40 cm dhe moshë mbi 25 - 30 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike),

kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohet duke marrë rrugën automobilistike Krujë - Qafë Shtamë. Aktualisht ka dëmtime nga zjarri.



Fig. 59: Sipërfaqe të mbuluara nga Pisha e Zezë në Qafë Shtamë

- **Kroi i Nënës Mbretëreshë**

Ndodhet në Parkun Kombëtar të Qafë Shtamës, në lartësinë rreth 1,100 m mbi nivelin e detit. Pranë ka pyje të dendur pishe, pjesë e parkut kombëtar të Qafë Shtamës. Emrin e ka marrë qysh në vitet 20' të shekullit XX, pasi prej këtu merrej uji që pinte familja mbretërore në Tiranë. Tashmë ajo është disi e rregulluar me mure të thjeshta guri. Ka ujë gjithë vitin. Peizazhi përreth me pyll të dendur, disa prroska që zbresin nga mali me plot gurgullimë, cicërimat e shpendëve të pyllit, ajri i pastër, etj, joshin çdo vizitor. Pranë saj është një qendër klimaterike për sëmundjet e mushkërive, ka disa kabina pushimi dhe një impiant për ambalazhimin e ujit të pijshëm “Qafshatama”. Monumenti ka vlera natyrore, hidrografike, estetike dhe historike.



Fig. 60: Pamje nga Kroi i Nënës Mbretëreshë

- **Rrapi ose Çinari i Bretit**

Ndodhet në Bashkinë e Krujës, rreth 240 m mbi nivelin e detit. Përbën një dru me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut rreth

4 m dhe moshë mbi 800 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohet duke marrë rrugën automobilistike Krujë - Bret (5 km).



Fig. 61: Rrapi i Bريت

- **Rrapi i Ballabanecit (Krujë)**

Ndodhet pak më në veriperëndim të qendrës së qytetit të Krujës, në të majtë të rrugës Krujë - Gryka e Vajes. Diametri i trungut është rreth 2 m, por shumë i zgavëruar, pasi shpesh është djegur, fillimisht nga rrufeja që dëmtoi degët e më pas banorët e pakujdesshëm kanë hedhur pranë tij mbetjet urbane. Ka rreth 10 vjet që rrapi ka nisur të nxjerrë degë të reja, të cilat tashmë kanë lartësinë 5 - 6 m. Sipas gojëdhënës, emri i këtij monumenti lidhet me atë të Ballaban Pashës, i cili erdhi për të pushtuar kalanë e Krujës, por nuk mundi t'i afrohej. Pikërisht tek rrapi Ballabani ngeci (ose siç thonë krutanët, neci). Prej këtij rrapi u quajt vendi ku Ballabani neci!




Fig. 62: Rrapi i Ballabanecit

- **Rrapi i Taslloit (Krujë)**

Ndodhet pranë murit të pjesës veriore të Kalasë së Krujës. Afër tij ka shtëpi banimi dhe një burim, që nuk shteron as në verë. Disa shkallë të gurta nisin nga sheshi i vogël

e ngjiten në brendësi të kalasë. Në stinën e verës vizitorët pushojnë nën hijen e rrapit, freskohen në ujin e ftohtë e ngjiten në kalanë e famshme të Krujës, tepër e njohur dhe me emër në historinë e Shqipërisë. Prej aty soditin me kënaqësi pjesën më të madhe të qytetit të Krujës dhe shpatin perëndimor të Sarisalltikut. Rrapi i Taslloit ka vlera natyrore, estetike e biologjike. Gjerësia e trungut është rreth 1,5 m, por i zgavëruar nga zjarri.



Fig. 63: Rrapi i Taslloit

- **Rrepet e Arramerasit (Fushë Krujë)**

Janë grupe drurësh prej rrapit, të cilat ndodhen pranë fshatit Arrameras, në të djathtë të rrugës automobilistike Kamëz - Fushë Krujë. Pranë tyre është kisha katolike Santa Chiara, e cila, ndoshta fillimet i ka në vitin 1200 dhe është përdorur gjatë nga Skënderbeu. Kisha është rindërtuar në vitet 1991 - 1992. Territori i kishës, ku ndodhen edhe drurët e rrepeve, është rrethuar me mur. Lartësia e drurëve i kalon 20 m, ndërsa trungjet kanë diametër 1 - 1,3 m. Drurët me të vjetër janë dëmtuar e prerë. Mbetjet e trungut të tyre tregojnë se diametri ka qenë rreth 2 m. Ky monument ka vlera natyrore, biologjike, estetike dhe fetare. Vizitohet duke marrë rrugën Tiranë ose Fushë Krujë - Arrameras.



Fig. 64: Rrepet e Arramerasit

3.2.3 Evidentimi i problemeve mjedisore, hotspote, burimet e ndotjes dhe ndikim në shëndetin publik.

Aktivitetet me impakt mjedisor

Ndotësi kryesor i Bashkisë Krujë ndër vite është cilësuar aktiviteti i furrave të shuarjes së gëlqeres. Këto veprimtari ndikonin negativisht në mjedis duke krijuar ndotje në tokë, ujë dhe ajër. Këto aktivitete vepronin në mënyrë të pakontrolluar duke mos respektuar asnjë normë për mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2013 u krye një aksion për mbylljen e këtyre aktiviteteve pasi u cilësuan si tejet ndotës dhe krejtësisht jashtë standardeve të përcaktuara në legjislacionin mbi mjedisin.

Shpyllëzimi është një faktor kryesor përse i përket ndikimit në mjedis, pasi ndikon në cilësinë e ajrit, si edhe në rritjen e shkallës së erozionit.

Shpyllëzimi fatmirësisht nuk është një fenomen që është i përhapur masivisht Bashkinë Krujë, por nuk përjashtohen raste sporadike të shpyllëzimeve nga banorë të zonës për përdorim vetiak.




Fig. 65: Aktivitetet me impakt mjedisor

Guroret kanë potencial ndikimi negativ në mjediset ujore, kryesisht nëse ndodhen afër burimeve ujore, pasi aktiviteti i shfrytëzimit në gurore mund të çojë në ndryshimin e cilësisë së ujit të pijshëm për shkak të penetrimit në thellësi të ujërave të shplarjes që përdoren në gurore, si dhe ndotësve të tjerë. Gjithësesi, impakti më evident i guroreve në mjedis, është ai i ndryshimit të peisazhit. Vlen për t'u përmendur edhe fakti që ky lloj aktiviteti mund të ndikojë negativisht edhe në cilësinë e ajrit. Në hartën shoqëruese të këtij raporti guroret shënohen me ngjyrë vjollcë.

Qendra e stokimit të mbetjeve urbane: Bashkia Krujë aktualisht ka vetëm një pikë për depozitimin e mbeturinave urbane. Kjo pikë pozicionohet jashtë zonës urbane rrugës për në Krastë. Gjendja funksionale e saj është jo e mirë, pasi është e mbingarkuar. Në këtë pikë depozitimi, mbetjet vetëm depozitohen dhe nuk bëhet asnjë proces tjetër (ndarja e materialeve të reciklueshme, të rrezikshme etj, apo trajtimi i tyre). Kjo pikë në hartë është shënuar me ngjyrë të verdhë.

Gjithashtu Bashkia Krujë ka planifikuar të ndërtohet një pikë e re e grumbullimit të mbetjeve urbane dhe që të plotësojë kushtet për të qenë një qendër stokimi teknike. Zona e propozuar nga Bashkia Krujë është shënuar në hartë me ngjyrë bojë qielli.

Fabrikat e çimentos: Bashkia Krujë në territorin e saj ka 2 fabrika çimentoje. Fabrikat e çimentos në rast se nuk monitorohen mund të kenë impakt negative në mjedis. Impakti kryesor është në cilësinë e ajrit pasi fabrikat e çimentos gjatë procesit çlirojnë sasi të konsiderueshme të CO, SO₂, NO_x dhe gjithashtu ndikojnë në rritjen e sasisë së grimcave të pluhurit në ajër me diametër 10 mikrometër ose edhe më të vogël (PM₁₀). Në hartë, fabrikat e cimentos janë shënuar me ngjyrë rozë.

Fabrika e tullave: Në Bashkinë Krujë ka 1 fabrikë tullash. Fabrikat e tullave në rast se nuk monitorohen në mënyrën më të mirë mund të jenë burim ndotje për mjedisin përreth. Gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre, këto fabrika çlirojnë në sasi të mëdha: monoksid karboni (CO), okside të squfurit (SO_x), okside të azotit (NO_x) si edhe grimca të pluhurit në ajër me diametër 10 mikrometër ose edhe më të vogël (PM₁₀). Fabrikat e tullave janë shënuar në hartë me ngjyrë rozë të çelët.

Industria fasone e prodhimit të këpucëve: Në Bashkinë Krujë është shumë i zhvilluar biznesi fason. Për sa i përket pjesës së këtyre bizneseve që merren me prodhimin e këpucëve apo të prodhimeve të ngjashme prej lëkure, edhe pse produktet importohen të përgatitura vetëm për montim, është i nevojshëm trajtimi i efluentëve të këtyre industrivë të cilat janë të pasura me solventë apo kimikate të tjera të përdorura gjatë procesit. Trajtimi i këtyre efluentëve të ndotur mund të bëhet brenda teritorit të industrisë nëpërmjet impianteve të ndërtuara për këtë qëllim ose të evadohen dhe trajtohen nga një shoqëri e specializuar dhe e liçensuar për të ushtruar trajtimin e mbetjeve.

Aeroporti " Nënë Tereza ": Përbën një nga burimet më të mëdha gjeneruese të ndotjes së ajrit, kryesisht nëpërmjet emetimit të gazeve serrë, si pasojë e përdorimit të sasive të mëdha të karburantit (kerosen).

Analiza mjedisore - Gjendja ekzistuese

Analiza mjedisore ka për qëllim të kontribuojë nga njëra anë në ruajtjen dhe rikuperimin e elementëve natyrorë që vijnë gjithmonë duke u zvogëluar për shkak të urbanizimit gjithnjë e më të shpejtë, dhe nga ana tjetër, favorizimin e zhvillimit të ekuilibruar në të gjithë sipërfaqen e territorit që përfshin PPV i Bashkisë Krujë.

Informacionet e nevojshme lidhur me PPV, alternativat e marra në shqyrtim, përcaktimi i ndikimeve mjedisore dhe socio-ekonomike si rezultat i aplikimit të PPV në territorin e planifikuar, do të jepen në vijim në Raportin Mjedisor.

Ndërsa më pas, Vlerësimi Strategjik Mjedisor si pjesë e PPV të Bashkisë Krujë, merr në konsideratë gjendjen ekzistuese të mjedisit në territorin e bashkisë, jep vlerësimin mjedisor për masat e propozuara nga PPV, përcakton fazat e monitorimit dhe indikatorët, institucionet përgjegjëse për procesin e monitorimit dhe risqet e pritshme të cilat mund të çojnë në mosrealizimin e masave.

Biodiversiteti

Flora kryesisht karakterizohet nga bimësi tipike për rajonet e Mesdheut si shkurret makje, pemë ulliri e egër dhe e kultivuar, pisha, lisi etj. Por kryesisht zonat kodrinore pranë fabrikave të industrisë së rëndë janë pothuajse të shkretuara nga bimësia si pasojë e shpyllëzimeve masive dhe prerjeve pa kriter. Gjithashtu edhe fauna në këto zona është pothuajse e dëmtuar, ku shumë popullata shpendësh si shapka, thëllëza apo mëllenja kanë migruar duke e varfëruar zonën. Përveç migrimit të popullsisë në këto zona është e përhapur edhe gjuetia e paligjshme duke çuar në zvogëlimin e numrit të popullsisë së lepurit dhe dhelprës së egër. Brenda territorit të bashkisë ndodhen disa rezervuare ujore të cilët më parë përdoreshin për sistemin e ujitjes, ndërsa sot janë lënë pas dore.

Bujqësia dhe blegtoria

Bashkia Krujë ka hapësira të mëdha me toka bujqësore të cilat janë të pasura më tre elementët kryesorë jetësorë për bimët si fosfor, kalium dhe azot dhe klasifikohen si toka bujqësore të pasura dhe të përshtatshme për kultivimin e pemëve frutore, perimeve dhe vreshtarisë. Ndërsa blegtoria karakterizohet nga ferma individuale të cilat janë të alternuara në bujqësi dhe blegtori. Kryesisht blegtoria në këto zona kushtëzohet nga mundësia për kullotje, faktorë të tjerë dhe gjëndja jo e mirë shëndetësore e gjedhëve.

Ndotja akustike

Qyteti i Krujës, ai i Fushë Krujës dhe fshatrat përreth janë nën ndikimin e vazhdueshëm të zhurmave të shkaktuara nga aktivitetet e industrisë së rëndë, si fabrikat e çimentos dhe e tullave. Mospërdorimi i rregullt i silenciatorëve nga ana këtyre industrive ka çuar në ndotje akustike të madhe për zonat ku ato operojnë (mbi 55 dB gjatë ditës). Gjithashtu ndotje akustike në territor kemi edhe nga trafiku i rënduar në qendër të qendrave të banuara, si pasojë e automjeteve të rënda të cilat transportojnë lëndë ndërtimi.

Ndotja e ajrit

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit vijnë nga emetimet e fabrikave të industrisë së rëndë (mungesa e filtrave) duke emetuar në ajër sasi të mëdha të PM10, (230

mg/m³)¹⁵, CO₂, SO₂, LNP etj. Një problem për ajrin e territorit janë edhe gropat ilegale të djegies së gëlqeres të cilat ndonëse janë mbyllur gjatë fushatave të ndërmarrja ngë institucionet përkatëse, banorët i kanë hapur sërish për t'i përdorur si mjet jetese. Një pjesë e tyre përdorin si lëndë djegëse plastikën, goma apo materiale këpucësh, të cilat emetojnë në ajër lëndë toksike me pasoja shumë të rënda jo vetëm në mjedis por edhe në shëndetin e njerëzve. Trafiku i rënduar i automjeteve në qytet, sjell një ndotje të madhe të qytetit nga emetimi i lëndëve djegëse fosile si CO₂, SO_x, NO_x, etj. Gjithashtu një burim tjetër për ndotjen e sipërfaqeve tokësore është emetimi i elementëve ndotës si CH₄ dhe N₂O nga djegia e mbetjeve urbane (nga individë) dhe vetëndezja e tyre në fushë-depozitim dhe në pikat ilegale të territorit të bashkisë. Sasi të mëdha të këtyre elementëve sjellin probleme të mëdha në mjedis (ngrohje globale) dhe në shëndetin e njerëzve.

Ndotja e tokës

Një problematikë tjetër për territorin e Bashkisë Krujë është edhe ndotja e tokës nga burime të ndryshme. Së pari, është shpyllëzimi intensiv i kodrave të Krastës për nxjerrjen e lëndës së parë për fabrikat e industrisë së rëndë (çimento dhe tulla), duke sjellë varfërim të tokës dhe mundësi për dukuri erozioni dhe rrëshqitje dheu. Fushë-depozitimi i mbetjeve urbane është jashtë çdo standarti higjeno-sanitar; mungon shtresa izoluese me tokën, duke sjellë në këtë mënyrë depërtimin e liksivateve në shtresat e tokës. Gjithashtu në territor janë të përhapura edhe shumë pika ilegale të depozitimit të mbetjeve, duke sjellë edhe ndotjen e këtyre sipërfaqeve tokësore. Disa zona pranë brigjeve të lumenjve janë shumë të paqëndrueshme ndaj dukurisë së erozionit. Në qytetin e Fushë Krujës ndodhen zonat ish-industriale të cilat kanë më se 20 vjet që kanë dalë jashtë funksionit. Gjatë viteve, në sipërfaqen tokësore ku ato janë vendosur këto fabrika, janë emetuar lëndë të ndryshme ndotëse me origjinë nga llojet e industrisë kimike dhe industrisë së lehtë të zhvilluar. Gjithashtu një dukuri tjetër që ndikon edhe në ndotjen e tokës janë edhe gropat ilegale të gëlqeres. Përbërësit e gëlqeres (CaO) modifikojnë tokën duke e varfëruar atë nga vlerat e saj.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Rrjeti i dëmtuar i kanalizimeve të ujërave të zeza është ndër burimet kryesore të ndotjes së sipërfaqeve ujore. Ato bashkohen më ujrat atmosferike (mungesë e rrjeteve separate) dhe derdhen të gjitha në rrjedhat natyrore në territor, duke dëmtuar ekosistemin ujqor të lumenjve, pasi shkarkimet e ujërave të përdorura urbane përmbajnë sasi të mëdha të amoniakut (NH₄⁺) dhe joneve fosfat. Përqindja e lartë e këtyre elementëve ul sasinë e oksigjenit të tretur në ujë, rritjen e NBO dhe NKO duke sjellë eutrofizimin e ujërave.

Një burim tjetër për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore janë mbetjet e ngurta urbane. Fushë-depozitimi i mbetjeve është jashtë çfarëdo lloji kushti higjeno-sanitar duke lejuar që liksivatet të depërtojnë në shtresat e tokës dhe në ujërat nëntokësore duke i ndotur ato. Gjithashtu brigjet e lumenjve janë kthyer në një vend depozitim mbetjesh, pasi jo vetëm bizneset që janë në të dy anët e tyre, por edhe banorët depozitojnë mbetjet atje. Ato transportohen nga rrjedha e lumit duke shtuar sasinë e lëndës së ngurtë në sipërfaqet ujore dhe ndotjen e tyre.

Konkluzione

Lidhur me sa u vu në dukje më sipër, PPV për bashkinë Krujë duhet të fokusohet në problemet e mëposhtme mjedisore, duke dhënë në të njëjtën kohë edhe rekomandimet për zbutjen ose eliminimin e tyre:

1. *Ndotja dhe dëmtimi thuajse në një shkallë të pakthyeshme i mjedisit që u trashëguan nga periudha para viteve 90' si hapja e tokave të reja bujqësore dhe dëmtimi i pyjeve dhe kullotave, të cilat sollën erozionin e zonave kodrinore dhe prishën ekosistemet dhe ekuilibrat natyrorë të zonës.*
2. *Ekosistemet dhe burimet natyrore kanë pësuar dëmtime dhe në vitet e fundit: janë zvogëluar e vazhdojnë të zvogëlohen çdo ditë sipërfaqet pyjore, dhe bilanci i rritjes së vëllimit drunor është negativ. Për pasojë ka varfërim të faunës dhe florës, zvogëlim të hapësirave të habitateve dhe rreziku i zhdukjes së specieve të veçanta është aktual.*
3. *Nga ana tjetër, ka shfrytëzim intensiv dhe të paligjshëm të burimeve minerare, kryesisht për prodhimin e materialeve inerte të ndërtimit (zhavorr dhe gëlqere), të cilat kanë dëmtuar territorin dhe peizazhet.*
4. *Nxjerrja e lëndës së ndërtimit nga lumenjtë, shkakton nivele të larta sedimentimi si pasojë e gërryerjeve të shtratit të lumenjve, erozion të tokës, etj.*
5. *Ndotja e ajrit mbetet problem për qendrat urbane kryesore të bashkisë Krujë, dhe kjo shkaktohet kryesisht nga trafiku i makinave, pluhuri i ndërtimeve apo rrugëve të prishura, djegia/vetëdjegia e mbeturinave në vendepozitime dhe nga aktiviteti i jashtëligjshëm i furrave të djegies së gëlqeres.*
6. *Menaxhimi i ujërave të ndotura urbane është një nga pikat mjedisore më të nxehta për të gjithë territorin e Bashkisë. Përveç mungesës dhe gjendjes së amortizuar të rrjetit të kanalizimeve në një pjesë të mirë të territorit, mungesa e një rrjeti separativ, si dhe e impianteve të trajtimit të këtyre ujërave, kanë një ndikim tepër negativ mbi cilësinë e mjedisit dhe shëndetit njerëzor.*
7. *Po ashtu, i një të njëjtës rëndësi si dhe ujërat e përdorura, është edhe menaxhimi i mbetjeve urbane, depozitimi i të cilave në mënyrë të pakontrolluar, ka çuar në dëmtime të peisazhit, në degradim të cilësisë së ujërave, tokës dhe përkeqësimit të cilësisë së jetës për popullsinë.*
8. *Dhe së fundmi, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe sistemit të furnizimit me ujë të popullsisë. Studimi do të thellohet në disa aspekte si: shtrirja e shërbimit edhe në zonat të cilat nuk e kanë, rillogaritja e kapaciteve të të gjithë komponentëve të sistemit (linja e jashtme, rezervuar, rrjeti shpërndarës), sigurimi i cilësisë së ujit për konsum.*

3.3 Përdorimi ekzistues i tokës; Aktivitetet dhe ndikimet e tyre

3.3.1 Ndarja në 5 sisteme bazë

Në këtë kapitull bëhet një pasqyrë e gjendjes ekzistuese e territorit, sipas koncepteve të ndarjes në pesë sisteme territoriale bazë, që dalin nga përcaktimet e kuadrit ligjor për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit¹⁶. Sa më sipër, me sistem territorial duhet të kuptojmë:

“Sistem territorial është bashkësia e një sërë përbërësish territorialë, të ndërruar dhe bashkëveprues me njëri-tjetrin, të cilët formojnë një tërësi”

Referuar këtij kuadri ligjor, njësitë e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në sisteme territoriale, si më poshtë:

- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujor (U);
- Sistemi infrastrukturor (IN).

Bazuar në këto sisteme, ekspertët multi-disiplinar të angazhuar në hartimin e PPV-së hedhin bazat e analizës metabolike¹⁷, me qëllim që të ofrojnë çasjet e duhura strategjike për zhvillimin e territorit. Këto sisteme organizohen në marrëdhënie mes qendrave, korridoreve dhe zonave, mbi bazën e të cilave do të detajohet dokumenti i PPV-së. Duhet theksuar fakti që ndarja në sisteme territoriale bazë nuk është vetëm përcaktim për përdorimin e tokës (land-use), por edhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përputhje me karakteristikat primare të sistemeve.

Duhet patur parasysh që analiza metabolike (në planifikimin e territorit), nuk është më një term teorik i përdorur nga studiuesit e kësaj fushe, por një kërkesë ligjore në procesin e planifikimit. Përmes saj, pesë sistemet bazë analizohen, jo si të veçantë, por në ndërveprim me njëri-tjetrin dhe nëpërmjet një hulumtimi multi-disiplinar arrihen të përcaktohen “pikat e ekuilibrit” të një zhvillimi të qëndrueshëm. Më konkretisht, më mbivendosjen dhe ndërthurjen e këtyre sistemeve, zbulohen ato pika (apo çështje) strategjike që lidhen direkt me sfidat dhe mundësitë e zhvillimit.

Duke marrë në konsideratë hierarkinë e instrumentave të planifikimit, në vijim, përshkrimi i secilit sistem bazë për territorin e Bashkisë Krujë do të jepet i gërshetuar edhe me parashikimet kryesore që vijnë nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Ndërsektoriale, në lidhje me territorin e kësaj bashkie.

Për të realizuar një skenar të integruar e të qëndrueshëm urban propozohet një model i cili ndan e më pas studion ndërveprimin e sistemeve të zhvilluara në territor. Siç

¹⁶ Përcaktimet kryesore për sistemet territoriale jepen në Nenin 73, VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”

¹⁷ Kuptimi i “Metabolizmit” si model jepet në Nenin 2 të VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”

përmendet në dokumentin e Draft PPK, vizioni dhe realizimi i objektivave të një zhvillimi të qëndrueshëm arrihet duke iu referuar analizës së sistemeve territoriale.

Përdorimi i tokës në bashkinë Krujë paraqitet në tabelën në vijim, ku vihet re se toka bujqësore zë rreth 50% të territorit dhe rreth 35% përbëhet nga pyje.

Tabela 11: Përdorimi i tokës rrethi Krujë (Burimi: Qarku Durrës)

Përdorimi tokës		Sip. (ha)	%
Tokë bujqësore:		16354	49.0
	Arë	11748	35.2
	Pemtari	1609	4.8
	Vreshtë	699	2.0
	Ullishte	1541	4.6
Kullota natyrore		1516	4.5
Tokë jobujqësore		1481	4.4
Pyje		11350	34.0
Total		33298	100.0

3.3.2 Sistemi urban

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.

Për objektivat që sistemi urban rekomandon sipas Draft PPK do të kishim prodhimin e politikave të fokusuara në zhvillim policentrik, densifikim dhe gjithëpërfshirje.

Për të zbutur pabarazinë e krijuar, Sistemi Urban sipas planit kombëtar propozon:

- Hierarkizimin e qendrave
- Profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.
- Rajonizimin, ose bazat për zhvillim rajonal i shprehur në bashkimin funksional të qendrave urbane primare dhe të specializuara.

Më konkretisht:

- Zhvillim Policentrik hapësinor dhe një marrëdhënie të re Urban-Rurale
- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane;

- Akses më i mirë në një infrastrukturë multimodale e cila është jo vetëm më efektive por edhe miqësore ndaj ambientit;
- Funksione mikse dhe komplementare;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në veçanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;
- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 5, Dt. 29.12.2014, “për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, sistemi urban për Bashkinë Krujë është identifikuar në hartën në vijim.

Më konkretisht, nga ekspertët GIS që u morën me evidentimin e situatës reale të urbanizimit, rezulton që nga 16900 objekte të dhëna brenda zonës së urbanizuar, kemi mbi 2700 objekte (rreth 14% e numrit të përgjithshëm) që mungojnë në databazën e Vendimit të KKT nr.5, dt.29.12.2014.

Zhvillimi i qendrave urbane është bërë ndër vite duke u ndikuar nga elementët e fortë territorialë dhe nga proceset historike dhe zhvillimore. Qyteti i Krujës mendohet të jetë një vazhdimësi e fortifikimit të Albanopolisit ku banorët u spostuan për të qenë më të mbrojtur. Ata nga zona fushore u spostuan drejt asaj malore duke pasur mundësi të kontrollojnë më mirë territorin nga lartësia.

Qyteti i Fushë Krujës është formuar në vitin 1970 por si vendbanim dhe zonë me lëvizje dhe shkëmbim intensiv ka ezistuar prej shumë vitesh. Pikërisht pozicioni gjeografik në kryqëzimin e dy akseve të rëndësishme ndërlidhëse e bën Fushë Krujën të jetë një pikë strategjike dhe atraktive për zhvillimin ekonomik.

Qendrat rurale janë zhvilluar sipas aksesit në infrastrukturën bujqësore. Kryesisht janë të zhvilluara territoret në zonën fushore të bashkisë që përkon me zonat qendrore, perëndimore dhe jugore. Këtu toka bujqësore është e një cilësie të mirë, terreni i favorshëm dhe burimet hidrike të pranishme.

Tendencat e zhvillimit janë në zgjerimin e zonave urbane, herë me ndërtime informale dhe ndërtime në toka bujqësore dhe herë me intensifikim brenda strukturës aktuale. Vitet e fundit është vënë re një tendencë për të ndërtuar objekte banimi të larta të cilat kanë dëmtuar peizazhin urban të qyteteve. Gjithashtu intensifikimi i ndërtimit në zonat historike dhe me potencial turistik ka dëmtuar strukturat urbane.




Fig. 66: Harta e zonave të urbanizuara të miratuara sipas VKM Nr. 5, Dt. 29.12.2014 për Bashkinë Krujë

Zhvillimi i zonave ekonomike dhe afërsia me hapësirën Tiranë – Durrës kanë bërë që të rritet popullsia në zonën e Niklës dhe Fushë Krujës duke sjellë edhe tendenca të zgjerimit të hapësirës urbane në këto zona. Gjithësesi ky ritëm i rritjes së popullsisë ka ardhur në rënie në vitet e fundit. Gjithashtu vihet re një braktisje e njësive administrative Cudhi për shkak të mungesës së zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor që lidhet kryesisht me terrenin malor të kësaj njësie. Rënie të lehtë paraqet edhe popullsia e Krujës.

Zhvillimi i ndërtimeve përgjatë akseve rrugore është një karakteristikë e territorit të bashkisë Krujë. Kjo ndodh për shkak të aksesit të kufizuar në infrastrukturë që kanë zonat periferike. Sidomos në aksin Kamëz – Thumanë ky zhvillim konsiderohet mjaft problematik pasi infrastruktura rrugore është bërë mjaft e rrezikshme për shkak të pranisë së aktiviteteve ekonomike të vendosura në të dy anët e rrugës dhe lëvizjes që imponojnë ato.

3.3.2.1 Qendrat e Banuara

Një element përbërës i sistemit urban janë qendrat e banuara. Në total qendrat e banuara përbëhen nga qendrat urbane, ato rurale dhe zonat tranzitore/informale.

Për territorin e Bashkisë Krujë kemi 52 qendra të banuara nga të cilat 50 fshatra dhe 2 qytete. Qendrat e banuara urbane janë:

- Qendra urbane e banuar Krujë
- Qendra urbane e banuar Fushë-Krujë

- Zona informale Fushë Krujë (lagja Grumbullim është miratuar si zonë informale në vitin 2008, sipas kriterëve të përcaktuara bazuar në legjislacionin përkatës)

Qendrat rurale janë 50 dhe janë shpërndarë në 4 njësi administrative si më poshtë:

- Zona rurale e banuar njësia administrative Krujë: 3 fshatra
- Zona rurale e banuar njësia administrative Fushë Krujë: 11 fshatra
- Zona rurale e banuar njësia administrative Bubq: 7 fshatra
- Zona rurale e banuar njësia administrative Nikël: 9 fshatra
- Zona rurale e banuar njësia administrative Thumane: 10 fshatra
- Zona rurale e banuar njësia administrative Cudhi: 10 fshatra



Fig. 67: Zona informale e miratur – Fushë Krujë.

Struktura e ndërtuar ndahet në dy tipologji të qarta. Lagjet periferike dhe zonat rurale mbizotërohen nga struktura pikësore, të tipit vilë, me lartësi të ulët, 1-2-3 kate. Të vendosura në distance nga njera tjetra dhe me oborre përreth që varijonë nga zona në zonë. Struktura hapësinore e fshatrave në këtë treve është përgjithësisht e shpërhapur në territor në formë njollash, grupe shtëpish, përveç zonave më të përqëndruara që përbënin qendrën e fshatit.

Ndërkaq në qyetet e bashkisë dhe disi më pak në fshatrat e ndërtuara mëpas viteve '50 shfaqen ndërtimet e tipit gjatësor, me lartësi mesatare, 4, 5, 6 kate.

Cilësia dhe kushtet e ndërtesave varen drejtpërsëdrejti nga koha e ndërtimit të tyre. Objektet e ndërtuara mes viteve '50 – '90, sidomos kur janë rezidenca banimi kolektive janë degraduar nga koha dhe mungesa e mirëmbajtjes. Ndërtimet e reja janë në gjendje më të mirë duke gjykuar nga pamja e jashtme, por lënë mjaft pëe të dëshiruar, qoftë nga paraqitja arkitektonike, qoftë nga formulimi urban, vendosja karshi zonës dhe objekteve përreth, respektimi i kushteve dhe normave urbane. Për t'u parë

ndoshta në një fazë më të avancuar do të ishin kushtet inxhinierike të ndërtimit, niveli i sigurisë ndaj tërmeteve, masa për mbrojtjen nga zjarri etj.

Në vijim paraqitet një inventar i ndërtesave publike dhe shërbimeve për 6 njësitë administrative.

Tabela 12: Inventar i ndërtesave publike (Bashkia Krujë)

	Krujë	Fushë Krujë	Nikël	Bubq	Thumanë	Cudhi
Spital	1					
Shtëpi lindjeje	1					
Poliklinikë / qendër shëndetsore	4	4			3	
Kopësht / çerdhe	5	7	4	5	4	2
Shkolla 9 vjeçare	6	8	9	8	8	10
Shkolla të mesme	1	1	1	1	2	1
Stadium	1	1				

3.3.2.2 Zonat industriale

Komponenti tjetër përbërës i sistemit urban janë zonat industriale. Në territorin e bashkisë Krujë kemi një larmi elementesh të zonës industriale; duke filluar që nga nxjerrja e përpunimi i minerareve, industria e përpunimit të drurit, artizanati. Zonat industriale të identifikuar në këtë territor janë:

- Zona e përpunimit të çimentos
- Zona e nxjerrjes së gurit gëlqeror
- Zona industriale e përpunimit të gurit Nikël
- Zonat e industrisë fasone
- Zona të shpërndara në brendësi të qendrave urbane

Në vitet e fundit është intensifikuar ndjeshëm numri i aktiviteteve dhe zonave të banimit në territor, sidomos në zonën qendrore dhe jugore të territorit. Përgjatë korridorit Tiranë – Kamëz – Nikël – Fushë Krujë kemi vendosjen e shumë aktiviteteve ekonomike (kryesisht mobilieri, përpunimi drurit, materiale ndërtimi) që kanë preferuar të pozicionohen përgjatë tij për të përfituar nga aksesit me Tiranën dhe korridoret kryesore kombëtare. Të njëjtin fenomen e vërejmë edhe përgjatë korridorit Veri-Jug. Në pjesën fushore të rrugës që lidh Fushë Krujën me Krujën ka një shtim të zonave të banimit dhe një vendosje të aktiviteteve ekonomike dhe shërbime ndaj transportit si pika karburanti që shfrytëzojnë aksesin e lartë të rrugës.

3.3.3 Sistemi natyror

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” në përputhje

me legjislacionin e posaçëm. Është detyrë primare e PPV-së të promovojë dhe mundësojë aksesin e zonave me karakteristika natyrore e peisazhistike. Menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor përballë rritjes e globalizimit . Në të njëjtën kohë i bën aktive dhe kontribuese në rritjen ekonomike të zonës duke i riaktivizuar si asete nëpërmjet përmirësimit të arritshmërisë së përshtatshme të tyre.

Procesi i planifikimit dhe i zhvillimit në territore natyrore, si dhe ndryshimi i kategorisë përkatëse bazë të përdorimit të tokës në kategori të tjera rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për pyjet dhe shërbimin pyjor, për tokën, për turizmin, për kullotat dhe livadhet, për menaxhimin e rezervave ujore dhe për mjedisin.

Përdorimi i tokës si pasojë e rritjes dhe zhvillimit, ka bërë që njëkohësisht të humbasin vazhdimisht sipërfaqe të lira së bashku me funksionet e tyre në ndihmë të ekosistemeve natyrore dhe mbrojtjen e klimës, çlodhjen, si edhe funksionet e tyre të kapacitetit ekonomik për pylltarinë dhe bujqësinë, prodhimin e energjisë së rinovueshme, si edhe mbrojtjen e burimeve të nëntokës së zonave përkatëse. Prandaj në kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm, mbindërtimi, shfrytëzimi i nëntokës për kanalizime e themele dhe fragmentimi i hapësirës së lirë, si edhe në mënyrë të veçantë shfrytëzimi i burimeve natyrore të parinovueshme, duhet të mbahet në një nivel sa më të ulët të jetë e mundur.

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë”. Në terma të përgjithshëm Draft PPK, në shkallë territori vendi për sistemin natyror rekomandon politika që stimulojnë rritjen e zonave të mbrojtura, promovimin dhe lehtësimin e aksesit te tyre.

Mjedisi si aset që bashkëvepron aktivisht me sektorët e tjerë të ekonomisë ka si Projekte Strategjike në këtë drejtim:

- Rrjetin kombëtar të bicikletave që akseson zonat natyrore me vlera peisazhistike natyrore, dhe në zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore.
- Parku i Alpeve
- Parku i Vjosës
- Parku i Lumit Buna

Ruajtja dhe shtimi i zonave të mbrojtura natyrore bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes së prioritetit të përdorimit të Zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin.
- Krijimi dhe konsolidimi i Korridoreve lidhëse Natyrore përgjatë luginave ujore të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.

Për territorin e bashkisë Krujë zonat përbërëse të këtij sistemi janë:

Mjediset pyjore

Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullësor të Bashkisë Krujë është në rreth 129 km², ku brenda kësaj sipërfaqeje 98 km² janë pyje, 5.5 km² janë kullota, 10 km² janë tokë me bimësi pyjore ndërsa 15.5 km² janë sipërfaqe djerrë dhe tokë inproduktive. Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullësor e cila do të administrohet nga Bashkia Krujë shkon në rreth 90 km², ndërsa pjesa tjetër prej 39 km², të cilat janë shpallur Zona të Mbrojtura do të jenë nën administrimin e AKZM.

Mjedisi i kullotave

Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Krujë, sipas të dhënave të marra nga Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullësor, (Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë), kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 548 ha.

Zonat e mbrojtura natyrore

Zona e mbrojtur Parku Kombëtar i Qafë Shtamës zë një sipërfaqe prej 2,000 ha. Parku Kombëtar në Qafë Shtamë prezanton një biodiversitet të lartë, duke u përfaqësuar me një shumëllojshmëri habitatesh dhe llojesh, por njëkohësisht dhe me vlera të larta turistiko-rekreative.

Në vijim paraqiten sipërfaqet për sistemin natyror në rang territori për bashkinë Krujë.

Tabela 13: Sipërfaqet e sistemit natyror

Sistemi	NenKategori	Zona	Sip Hektar	%
Sistemi Natyror	Bimesi sklerofile	22	2310.07	8.93
	Lidhadhe natyrore	27	1123.67	4.34
	Plazhe, duna, rera	3	178.51	0.69
	Pyje gjethegjere	11	16558.53	64.03
	Pyje halore	8	1617.67	6.25
	Pyje te perziera	1	58.73	0.23
	Toke me bimesi pyjore	13	728.81	2.82
	Zona te ndermjetme kenetore	20	3286.08	12.71
	Total	105	25862	100

3.3.4 Sistemi Bujqësor

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”. Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtim me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Zhvillimi dhe ndërtimi në zona bujqësore kryhen sipas dokumenteve të planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm për tokën bujqësore. Çdo dokument i përgjithshëm ose

sektorial planifikimi që parashikon edhe ndryshim të kategorisë së përdorimit të tokës nga bujqësi në përdorime të tjera dhe anasjellas shoqërohet, sipas rastit, me aktet përkatëse të ndryshimit sipas legjislacionit të posaçëm.

Politikat që mbështet Plani Kombëtar në këtë drejtim janë:

- Ruajtje
- Konsolidim
- Modernizim

Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqiptarë.

- Bimë Mjekësore
- Pemë frutore arvore
- Ullinj dhe Vreshta
- Perime karakteristike të vendit
- Produkteve bujqësore të përpunuara

Për territorin e Bashkisë Kruje evidentohen vlerat e tokës bujqësore dhe sipërfaqet e këtij sistemi si më poshtë.

Tabela 14: Sipërfaqet e sistemit bujqësor

Sistemi	NenKategori	Zona	Sip Hektar	%
Sistemi Bujqesor	Kullota	12	445.40	1.84
	Modele kultivimi komplekse	5	17125.49	70.66
	Peme frutore dhe plantacione luleshtrydresh	6	330.54	1.36
	Toka djerre (te paujitura)	12	2327.76	9.60
	Toke bujqesore me bimesi natyrore te rendesishme	31	2902.22	11.98
	Ullishte	7	1077.08	4.44
	Vreshtari	1	26.77	0.11
	Total	74	24235.25	100.00

3.3.5 Sistemi Ujor

Sistemi ujor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”.

Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në territore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit “Ujëra dhe ligatina” rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria.

Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm dhe kjo rregullore. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Menaxhimi shkencor i ujit dhe energjisë ka qenë dhe mbetet një moment thelbësor me pasoja të rëndësishme për të sotmen dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm. Bashkimi Evropian ngulmon, që rritja ekonomike nuk duhet të kondicionohet me përdorimin intensiv të burimeve në përgjithësi e sidomos të atyre ujore e energjetike në veçanti. Kjo duhet të kompensohet me zhvillimet në teknologji efektive për ruajtjen e balanceve të përdorimeve të tyre me kërkesat në rritje të nevojave jetike për to: të ruajtjes dhe të rigjenerimit të tyre. Rekomandohet që raportet aktuale midis rritjes ekonomike, konsumimit të resurseve ujore e energjetike dhe prodhimit të mbetjeve të ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Zhvillimi ekonomik duhet të shoqërohet me përdorimin racional e të qëndrueshëm të burimeve të ujit dhe energjisë, me prodhimin e sasive të kufizuara të mbetjeve, duke ruajtur biodiversitetin, ekosistemet dhe mënjanuar transformimin e mjedisit në djerrinë.

Politikat që Draft PPK rekomandon në shkallë territori vendi janë:

- Vendosja e Vijës Blu. Mbron resurset ujore nga përdorimi i papërshtatshëm si
Shfrytëzim intensiv i inerteve të lumit,
Vend-depozitime të mbetjeve urbane
Aktivitet bujqësor e industrial i konsiderueshëm.
- Korridoret natyrore do të kalojnë kryesisht përgjatë luginave të lumenjve duke mbrojtur këtë resurs.
- Ngritja dhe forcimi i sistemit të infrastrukturës së ujësjellës kanalizimeve në përputhje me kërkesat për urbanizim sipas hierarkizimit të qendrave.

Për territorin e Bashkisë Krujë evidentohen lumenjtë si përbërës kryesorë të sistemit, ku ndër më kryesorët janë Lumi i Zezës, që kalon nëpër qytetin e Fushë Krujës, i cili pasi bashkohet me Lumin e Gjolës formojnë Lumin e Ishmit. Prurja mesatare vjetore e Lumit të Gjolës është rreth 16m³/s ndërsa e Lumit Ishëm rreth 18 m³/s.

Korridoret lumore

Korridori i Zezës – lumi i Zezës, një nga degët e lumit Ishëm. Ky lum kalon mospërmas qytetit të Fushë Krujës dhe ka qenë një nga elementët kryesorë qytetformues. Vendbanimet më të vjetra të territorit, janë vendosur përgjatë këtij lumi.

Korridori i Ishmit – lumi i Ishmit. Tek lumi i Ishmit derdhen të gjithë lumenjtë e tjerë të luginës. Përgjatë këtij lumi kanë gravituar një pjesë e madhe ndërtimeve të reja gjatë viteve të fundit.

3.3.6 Sistemi Infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

Me formulimin e kërkesave të aksesueshmerisë për qendrat kryesore dhe sekondare duhet të garantohet roli qendror i tyre dhe të sigurohet cilësia e qendrave prioritare si pika spirancë në hapësirën dhe mobilitetin e njerëzve për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Më tej, hierarkizimi i rolit të këtyre qendrave, kërkon vendosjen e prioriteteve lidhur me sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjeteve dhe korridoreve të reja infrastrukturore dhe mirëfunksionimin e tyre.

Objekti i Draft PPK është integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe një shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat e propozuara lidhen me organizimin e territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës

Për transportin objekti i principal është zhvillimi i tipit multimodale dhe miqësor ndaj ambientit.

3.3.6.1 Aeroportet



Fig. 68: Terminali i Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza

Aeroporti Nënë Tereza është i vetmi aeroport ndërkombëtar në Shqipëri. Ai u ndërtua në periudhën 1955 - 1957 dhe ndodhet 17 km larg nga kryeqyteti si dhe 18 km larg qytetit të Krujës. Ai ka një pistë të gjatë 2750 m dhe me gjerësi 45m. Në vitin 2014 nëpërmjet këtij aeroporti kanë udhëtuar 1 810 305 pasagjerë dhe janë kryer 17 928 fluturime. Gjithashtu, në vitin 2014 aeroporti ka trajtuar edhe ngarkesa cargo prej 2324 tonësh. Aeroporti është edhe një pikë e rëndësishme ekonomike ku janë punësuar rreth 950 punonjës. Që prej vitit 2005 ai administrohet nëpërmjet një kontrate koncesionare nga shoqëria TIA. Gjatë Kësaj periudhe, aeroporti ka rritur ndjeshëm kapacitetet dhe ka përmirësuar infrastrukturën. Terminali i ri është ndërtuar në dy faza dhe sot ka një kapacitet prej 2 milionë pasagjerësh në vit.

3.3.6.2 Transporti rrugor

Territorin e Bashkisë Krujë e përshkojnë 102.45 km rrugë nacionale, 18.9 km rrugë rurale dhe pjesa tjetër rrugë lokale. Këtu kalon korridori kryesor që lidh Tiranën me Shkodrën e më tej me Malin e Zi (Tiranë – Hani i Hotit, aksi i vjetër 26.1km dhe Tiranë – Hani i Hotit, aksi i ri 23.65km). Të gjitha rrugët nacionale janë në gjendje të mirë dhe administrohen e mirëmbahen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Përjashtim bën segmenti shumë i amortizuar Dalje F. Krujë – Thumanë 11.5km i cili është parashikuar të rikonstruktohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Rrugët rurale kanë kaluar së fundmi nën administrimin e Bashkisë Krujë.

Tabela 15: Inventari ARRSH (Bashkia Krujë)

Nr. I Rrugës	Emërtimi i Aksit Rrugor	Gjatësia L= (km)	Gjerësia B= (m)	Kategoria
1	Tiranë - Hani i Hotit (aksi i vjetër)	26.10		
1/2	Qerekë (kufi Tiranë)	11.00	7	
	Fushë Krujë			
	Fushë Krujë	7.70	7	
	K/Qendër Borizanë			
	K/Qendër Borizanë	4.70	7	
	K/Thumanë Qendër			
	K/Thumanë Qendër	2.70	7	
	Ura e Drojës (aksi i vjetër)			

1	Tiranë - Hani i Hotit (aksi i ri)	23.65		
1/2	Qerekë (kufi Tiranë)	11.00	7	C
	Fushë Krujë			
	Fushë Krujë	2.35	7	
	K/Fshat Hasan			
	K/Fshat Hasan	1.10	7	
	K/Fshat Luz			
	K/Fshat Luz	2.60	7	
	K/Fshat Derven			
	K/Fshat Derven	1.30	7	
	D/Borizane			
	D/Borizane	1.60	7	
	D/Thumanë			

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

	D/Thumanë	2.70	7	
	K/Fshat Bushnesh			
	K/Fshat Bushnesh	1.00	24	B
	Ura e Drojës (aksi i ri)			

38	F.Krujë - Krujë - Nojë - Q. Shtamë	36.60		
38/1	Fushë Krujë (dalje)	2.50	6.0	C
	Halilaj			
	Halilaj	8.10	6.0	
	Krujë (kufi)(degëzimi për Q.Shtamë)			
38/2	Krujë (kufi)(degëzimi për Q.Shtamë)	6.40	4.0	C
	Ndojë			
	Ndojë	11.60	4.0	
	Cudhi			
	Cudhi	8.00	4.0	
	Qafë Shtamë (Kufi me Burrelin)			

39	K.Rr.Nacionale Nr.1 - Fab.Çimentos	4.00		
39/1	K/Rrugë nacionale Nr.1 (aksi i vjetër)	4.00	7.0	C
	Fabrika Çimentos			

52	Vorë - K/Rinas - F.Krujë	2.00		
52/2	Kufi Krujë (Ahmetaq)	1.80	11.0	C
	Hyrje mbikalim F.Kruje			
	Hyrje mbikalim F.Kruje	0.20	11.0	
	Dalje mbikalim F Kruje			

62	K/Rr.Nr.52 (aksi i vjeter)- Bilaj (Llixha)	3.50		
	K/Rrugë nacionale (me Rr.Nr.52)	3.50	7.0	C
	Llixha kufi			

	Krujë - Sarisalltik	6.60	4	
	Krujë (dalje qytetit)	6.60	4.00	C
	Sarisalltik			

	TOTALI PER BASHKINË KRUJË	102.45	KM	
--	----------------------------------	---------------	-----------	--

Tabela 16: Inventari rrugëve rurale (Bashkia Kurbin)

Nr. i segmentit	Emërtimi i Aksit Rrugor	Gjatësia L ⁼ (km)	Gjerësia B ⁼ (m)	Kategoria
1	Rruga Nacionale - Nikël	1		F
2	Ura e Gjolës - Budull	2		F
3	Cudhi - Bruz	8		F
4	Krujë - Qafështamë (pjesa fundore)	7.9		F
	TOTALI	18.9	KM	

Bashkia Krujë e favorizuar nga vetë pozicioni gjeografik, lidhet me Shkodrën, Lezhën, Kurbinin dhe Tiranën dhe gjithë pjesën e Jugut të Shqipërisë nëpërmjet rrugës kombëtare Tiranë – Hani i Hotit (SH1). Një rrugë tjetër e rëndësishme është rruga SH52, F. Krujë – Vorë (SH52), e cila lidhet me Aeroportin “Nënë Tererza” dhe më tej me Durrësin e Jugun e Shqipërisë nëpërmjet rrugës SH2, Tiranë – Durrës. Me rëndësi është të theksojmë se nga ana e ARSh-së është parashikuar dhe është bërë projekti i një rruge e cila do të lidhë qytetin e Krujës me Tiranën në fillimin e Rrugës së Arbërit.

Gjithashtu parashikohet ndërtimi i aksit të ri rrugor nga Thumana, në vijë të drejtë, deri në Bërxullë për tu lidhur me aksin rrugor Tiranë – Durrës dhe vazhduar më tej.

Aksi ekzistues Tiranë – Kamëz – Fushë Krujë ka shumë kryqëzime në nivel përgjatë gjithë gjatësisë të cilat kërkojnë strukturim. Ky segment rrugor përshkon zonën e Niklës dhe përgjatë tij janë të vendosura aktivitete të përpunimit dhe tregëtimit të drurit.

Sipas studimit të Institutit të Studimeve të Transportit të vitit 2005, aksi Fushë Krujë – Tiranë rezulton aksi i dytë rrugor me trafikun më të madh pas aksit Tiranë – Durrës.

Përsa i përket lëvizjes së mjeteve, sipas të dhënave të marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, numri i mjeteve që kalojnë në 24 orë të matura në muajin Korrik 2015 në aksin rrugor Fushë Krujë – Milot (SH1) jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 17: Numri i mjeteve që kalojnë në 24 orë në aksin rrugor Fushë Krujë (SH 1) – Milot

Data	Dita	mjete/24orë
7/20/2015	E Hënë	23421
7/21/2015	E Martë	24698
7/22/2015	E Mërkurë	24102
7/23/2015	E Enjte	23695
7/24/2015	E Premte	25328
7/25/2015	E Shtunë	25750
7/26/2015	E Djelë	26332

3.3.6.3 Hekurudha

Linja hekurudhore që kalon në territorin e Bashkisë Krujë është linja Tiranë-Vorë-Lezhë-Shkodër. Kjo linjë kalon 4,3 km larg qytetit të Fushë Krujës dhe ka një degëzim në fshatin Budull ku kthehet dhe kalon pranë qytetit dhe më pas shkon deri tek fabrika e çimentos. Linja ka edhe një stacion në qytetin e Fushë-Krujës. Kjo linjë ka funksionuar kryesisht për transportin e prodhimeve të fabrikës së çimentos.

3.3.6.4 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Në kuadrin e realizimit të Planit Rregullues Vendor për Bashkinë e Krujës, detyrë e Konsulentit është edhe paraqitja e konceptit të sistemit të furnizimit/trajtimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve/pastrimit të ujrave të përdorura urbane. Përpara zgjedhjes së variantit përfundimtar të projektit të zbatimit, një studim fizibiliteti do të ndërmerret nga ana e Konsulentit, me qëllim shqyrtimin e të gjitha varianteve, mundësive të realizimit të tyre, vlerësimin e nevojave dhe kapaciteteve, gjithmonë në funksion të një strategjie zhvillimi që do të garantojë një infrastrukturë të përshtatshme dhe të qëndrueshme, e cila do të rezultojë nga kompromisi më i mirë midis ndërhyrjeve të propozuara dhe ruajtjes së mjedisit. Ndërhyrjet e propozuara, përveç një impakti minimal mbi mjedisin natyror dhe human, do të jenë të tilla që do të ruajnë të paprekur pronësitë mbi trojet dhe ruajtjen në maksimum të fondit të tokës. Ato do të shtrihen kryesisht në rrugët ekzistuese dhe në ato që do të propozohen nga P.R.V. Përpara se projekti përfundimtar të prezantohet, nga ana e Konsulentit do t'i kërkohet Porositësit (Bashkia Krujë), hartimi i Termave të Referencës, të cilat do të mbahen parasysh në hartimin e detyrës së projektimit.

Ky raport përfshin:

- Paraqitja e gjendjes ekzistuese të furnizimit me ujë të popullsisë dhe kanalizimeve;
- Vlerësimi paraprak i alternativave të sistemit të furnizimit me ujë;
- Vlerësimi paraprak i alternativave të pastrimit të ujrave të ndotura urbane.

Furnizimi me ujë

Qyteti i Fushë-Krujës furnizohet me ujë nga këto pus-shpime:

- Puset nr.450, 451 dhe 452 me një kapacitet total prej 78 l/sek. Këto puse janë ndërtuar në vitin 2006 me një investim të bankës Islamike.
- Pusi nr.63 në fshatin Hasan me një kapacitet prej 43 l/sek. Ky pus është ndërtuar në vitin 2008.

Rrjeti kryesor i furnizimit me ujë të qytetit është i ri. Tubacioni kryesor i dërgimit të ujit stacion i pompave Hasan-kodër e Gjineve është me diametër 355 mm, ndërsa tubacioni i kthimit ka një diametër prej 315mm. I gjithë rrjeti i shpërndarjes është ndërtuar në vitin 2006 nga Fondi i Bankës Islamike.

Tubacioni tjetër kryesor i dërgimit të ujit Hasan - depo e Taleve ka një dimatër prej 250mm prej polietileni dhe është ndërtuar në vitin 2000 nga një shoqatë joqeveritare CRS.

Rrjeti sekondar i shpërndarjes është ndërtuar në vitin 1967 dhe është në gjendje tejte të amortizuar, gjë që sjell humbje në rrjet mbi 60%. Kapaciteti i këtij rrjeti nuk i përgjigjet nevojave në rritje për furnizim të qytetit. Për këtë është bërë dhe kerkese pranë Ministrise në vitin 2006 për hartimin e një projekti të ri të rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit Fushë Krujë. Kohëzgjatja aktuale e furnizimit me ujë të pijshëm në varësi të zonave të ndryshme të qytetit varion nga 18 orë në ditë në dimër deri në 12 orë në ditë në stinën e verës. Në lagje të veçanta furnizimi shkon nga 24 orë në ditë deri në 4 orë në ditë.

Për më tepër shih: Treguesit 2006 - 2014 UK Krujë, Treguesit 2006 - 2014 UK Fushë Krujë (Aneks 1)

Kanalizimet Fushë Krujë

Në vitin 2007 është realizuar ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha të qytetit të Fushë Krujës me financimin e Bankës Islamike. Ky sistem kanalizimesh është i ndarë: ujërat e zeza rrjedhin në një sistem tubacionesh të ndarë nga ujërat e bardha (shirave). Përpara ndërtimit të sistemit të ri, sistemi i kanalizimeve ka qenë i tipit miks, d.m.th ujërat e zeza dhe të bardha largoheshin nga i njëjti sistem kanalizimesh. Sistemi i ujërave të zeza dhe të bardha është me vetërrjedhje (gravitet) dhe nuk ka sisteme pompimi për ngritjen e ujërave. Si pritës i të dy sistemeve të kanalizimeve, aktualisht shërben lumi Zeza. Për sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, pjesa në lindje të qytetit të Fushë Krujës shkarkon ujërat e zeza direkt në Lumin Zeza nëpërmjet katër kolektorëve me diametër Ø 630 mm, 2 x Ø 400 mm, dhe Ø 300 mm. Pjesa në perëndim të lumit Zeza shkarkon në lumin Zeza në pikën e bashkimit me lumin Bardhari nëpërmjet një kolektori me diametër Ø 500 mm. Ujërat e bardha në pjesën lindore shkarkojnë në lumin Zeza nëpërmjet një kolektori me diametër Ø 1000 mm, ndërsa pjesa perëndimore shkarkon në kanalin përgjatë rrugës nacionale Fushë Krujë – Lezhë me një tubacion me diametër Ø 1000 mm.

Përpara ndërtimit të sistemit të ri të kanalizimeve në vitin 2007, sistemi i vjetër ishte ndërtuar përpara 30 - 40 vitesh dhe paraqitej në gjendje tejte të amortizuar. Tubacionet ishin me diametra të vegjël nga Ø 100 deri Ø 130 mm, kryesisht prej materialesh betoni dhe gres. Sistemi i vjetër, si pasojë e dimensioneve të vegjël, rritjes në vite të numrit të popullsisë si dhe të gjendjes së amortizuar, nuk ishte në gjendje të kryente largimin normal të ujërave të zeza dhe në shumë raste ndodhnin bllokime dhe përmytje në shumë pjesë të tij. Në disa pjesë të qytetit, mungesa e rrjetit të largimit të ujërave të bardha, bënte që këto të fundit përziheshin me ujërat e zeza duke sjellë përmytje nëpër rrugë dhe duke paraqitur një rrezik serioz për shëndetin publik. Zona e mbulimit me sistem kanalizimesh të ujërave të zeza për territorin e Bashkisë Fushë Krujë është rreth 39 %, ndërsa pjesa e qytetit pothuajse mbulohet tërësisht nga ky shërbim. Mungon sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza për disa fshatra të territorit të njwsw administrative si dhe në lagjen e re në rrugën e Krujës që ndodhet brenda territorit të qytetit. Gjithashtu, rrjeti i kanalizimeve në lagjet e vjetra të qytetit në lindje të lumit Zeza (lagjet Punëtori, SMT dhe Kastriot), është shumë i amortizuar dhe jo në gjendje të përballojë flukset e ujërave të zeza. Problem shumë i mprehtë mbetet mungesa e

sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Hasan, në të cilin ndodhen pushpimet dhe stacioni i pompimit që furnizon me ujë qytetin e Fushë Krujës, duke rrezikuar kështu ndotjen e shtresave ujëmbajtëse nëntokësore. Në vitin 2009 është ndërtuar sistemi i kanalizimeve në Lagjen e Re mbi Unazë dhe lagjen Magaze me investimet e bashkisë. Mund të themi se me projektin e vitit 2007 janë ndërtuar pjesa më e madhe e kolektorëve të ujërave të zeza të qytetit. Mbeten për t'u kompletuar edhe disa zona të ndërmjetme me kolektorët e ri të ndërtuar.

Siç e përmendëm dhe më lart, sistemi është me vetërrjedhje dhe tubacionet e përdorur janë polietileni të brinjëzuar PEHD:

- Kolektorët kryesorë me diametër Ø 400 - Ø 630 mm;
- Degëzimet (kolektorët sekondarë) me diametër Ø 200 - Ø 400 mm;
- Pusetat e kontrollit dhe të nyjeve janë ndërtuar prej betoni.

Shkarkimi në ujërat e lumit Zeza është bërë pasi për momentin mungon një sistem (impiant) i trajtimit të ujërave të zeza.

Ndërtimi i sistemit të largimit të ujërave të zeza është konceptuar duke patur parasysh mbledhjen dhe dërgimin e sasisë së këtyre ujërave në një pikë ku do të parashikohet ndërtimi i një impianti trajtimi. Kjo do të sjellë eliminimin e shkarkimeve direkte të kolektorëve të ujërave të zeza në rrjedhjet natyrale (lumi Zeza) dhe përmirësimin e kushteve mjedisore të këtij të fundit. Shkarkimi i kolektorëve të ujërave të zeza në lumin Zeza duhet konsideruar një zgjidhje afatshkurtër dhe numri i shkarkimeve direkt në të të kolektorëve duhet reduktuar në maksimum. Zonat e banimit me dendësi të ulët dhe shtëpitë e veçuara për momentin duhet të shërbejnë me zgjidhje të veçuara (p.sh. me gropa septike) deri në momentin që rritja e numrit të popullsisë të justifikojë ndërtimin e një rrjeti të mirëfilltë kanalizimesh të ujërave të zeza. Lidhjet e ndërtesave me sistemin e ri të kolektorëve janë kryer ose nga vetë banorët ose janë lidhur degëzimet ekzistuese. Në të dy rastet, gjendja e degëzimeve (shkarkimeve të banesave me kolektorët kryesorë) le për të dëshiruar si pasojë e vjetërsisë dhe pamjaftueshmërisë përcjellëse, dhe moszbatimit të kushteve teknike. **Aktualisht në qytetin e Fushë Krujës nuk ekziston një impiant i pastrimit të ujërave të zeza dhe si rrjedhim këto të fundit derdhen direkt në lumin Zeza duke shkaktuar ndotjen e tij.**

Lumi Zeza, i cili përshkon mospërmas qytetin e Fushë Krujës, për momentin paraqet probleme të rënda mjedisore, si pasojë e derdhjeve në të të pothuaj tërë sasisë së ujërave të zeza të prodhuara nga qyteti. Nuk disponohen për momentin të dhëna lidhur me ndotjen e lumit Zeza dhe të parametrave të NBO5 (Nevoja Biokimike për Oksigjen) dhe të LP (Lënda Pezull). Në të dyja anët e lumit në pjesën brenda territorit të qytetit, aktualisht ka ndërtime shumë afër rrjedhës të cilët gjithashtu shkarkojnë direkt në lumë. Vrojtimet hidrologjike në lumin Zeza kanë filluar në vitin 1955 në urën e Zezës dhe kanë vazhduar në këtë pikë deri në vitin 1960. Nga viti 1963 deri në vitin 1981, është rihapur pika e vrojtimit në krah të djathtë të rrjedhës në urën e lumit Zeza. Në vitin 1981 është hapur një pikë e re vrojtimi rreth 400 - 500 m sipër urës pranë fshatit Arrameras, e cila vazhdon vrojtimit edhe në ditët e sotme. Përveç matjeve të niveleve dhe prurjeve, në këto pika janë kryer vrojtme edhe lidhur me turbullirën dhe analiza kimike periodike, por jo analiza të mirëfillta lidhur me nivelet e ndotjes. Nivelet më të ulëta dhe më të larta të vrojtuar gjatë periudhës së vrojtimit janë:

- Hmax (1955-1960) – 422 cm, datë 23.05.1958; Hmin – 61 cm, datë 01.11.1956
- Hmax (1963-1981) – 534 cm, datë 25.02.1965; Hmin – thatë, datë 1964 - 65, 1967, 1979
- Hmax (1981 - vazhdim) – 271 cm, datë 04.03.1981; Hmin – thatë, datë 1982 - 85, 1989 - 92, 1994.

Niveli më i lartë historik sipas të dhënave jo zyrtare është 562 cm në muajin dhjetor 1946. Prurjet ditore janë nxjerrë për periudhën 1956 – 1992: Qmax = 230 m³/sek, Qmin = 0 m³/sek, datë 1956 e në vazhdim. Të dhënat hidrologjike për lumin Zeza duhet të kihet parasysh gjatë sistemimit të shtratit të tij (gjerësia, thellësia, pjerrësia hidraulike etj), me qëllim që shkarkimet direkte të ujërave të shirave në të të bëhet pa probleme dhe të evitohen përmbytjet gjatë periudhës së reshjeve dhe ngritjes së nivelit të ujit në lumë. I njëjti problem duhet konsideruar edhe për kuotat e kolektorëve të ujërave të zeza që do kalojnë në anë të lumit dhe do të mbledhin shkarkimet aktuale.

Lidhur me furnizimin me ujë, Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të përcaktojë drejtimit kryesorë të ndërhyrjes për përmirësimin e situatës me synimin e rritjes së performancës së sistemit (shtrirja e sistemit në të gjithë territorin e administruar nga bashkia dhe rritja e kohës së furnizimit me ujë sipas standarteve për ujërat e destinuar për konsum njerëzor).

Mungesa e trajtimit të ujërave urbane, përdorimi i të ashtuquajturave gropa septike në zonat rurale, rritja e shkallës së ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe në ujërat nëntokësorë, vazhdojnë të japin një impakt negativ si mbi mjedisin ashtu edhe mbi shëndetin njerëzor, duke u bërë pengesë edhe për zhvillimin e resurseve ekonomike, kryesisht të turizmit në bashkinë e Krujës.

3.3.6.5 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike në TL

Bashkia Krujë furnizohet me energji elektrike nga linja 110 kV e transmetimit (NS Fushe Kruje 110/6kV). Konsumi vjetor i energjisë elektrike për qytetin në vitin 2015 ishte 68 GW/h. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset.




Fig. 69: Harta energjitike Kruje

Nestacioni 110/6kV i Krujës furnizohet nga linja 110kV

E cila vjen nga nenstacioni 110/6kV Fush Kruje. Vet NS 110/6kV i Fush Krujes furnizohet nga dy linja ajrore 110kV (L-110-22/1 - 19.4km - AÇ -120 – 1968 dhe L-110-13 - 16km - AÇ -120 – 1965).

Linja L-110-22/1 vjen nga NS 220/110/35/20kV TIRANA dhe linja L-110-13 nga NS 110/6kV LAC 1.




Fig. 70: Skema e furnizimit me energji elektrike Kruje

Nestacioni i Krujes eshte i perber nga nje transformator 10MVA 110/6kV. Kapaciteti total i ketij nestacioni eshte 10MVA. Gjate ketyre viteve rimontet dhe sherbimet ndaj ketij nestacioni kane qene te pamjaftueshme.

NS ka vetem nje seksion ne anen 6kV nga ku dalin te gjitha linjat e furnizimit me energji te qytetit.

Problematikat e furnizimit me energji ne TL jane lidhur ngushte dhe me kohen e gjate te shfrytezimit, amortizimit dhe nivelit te tensionit qe aktualisht perdor qyteti ne TM.

Furnizimi me energji elektrike TM

Rrjeti TM qe furnizone qytetin e Krujes nis nga nenstacioni 110/6kV. Dy transformatori i instaluar ne kete nestacion ka nje kapacitet prej 10MW. Ne anen sekondare te nestacionit me tension nominal 6kV jane lidhur te gjitha fiderat qe furnizojne qytetin dhe periferine e tij.

Kryesisht keto linja jane ajrore me percjellsa alumini. Keto linja jane tejet te ngarkuara dhe si pasoje ne pikat fundore te konsumatorve shfaqen leht problemet e renies se tensionit. Problem i cili shkakton mosfeksionim optimal te pajisjeve elektrike.

Problem dytesor me linjat e ngarkuara eshte dhe humbjet teknike ne rrjet qe vijne si pasoje e mbingarkimit te ketyre linjave.

Me poshte do te gjeni te paraqitur NS 110/6kV lezhe sebashku me fiderat e tij.




Fig. 71: Skema principale NS 110/6kV Kruje

Me poshte do te gjejme nje pershkrim te shkurter te fiderave 10kV qe mbulojne zonen.

1. Fideri 1 – Del nga nestacioni me linje kabllore Al 3x185 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Ajrore ALÇ 3x1x50 mm² dhe ALÇ 3x1x95 mm²
2. Fideri 2 – Del nga nestacioni me linje kabllore Al 3x185 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Ajrore ALÇ 3x1x95mm²
3. Fideri 3 – Del nga nestacioni me linje kabllore Cu 3x95 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Kabllore ALÇ 3x1x95mm².
4. Fideri 4 – Del nga nestacioni me linje kabllore Al 3x70 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Kabllore ALÇ 3x1x70mm².
5. Fideri 5 – Del nga nestacioni me linje kabllore Al 3x50 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Ajrore ALÇ 3x1x50mm²
6. Fideri 6 – Del nga nestacioni me linje kabllore Al 3x70 mm² deri ne portalet TM dhe vazdone per gjithë gjatesine e vete me Linje Ajrore ALÇ 3x1x50mm²

Sic shihet dhe nga pershkrimet e mesiperme rrjeti energjitik ne TM i Krujes eshte akoma ne pjesen dermuese me linja ajrore. Keto linja ne shumicen e rasteve jane demtuar fizikisht dhe ne shume pjese te qytetit intersektohen me rruge, godina banimi si dhe me linja te tjera te rretit elektrik.

Per shkak te nivelit te tensionit aktual 6kV, linjave ajrore te ngarkuara, cilesia e furnizimit me energji deri ne gabinat elektrike. Vihen re humbjet te tensionit ne TM qe

ne momente piku kalojne 10% ΔU problem qe i shtohet dhe humbjeve te tensionit ne TU.

Po keshtu problemet e mesiperme kane dhe anen negative te tyre te cilat jane humbjet teknike ne rrjet. Keto humbje qe llogariten rreth 34% kane dhe koston financiare te tyre.

Gjendja aktuale e linjave ajrore paraqiten ne kushte te keqia dhe jashte normave te sigurimit teknik. Ne shume pjese te trakteve te linjave vihen re kurora te bimesish qe kalojne distacen e sigurise me linjat elektrike, gjithashtu godina banimi shume afer me keto linja, shtylla te dala nga qendra e rendeses si dhe izolator te shumellojshem per te cilat karekteristikat teknike elektrike dhe mekanike jane te ndryshme.

Furnizimi me energji elektrike TU

Ashtu si dhe rrjeti ne TM dhe rrjeti elektrik ne TU eshte tejet i amortizuar dhe i ngarkuar. Shumica e ketyre linjave perbehen nga linja ajrore me percjelles alumini te shveshur.

Pergjat trakteve te ketyre linjave vihen re lidhje dhe degezime jash kushteve teknike si dhe perdorimi i materjaleve rrethanore apo produkte te pa standartizuara per te tilla rrjete.

Probleme kryesore hasin zonat periferike, sic u tha dhe mesiper, duke nisur qe nga humbjet e TM ne transmetim deri ne kabine elektrike. Shtimi i konsumatoreve ka cuar ne nje mbi ngakese te ketyre kabinave. Demtimet elektrike te transformatoreve nga faktore elektrik nuk kane qene te ralla.

Mos standartizimi i rrjetit transmetues ne TU here pas here eshte bere dhe burim aksidentesh dhe nderhyrjesh te pa ligjshme ne rrjet.

Vihet re diversitet tipologjie produktesh qe perbejne rrjetin shperndares duke nisur qe nga standarti shqiptar (pjese qe ka ngelur nga rrjeti i trasheguar), produkte te standartizuara nga Europa lindore si dhe produkte EC. Xhuntimet dhe nderhyrjet ne linja jane jashte kushteve teknike ne kontakt me agjentet atmosferik.

Ndricimi publik Rrugor

Kruja është një qytet në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, kryeqendër qarku dhe një qytet me potencial të turistik. Si e tillë ndricimi i ambjenteve publike të qytetit kthehet në një domosdoshmëri. Pjesa me e madhe e lagjeve të qytetit të Krujës aktualisht janë të ndriçuara, por teknologjia e përdorur le për të dëshiruar pasi ky sistem ndricimi konsumon dhe ndikon në ndotje mjedisore.

Ndricimi nuk është i kënaqshëm dhe kostoja e mirëmbatjes është relativisht e lartë

Rrjeti shperndares elektrik ne zonen e qytetit

Simbas kushteve teknike ne fuqi kohe zgjatja e shfrytezimit te linjave eshte 20 vjet. Rrjeti shperndares i TM6kv i kesaj zone ka rreth 40 vjet qe jane ne shfrytezim dhe ne pjesen me te madhe te gjatesise se tyre jane shume te amortizuar dhe kane

nevoje per rinovim total. Ne kete situatë dhe me keto treguesat teknik, rrjeti shperndares TM 6kv nuk ploteson kërkesat e sigurisë se furnizimit me energji elektrike te zones. Si konkluzion lind nevoja per nje rrjet te ri, te kalimit nga sistemi ekzistues i rrjetit TM. 6kv , ne sistemin e ri me TM.20KV me rrjete unazore .

Verejtje:

Megjithese qyteti i Krujes eshte aktualisht i furnizuar mire me energji, cilesia e tij le per te deshiruar sidomos persa i perket perspektives. Eshte e domosdoshme qe sistemi i furnizimit me energji elektrike te kaloje ne linjen e 20 kv dhe te futet i gjithi nen toke, sidomos ne ato pjese ku linja ajrore kalon prane zonave te banimit.

Plani i ri rregullues duhet te beje bashkerendimin me planet e OSHEE per te bere rikonstrukcionin dhe permiresimin e rrjetit shperndares te brendeshem te qytetit ne baze te parametrave bashkekohore per perspektiven duke i paraprire zhvillimit hapesinor te tij. Ne planet e tyre duhet te perfshihen zonat e banimit ekzistuese si edhe zonat e zhvillimit perspektiv si ne aspektin e banimit ashtu edhe ne aspektin e sherbimeve industrise dhe ekonomise se qytetit.

3.3.6.6 Mbledhja dhe menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve ne Shqiperi eshte ne nje nivel te ulet. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit te mbetjeve te ngurta urbane kryhet ne pjesen me te madhe te qyteteve. Riciklimi kryhet per nje pjese shume te vogel te mbetjeve. Metoda me e përdorur e asgjësimit te mbetjeve eshte hedhja e tyre. Ne vend nuk ka landfillte te ndertuara sic duhet. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit te mbetjeve nuk kryhet ne zonat rurale dhe ne qytetet e vogla. Asgjësimi i pjeses me te madhe te mbetjeve ne keto zona behet duke i hedhur neper kanale, lugina apo anash rrugeve dhe pasi behet pastrimi i rrugeve ato hidhen ne vendet tjera dhe se fundmi edhe ne rrjedhat e ujerave. Nuk ekziston nje sistem per menaxhimin e sigurte te mbetjeve te rrezikshme (familjare dhe tregtare). Riciklimi i mbetjeve eshte ne nje nivel te dobet. Menyra kryesore e trajtimit te mbetjeve eshte ajo e hedhjes se tyre, megjithese duhet te permendim faktin qe keto vende grumbullimi te mbetjeve nuk jane ndertuar sic duhet (nuk jane landfillte), dhe si rrjedhoje ka nje ndotje te perhereshme te mjedisit. Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe menaxhimit te tyre jane te shumta dhe te ndryshme. Sasite me te medha te gjenerimit te mbetjeve (per nga pesha) jane mbetjet nga materialet inerte, ne vecanti nga ndertimet, por rreziku me i madh eshte i lidhur me volumet me te vogla te gjenerimit te mbetjeve te rrezikshme (kryesisht industriale). Mbetjet bashkiake kane nevoje per grumbullim, transportim dhe asgjësim te vecante dhe te shtrenjte. Per kategori te vecanta mbetjesh si psh mbetje spitalore, duhet te aplikohen kushte te vecanta.

Shërbimet e tanishme për mbledhjen e mbetjeve janë shumë të kufizuara në zonat urbane – nën juridiksionin e bashkive. Ka pak mbledhje formale mbetjesh në komuna, dhe mbetjet kanë tendencën të hidhen në vendet që zakonisht pranohen se janë vendgrumbullime mbetjesh, por nuk kanë leje dhe janë ilegale.

Qyteti i Krujës dhe i Fushë Krujës kanë një prodhim mbetjesh rreth 5000 tonë në vit. Në bazë të Planit Kombëtar të Menaxhimit të mbetjeve është parashikur që të ngrihet impianti i parë i djegjes së tyre pranë fabrikës së çimentos në Krujë.

Në territorin e bashkisë Fushë Krujë shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave kryhet nga një firmë private e kontraktuar nga bashkia. Shërbimi i ofruar nga firma private përfshin:

- Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në venddepozitimin e përcaktuar nga bashkia.
- Pastrimin e hapësirave urbane: rrugë dhe sheshe.
- Fshirjen e rrugëve dhe shesheve.
- Larja dhe lagja e rrugëve dhe shesheve.

Grumbullimi i mbeturinave bëhet me kontenierët në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga bashkia nga ora 7.00 në orën 9.00. Largimi dhe transporti i këtyre mbeturinave bëhet me makina teknologjike. Aktualisht hedhja e mbeturinave bëhet mbrapa ujëmbledhësit të Fushë Krujës sipas vendit të caktuar nga bashkia, por ky venddepozitim i mbetjeve të ngurta nuk disponon një leje nga Ministria e Mjedisit. Vëllimet e punimeve për qytetin. Zona për të cilën ofrohet shërbimi harta e vendosjes së kontenierëve, rrugët që pastrohen. Mirëmbajtja pastër e rrugëve gjatë ditës, grumbullimi i papastërtive të ndryshme bëhet nga ora 10:00 deri në orën 18:00.

Fshirja e rrugëve kryhet me makineri teknologjike fshesë për rrugët dhe sheshet në një sipërfaqe totale prej 46968 m². Fshirja e rrugëve kryhet çdo natë nga ora 22:00 deri në orën 03:00 të mëngjesit. Sipërfaqja për larjen e rrugëve dhe shesheve është 62345 m² ku përfshihet sipërfaqja prej 16800 m² në pikën 2 përjashtoj sipërfaqen prej 1423 m² të rrugës së ish stacionit të trenit (400m²), rrugës së ish grumbullimit (400 m²) dhe lagjes SMT (623 m²). Lagja e rrugëve të qytetit bëhet për periudhën Maj-Tetor me tre lagje në ditë: paradite, në drekë dhe pasdite. Sipërfaqja totale e rrugëve që lahen shkon në 46968 m².

3.4 Analiza e vlerësimeve demografike

Bashkia Krujë, e përbërë nga 6 njësi administrative, është një pjesë përbërëse e qarkut Durrës. Sipas të dhënave të Censurit 2011, popullsia e bashkisë Krujë (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj) ka një numër prej 59 814 banorë, ndërsa sipas regjistrit të gjendjes civile 79 608 banorë. Mbi bazën e këtyre të dhënave llogaritet dendësia 176.43 banorë/km² sipas Censurit, ndërsa sipas Regjistrit të gjendjes civile dendësia është 234.81 banorë/km².

Arsyeja e paraqitjes së të dhënave të ndryshme nga INSTAT-i dhe Regjistri i gjendjes civile janë lëvizjet brenda vendit pas vitit '89, të cilat nuk shoqëroheshin gjithmonë me procedurat e regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë.

Tabela 18: Ndryshimi i popullsisë 1989-2011 (INSTAT)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikël	Thumanë
Popullsia 2011	5951	1812	18477	11721	9518	12335
Ndr. i popullsisë 1989/2001 (në %)	-8.28	-54.84	29.2	-14.74	46.88	4.9
Ndr. i popullsisë 2001/2011 (në %)	-3.6	-52.91	0.2	-10.36	6.6	-5.49

Nga të dhënat e mësipërme, vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të banorëve në njësine administrative Cudhi dhe në Krujë, ndërsa njësitet administrative Fushë Krujë dhe Nikël kanë rritje të numrit të banorëve. Kjo rritje ka ritme shumë të shpejta në 10-vjeçarin e parë të periudhës së marr në studim (vitet 1989-2001). Pas vitit 2001, edhe pse me ritme të ulëta, janë të vetme njësi administrative me rritje të popullsisë së Bashkisë Krujë.

Ndërkohë nga të dhënat e Regjistrat të gjendjes civile, ecuria e popullsisë të bashkisë së Krujës për dy vitet e fundit, është sipas tabelës së mëposhtme. Vihet re që lëvizjet vjetore të popullatës në njësitet administrative luhaten nga +/- 0.2 – 3.2 %.

Tabela 19: Popullsia 2014-2015 (Bashkia Krujë)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikël	Thumanë
Popullsia 2014	8442	3134	26081	16365	10430	15998
Popullsia 2015	8525	3093	26380	16400	10099	16400
Diferenca 2015-2014	83	-41	299	35	-331	402

Në tërësi, popullsia e bashkisë ka pësuar rritje të ndjeshme në periudhën 1989 – 2001 (rreth 12%) ndërsa në periudhën 2001 – 2011 ka pësuar rënie (rreth 6%). Këto shifra tregojnë një rritje prej rreth 5.3% të popullsisë në 22 vite me një mesatare vjetore rreth 0.24 %. Kjo tendencë në vitet e fundit ka rezultuar në rënie duke u shoqëruar edhe me zvogëlim të numrit të banorëve në rang bashkie në dhjetëvjeçarin 2001-2011. Migrimi i brendshëm ka ndodhur nga zonat periferike drejt qendrave urbane dhe zonave me akses kundrejt infrastrukturës. Frenimi i zhvendosjeve masive të popullsisë në rang vendi në fundin e viteve '90 solli edhe reduktimin e popullsisë së ardhur nga zonat e thella. Në përmbledhje mund të themi se Bashkia Krujë ka tendencë për reduktim të numrit të popullsisë në vitet e ardhshme dhe do të vazhdojë të ketë lëvizje të brendshme popullsie nga zonat e thella drejt qendrave ekonomike, atyre të shërbimeve dhe infrastrukturës.

Për sa i përket strukturës së popullsisë, përveç migrimit, ulja e lindshmërisë dhe vdekshmëria kanë ndikim të rëndësishëm. Sipas të dhënave të INSTAT-it, 21.4% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç dhe 9.42% është mbi moshën 65 vjeç (INSTAT, Popullsia dhe dinamika e saj në Shqipëri). Këto të dhëna tregojnë që grupi i popullsisë aktive 15-64 vjeç zë përqindjen më të madhe. Koeficienti i varësisë (numri i personave nën 14 vjeç dhe mbi 65 vjeç, përkundërt numrit të personave në moshë aktive 15-64 vjeç) shprehur në përqindje është 49.22, shifër kjo ndjeshmërisht më e ulët se niveli kombëtar. Kjo nënkupton një zvogëlim të barrës së personave të varur brenda njësive ekonomike familjare.

Tabela 20: Popullsia banuese, Dt. 31.12.2011 (Bashkia Krujë)

Emërtimi	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Nr. i familjeve	Pjestar për familje
Popullsia	81512	40504	41008	19726	4.1

Nga tabela e mësipërme, vihet re që raporti meshkuj/femra në Bashkinë Krujë është në përqindje të përafërta, pra raporti gjinor është me vlerë të ulët. Familjet përbëhen me mesatarisht nga 4.1 pjesëtar, shifër kjo e përafërt me mesataren e vendit.

Tabela 21: Numri i lindjeve dhe i vdekjeve sipas muajve, 2011 (Bashkia Krujë)

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Lindjet	81	83	70	45	71	69	122	162	109	104	91	103	1110
Vdekjet	4	6	13	5	6	5	4	12	3	3	6	13	80

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura në këto tabela, rezulton për rrethin e Krujës në vitin 2011 të kemi 13.6 lindje për 1000 banorë.




Fig. 72: Numri i lindjeve dhe i vdekjeve sipas muajve, 2011

Për qarkun e Durrësit, ky koeficient (raporti i lindjeve për 1000 banor të një territori, në një vit të dhënë) për vitin 2015, sikurse duket nga grafiku i mëposhtëm, është pak më i lartë sesa mesatarja kombëtare e lindjeve.




Fig. 73: Koefficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016)

3.4.1 Lëvizjet natyrore dhe hapsinore

Nga të dhënat e INSTAT në 22 vite ('89-'11), del se popullsia është në rritje, mesatarisht me rreth 0.24% në vit paçka se vitet e fundit vihet re rënie e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Shtesa natyrore e popullsisë deri në vitet '90' ka qënë e lartë falë politikave sociale dhe ritmeve të larta të lindshmërisë të shoqëruara nga ulja e vazhdueshme e treguesve të vdekshmërisë. Pas viteve '90 vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të lindjeve. Shkak kryesor është migracioni i theksuar për moshën 20-35 vjeçare, ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i nevojës për krahë pune në bujqësi.

Lëvizja hapësinore e popullsisë karakterizohet nga dy forma tradicionale të saj: migracioni i brendshëm dhe emigracioni jashtë kufinjve të vendit. Kjo lëvizje e popullsisë dhe të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik të zonës me ulje-ngritjet e saj, janë reflektuar dhe në punësimin e familjeve me grup-moshë aktive.

Gjithashtu mbas viteve '90' ka ndikuar dhe lëvizja e lirë e njerëzve për t'u punësuar në rrethinat më të zhvilluara brenda vendit, sidomos në zonën Tiranë-Durrës. Kjo u shoqërua me rritje të ndjeshme të popullsisë me prurje nga zonat e thella të vendit që u zhvendosën në territore pranë zonës ekonomike Tiranë Durrës dhe aksit kombëtar Tiranë – Lezhë. Ky fenomen ka qënë dhe vazhdon të jetë aktiv. Ka lëvizje të njerëzve nga fshatrat e thella, drejt fshatrave të cilat janë më pranë zonave me përparësi urbane dhe nga qytetet e vogla, drejt qyteteve më të mëdha, që ofrojnë më shumë mundësi punësimi dhe jete sociale.

Kruja, si gati gjithë Shqipëria, ka më shumë se 20 vjet që është përfshirë nga eksodi i orientuar drejt qyteteve, zonave fushore dhe jashtë kufirit të Shqipërisë. Kjo ka të bejë

sa me burimet e pakëta natyrore, apo me pamundësinë e shfrytëzimit të tyre si duhet, aq edhe me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të disa territoreve. Banorët janë në kërkim të një jete më të mirë, veçanërisht për fëmijët e tyre, mundësive të rritjes së prodhimit bujqësor, mundësive më të mira për punësim e për shanse më të favorshme. Infrastruktura e sotme: rrugët, rrjeti elektrik dhe ai ujesjellës, shkolla, qendrat shëndetësore, qendrat kulturore dhe argëtuese, janë zhvilluar në mënyrë jo të njëjrtshme në territorin e vendit, duke krijuar diferenca të ndjeshme dhe nevojën e natyrshme për migrim.

3.4.2 Projektionet

Aktualisht lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale apo të thella drejt qyteteve dhe zonave fushore e bregdetare, për Bashkinë Krujë, janë stabilizuar dhe pjesa më e madhe e zonave të banuara po shkojnë drejt konsolidimit. Rol pozitiv në këtë aspekt luan dhe procesi i legalizimit të ndërtimeve informale në rang vendi. Projektioni i popullsisë u bë duke tentuar një vijë të mesme mes të dhënave të INSTAT-it dhe atyre nga regjistri civil i Bashkisë Krujë. Përtej vlerësimit të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migrimit ndërkombëtar, problemi i projeksioneve mbetet një detyrë e vështirë për parashikimet e të ardhmes. Hipotezat për lidhjen e të dhënave u konceptuan në tre variante, si e lartë, e mesme dhe e ulët. Në hipotezën e mesme normat e lëvizjes u konsideruan konstante dhe si mesatare mes të dhënave të INSTAT-it nga 2007-2011 (që ata e konsiderojnë normë e mesme) dhe të dhënave nga Bashkia për po këto vite. Një element shtytës për këtë kombinim ka qenë edhe pozicioni strategjik i Bashkisë, pranë qendrave të mëdha urbane, Ultësirës perëndimore dhe Detit Adriatik. Mendojmë që lëvizjet e brendshme do e favorizojnë disi Krujën, duke bërë të ngjashëm me Qarqet e Tiranës dhe Durrësit, po sigurisht jo më të njëjtin ritëm rritjeje.

Në hartimin e projeksioneve u analizua edhe tendenca e zhvillimit të territorit dhe lëvizjet demografike sidomos ato të 25 viteve të fundit. Nisur nga luhatjet e popullsisë sipas fazave të zhvillimit, mendohet se skenarët e pritshëm të ndryshimit të popullsisë janë në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe bashkisë në veçanti.

- Në rastin e një zhvillimi apo rritjeje ekonomike, popullsia mbetet e njëjtë ose pëson një rritje të lehtë
- Në rastin e një regresioni ekonomik popullata ka prirjen të tkurret e të zhvendoset në qendra me aktivitet më të lartë ekonomik

Pavarësisht të dhënave kontradiktore për popullsinë, duke u nisur edhe nga elementë të tërthortë tregues (femrat në moshë fertile - 51,77%) dhe analiza të treguesve, si konkluzion mund të themi se rritja e popullsisë prej 0.23% në vit mendohet reale, e qëndrueshme dhe pjesë e një modeli të besueshëm, si rrjedhim, popullsia e Bashkisë Krujë, në vitet 2030 do të jetë mes 62,000 dhe 82,500 banorësh, me një mesatare të pranueshme prej 73,000 banorësh.

3.5 Aspektet sociale dhe ekonomike

3.5.1 Biznesi

Bashkia e Krujës ka një profil ekonomik të diversifikuar. Aktivitet kryesore ekonomike janë përqëndruar përgjatë rrugës nacionale SH1 dhe në vazhdimësi të saj, autostradës E672; midis Njesisë Administrative Fushë-Krujë dhe Krujë (rreth rrugës nacionale Sh 38); si dhe fasone të përqëndruar rreth qytetit të Krujës.

Para viteve '90 kjo zonë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ekonominë kombëtare përsa i përket produkteve bujqësore dhe blegtorale (veçanërisht zona e Fushë Krujës). Aktualisht, tokat bujqësore zënë rreth 40% të territorit të të gjithë bashkisë, megjithatë prodhimet aktuale janë nën potencialin e tyre.

Ndër aktivitetet ekonomike, një përqindje të madhe zënë ato që shfrytëzojnë drejtpërdrejt pasuritë natyrore, si p.sh.: guroret dhe pikat e shfrytezimit të inerteve.

Sektor tjetër i rëndësishëm është ai i industrive përpunuese si ajo e çimentos, drurit, mermerit, përpunimit të sheqerit, etj. Ndërkohë që industritë përpunuese ushqimore, tradicionale për zonën, si fabrika e zhveshjes së orizit, e çembrionizimit të misrit, e tharjes së prodhimeve bujqësore, janë tashmë jashtë funksionit.

Sektori i shërbimeve për bizneset dhe konsumatorët ofron të gjitha llojet e shërbimeve për të plotësuar nevojat e përdoruesve. Një veçori e kësaj zone është prania e ujrave termale, në fshatin Bilaj të Njesisë Administrative Fushë Krujë, të njohura për efektet e tyre kurative.

Aktualisht, në bashkinë e Krujës janë vendosur 1265 aktivitete ekonomike, nga të cilat 934 janë biznese te vogla dhe 331 biznese të mëdha.

Tabela 22: Evidenca në lidhje me bizneset (Bashkia Krujë)

Lloji	Aktiviteti	Numri
Biznes i vogël	Tregti	680
	Shërbime	254
	Totali	934
Biznes i madh		
	Ndërtim	30
	Tregti	150
	Shërbim	50
	Prodhim dhe faqosje këpucësh	10
	Prodhim druri	15
	Prodhim inertesh	2
	Drejt. Dhe blerjen për shfrytezimin e burimeve natyrore tokë/nën	1

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

	Ndërtim i linjës së prodhim dhe shitje sheqeri	1
	Prodhim energjie	1
	Prodhim çimento	1
	Përpunim mermeri	1
	Gurore	42
	Të tjera	27
	Totali	331

Për Njësinë Administrative Fushë Krujë sipas të dhënave të planit të përgjithshëm vendor të viti 2013, janë të regjistruara gjithsej 482 biznese, nga të cilat 391 janë biznese të vogla dhe 91, biznese të mëdha.

3.5.2 Sektori i Bujqësisë

Kruja është një bashki me zhvillim tradicional të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, veçanërisht zona e Fushë Krujës, edhe pse sot potencialet e saj nuk janë të shfrytëzuara.

Përsa i përket prodhimeve bujqësore, Bashkia e Krujës dallohet për prodhimin e bimëve të arave, foragjereve, perime në sera, fruktikulturë, vreshta, ullishte, bimë mjekësore dhe kultivimin e kërmillit. Gjithashtu, ajo paraqet nivel të lartë të sipërfaqeve të mbjella, si dhe të prodhimit ullinjve dhe vreshtave. Fushë Kruja është njësi me prodhimtari më të madhe, si dhe me më shumë sipërfaqe të mbjella. Kërmilli kultivohet në Bubq dhe Fushë Krujë, ndërsa për bimë mjekësore është e dalluar njësi e Niklës, por edhe Thumana, Fushë Kruja dhe Cudhi. Shpërndarja e fermave bujqësore për secilën njësi administrative, për çdo produkt bujqësor, sipas të dhënave të vitit 2014 të Drejtorisë së Bujqësisë së Qarkut Durrës, tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 23: Ferma Bujqësore, 2014

Njësia Administrative	Gjithsej		Ferma me bimë arash		Ferma me bimë foragjere		Ferma me perime në sera		Ferma me drejtim frutikulturë		Ferma me drejtim vreshta		Ferma me drejtim ullishte		Ferma me drejtim agrume		Ferma me bimë aromatike mjekësore		Ferma me kultivim kërmilli	
	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha
Krujë	122	835.8	0	0	0	0	0	0	8	0	12	122	815.8	0	0	0	0	0	0	0
Fushë Krujë	2,432	2,415.1	41	47.7	55	24	13	5.3	18	107.7	6	21.1	19	130.2	0	0	3	1.5	1	0.5
Thumanë	3,352	4,904.5	23	215	17	310	11	0.8	9	17.6	2	17.4	2	0.0	0	0	1	3	0	0
Nikël	1,774	2,151.5	218	125	284	194	16	3.4	78	38.4	12	9.2	65	32.9	0	0	6	2.5	0	0
Bubq	1,555	2,394.1	14	132	16	130	3	0.4	3	48.8	1	11.4	5	125.5	0	0	0	0	1	0.5
Cudhi	616	518	0	0	0	0	0	0.0	5	21.7	0	4.3	0	133.4	0	0	1	1	0	0
Shuma	9,851	13,218.9	296	519.7	372	658	43	9.9	113	242.1	21	75.4	213	1,237.8	0	0	11	8	2	1

Edhe në sektorin e blegtorisë, njësi me numër më të madh fermash blegtorale me gjedh, të leshta dhe të dhirta është Cudhi. Fushë Kruja dallohet për fermën me shpendë, ndërsa Nikla për mbarështimin e bletëve.

Tabela 24: Ferma Blegtorale, 2014

Njësia Administrative	Ferma me gjedh		Ferma me të leshta		Ferma me të dhirta		Ferma me shpendë		Ferma me bletë	
	Nr. i fermave	Nr. i krerëve	Nr. i fermave	Nr. i krerëve	Nr. i fermave	Nr. i krerëve	Nr. i fermave	Nr. i krerëve	Nr. i fermave	Nr. i krerëve
Krujë	4	45	12	700	34	3,670	0	0	2	120
Fushë Krujë	3	162	14	1,220	3	1,180	1	700,000	5	380
Thumanë	10	170	8	660	6	400	1	3,000	4	400
Nikël	3	50	1	170	2	270	0	0	7	490
Bubq	3	42	18	1,420	12	865	0	0	1	201
Cudhi	14	213	17	1,678	44	5,360	0	0	1	112
Shuma	37	682	70	5,848	101	11,745	2	703,000	20	1,703

Në total, njësia me numrin më të madh të fermave bujqësore është Thumana dhe ajo me numrin më të madh të fermave blegtorale është Cudhi. Kruja, është njësia me numër më të vogël, si të fermave bujqësore ashtu edhe të atyre blegtorale.

Tabela 25: Ferma Bujqësore dhe Blegtorale, 2014

Njësia Administrative	Ferma gjithsej	Ferma Bujqësore		Ferma Blegtorale		Të tjera	
		Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha
Krujë	174	122	835.8	50	4,415	2	120
Fushë Krujë	2,458	2,432	2,415.1	20	2,562	6	700,380
Thumanë	3,381	3,352	4,904.5	24	1,230	5	3,400
Nikël	1,787	1,774	2,151.5	6	490	7	490
Bubq	1,589	1,555	2,394.1	33	2,327	1	201
Cudhi	692	616	518	75	7,251	1	112
Shuma	10,081	9,851	13,218.9	208	18,275	22	704,703

Problematika dhe rekomandime

Problematikat kryesore të këtij sektori janë si mëposhtë:

- Fragmentarizimi i lartë i tokës bujqësore dhe madhësia shumë e vogël e fermave, të cilat përbëjnë një pengesë reale për prodhimin dhe shitjen e sasise të konsiderueshme në tregjet rajonale dhe kombëtare, si dhe për investime teknologjike në shkallë të madhe.
- Zonat tradicionale bujqësore e blegtorale kanë pësuar një shpopullim masiv. Moshë e fermerëve është relativisht e lartë.
- Mekanika bujqësore nuk mbulon të gjitha hallkat teknologjike për kultivimin e kulturave bujqësore. Mjetet e përdorura janë të amortizuara dhe jo të pajisura me të gjitha agregatet e nevojshme për të gjitha pjesët e procesit.
- Pothuajse të gjitha njësitë rrezikohen nga përmytjet e tokave bujqësore.

- Mungesa e shërbimeve, si në sistemin e vaditjes dhe kullimit ashtu edhe në aplikimin e teknologjive bashkëkohore, si dhe mungesa e standarteve bazë higjeno-sanitare.
- Mangësi në teknikat për mbarështimin dhe përmirësimin e racave ekzistuese.
- Infrastruktura agro-industriale e zhvilluar në nivel të pamjaftueshëm.
- Kosto e inputeve është shumë e lartë.

Në nivel politikash duhet të merrem masa për:

- të luftuar informalitetin kontraktual/tregtar dhe atë fiskal;
- bashkëpunim me institucionet financiare, publike, private dhe organizata të specializuara, hartimin e produkteve financiare mbështetëse (kredi, grante, subvencione) të përshtatura për nevojat e sektorit;
- të siguruar mbështetjen nga pikëpamja institucionale dhe administrative mbrojtjen e prodhimeve tipike të zonës (markat rajonale/patenta/standartet e sigurisë e cilësisë);
- nxitjen e bizneseve të vogla bujqësore, blegtorale dhe industrinë përpunuese ushqimore nëpërmjet mundësitë të infrastrukturave territoriale mbështetëse dhe politikave fiskale lehtësuese (ndërtim tregjesh vendore, investim në burime njerëzore, provovim/marketim i produkteve);
- edukimin, informimin dhe orientimin në lidhje me mundësitë e skemave të financimit dhe mekanizmave institucionalë për thithjen e fondeve nga burime të ndryshme (publike, private, të huaja); për përfitimet e organizimit të fermerëve dhe blegtorëve në shoqata dhe minikooperativa; për domosdoshmërinë e zbatimit të standarteve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit (kjo masë mund të arrihet nga një koordinim përpjekjesh mes strukturash lokale dhe qendrore).

3.5.3 Sektori i Turizmit

Turizmi në Krujë konsiderohet si një nga sektorët prioritarë e më premtues për sa i përket potencialit që ka për të kontribuar në zhvillimin social-ekonomik të Bashkisë Krujë në veçanti dhe rajonit në përgjithësi.

Zona disponon një sërë asetesh (natyrore e kulturore) që e favorizojnë tej mase zhvillimin e turizmit ku ndër më kryesorët janë:

- trashëgimi e pasur arkeologjike, etno-kulturore e historike, monumente kulture etj. që e bëjnë tërheqëse këtë zonë nga vizitorë vendas dhe të huaj;
- zonat natyrore dhe monumentet e natyrës që ndodhen në zonë tregojnë që asetet turistike të zonës nuk janë vetëm në zonën historike të qytetit të Krujës por edhe në gjithë shtrirjen e territorit të bashkisë;
- tradita e zhvilluar e mikpritjes dhe gatimeve tradicionale, janë një vlerë e shtuar që ofron kjo zonë;
- pozicion gjeografik i përshtatshëm dhe ndërthurja e disa infrastrukturave rrugore kombëtare e bëjnë atë një zonë mjaft tërheqëse dhe të aksesueshme,

- prania e Aeroportit “Nënë Tereza” rrit ndjeshëm, potencialin e Bashkisë Krujë për të zhvilluar turizmin jo vetëm në kontekstin lokal por edhe në atë rajonal e ndërkombëtar.

Para se të analizohen aspektet kryesore turistike të Bashkisë, është me rëndësi të përmenden disa tregues makro-ekonomikë të këtij sektori, të cilat dëshmojnë rëndësinë që ka zhvillimi i turizmit në vendin tonë dhe potencialin që paraqet për të ardhmen.

- Sipas statistikave, për Shqipërinë kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit për PBB-në për vitin 2013 ishte 4,8 % ndërsa kontributi i përgjithshëm për ekonominë ishte 16,7%. Sektori i turizmit ka hapur drejtpërdrejt 4,3 % të numrit të përgjithshëm të vendeve të reja të punës ndërsa në mënyrë të tërthortë ka hapur 15,2% të tyre.¹⁸
- Që prej vitit 2001 numri i vizitorëve të huaj në Shqipëri është rritur ndjeshëm duke arritur në mbi 3,45 milion vizitorë në 2012. Rritja ishte kryesisht nga Evropa dhe Ballkani Jugor (Kosova dhe ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë) midis viteve 2008 dhe 2012.
- Në 2010 vizitorët e huaj shpenzonin 82 Euro/në ditë me një kohëzgjatje mesatare prej 5 ditësh ndërsa për turistët e argëtimit, koha mesatare e qëndrimit ishte më e shkurtër – rreth 2,8 ditë. Shpenzimi mesatar në destinacionin vendor është 79 Euro.

Kruja në nivel kombëtar të potencialeve turistike zë vendin kryesor për turizmin historik-kulturor ku veçohet edhe si destinacioni kryesor i vizituar nga shtetasit shqiptarë dhe ata kosovarë. Qyteti aktualisht ka dy ndër muzetë më të vizituar në vend si dhe përfiton një numër të lartë turistësh edhe për shkak të arritshmërisë së lehtë që ka nga kryeqyteti. Kështjella mesjetare, pazari i vjetër, muzeu etnografik dhe muzeu kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” janë ndër atraksionet kryesore që ofron qyteti i Krujës. Turizmi ka sjellë edhe ruajtjen e traditës së artizanatit në disa zeje të kufizuara në Pazarin e Krujës. Muzeu “Gjergj Kastrioti” ka mbi 25 000 vizitorë në vit.

Potenciale të tjera për zhvillimin e turizmit mbeten edhe Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis), Parku i Qafë Shtamës, Kodrat e Krastës, Mali i Krujës dhe Teqja e Sari Salltikut, Zona e Ujrave termale në Bilaj etj. Gjithashtu oferta turistike ka dhe mjaft elementë të trashëgimisë kulturore dhe monumente të natyrës të shpërndara në territor që mund të pasurojnë itineraret.

Problematika dhe rekomandime

Mungesa e një qasje të koordinuar të ofertës turistike tregon qartë nevojën për vëmendje dhe investime strategjike në këtë sektor. Përgatitja e një plani veprimi me fokus zhvillimin e sektorit të turizmit në zonë është i domosdoshëm.

Kaosi në ndërtime dhe informaliteti, edhe pse në shkallë më të ulët sesa rajoni, përbën në çdo rast rrezik për vlerat turistike të zonës e sidomos për peizazhin historik dhe atë

¹⁸ Nga të dhënat e Këshillit Botëror për Turizmin dhe Udhëtimet

natyror. Ngritja dhe efektshmëria e strukturave për kontrollin e zhvillimit të territorit duhet të jetë prioritet i Bashkisë Krujë.

Përmirësimi i infrastrukturave të shërbimeve në përgjithësi duke përfshirë dhe objektet social-kulturore është i domosdoshëm. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar rrjetit të ujësjellës kanalizimeve si një ndër infrastrukturat kryesore që ndikojnë në ruajtjen dhe cilësinë e mjedisit.

Bashkia duhet të inventarizojë resurset e veta turistike, për të konceptuar dhe konsoliduar më lehtësisht produkte të integruara turistike dhe gjithashtu investime të mëtejshme në mënyrë që sektori të bëhet konkurrues dhe i diferencuar edhe në nivel vendi. Përgatitja e hartave me itineraret turistike të të gjitha llojeve që ofrohen në territorin e bashkisë është një domosdoshmëri për të orientuar vizitorët.

Përfshirja e bashkisë Krujë në itineraret turistike rajonale e ndërkombëtare që sugjerohen nëpër publikime/media të ndryshme do të rriste interesin për këtë destinacion. Rritja e bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës do të shërbente për promovimin e vlerave turistike të zonës.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për aksesim sa më të thjeshtë të monumenteve të kulturës, dhe nxjerrjen në pah dhe promovimin e tyre është i domosdoshëm për zhvillimin e një turizmi alternativ kulturor, duke i dhënë kështu vëmendje dhe zhvillim jo vetëm zonës bregdetare por gjithë territorit të bashkisë.

3.5.4 Sektori i Industrisë

Industri të ndryshme nxjerrëse dhe përpunuese ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bashkinë Krujë, të cilat shfrytëzojnë pasuritë natyrore të këtij territori: argjila, guri gëlqeror dhe zallishtja e lumit.

Guroret janë lokalizuar kryesisht në zonën e Krastës. Po në të njëjtën zonë ndodhen edhe dy fabrikat e çimentos. Fabrika tjetër e çimentos ndodhet në veri të territorit, në zonën e Thumanës. Pranë fshatit Luz, ndodhet fabrika e tullave, ndërsa industria fasone (kryesisht për përpunimin e këpucëve) është përqëndruar rreth qytetit të Krujës. Përpunimi i drurit është një nga aktivitetet që operon kryesisht në zonën e Fushë Krujës.

Problematike në këtë zonë mbeten furrat e gëlqeres. Këto furra kanë qënë një burim ndotjeje jo vetëm në afërsi të zonës ku ato ushtronin aktivitetin e tyre, por ndotja shtrihej dhe më gjërë. Në këtë zonë nuk janë bërë publike të dhënat për cilësinë e ajrit, edhe pse për vite me radhë furrat e gëlqeres janë cilësuar mjaft problematike për mjedisin. Djegia çliron në ajër dy helme të rrezikshëm dioksinë dhe fenole. Ato kanë një rreze të gjërë veprimi që mund të arrijë deri në 50 kilometër. Pra ndotja nuk bëhet vetëm në Krujë, por edhe më gjërë. Edhe pse janë mbyllur nga Inspektorati i Mjedisit rreth 109 furra në territorin e Krujës, për arsye ekonomike, ato janë rivënë në funksion nga banorët edhe pse në mënyrë të jashtëligjshme.

Problematika dhe rekomandime

Sektori i industrisë karakterizohet nga veprimtari jashtë monitorimit shtetëror të aktivitetit, të cilat mund të dëmtojnë interesin publik. Ndotja mjedisore dhe shpyllëzimi janë dy problemet kryesore që kërkojnë urgjentish adresim.

Në përgjithësi, aktivitetet industriale, karakterizohen nga informaliteti, kushte të vështira pune dhe paga minimale.

Masat që duhet të ndërmerren në janë:

- Zhvillimi dhe modernizimi i të gjithë sektorëve të industrisë;
- Hartimi i politikave kombëtare për nxitjen, orientimin dhe sigurimin e investimeve financiare masive vendase dhe të huaja;
- Monitorimin e veprimtarive industriale me synim garantimin e interesit publik në këtë sektor,
- Ndërprerjen e veprimtarive të rrezikshme, që dëmtojnë rëndë mjedisit, si dhe veprimtarive pranë qendrave urbane;
- Marrjen e masave për ruajtjen e ujërave nëntokësore nga ndotjet e mundshme (infiltrimi i ujit) nga veprimtaritë industriale;
- Identifikimin dhe monitorimi i trajtimit të mbetjeve të ngurta nga aktiviteti industrial përgjatë lumenjve.
- Marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve ekzistuese.

3.5.5 Të ardhurat e Bashkisë Krujë

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për qeverisjen vendore dhe sistemin e taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Krujë përfiton të ardhura me anë të instrumenteve të mëposhtme:

Të ardhurat nga taksat.

Bashkia Krujë aplikon taksat si vijon: taksë e thjeshtuar mbi biznesin e vogël, taksë mbi ndërtesën, taksë mbi truallin, taksë mbi tokën bujqësore, taksë mbi ndikimin në infarstrukturë për ndërtimet e reja, taksë e regjistrimit të automjeteve, taksë e kalimit të pronësisë, taksë e zënies së hapësirave publike, taksë tregu, taksë tabele, taksë e fjetjes në hotel, zjarrfikset dhe pyjorja.

Të ardhurat nga tarifat

Tarifat e aplikuara nga kjo bashki për shërbimet publike që ofron, janë si mëposhtë: tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi, tarifë shërbimi veterinar, dhënie licensa, certifikata, leje apo autorizime transporti, tarifë parkimi i automjeteve, tarifë shërbimi administrativ.

Të ardhura të tjera

Në këtë grup të ardhurash përshihen qeratë nga objektet, gjoba, të ardhura nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik, të ardhura nga Pallati i Kulturës, të ardhura nga ALUIZNI, të ardhura nga çerdhet.

Përveç të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tatime, burim tjetër të ardhurash janë grantet dhe të ardhura të tjera, si p.sh nga Fondi i Zhvillimit Rajonal, PNUD-i, etj. Në

tabelën e mëposhtme, tregohet totali i të ardhurave për vitin 2015 për bashkinë e Krujës.

Tabela 26: Të ardhurat (Bashkia Krujë)

Emërtimi	Vlera (në lekë)
Granti i vitit + trashëguar	161074948
Të ardhurat të realizuara	104478645
Fonde nga FZHR	38238968
Të ardhura me kap.6	22792885
TOTALI	326585446

3.5.6 Analiza e periferialitetit

Analiza e periferialitetit ndihmon në identifikimin e diferencave sociale brenda territorit të bashkisë. Për të kuptuar këto pabarazi duhen studjuar paralelisht gjetjet dhe hartat e disa elementëve social-ekonomike dhe infrastrukturorë. Në disa raste është mjaft e vështirë gjetja e të dhënave të specifikuara sipas territorit, si psh të ardhurat mesatare për frymë sipas zonave, por disa të tjera janë më të qarta, si zonat jashtë rrezeve të shërbimit të objekteve sociale, arsimore dhe shëndetsore.

Shpërndarja hapësinore e aktiviteteve ekonomike, e paraqitur në paragrafin e mësipërm, ka lidhje të drejtpërdrejt edhe me aksesin në të mira dhe shërbimet, me përqëndrimin më të lartë të popullsisë në qendrat e banuara. Brenda territorit të bashkisë Krujë, një numër i konsiderueshëm personash kanë një vend pune fiks larg vendbanimit të tyre. Sipas të dhënave të Censurit 2011, në këtë bashki numri i personave që shkon në punë në këmbë ose me biçikletë përbën 48.01% të totalit të numrit të personave që punojnë në një vend fiks larg shtëpisë në Shqipëri, atyre që nuk kanë një vend pune fiks në Shqipëri dhe atyre që punojnë jashtë shtetit. Ky koeficient, për mjetet e tjera të transportit është si vijon: për transportin me autobus, minibus, tren dhe taksi 18.2%, ndërsa personat që përdorin si mjet transporti për në punë makinën dhe motorçikletën përbëjnë 29.3%

Tabela 27: Numri dhe përqindja e personave që udhëtojnë çdo ditë për arsye punësimi (INSTAT, 2011)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikël	Thumanë
Popullsia 2011	5951	1812	18477	11721	9518	12335
Dalje nga Njësia Administrative	597	180	2782	3061	1012	962
Përqindja e personave që dalin nga Njësia	10%	10%	15%	26%	11%	8%

Në tabelën e mësipërme tregohet numri i personave që lëvizin nga njësia administrative për arsye pune. Këta persona kanë një vend fiks pune larg vendbanimit të tyre dhe udhëtojnë rregullisht për të shkuar në punë. Vihet re se ky numër është më i lartë për qytetet sesa për fshatrat.

Lëvizja për në punë me anë të mjeteve motorikë, është me mund nga ekzistenca e rrjetit rrugor, i cili edhe pse nuk është në gjendje të mirë gjatë gjithë gjatësisë së tij, lejon transportin nga vendbanimet në vendet e punës dhe anasjelltas. Falë edhe

terrenit, lidhja e zonave të banuara në pjesën perëndimore është mjaft e mirë, që garanton akses të shpejtë në rrugë nacionale. Përsa i përket furnizimit me energji elektrike, i gjithë territori i bashkisë Krujë është i mbuluar. Gjithsesi, rrjeti i furnizimit të tensionit të lartë, për shkak të kohës së gjatë të shfrytëzimit është i amortizuar, ndërsa ai i tensionit të mesëm është i mbingarkuar. Në cdo rast ky shërbim ofrohet 24 orë për banorët ashtu edhe për bizneset.

Përsa i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemit të kanalizime shoqëria “Ujësjiellës-Kanlizime Krujë” sh.a. ka deklaruar se, nga viti 2013 i gjithë territori i bashkisë së Krujës së atij viti, është i mbuluar me infrastrukturën për furnizimin me ujë të pijshëm dhe 93.79% e këtij territori është e pajisur edhe me kanalizime të ujrave të zeza. Ndërsa shoqëria “Ujësjiellës-Kanlizime Fushë Krujë” sh.a., në vitin 2014 mbulon me rrjet për furnizimin me ujë të pijshëm 39.22%. Mbulimi me ujësjiellës urban është 70.32% është dhe 9.22% mbulim me ujësjiellës rural. Përsa i përket kanalizimeve është e mbuluar vetëm 34.10% e territorit. Si sqarohet në kapitullin e Infrastrukturës dhe Hartën përkatëse, rrjet të mirëfilltë kanë vetëm qytetet dhe pjesërisht fshatrat pranë tyre, por në periferi ky rrjet ka shumë probleme, ose nuk funksionon. Për një pjesë të mirë të territorit, rrjeti i ujrave të zeza është inekzistent dhe një pjesë e mbeturinave largohet me autobot, kurse një pjesë i rikthehet fushës, zgjidhje që tingëllon problematike, por në fakt eviton derdhjen në det dhe është hap i rëndësishëm i një zhvillimi të qëndrueshëm.

Sipas të dhënave të Censurit 2011, përqindja më e madhe e banesave që nuk ka asnjë lloj furnizimi me ujë ndodhen në Bubq (8.89%) ndërsa më përqindja më e vogël në Cudhi (0.75%) dhe më pas Kruja me 1.37%. Për njësitë e tjera kjo përqindje luhet nga 2.92% në Fushë Krujë në 4.42% në Nikël.

Përsa i përket burimit të të ardhurave, për të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lezhë, burimi kryesor i të ardhurave janë të ardhurat nga pagat. Raporti i njësive ekonomike familjare që kanë burim kryesor të ardhurash nga puna e paguar, me njësitë ekonomike familjare në total, ka përqëndrim më të lartë në Krujë (68.47%) dhe më të ulët në Thumanë (41.78%). Kjo përqindje për njësitë e tjera luhet nga 65.78% për Fushë Krujë, në 58.93% për Bubqin.

Të ardhurat nga remitancat, edhe pse në rënie vit pas viti, vazhdojnë të jenë një burim të ardhurash për njësitë administrative të kësaj bashkie. Kështu, në Thumanë 8.06% e familjeve kanë burim kryesor të ardhurash ato nga remitancat, në Bubq 7.85%, Fushë Kruja 6.6%, Cudhi 5.47%, Nikël 4.03% dhe Kruja me 3.92%.

Territori i bashkisë Krujë paraqitet në gjendje të mirë, përsa i përket shërbimeve sociale. Pothuajse të gjitha fshatrat dhe qytetet përbërëse të njësive administrative janë brenda rrezes së mbulimit qoftë të institucioneve arsimore ashtu edhe ato shëndetësore.

Në bashkinë Krujë nuk kemi zona të segreguara, me popullsi të marginalizuar apo me forma të përjashtimit, qoftë në nivel social qoftë në nivel ekonomik. Edhe prezenca e grupeve Etniko-Kulturore të ndryshme është minimale. Si duket edhe nga cilësia e banesave, bashkëjetojnë shpesh prane e pranë realitete të ndryshme social – ekonomike, që nuk mundësojnë hartëzimin e këtyre diferencave. Kuptohet të ardhurat

më të larta, numri i papunësisë më i ulët, numri i personave të arsimuar më i lartë, etj, elementët që tregojnë një nivel më të lartë gjendjeje ekonomike janë më evidente në Krujë dhe Fushë Krujë dhe shpërndahen në mënyrë gati radiale, në fillim në zonat përgjatë aksit nacional dhe më tej në periferitë e fshatrat e bashkisë.

Në përgjithsi Qarku i Durrësit, e më tej Bashkia Krujë ka një nivel kriminaliteti të grupit të dytë, të përafërt me mesataren e vendit, dhe të përqëndruar kryesisht në zonat urbane me dendësi më të lartë. Qoftë prej dendësisë së ulët, qoftë prej traditës zakonore, problemet me sigurinë janë të anasjellta me situatën ekonomiko-sociale, pasi zonat që konsiderohen periferike në lidhje me këto të fundit, janë më të sigurtat dhe me nivel më të ulët të veprave penale kundër personit apo pronës.

3.5.7 Arsimi dhe shëndetësia

Në Bashkinë Krujë ndodhen 56 objekte arsimore publike.

Arsimi parashkollor ofrohet nga 24 kopshte dhe çerdhe, nga të cilat 4 ndodhen në njësinë administrative Bubq, 1 në njësinë administrative Cudhi, 6 në Fushë Krujë, 3 në Krujë, 5 në Nikël dhe 5 në Thumanë.

Shërbimi arsimor bazë ofrohet për të gjitha njësitë administrative me anë të 27 objekteve arsimore publike. Në njësinë administrative Bubq ndodhen 4 shkolla 9-vjeçare, 3 në njësinë administrative Cudhi, 6 në Fushë Krujë, 4 në Krujë, 5 në Nikël dhe 5 në Thumanë.

Për sa i përket arsimit para-universitar, ndodhet nga një shkollë e mesme për secilën nga këto njësi administrative: Bubq, Fushë Krujë, Krujë, Nikël, Thumanë. Ndërkohë, në njësinë administrative Cudhi nuk ka shkollë të mesme.

Tabela 28: Shpërndarja e objekteve arsimore (Bashkia Krujë)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikel	Thumanë
Kopshte/çerdhe	4	1	6	3	5	5
Shkolla 9-vjeçare	4	3	6	4	5	5
Shkolla të mesme	1		1	1	1	1

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Krujë, ofrohet nëpërmjet shërbimit shëndetësor parësor dhe shërbimit shëndetësor dytësor.

Në bashkinë Krujë, ndodhet një spital dhe 2 poliklinika specialitetesh. Poliklinikat e specialiteteve janë gjenden në njësitë administrative Fushë Krujë dhe në Krujë, ndërsa spitali në njësinë administrative Krujë.

Spitali i Krujës ofron specialitet: patologji, pediatri, kirurgji, infektiv, ORL, obstetri-gjinekologji, shtëpi lindje në fshat dhe repart urgjence. Ky spital ka gjithsej 128 shtretër.

Qendra shëndetësore janë gjithsej 44. Ato janë të shpërndara nëpër Njësitë Administrative si vijon: 9 poliklinika në Bubq, 10 në Cudhi, 5 në Fushë Krujë, 5 në Krujë, 6 në Nikël dhe 9 poliklinika në Thumanë.

Tabela 29: Shpërndarja e objekteve shëndetësore (Bashkia Krujë)

Të dhënat/Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikel	Thumanë
Spitale				1		
Poliklinika specialitetesh			1	1		
Qendat shëndetësore (ambulancat e lagjeve/fshatrave)	9	10	5	5	6	9

3.5.8 Papunësia dhe përkrahja sociale

Bashkia e Krujës bën pjesë në rrethin e Durrësit dhe në rajonin qendror. Edhe pse sipas të dhënave të INSTAT-it të vitit 2015, niveli i jetesës në Shqipërisë është ulur nga viti 2008 e në vazhdim, si pasojë e krizës globale financiare dhe niveleve të ulta të rritjes, të dhënat qoftë për qarkun e Durrësit, qoftë për rajonin qendror flasin për ulje të varfërisë.

Përqindja e të varfërve për këtë qark (i cili përfshin rrethin e Durrësit dhe atë të Krujës) është 16.5%. Hendeku i varfërisë, i quajtur ndryshe edhe thellësia e varfërisë, tregues alternativ i cili shpreh sa larg janë familjet nga linja e varfërisë, është 3.6%. Ndërsa ashpërsia e varfërisë, tregues tjetër alternativ që tregon jo vetëm distancën e të varfërve nga linja e varfërisë, por edhe pabarazinë midis të varfërve është 1.3%. Edhe treguesit për rajonin qendror flasin për ulje të varfërisë, së këtij rajoni nga viti 2002 në vitin 2012.

Tabela 30: Treguesit e varferise (në %) sipas qarqeve (INSTAT, Anketa e matjes së nivelit të jetesës, 2012)¹⁹

Qarqet	Treguesit e varfërisë		
	Përqindja	Hendeku	Ashpërsia
Berat	12.3	2.3	0.7
Dibër	12.7	2.3	0.7
Durrës	16.5	3.6	1.3
Elbasan	11.3	2.3	0.7
Fier	17.1	3.4	1.0
Gjirokastrë	10.6	2.4	1.0
Korçë	12.4	2.5	0.7
Kukës	22.5	3.8	0.9
Lezhë	18.4	4.7	1.8
Shkodër	15.5	3.7	1.6
Tiranë	13.9	2.7	0.8
Vlorë	11.1	2.4	0.8
Gjithsej	14.3	3.0	1.0

¹⁹ Pas publikimit të shifrave të plota të popullsisë për vitet 2001-2014 në maj 2014, është rishikuar seria kohore e të dhënave të AMNJ 2005, 2008, 2012.

Tabela 31: Treguesit e varfërisë (në %) sipas rajoneve (INSTAT, Anketa e matjes së nivelit të jetesës, 2012)

Matësit e varfërisë	Tirana		Bregdetar		Qëndror		Malor		Gjithsej	
	I varfër	Tejet i varfër	I varfër	Tejet i varfër	I varfër	Tejet i varfër	I varfër	Tejet i varfër	I varfër	Tejet i varfër
2002										
Përqindja	17.8	2.3	20.6	3.6	25.6	4.6	44.5	10.8	25.4	4.7
Hendeku	3.8	0.6	4.4	0.7	5.7	0.5	11.1	2.0	5.7	0.8
Ashpërsia	1.3	0.2	1.5	0.2	1.8	0.1	4.1	0.5	1.9	0.2
2005										
Përqindja	8.1	1.0	16.8	2.3	20.8	4.9	25.2	3.1	17.9	3.3
Hendeku	1.6	0.1	3.3	0.3	4.8	0.8	5.0	0.4	3.9	0.5
Ashpërsia	0.5	0.0	1.0	0.1	1.7	0.2	1.5	0.1	1.3	0.1
2008										
Përqindja	8.8	0.2	12.7	1.5	10.7	0.9	25.9	3.7	12.5	1.2
Hendeku	1.2	0.0	2.6	0.3	1.9	0.2	5.5	0.5	2.4	0.2
Ashpërsia	0.2	0.0	0.8	0.1	0.5	0.0	1.7	0.1	0.7	0.1
2012										
Përqindja	12.1	1.6	17.7	3.0	12.6	2.3	15.1	1.2	14.3	2.3
Hendeku	2.4	0.2	3.8	0.5	2.7	0.5	2.4	0.1	3.0	0.4
Ashpërsia	0.7	0.0	1.3	0.1	0.9	0.2	0.6	0.0	1.0	0.1

Sipas të dhënave të Censurit të 2011, rrethi i Krujës ka një shkallë papunësie nën mesataren, me një vlere 29.8%. Shkalla e papunësisë për meshkujt është 29.34%, ndërsa për femrat 30.75%.

Numri i personave të regjistruar si punëkërkues të papunë si dhe shkalla e papunësisë, për bashkinë Krujë për vitin 2014 tregohet në tabelën e mëposhtme. Vihet re një shkallë papunësie pak a shumë konstante në 5 vitet e fundit, ku diferenca është me një pikë përqindje. Numri më i lartë i personave të papunë, shënohet në vitin 2015, ndërsa më i ulët viti 2014.

Tabela 32: Shkalla e papunësisë (Bashkia Krujë)

Viti	Shkalla e papunësisë	Punëkërkues të papunë
2015	14.7%	3231
2014	12.8%	2719
2013	13.0%	2757
2012	13.3%	2818
2011	13.8%	2871

Shpërndarja e të papunëve sipas njësive administrative tregohet në tabelën e mëposhtme. Nga kjo tabelë vihet re se papunësia në zonat urbane është më e lartë se papunësia në zonat rurale.

Tabela 33: Shpërndarja e të papunëve sipas njësive administrative (Bashkia Krujë)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikel	Thumanë
Popullsia	8442	3134	26081	16365	10430	15998
Të papunë gjithsej	26	11	1588	1432	91	37
Shkalla e papunësisë	1.9%	0.8%	14.9%	14.3%	3.4%	2.1%

Kjo tregon që në zonat rurale, banorët vendas kanë mundësi të merren me një aktivitet. Ky përfundim mbështetet edhe nga tabela në vijim, ku vihet re se numri i të vetpunësuarve në zonat rurale, ne raport me popullsinë e zonës, është më i madh sesa numri i të vetpunësuarve në zonat urbane.

Tabela 34: Punësimi për moshat mbi 18 vjeç (Bashkia Krujë)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikel	Thumanë
Punëdhënës	15		146	97	26	38
I vetpunësuar	8		28	19	8	12
I punësuar	258		2833	2188	492	402
I papunë	26	11	1588	1432	91	37

Numri i familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike është ulur ndjeshëm nga viti 2011 në vitin 2015. Ecuria e trajtimit me ndihmë ekonomike tregohet nga tabela e mëposhtme.

Tabela 35: Numri i familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike (Bashkia Krujë)

Viti/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	64	67	66	71	69	74	73	77	80	77	76	73
2014	204	223	208	201	198	85	79	74	98	79	79	79
2013	225	224	222	225	224	227	22	23	231	228	224	224
2012	235	229	236	230	235	232	242	247	248	244	238	238
2011	242	231	237	239	240	242	242	244	249	246	247	247

Sipas të dhënave të Censurit 2011, njësitë ekonomike familjare me status banimi "pronar" (që paguan kredi ose jo) kundrejt numit të njërive ekonomike total janë si vijon: për njësinë administrative Krujë 95.03% zotërojnë shtëpitë e tyre; për njësinë administrative Fushë Krujë 95.75%; për njësinë administrative Bubq 90.60%, për Cudhi 75.12 %, për Thumanën 87.85% dhe për Niklën 93.25%.

Tabela 36: Statusi i banimit të banesave (INSTAT, 2011)

Njësia administrative	Statusi i banimit të banesës			
	Gjithsej Total	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
BUBQ	1,975	1,450	25	500
CUDHI	716	398	18	300
FUSHË KRUJË	5,185	4,008	140	1,037
KODËR THUMANË	3,421	2,767	94	560
KRUJË	3,515	2,918	36	561
NIKËL	2,304	1,910	14	380

Tabela e mësipërme tregon statusin e banimit të banesave për secilën njësi administrative. Nga tabela e mësipërme vihet re se përqindja e banesave dytësore apo sezonale është shumë e vogël 1-2%. Njësia administrative me përqindje më të lartë të banesave të pabanuara është Cudhi me 75% dhe pas saj vjen Bubqi me 34%. Ndërsa njësitë e tjera kanë 19-26% shtëpi të pabanuara, ndër të cilat Kruja ka 19% dhe Fushë Kruja 26%.

Sipërfaqja mesatare e banueshme për person për secilën njësi administrative për Bashkinë Krujë është: për njësinë administrative Krujë 14.5 m² për person; për njësinë administrative Fushë Krujë 13 m² për person, për njësinë administrative Bubq 15.5 m² për person, për njësinë administrative Cudhi 12.1 m² për person, për njësinë administrative Thumanë 13.1 m² për person dhe për njësinë administrative Nikël 12.6 m² për person. Ky tregues është nxjerr duke llogaritur numrin total të dhomave në një banesë (duke përfshirë këtu edhe ato të përdorura si kuzhinë) kundrejt numrit gjithsej të personave në banesë. Bashkia Krujë tregon një vlerë mesatare në këtë drejtim duke patur parasysh që vlera më e lartë e vendit është 26.2 m² për person dhe vlera më e vogël është 6.4 m² për person.

3.5.9 Kriminaliteti dhe zonat e marginalizuara

Kriminaliteti është një dukuri mjaft problematike për shoqërinë. Nje nga mënyrat e matjes së shpërndarjes së tij është me anë të koeficientit të kriminalitetit. Ky koeficient është një parametër që mat raportin e kriminalitetit në një mjedis të caktuar, me popullsinë a atij mjedisi. Pra, tregon shkallën e konsumimit të veprave penale (krime apo kundravajtje) përballë numrit të personave. Në përgjithësi, ai shprehet si numri i krimeve për 1000 banorë. Nga studimi i veprave penale të kryera, koeficienti i kriminalitetit për vitin 2013 në shkallë vendi, rezulton 175 krime për 100 000 banorë (Vjetari Statistikor 2013, Ministria e Drejtësisë).

Sipas Vjetarit Statistikor 2013, të Ministrisë së Drejtësisë në rrethin e Lezhës janë gjykuar dhe përfunduar gjithsej 230 çështje, nga të cilat 124 për krime dhe 106 për kundravajtje. Popullsia e llogaritur për rrethin e Lezhës, në momentin e vlerësimit të veprave penale të sipërpërmendura është 61 860 banorë. Nga këto të dhëna, koeficienti i kriminalitetit për rrethin Krujë është 172, ndërsa koeficienti për vepra penale 255.

Ky koeficient, bën që rrethi i Krujës, në shkallë vendi, të klasifikohet në grupin e dytë, pra në rrethet me koeficient kriminaliteti të përafërt me mesataren e vendit 100-175 krime për 100 000 banorë.

Përsa i përket grupeve të marginalizuara përkufizimet për to janë të shumta. Megjithatë, shumica e të anketuarve në lidhje me këtë temë, klasifikojnë si grupe të marginalizuara, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, romët, të papunët, si vulnerabël për shkak të nivelit të lartë të varfërisë; si dhe gratë si vulnerabël kundrejt rrezikut të përjashtimit social.

Varfëria, punësimi dhe arsimit konsiderohen çështje të rendësishme për tu ndjekur gjatë vëzhgimit të ecurisë së procesit të përfshirjes sociale të këtyre grupeve.

Përsa i përket vajzave, bashkia e Krujës paraqet një nivel të lartë regjistrimi të tyre në të gjitha nivelet e arsimit. Sipas të dhënave të Censusit 2011, shkalla e punësimit të tyre për rrethin e Krujës është 20.94%, ndërsa shkalla e punësimit të meshkujve është 42.57%.

Sikurse u diskutua në paragrafin e mësipërm, bashkia Krujë bën pjesë në qarkun e Durrësit, treguesit e varfërisë së të cilit janë përmirësuar nga viti 2005 e në vazhdim. Ndërsa numri i familjeve që trajtohet me ndihmë ekonomike ka zbritur ndjeshëm sidomos vitet e fundit.

Në territorin e bashkisë së Krujës, është vendosur një komunitet rom. Raporti i popullsisë së këtij komuniteti, me popullsinë gjithsej, përbën 0.79% sipas të dhënave të Censurit 2011. Ky komunitet është përqëndruar në njësinë administrative të Fushë Krujës. Sipas Census 2014, Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri, në Fushë Krujë gjendet 3.2% e popullatës rome e shpërndarë në 64 familje. Përqindja më e madhe e tyre është vendosur në shtëpi private, pjesa më e madhe e këtyre shtëpive nuk janë në gjendje të mirë fizike.

Të dhënat në lidhje me arsimimin e këtij grupi janë të pakta dhe disa herë kontradiktore. Në çdo rast, vitet e shkollimit të këtij grupi janë minimale. Edhe në rastet e regjistrimit të tyre në shkollë, niveli i braktisjes është i lartë.

Mungesa e kualifikimit, numri i lartë i pjesëtarve në familje, gjendja shëndetësore dhe paragjykimet ndaj këtij grupi, janë probleme që hasen më shpesh dhe në shumicën e rasteve të gjitha në të njëjtën kohën. Këto probleme, pengojnë përfshirjen sociale të këtij komuniteti.

3.5.10 Stoku i banesave

Sipas INSTAT-it, në bashkinë Krujë, fondi i banesave unifamiljare zë rreth 95.4% të volumit të përgjithshëm duke përballuar edhe pjesën dërrmuese të strehimit të popullsisë. Shumica e rezidencave multi-familjare janë ndërtuar para vitit '91.

Banesat unifamiljare janë kryesisht një deri në tre katëshe dhe me oborr rrethues. Parcela ndërtimore më e madhe ka qënë rreth 500 m² dhe në përgjithsi mesatarja e sipërfaqeve në të cilat janë zhvilluar këto godina në të kaluarën, është afërsisht 300 m².

Në përgjithsi mesatarja e sipërfaqes së banimit për banor është e ulët. Nga 25-50 m²/banor që janë rekomandimet, sipërfaqja e përdorur nga një banor mesatarisht në Krujë është 13.5 m², gjithsesi e krahasueshme me mesataren e vendit (14.5 m²). Akoma më problematike është kjo e dhënë, nëse vihet në diskutim numri i banorëve, që ka diferencë të madhe nga Regjistri i Gjendjes Civile (79608) në indikacionet e INSTAT-it (59814), të cilave ky kapitull u referohet.

Më pozitive paraqitet gjendja e dhomave për familje, që është 3.3 dhe numri i dhomave për banor që është 0.8, pra gati një dhomë për banor, mgjs me sipërfaqe të vogël.

Në bashkinë Krujë rreth 21.3% e banesave janë të pabanuara; nga këto 19.1% janë të pabanuara e në përgjithsi të braktisura, ose në kushtë të këqija, kurse 2.2% janë shtëpi të dyta ose e përdorim të përkohëshëm, si shtëpi pushimi veror ose malor.

Po kaq i rëndësishëm është fakti që vetëm 24.8% e njësive të banimit, qofshin këto apartamente apo shtëpi të veçuara, janë ndërtuar përpara vitit 1991, që tregon vëllimin e madh të ndërtimit në 25 vitet e fundit. Ky bum ndërtimesh është kushtëzuar sigurisht

nga nevoja e madhe dhe norma e ulët e sipërfaqes së strehimit, të kushtëzuar nga gjendja e vendit në vitet e komunizmit. Mjafton gjithsesi fakti që më shumë se 75% e ndërtimeve janë ngritur në këtë segment relativisht të shkurtër kohor, për të kuptuar më mirë që i është bërë pjesës së lirë të territorit të bashkisë, qoftë ajo sipërfaqe bujqësore, apo natyrore. Edhe pse raporti i INSTAT-it pranon se viti i saktë i ndërtimit nuk është identifikuar për rreth 30% të ndërtesave, ritmi me të cilin është ndërtuar në këto 25 vite mbetet i lartë e me pasojë të konsiderueshme për ambientin.

Tabela 37: Statusi i përdorimit të banesave (%)

Njësia administrative	Njësi banimi	Banim i përhershëm	Banesë dytesore/ sezonale	Banesë e pabanuar
Bubq	100	48.42	26.42	25.16
Cudhi	100	13.81	44.35	41.84
Fushë Krujë	100	57.52	22.58	19.90
Thumanë	100	64.72	19.01	16.27
Krujë	100	67.06	16.98	15.96
Nikël	100	66.58	17.01	16.41

Ndërtimet për qëllime banimi të ndërtuara pas viteve 90, dallohen qartazi nga ato të kahershmet. Kanë tendencën të jenë më të larta, me larg nga vendbanimet tradicionale, por më afër rrugëve të komunikimit, më të mëdha dhe me përdorim materialesh më cilësore. Edhe në aspektin e sipërfaqes së banimit, banesat e ndërtuara së fundmi veçohen dukshëm, duke patur hapësira që i kalojnë 100 m² për familje që sa vijjnë e zvogëlohen për nga numri i pjestarëve.

Ka një tendencë të dukshme për krijimin e zonave të urbanizuara dhe kjo është më e qartë përgjatë akseve rrugore që përshkojnë rajonin, sidomos në ultësirën perëndimore. Këto zona do të përbëjnë thelbin e studimit urban të rajonit. Zonat e urbanizuara rishtas përbëhen nga me ndërtesa me funksione banimi, industriale dhe prodhimi por jo mbi bazën e studimeve paraprakë. Ndërtimet e reja shfaqen kudo, në prona private dhe nganjëherë troje publike, të përvetësuara ose të kontestuar.

Situata e përgjithshme e fondit të banesave, duke u bazuar në rezultatet e INSTAT-it për vitin 2011, paraqitet si më poshtë:

Tabela 38: Tabela e stokut të banesave

EMËRTIMI	Sasia	Njësia
Popullsia	59814	banorë
Familja mesatare	4.3	banorë/familje
Familje	13910	
Dhoma/familje	3.3	
Dhoma/banor	0.8	
Sipërfaqe mesatare/ njësi banimi	58.05	m ²
Sipërfaqe njësisht banimi (e jetuar)	807489	m ²
Sipërfaqe banimi/banor	13.5	m ² /banor
Njësi banimi me qera	1.98	%

Njësi banimi ndërtuar para '91:	24.8	%
Njësi banimi të pabanuara	21.3	%

Pavarësisht numrit relativisht të lartë të shtëpive të pabanuara, rritja natyrale e popullsisë së bashkisë Krujë dhe rezerva që vjen nga diferenca e ndjeshme mes të dhënave nga institucionet e ndryshme për popullsinë, na shtyjnë të parashikojmë një rritje të fondit të banesave në këtë bashki, bazuar në një analizë specifike, duke marrë në konsideratë parametrat e mëposhtëm:

- Norma e sipërfaqes së banimit/person dhe shkalla e formimit të familjeve të reja;
- Numrin e njësive që kërkohen për të zbutur mbi-popullimin;
- Banesat që mungojnë;
- Zëvendësimi i njësive ekzistuese të cilat do të amortizohen plotësisht gjatë periudhës së planifikimit;
- Zëvendësimin e njësive të dëmtuara ri-ndërtimi i të cilave nuk është ekonomikisht i leverdisshëm;

Si rezultat mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe tendencave të rritjes, dalin këto supozime:

- Bashkia Krujë do të arrijë një popullsi mesatare prej 73,000 banorë deri në vitet 2030, nëse ritmi i rritjes supozohet 0.23% në vit (referuar projeksonit të popullsisë);
- Mesataria aktuale është 13.5 m² sipërfaqe banimi/banor, një parametër i papranueshëm në të ardhmen, që do të ndikojë ndjeshëm në nevojën për banesa;
- Nevojitet gati dyfishimi i sipërfaqes së banimit, nevojiten për përmirësimin e normave në 25-30 m² ndërtim/banor.
- Shtesa e popullsisë deri në vitin 2030 do të jetë 2, 500 banorë, numri i familjeve të shtuara rreth 600 - 650;
- Rreth 600-650 njësi të reja banimi nevojiten për sistemimin e familjeve të reja, duke menduar vazhdimësinë e koeficientit prej 1 familje/banesë;
- Në total mendojmë se sasia reale për njësi të reja banimi si rezultat i rritjes së popullsisë dhe përmirësimit të kushteve të banimit parashikohet rreth 5,000 - 7,000 njësi banimi.
- Rreth 10% e banesave do të amortizohen krejtësisht gjatë periudhës së planifikuar ndërsa rreth 20%, do të kenë nevojë për rinovim gjatë periudhës së planifikuar

3.5.11 Toka dhe çështjet e pronës

Çështjet e pronësisë vazhdojnë të konsiderohen ende sot, një shqetësim madhor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit tonë. Tregu i pasurive të patundshme përballet në mënyrë konstante me sfida të shumta, që në një numër të konsiderueshëm të rasteve, e kanë origjinën tek mungesa e një sistemi të qartë e funksionues të administrimit të të drejtave të pronësisë. Mirëspecifikimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i mirë-dokumentuar i pronave të paluajtshme kanë një rëndësi primare në projektimin afatgjatë dhe përmirësimin e planifikimit urban, si dhe të zhvillimit të infrastrukturës, duke lejuar hapësirat e nevojshme për implementimin e reformave shtetërore. Me qëllim që të jetë eficient, sistemi i administrimit të pronave duhet të garantojë pronësinë dhe zotërimin e pronës nga pronarët, e ligjshëm, duke i

shërbyer përforcimit të qendrueshmërisë së sektorit të pronave të paluajtshme, reduktimit të mosmarrëveshjeve për tokën, lehtësimit të transaksioneve në lidhje me pronat dhe mbështetjes së mirëqeverisjes. Realiteti kaotik i pronave të paluajtshme në vendin tonë dhe shqetësimet e grupeve të interesit për të drejtat e pronësisë kanë rritur vëmendjen mbi rëndësinë e efektivitetit të reformave dhe efijencës së agjensive shtetërore përgjegjëse për këto çështje.

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i zhvillimit të drejtës së pronës në përgjithësi për vendin tonë dhe problematikat kryesore të trashëguara, në bazë të të cilave bëhet një pasqyrë e qartë e situatës ekzistuese edhe në kontekstin e bashkisë Krujë.

Aspekte juridike

Në aspektin ligjor, subjekti (personi fizik a juridik) që zotëron ligjërisht një pronë, nuk zotëron vetëm pronën si pasuri fizike me efektet ekonomiko-sociale perkatëse, por duhet të zotërojë edhe pasurinë juridike mbi “të, pra mbrojtjen ligjërisht të tërësisë të të drejtave dhe obligimeve (titulli juridik perkatës) në lidhje me zotërimin faktik të saj. Kjo është ana statike e sistemit juridik mbi pronësinë. Ndërsa transaksionet apo veprimet e tjera në vëllim, hapësirë dhe kohë e këtyre “titujve juridikë” përbëjnë “rregullimet dinamike” ligjore për zhvillimin juridiko-faktik të marrëdhënieve mbi pronën.

Juridikisht, krijimi i kadastrave në vendin tonë, ka filluar me daljen e ligjit “Mbi titujt defterhane” në vitin 1874. Në atë kohë nuk regjistroheshin ndërtimet, pemtaritë që mbilleshin etj, pasi regjistrimi nuk ishte i detyruar. Tapitë lëshoheshin për titujt e pronësisë perkatëse duke treguar: Emrin e personit, emrin e tokës, vendin dhe emrat e pronareve kufitare.

Shteti shqiptar mbas vitit 1912 filloi të zëvendësojë gradualisht legjislacionin turk mbi tokën, duke respektuar njëkohësisht edhe Regjimin juridik nën të drejtën kanunore. Por legjislacionet që rregulluan juridikisht marrëdhëniet mbi tokën filluan me statusin themeltar të viteve 1925 dhe 1928, si rezultat i të cilave, iu dha fund ndarjes së tokës sipas Ligjit të vitit 1856 dhe të gjitha tokat u ndanë në pronësi të shtetit, personave juridike e personave fizike. Me Kodin Civil të Regjimit të Zogut, të aplikuar qysh nga viti 1929, proklamohej se prona është e shenjtë dhe e paprekshme. Në baze të këtij parimi me Ligjin “Mbi zyrtat e hipotekave dhe taksat e tyre” dt 17.04.1929 u suprimuan kadastrat dhe u krijuan zyrtat e hipotekës. Tjetërsimi si transaksion, tashmë, kalonte mes detyrimeve juridike të drejtën e pronësisë, posedimit, qiradhenies etj. Pasuritë regjistroheshin nga personat e interesuar vetëm atëherë kur nevojitej prej tyre mbrojtja e ligjit për transferime dhe transaksione. Mungesa e regjistrimit ishte me evidente në fshat, ku një pjesë e madhe e tokës dhe transaksioneve ishte e pa regjistruar. Akti noterial nuk bëhej nëse regjistrimi i pasurisë nuk ishte kryer dhe gjithashtu kadastra nuk lëshonte asnjë dokument, pasi ajo ishte e dobët dhe e karakterit të një Regjistri deklarativ. Pra institucionet e sigurisë dhe garancisë së pronave nga pikepamja juridike kanë funksionuar kryesisht për disa qytete kryesore dhe për një numër të kufizuar të pronareve në zonat rurale.

Periudha e regjimit politik 1945-1990 nga pikëpamja e regjimit juridik të Tokës filloi me Reformën Agrare të viteve 1945-1946 e cila e kufizonte shumë të drejtën e pronësisë për tokën (deri në 5 ha për pronaret e medhenj), por veç kësaj me Qarkoren e datës 19. 01.1945 ndalonte noteret të merrnin veprime për shit-blerjen për objekt të tokës bujqësore. Sipas Ligjit të Reformës Agrare (neni 12) fshatrat që morën tokë u regjistruan në regjistratë të posaçëm në Zyrat e Reformës Agrare, por nuk u pajisen kurrë me titujt juridikë të tokës. E drejta e zotërimit të pronësisë mbi tokën u zëvendësua në mënyrë graduale dhe “defakto” në vitin 1967 nuk kishte më pronë private mbi tokën ndërsa “de jure” me kushtetutën e vitit 1976 u sanksionua perfundimisht se toka ishte në pronësi të shtetit. Sistemi kadastral i organizuar teknikisht mjaft mirë qësh në vitin 1947 nuk kishte për bazë parcelën e bazuar në të drejtat e pronësisë së tokës, por të parcelave të poseduesit faktikë e cila kishte të bente me kadashtren fiskale dhe jo atë juridike. Matja e tokave në vitet 1950-1953, pavarësisht se u bë me matje të thjeshta, u shtri në gjithë territorin e vendit për kadastrimin e tokave bujqësore dhe përbën një informacion mjaft të vlefshëm në krijimin e një kadastrë teknike dhe shërben si bazë për tatimet mbi tokën. Kadastrimi vazhdoi me tej me matje topografike, të cilat kishin standarte mjaft të larta dhe u bazua kryesisht në parcelën e përdorimit të tokës. Në prag të viteve 1990 ishin kadastruar në këtë mënyrë rreth 90% të tokave bujqësore të shtrira në rreth 11 000 km² në mbarë vendin.

Duke filluar qësh nga viti 1991, regjimi i marrëdhënieve pronësore të pasurisë mbi tokën mori përcaktime raportesh të reja. Reforma për tokën që u shpall në ligjin nr 7501 “Për tokën” e që u pasurua me vonë me ligje të tjera të cilat përcaktuan juridikisht kategorizimet juridike të tokës bujqësore e jobujqësore. Ky ligj solli shpërndarjen e organizatave kooperativiste e të fermave bujqësore, duke rishpërndarë pronësinë juridike mbi tokën gjithë popullsisë së zonës fshatare, fillimisht duke moslejuar shit-blerjen e tokës bujqësore. Tokat fizike dhe të drejtat mbi të u kaluan për zotërim juridik në formë pronësie apo përdorimi fshatare, nëpërmjet komisioneve në nivel fshati, komune e rrethi të cilët kishin të drejtën e dënies se titullit juridik (tapisë) në pronësi e përdorim. Pra sipas këtij ligji tokat bujqësore iu ndanë personave që i punonin dhe familjeve të tyre (gati dy të tretave të popullsisë, gjithsej). Të gjitha ish-kooperativat u shpërndanë në kuadër të këtij procesi, megjithëse hollësitë e zbatimit ndryshonin nga krahina në krahinë (Për shembull, në zonat malore në veri të Shqipërisë, komunitetet lokale nuk e shpërndanë tokën sipas frymëve, siç e kërkonte ligji, por sipas familjeve dhe sipas trashëgimisë së pronës që prej kohërave përpara regjimit komunist). Kjo qasje e pabarabartë solli mosmarrëveshje të shpeshta, të cilat zakonisht autoritetet vendore nuk ishin në gjendje t’i zgjidhnin.

Përsa i përket zonave të urbanizuara, ligji nr. 7652, dt. 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, u dha personave që i kishin në shfrytëzim banesat mundësinë që t’i merrnin në pronësi ato. Sipas këtij ligji janë privatizuar rreth 440.000 apartamente dhe shtëpi.

Në tabelën në vijim jepet një përmbledhje të legjislacionit kryesor për të drejtat e pronës në Shqipëri.

Tabela 39: Legjislacioni për pronat pas viteve '90

Ligji Nr. 7501 dt. 19.07.1991	“Për tokën” sipas të cilit tokat bujqësore iu ndanë personave që i punonin.
Ligji Nr. 7652 dt. 23.12.1992	“Për privatizimin e banesave shtetërore”, i kaloi pronësinë e banesave personave që i kishin në shfrytëzim ato
Ligji Nr. 7698 dt. 15.04.1993	“Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, shërbej si bazë për privatizimin e pronave në qytet (shfuqizuar me ligjin 9235, në 2004)
Ligji Nr. 7843 dt. 13.07.1994	“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” shfuqizuar në 2012 me ligjin 33/2012
Ligji Nr. 7850 dt. 29.07.1994	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë reformimi i të drejtës civile siguroi kuadrin ligjor për veprimet private me pronat.
Ligji Nr.8417 dt. 21.10.1998	Kushtetuta e Shqipërisë miratimi i Kushtetutës, përfshin dispozita që garantojnë të drejta mbi pronat e paluajtshme.
Ligji Nr.9235 dt. 29.07.2004	“Për kthimin dhe kompensimin e pronave” zëvendësoi ligjin e vitit 1993 dhe futi kompensimin me vlerën aktuale të tregut.
Ligji Nr.9404 dt. 29.10.2004	“Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, vendosë rregulla për ndërtesat e paligjshme, në bazë të një procesi vetëdeklarimi të administruar nga pushteti vendor.
Ligji Nr.9482 dt. 03.04.2006	“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” zëvendëson ligjin e vitit 2004 dhe vendosë rregulla për vendbanimet dhe ndërtesat e paligjshme të ndërtuara përpara muajit maj 2006, duke ia nënshtruar një procesi vetëdeklarimi të administruar nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).
Ligji Nr.10239 dt. 25.02.2010	“Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”
Ligj Nr.33/2012 dt. 21.03.2012	“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”
Akt Normativ Nr.3 dt. 01.08.2012	Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar (Miratuar me ligjin nr.82/2012, datë 13.9.2012) Akti normativ përcakton hapa dhe afate konkrete për lirin e banesave ish-pronë e subjekteve të shpronësuar. EKB caktohet institucioni që do ndjek procesin.
Ligj Nr.133/2015 dt. 05.12.2015	“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” shfuqizon ligjin nr.9235, dt. 29.07.2004 dhe ligjin nr.10239 dt. 25.02.2010

Procesi i kthimit të pronave filloi me ligjin nr. 7698/1993 i cili përbën përpjekjen e parë për t'i dhënë zgjidhje çështjes së pronave të shtetëzuara, të shpronësuar apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944, të cilat ishin marrë pa të drejtë nga shteti. Sipas këtij ligji u krijuan Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në bashki dhe në ish-Këshillat e Rretheve (respektivisht për zonat urbane dhe për zonat jashtë urbane), të cilat njihnin të drejtën e pronësisë, kthenin apo kompensonin pronat e subjekteve të shpronësuar. Komisionet drejtoheshin nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili funksiononte si organ monokratik që drejtohej nga Kryetari i tij.

Pas vitit 2004, me miratimin e ligjit 9234/2004, u rrit kufiri maksimal i sipërfaqes së tokës bujqësore për njohje, kthim apo kompensim, u zgjeruan mënyrat e kompensimit, u vendos detyrimi për krijimin e fondit të pronave të paluajtshme për kompensim fizik, si dhe detyrimi për krijimin e fondit për kompensimin financiar. U krijua Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, si një organ kolegjal me 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe me komisione vendore në varësi për secilin qark. Në vitin 2006, Komiteti u suprimua, nëpërmjet krijimit të Agjencisë të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronës. AKKP-ja, së bashku me zyrat e rajonale në qarqe, u krijua në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për të siguruar një organizim të centralizuar, efektiv dhe të shpejtë vendimmarrës. Zyrat Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në secilin qark të vendit u suprimuan me ndryshimet ligjore të vitit 2009 dhe tashmë i gjithë procesi administrativ i shqyrtimit dhe vendimmarrjes është përqendruar në AKKP-në Tiranë, që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili në zbatim të përgjegjësiave për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Hapi i parë për futjen në përdorim të një sistemi bashkëkohor për regjistrimin e pronave u hodh në vitin 1994, mirëpo procesi i regjistrimit fillestar të pronave nuk ka përfunduar ende. Ligji për regjistrimin e pronave të paluajtshme, i miratuar në vitin 1994, parashikon një sistem modern regjistrimi të bazuar në parcela, dhe krijon një dikaster të posaçëm për administrimin e këtij procesi: Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Ligji 33/2012 përveç përshtatjes me nevojat e kohës synon marrjen e një sërë masash juridike që do të rregullojnë shitjen e apartamenteve pas bumit të ndërtimëve të shfaqur pas viteve 2000. Kjo nisur nga shqetësimi që një pjesë e madhe e kredive me probleme është e kolateralizuar me pasuri të patundshme dhe është e koncentruar kryesisht në sektorin e ndërtimit. Një nga ndryshimet kryesore të propozuara është që shoqëria e ndërtimit do të ketë detyrim ligjor regjistrimin si të lejes së ndërtimit ashtu edhe të kontratave të sipërmarrjes/porosisë, duke rritur dhe sigurinë juridike për këtë kategori kolektive.

Gjithashtu konstatohet se shumë prona u janë nënshtruar veprimeve informale me kalimin e viteve dhe përdoruesit e tanishëm shpesh kanë kaluar mjaft probleme për të gëzuar të drejtën e pronësisë. Shitblerja dhe ndarja e mëtejshme shpesh bëhet pa dokumentacion dhe, edhe atëherë kur ka dokumente për shitblerjen, ato shpesh janë jo të noterizuara apo të regjistruara për shkak se prona nuk i është regjistruar shitësit. Për pasojë, shumë përdorues të tanishëm kanë paguar shuma të konsiderueshme parash për pronën por kanë shumë pak mbrojtje juridike sepse veprimi i shitblerjes mbetet informal nga këndvështrimi i ligjit.

Informaliteti dhe procesi i legalizimit

Vlerësohet se në gjithë vendin janë ngritur rreth 350.000 deri në 400.000 ndërtesa pa leje. Migrimi i brendshëm i vrullshëm gjatë viteve me pasiguri ekonomike dhe me liri të lëvizjes 1990-2000, çoi në zbatim në masë të tokave shtetërore dhe private, sidomos në zonat bregdetare dhe zonat ngjitur me qytetet (zonat peri-urbane).

Mungesa e një mekanizmi zyrtar që orientonte këto banorë që zhvendoseshin nga vendlindja e tyre për një jetë më të mirë, bëri që njerëzit thjesht të zinin tokën dhe fillonin të ndërtonin. Toka u copëtua në mënyrë informale, mirëpo një pjesë e mirë e saj mbeti e klasifikuar si tokë bujqësore dhe, kështu, nuk e plotësonte kriterin si truall për leje ndërtimi. Ndërtimet bëheshin pa marrë në konsideratë ligjet e rregullimit të territorit apo të ndërtimit, pa leje nga autoritetet zyrtare, pa infrastrukturën e duhur dhe, shpesh (por jo gjithmonë), në tokë e cila nuk i takonte ndërtuesit. Për pasojë, shumë prona në qytet konsiderohen si jo të ligjshme. Mungesa e planifikimit dhe kontrollit të efektshëm të ndërtimeve mundësoi ndërtimin e shtesave në ndërtimet ekzistuese, të cilat tani konsiderohen si jo të ligjshme.

Sipas disa vlerësimeve të bëra, ndërtimet jo të ligjshme përbëjnë një të tretën e inventarit strehues gjithsej dhe kanë kushtuar afro 10 miliard euro për t'u ndërtuar. Afërsisht një e treta e tokës në të cilën janë ndërtuar objektet e paligjshme u përket ndërtuesve, një e treta i përket shtetit dhe një e treta një personi tjetër, si për shembull një pronari të cilit i është kthyer prona ose një personi i cili ka marrë tokë sipas ligjit për tokën të vitit 1991. Procesi i krijimit të vendbanimeve informale dhe i ndërtimeve informale shkaktoi tensione shoqërore, vështirësi për organet shtetërore dhe solli pasoja politike. Në vitet 1990, përdoruesit përdorën forcën për ta shtënë në dorë dhe për ta mbrojtur pronën e zënë nga përpjekjet sporadike (dhe kryesisht jo të suksesshme) të autoriteteve për t'i nxjerrë nga prona. Me rritjen e komuniteteve të zaptuesve, autoritetet filluan të kenë gjithnjë e më shumë kujdes të mos ndërhyjnë. Qasja jo e ligjshme e banorëve të rinj dhe mosndalimi i tyre nga autoritetet shkaktoi mëri te banorët e qyteteve pranë tyre, si edhe inat dhe acarim tek pronarët e tokave të zaptuara. Një sfidë konkrete për të gjitha bashkitë del sot urbanizimi dhe ofrimi i shërbimeve kryesore këtyre vendbanimeve informale.

Në bazë të statistikave të ALUIZNI-t, Qarku Durrës (ku përfshihet edhe Bashkia Krujë) përfshihet në ato me informalitetin më të zhvilluar në gjithë vendin. Numri i vetë-deklarimeve të bëra në periudhën 2004-2006 arrin 43 343 që përbën rreth 16% të totalit (270 592 në gjithë vendin)

Pavarsisht angazhimit serioz të qeverisë shqiptare akoma konstatohet që procesi i legalizimit ka ecur ngadalë përkundër burimeve financiare që i janë kushtuar. Së fundmi (në vitin 2015) ALUIZNI ndërmori nismën për të bërë fotografimin ajror për të bërë evidentimin e gjendjes reale të informalitetit pasi konstatohet që nga viti 2006 gjendja në territor ka ndryshuar në mjaft zona të Shqipërisë përsa i përket këtij fenomeni.

Sipas raportimeve të ndryshme, një ndër faktorët kryesorë që kanë penguar procesin e legalizimit janë problemet e bashkërendimit midis ALUIZNI-t, ZRPP-së dhe AKKP-së. Të dhënat gjeografike të ALUIZNI-t, të cilat janë prodhuar në bazë të teknologjisë më të fundit të fotografimit ajror dhe GPS, mbështeten në një teknologji më të saktë dhe më të fundit se ajo e ZRPP-së.

Problematikat kryesore të sistemit

Historiku i zhvillimit të së drejtës së pronës në vendin tonë tregon qartë edhe problematikat e trashëguara në sigurinë juridike të pronës. Ndër problematikat

kryesore të evidentuara edhe në raportet ndërkombëtare për këtë qëllim, mund të cilësojmë:

- Mungesa e një qasje të qartë dhe konsistente politike në reformat e ndërmara 25 vitet e fundit, pavarësisht qëllimeve të pranura gjerësisht nga të gjitha palët, ka rezultuar në një implementim të dobët të kuadrit ligjor në këtë drejtim. Si rezultat i kësaj paqartësie në vendim-marrje, statistikave të Gjykatës së Strazburgut për çështjet shqiptare të pronësisë tregojnë që gjyqësori shqiptar të jetë në shkallë në 85% të vendimeve të dhëna.
- Së dyti, reformat janë implementuar me definicione të ndryshme ligjore për lloje të ndryshme të pronave bujqësore, pyjore, kullota, banesa publike apo toka tregtare ose industriale, duke krijuar një sistem kompleks me shumë zbrastime dhe mbivendosje.
- Faktor i tretë vlerësohet të jetë fragmentimi i njësive të pronave dhe parcelave të tokës, duke kërkuar në këtë mënyrë angazhimin e çdo pronari në marrëveshje të shumfishta suplementare për të realizuar përdorimin rutinë të pronës.

Të marrë së bashku, këta faktorë e kanë bërë të vështirë adaptimin e marrëdhënieve të tregut dhe modeleve të të drejtës civile europiane, në mjedisin shqiptar, duke ngadalësuar progresin e reformave dhe duke e bërë sistemin të çnueshëm ndaj rritjes së praktikave informale dhe korruptive.

Angazhimet kryesore që duhen ndërmarrë

Duke Sa më sipër ndër angazhimet kryesore që dalin të nevojshme për t'u ndërmarrë në këtë sektor janë:

- Agjensitë shtetërore si ZQRPP, AKKP and ALUIZNI duhet të rritin koordinimin mes tyre për të siguruar një sistem administrimi të shpejtë, mirë-funksionues dhe të pakontestueshëm. Në të njëjtën gjatësi vale duhet të jetë edhe bashkëpunimi mes qeverisë lokale dhe asaj qendrore.
- Unifikimi i databazës së pronave të paluajtshme duke aplikuar të njëjtat kërkesa dhe standarde teknike, mbështetur në dokumentet e pranuar ligjore të pronësisë në përputhje me të dhënat hartografike, është një proces i rëndësishëm.
- Procedura më efiçente të regjistrimit të pronës do të ndikojnë në reduktimin e kostove për transaksionet dhe do të përmirësojnë sigurinë e të drejtave të pronësisë.

Duhet theksuar që në këtë dokument, duke bërë një analizë juridike të së drejtës së pronës në vendin tonë janë evidentuar edhe problematikat e marrëdhënieve të pronësisë, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit. Këto problematika kanë një karakter të ngjashëm (pothuajse të njëjtë) në të gjithë vendin dhe zgjidhja e trajtimi i tyre nuk mund të jenë objekt as i PPV as i pushtetit lokal, por duhen adresuar pranë pushtetit qendror që harton dhe politikat dhe kuadrin ligjor përkatës.

3.5.12 Pronat publike

Në zbatim të ligjit nr.8744,dt. 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Bashkia Krujë ka krijuar strukturat dhe njësitë përkatëse, për inventarizimin dhe transferimin në pronësi apo përdorim të saj të pronave në fjalë.

Procesi ka nisur fillimisht me inventarizimin e pronave të transferuara dhe sigurimit të bazës të nevojshme teknike (harta treguese, librat e ngastrave etj.). Procesi mbyllet me përgatitjen e dosjeve përkatëse dhe dërgimin e tyre në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Prioritet për transferimin në pronësi apo përdorim të Bashkisë po u jepet objekteve (aseteve) ku kryesisht përfshihen:

- Godinat administrative;
- Social-Kulturore, Arsimore,
- Shëndetsore
- ambiente të tjera publike (sheshe ,lulishte, rrugë trotuare).

Bazuar në informacionet ekzistuese dhe hulumtimeve të mëtejshme të bëra nga ekipi, plani duhet të marrë parasysh paraqitjen e analizave të hollësishme të përdorimit të pronës publike, duke përfshirë edhe vendndodhjen, funksionin dhe pronësinë.

Nga procesi inventarizimit transferimit të pronave në vitin 2008 kanë kaluar në administrim të bashkisë një pjesë e pronave shtetërore. Këto prona janë asetet e bashkisë dhe në pjesën më të madhe janë infrastrukturë publike, kryesisht rrugë, sipërfaqe të gjelbra, sheshe dhe truall.

Pjesa më e madhe e tokës bujqësore në zonën administrative të bashkisë është private. Përrjashtim bëjnë zonat industriale, në funksion ose jo, dhe serat bujqësore që mbeten në pronësi të shtetit. Ndër to dy janë zonat me sipërfaqe të konsiderueshme. Zona e parë ndodhet në fshatin Arrameras në të djathtë të lumit Ishëm dhe rrugës hyrëse për në Fushë Krujë (pas urës së Gjoles). Me një sipërfaqe 90 ha kjo tokë i përket ish Institutit të Farërave Foragjere sot QTTB-Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore. Zona e dytë është në të majtë të rrugës së vjetër për Lezhë menjëherë sa del nga qyteti i Fushë Krujës, i përket serave me ngrohje, sot jashtë funksionit dhe ka një sipërfaqe rreth 15 ha.

Kodrat e Krastës, që në pjesën më të madhe janë të pyllëzuara, me pemë frutore ose ullishta gjithashtu janë në pronësi të shtetit.

Në qytetin e Fushë Krujës ndodhet edhe Lagjja Grumbullim, e miratuar si zonë informate në vitin 2008, sipas kriterëve të përcaktuara bazuar në legjislacionin përkatës.

Gjykojmë që evidentimi i qartë i gjithë pronave publike në dispozicion dhe përshpejtimi i ritmeve të regjistrimit të tyre do ndihmonte të bashkisë Krujë në disa aspekte:

- Kryerje të investimeve për nevoja të komunitetit në pronat e vetë bashkisë (kopshte,çerdhe, banesa për strehime social etj.);

- Sigurimi i të ardhurave nga dhënia si në zona urbane për qëllime biznesi ashtu edhe në toka bujqësore dhe pyjore për mbarshtim pyjesh apo qëllime të ndryshme bujqësore;
- Hyrja në marrëveshje të tipit PPP për investime strategjike, në të cilat bashkia ofron truallin ndërsa biznesi shërbimin e caktuar;

Gjithashtu në zbatim të VKM Nr. 1108, dt 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit” ka kaluar në pronësi të bashkisë Krujë :

- Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, sipas tabelave 1 dhe 1/1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- Asetet e paluajtshme, nga bordet e kullimit te bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre, sipas tabelës 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje dhe që u janë transferuar bashkive.

4 Përgatitja e bazës të dhënave territoriale në platformën GIS

4.1 Përditësimi i të dhënave ekzistuese

4.1.1 Harta bazë dhe GIS

Harta bazë, më tepër se sa për kryerjen e analizave territoriale, shërben për të gjithë procesin e planifikimit vendor. Harta bazë, dhe harta të mëtejshme analitike e tematike të PPV-së, prodhohen në sistemin gjeografik të informacionit (GIS), si sistemi më i përshtatshëm për të lidhur informacionin sasior të territorit me vendndodhjen e tij. GIS, është një bashkësi procesesh, qëllimi i të cilës është të mbledhë të dhëna, t'i "magazinojë" sipas një strukture tabelare dhe hartografike, t'i analizojë ato e të ndihmojë në vendimmarrjen e autoriteteve. Sistemi GIS që po ndërtohet për qëllimin e planifikimit Vendor do të japë informacion gjeohapësinor në lidhje :

- a) Gjëndjen aktuale të territorit (Ndërtesa, Rrugë, Hidrografi, Parcelizim, Reliev)
- b) Klasifikim i territorit sipas 5 sistemeve bazë dhe nënkategoritë përkatëse;
- c) Rrjetet e infrastrukturës publike, për ndërtesat dhe për territoret e tyre;
- d) Statusin ligjor të territorit, bazuar në dokumentet e planifikimit të territorit e të përdorimit tokës;
- e) Zona të veçanta, me regjim ligjor të veçantë, të përcaktuar në bazë të legjislacionit apregulloreve sektoriale, si zona të mbrojtura, me rrezikshmëri, etj;
- f) Trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen natyrore, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqinë rregullore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e ruajtjen e natyrës;
- g) hartimin, miratimin dhe monitorimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit.

4.1.2 Legjislacioni

Si referencë bazë për organizmin e bazës të dhënave është përdorur informacioni nga Autoriteti Shtetror për Informacionin Hapsinor (ASIG), ndërsa si bazë ligjore, ligjin 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapsinor në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjithashtu ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", sanksionon përdorimin e GIS për hartimin e planeve territoriale në vendin tonë (specifikisht në nenet 54 deri në 57 të tij). Sipas këtij ligji, "Informacioni në regjistër organizohet sipas një rrjeti të integruar e shumëqëllimësh të bazave të të dhënave shtetërore për tokën dhe zhvillimet në të, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Autoritetet përgjegjëse ndërtojnë, administrojnë e mirëmbajnë bazën e tyre të të dhënave, pjesë përbërëse të regjistrit, sipas një platforme teknike, strukture dhe standardeve të përbashkëta gjeodezike e GIS-it për të siguruar përputhshmërinë e ndërveprimit ndërmjet tyre dhe shkëmbimin e përdorimit e informacionit të regjistruar në to." (neni 55).

Me akte nënligjore (sipas nenit 57 të ligjit) përcaktohen "standardet e përbashkëta gjeodezike dhe të GIS-it, ... rregullat e lidhjes në rrjet dhe të transferimit të ndërsjellë të të dhënave ndërmjet autoriteteve të planifikimit dhe institucioneve të tjera shtetërore, ...", si dhe të drejtat e detyrimit e autoriteteve në përdorimin e Regjistrat. Fakti që Regjistri i integruar i territorit është i bazuar në formatet e GIS dhe detyrimi i ngarkimit të "shapefile-ve" në të, krijon një incentivë që GIS të përdoret në çdo hap të hartimit të planeve territoriale.

4.1.3 Identifikimi dhe Mbledhja e të dhënave

Hapi i parë për përgatitjen e një baze të dhënash të saktë gjeohapësinore është identifikimi dhe mbledhja e të dhënave. Në këtë rast burimet institucionale për marjen e informacionit hartografik kanë qënë :

- AKPT

Te dhënat janë marë fizikisht në format digjital dhe janë si në tabelën më poshtë:

Tabela 40: Struktura e të dhënave nga AKPT

Nr	Elementet	Layer	Pershkrimi	Tipi	Marre nga:
1	Kufinjtë Shtetëror dhe Kufinjtë Administrativ	AB_Line_Of_Concern	Kufinjtë Administrativ të bashkise se re	Poligon	
		AB_Urbanizimi	Zona ku mund të ndërhyet në funksion të zhvillimit urban	Poligon	AKPT
		AB_Urbanizimi_Buffer	Zona buffer +15m sipas vendimit Nr.5 dt.29.12.2014	Poligon	AKPT
		AB_Yellow_Line	Vija e verdhe	Poligon	
2	Ndertesat	BD_Building	Vendodhja e ndertesave	Poligon	MB
3	Përdorimi i tokës_Vendbanime	LU_131_Mineral extraction sites	Vendndërrje minierale	Poligon	CORINE
		LU_121_Industrial or commercial units	Njesite industriale dhe komerciale	Poligon	CORINE
		LU_PublicFacilities_142_Sport and leisure facilities	Objekte publike, Sporte dhe objekte kalimi të kohës së lirë	Poligon	CORINE
		LU_Monumentet	Monumentet Historike	Poligon	IMK
		LU_Landfill_132_Dump sites	Venddepozitime mbeturinash	Poligon	CORINE
		LU_Industrial_and_Comercial_Zone	Zonat Industriale	Poligon	MZHETTS
		LU_Comercial_and_Industrial_Zone	Zonat Ekonomike	Poligon	MZHETTS
		LU_Excavation_and_Mining	Vendodhja e Lejeve të shfrytëzimit minierar	Poligon	AKBN
4	Përdorimi i tokës_Hidrografia	LU_Floating_and_Standing_Water	Hidrografia (Lumenj, Liqene)	Poligon	CORINE

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

		LU_Sea	Deti	Poligon	CORINE
		LU_Dock	Portet	Poligon	CORINE
5	Perdorimi i tokës_Transporti dhe Trafiku	LU_Road	Rrjeti rrugor	Line	Instituti i Transportit
		LU_Railroad	Rrjeti hekurudhor	Poligon	Corine
		LU_Shipping_Traffic	Portet	Poligon	CORINE
		LU_Air_Traffic	Aeroportet	Poligon	CORINE
6	Natyra dhe mjedisi	LU_Agriculture	Perdorimi i tokës Bujqesi	Poligon	CORINE
		LU_Forest	Pyjet	Poligon	CORINE
7	Sherbime Publike	PU_Substacion	Nenstacionet	Pike	OSHE_KKT
		PU_Cable	Linja e Transmetimit	Vije	OSHE_KKT
8	Kushtet sociale,	SEC_Kindergarden_School	Pozicioni i shkollave	Pike	MAS
9	Te tjera	Monumente Natyre	Vendodhja e Monumente te Natyres	Pike	MM
		Zonat e Mbrojtura Natyrore	Vendodhja e zonave te mbrojtura natyrore	Poligon	MM
		Kurora e Tiranës		Poligon	AKPT
		Digat	Digat bujqesore	Pike	MBZHRAU
		Vendbanime Rome Census	Vendodhja e banimeve rome	Pike	CENSUS

- Gjeoportali Kombëtar

Si burim të dhënash i rëndësishëm në këtë proces ka shërbyer dhe Gjeoportali Kombëtar, i cili administrohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacioni Gjeohapësinor, dhe ndodhet në linkun <http://geoportal.asig.gov.al>. Në këtë portal janë publikuar një pjesë e madhe e informacioneve hartografike që administrohen nga Autoritete Publike. Informacioni mund të aksesohet në programet GIS Desktop në mënyrë të hapur nëpërmjet shërbimeve online të shikimit sipas standardeve WMS dhe WMTS.

Ky lloj shërbimi mundëson jo vetëm shikimin e të dhënave (si raster) por edhe marrje informacioni id. Shërbimi nuk lejon shkarkimin e tij si format vektorial dhe përpunimin nga ana jonë. Më poshtë, në formë tabelare, po listojmë të dhënat që janë përdorur nga gjeoportali:

Tabela 41: Struktura e të dhënave Gjeoportali Kombëtar

Struktura e të dhënave Gjeoportali Kombëtar				
	Institucioni Qendror	Institucioni Varesi	Emërtimi i Shtreses	Përshkrimi
1	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)		Ortofoto e Zonave Urbane 2015	Ortofoto për zonat urbane (59 qytete , 1028 km ²). Rezulucion 8 cm/pixel në formatin RGB.
2	Ministria e Zhvillimit Urban	ALUIZNI	Ortofoto 2007	Ortofoto për territorin e Republikës së Shqipërisë me rezolucioni 20/35 cm per pixel

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

3	Instituti Gjeografik Ushtarak		Index 1:100000; 1:50000; 1:25000 ; 1:10000; 1:5000 ;1:2500	Nomenklatura per Harta Topografike te Shk.1:100000; 1:50000; 1:25000 ; 1:10000; 1:5000 ;1:2500
			Harta Topografike 1: 10000	Skanime te Hartave Topografike 1:10000 per pjesen perendimore dhe vijen bregdetare te territorit te Republikes se Shqiperise, 423 nomenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 25000	Skanime te Hartave Topografike 1:25000 per gjithë territorin e Republikes se Shqiperise, gjithesej 256 nomenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 50000	Skanime te Hartave Topografike 1:50000 per gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ,gjithezej 82 nomenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 100000	Skanime te Hartave Topografike 1:100000 per gjithë territorin e Shqiperise ,gjithezej 35 numenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 200000	Skanime te Hartave Topografike 1:200000 per gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ,gjithezej 10 nomenklatura (flete) .
4	INSTAT		Ndarja Administrative	Ndarja eshte kryer nga konstatimi ne terren bazuar ne Ortofoto 2007 ne periudhen e Censurit 2011.
			Njesite Vendore	Ndarja eshte kryer nga konstatimi ne terren bazuar ne Ortofoto 2007 ne periudhen e Censurit 2011.
			Grid 1 Km	Dendesia e popullsise ne kushtet e rrjetit te qelizave (grid) prej 1 km katror. Grid 1 km katrore (EUROSTAT - GEOSTAT)
			Ndertesat	Te dhenat e Census 2011 per Ndertesat
5	Ministria e Energjise dhe Industrise	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	Gjeologji	Harta Gjeologjike e territorit te Republikes se Shqiperise Shk.-1:200 000
			Hidro-Gjeologji	Harta Hidro Gjeologjike e territorit te Republikes se Shqiperise te skanuara ne Shk-1:100 000
6	Ministria e Mjedisit	Agjensia Kombetare e Mjedisit	Brezi i Gjelbër Tirane	
			Rrjeti Emerald	Ngritja e rrjetit EMERALD bazohet ne Ligjin 8906, 06.06.2002 "Per Zonat e Mbrojtura",i ndryshuar. Ky rrjet rrjedh si detyrim nga Konventa e Bernes (Konventa per Ruajtjen e Flores dhe Faunes se Eger dhe Habitave Natyrore te Evropes) ku Shqiperia esh
			IBA Bregdetare	IBA (Important Bird Areas), shpallur me Urdherin e Ministrit nr. 283, date 10.04.2013, " Per miratimin e listes se siperfaqeve ligatinore bregdetare, qe sherbejne si habitate per shpendet migratore"
			Monumente Natyre	
			Zonat e Mbrojtura	Zonat Mjedisore te Mbrojtura te miratuara ne baze te ligjit nr. 8906, date 6.6.2002, "Per Zonat e Mbrojtura" i ndryshuar.
			Zonim i Zonave te Mbrojtura	Zona Mjedisore te Mbrojtura te miratuar ne baze LIGJ Nr. 8906, date 6.6.2002 "PER ZONAT E MBROJTURA" ndryshuar me LIGJIN . Nr.9868, date 4.2.2008 "PER DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

				LIGJIN NR.8906, DATE 6.6.2002 "PER ZONAT E MBROJTURA"
7	Ministria e Zhvillimit Urban	Ministria e Zhvillimit Urban	Vend depozitimet e mbetjeve te ngurta urbane	Vend depozitimet ekzistuese te mbetjeve te ngurta urbane per cdo njesi te qeverisjes vendore.
8	Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	Harta Treguese e Pasurive te Paluajtshme (Kufi Zone)	Kufijte e zonave kadastrale te marra nga Hartat Treguese te Pasurive te Paluajtshme.
			Harta Treguese e Pasurive te Paluajtshme (Ndertesat)	Ndertesat te marra nga Hartat Treguese te Pasurive te Paluajtshme.
			Harta Treguese e Pasurive te Paluajtshme (Parcelat)	Parcelat te marra nga Hartat Treguese te Pasurive te Paluajtshme
9	Ministria e Kulures	Instituti i Monumenteve të Kulures	Harta e Monumente të Kulturës , Zonave të Mbrojtura ejt	

4.1.4 Analiza e informacionit

Informacioni Hartografik i marë nga AKPT kaloj në disa faza inventarizimi dhe kontrollit të cilësisë në bazë të kriterëve si :

- Mbulim i territorit me informacion
- Format i të dhënave
- Cilësia e të dhënave
- Saktësia e të dhënave
- Përditësimi i të dhënave

Duke mos dashur të ndalemi në analizë të thelluar të gjendjes për cdo grup të dhënash nga ana jonë u vlerësua që informacioni në përgjithësi kërkon korrigjim, përditësim, konvertim, transformim, digjitalizim dhe në disa raste krijim nga fillimi. Si shembull mund të japim këto raste

- Korrigjim kërkojnë të dhënat qe janë marë nga projekti CORINE, për arsye se origjina këtij lloj dataseti nuk plotëson saktësinë dhe cilësinë që kërkohet në këtë fazë të planifikimit të territorit.
- Përditësim kërkojnë ato shtresa (layer) informacioni hartografik thelbësore në krijimin e Hartës bazë si ndërtesa, infrastruktura rrugore, përdorimi i tokës.
- Konvertim dhe transformim kërkon një pjesë e madhe e informacionit që është në format jo GIS por CAD. Të dhëna si relievi, kadastra e pronave etj., kërkojnë një punë të konsiderueshme që të sillen në formate GIS në mënyrë që të importohen në një Gjeodatabazë.
- Digjitalizim i të dhënave është bërë në ato raste kur materiali hartografik ka qenë në format raster (Gjeologjia, Hidrogeologjia, Sizmika etj.).
- Krijim nga fillimi për grupin e të dhënave të hidrografise (lumenj, liqen, rezervuare, kanalizime)

Duhet theksuar që mjaft nga këto grupe të dhënash nuk ishte specifikuar së në çfarë referencë Gjeodezike (Projeksion/Eliposid) ndodheshin dhe kjo kërkonte një kontroll

të detajuar vizual nga ana e operatoreve për të percaktuar dhe transformuar materialin.

Përsa i përket informacionit që mund të aksesohet nga Gjeoportali Kombëtar shtresat Ortofoto 2007 & 2015 dhe Harta Topografike të shkallëve të ndryshme na siguron një bazë Hartografike ku do të zhvillohet e gjithë Gjeodatabaza e PPV-së. Po ashtu informacion si Grid i Popullsisë (INSTAT) dhe monumentet e kulturës do të digjtalizohen duke u kthyer në format vektorial GIS nga ana jonë.

4.1.5 Përpunimi i Informacionit

Përpunimi i informacionit hartografik është kryer në dy fazash punimesh :

- Zyrë
- Terreni

Në fazën e parë informacioni është importuar brenda gjeodatabazës së PPV-së në mënyrë që të realizohet “Overlay” i informacionit.




Fig. 74: Paraqitje skematike e përpunimit të informacionit

Për të realizuar integrimin në këtë databazë janë kryer disa kategori përpunimi në programet GIS, ku mund të dallojmë :

Projektimi i të dhënave

Siç u trajtua dhe më sipër informacioni ekzistues i vënë në dispozicion nuk ishte në një referencë të njëjtë gjeodezike. Zakonisht të dhënat janë në projeksione të ndryshme si psh:

Te dhëna	Projeksioni	Elipsoid
Harta Kadastrale	Gauss Kryger 4N	Krassowsky
Ndërtesa	UTM 34N	WGS84

Kjo vecori sjell që të dhënat të mos përputhen dhe të mos jenë të përdorueshme. Për këtë arsye është kryer korrigjimi i të dhënave dhe sjellja në një sistem Referimi Unik që është UTM34/WGS84 .

Për parametrat e transformimit janë përdorur koeficientët e marrë nga: *Udhëzim Nr.4381/1, datë 22.9.2015“Për Transformimin e Koordinatave nga Korniza Referuese Gjeodezike Globale “Itrf2005 (Epoka 2007.2)” dhe Sistemi Gjeodezik Shqiptar “Alb86” në Kornizën Referuese Gjeodezike Evropiane “Etrf2000 (Epoka 2014.177)” dhe “Etrf2000 (Epoka 2008)”*.

Azhornimi dhe korrigjimi i të dhënave

Gjatë fazës të vlerësimit të informacionit nga grupi i ekspertëve u konkludua që disa shtresa (layer) inofrmacioni kishin nevojë për azhornime, ndër më kryesoret shtresa Ndërtesë dhe Infrastrukturë Rrugore.

Azhornimi dhe korrigjimi për këto të dhëna është kryer duke përdorur bazë hartografike të saktë, të cilat janë përpunuar në programet GIS Desktop si QGIS nëpërmjet Shërbimeve Online. Për këtë qëllim Ortofoto 2015 (zonat Urbane), Orto 2007 por edhe shumë të dhëna të tjera u aksesuan nga Geoportali Kombëtar në linkun <http://geoportal.asig.gov.al/InfoandServices.aspx?lang=AL> . Për pjesën jo Urbane janë përdorur shërbime online si Bing Aerial ose OpenLayers.

Unifikimi i të dhënave në formatin GIS .

Rasti që ka kërkuar më shumë punë nga ana e operatorëve ka qënë ai i hartave kadastrale që ishin në formatin Cad. Për kalimin e të dhënave në formatin Esri Shapefile është kryer një proces topologjie shumë rigoroz mbi të dhënat grafike në mënyrë që të mos kemi mbivendosje informacioni ose dhe zona bosh.




Fig. 75: Paraqitje skematike e tipeve të topologjisë

Duam të theksojmë që të gjithë Datasetet e integruara në Gjeodatabazën e PPV-së ka kaluar Topologjinë , si masë kontrolli.

Digjitalizimi i të dhënave

Për shumë grupe të dhënash informacioni i mbledhur ka qënë në format jo Vektorial si p.sh. harta gjeologjise ose harta e bonitetit të tokës. Informacioni për këto raste është gjeorefencuar në reference gjeodezike UTM34/WGS84 dhe më pas është digjitalizuar.

Po ashtu shtresa inofrmacioni si Hidrografia ose Grid Instat janë përfituar nga digjitalizimi në vektor ku si bazë janë përdorur shërbimet online që janë të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.

Punime terreni

Pjesa më e rëndësishme dhe që ka kërkuar më shumë burime njerëzore dhe teknike kanë qënë marrja e të dhënave në terren. Me përcaktimin e një modeli të komplikuar të dhënash, grupeve të terrenit i është parashtruar një volum shumë i madh pune. Organizimi i punës si dhe materialet ndihmëse hartografike dhe tabelore nëpërmjet programeve GIS në këtë rast luajnë një rol të rëndësishëm në saktësinë dhe shpejtësinë e marrjes të dhënës.

Në rastin e Ndërtesave objektet janë indeksuar me një ID unike me anë të cilit Ndërtesa identifikohet si në hartë po ashtu në tabelen ku hidhen attribute si Nr kat, Funksioni, Lloj i ndërtimi etj.




Fig. 76: Hartat dhe tabelat e përdorura në terren

Baza finale e të dhënave

- Harta bazë
- Të dhënat bazë të 5 sistemeve territorial
- Kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës (ekzistues)
- Shërbime urbane ekzistuese
- Kufizime – element përjashtues (zonat tampon - buferike)

Te dhënat bazë (metadat) për secilin sitem bazë duhet të jenë në përputhje me përcaktimet VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”

4.1.6 Analiza e situatës ekzistuese

Gjatë fazës së evidentimit të gjendjes ekzistuese, në njësitë vendore është kryer dhe inventarizimi Hardware, Software si dhe ai i burimeve njerëzore. Ky proces do na shërbejë në rekomandimet, që konsulenti duhet të japë mbi veprime dhe masa për të rritur efikasitetin e GIS dhe strukturën e Regjistrir Urban.

Tabela:

	<i>Krujë</i>
<i>Sektor GIS</i>	<i>mungon</i>
<i>Ekspert GIS</i>	<i>2 ekspertë GIS – 1 i punësuar, 1 vullnetar pranë Bashkisë Krujë</i>
<i>Software GIS</i>	<i>mungon</i>
<i>Workstation Comp</i>	<i>mungon</i>
<i>Server</i>	<i>mungon</i>
<i>Local Network</i>	<i>mungon</i>

4.1.6.1 Veprime dhe masa për të rritur efikasitetin e GIS dhe strukturën e Regjistrir Urban.


Rezultatet e inventarit na çojnë në përfundimin se bashkia duhet investojë sidomos në rritjen e kapaciteteve e burimeve njerëzore. Propozimi i konsulentit është që të krijohet një sektor i dedikuar, që do ketë si objektiv përpunimin e të dhënave hartografike e tabelore, me qëllim mirëmbajtjen e **databazës territoriale GIS**. Ky sektor duhet të përbëhet nga specialistë që kanë njohuri në:

- sistemet GIS (preferohen sistemet OpenSource)
- administrimin e Databazës
- administrimin e Sistemeve Kompjuterike dhe Hardware-ve

Patjetër kjo iniciativë duhet të shoqërohet dhe me trajnimin e stafit të Bashkisë për fushat GIS dhe IT. Meqënëse stafi i bashkisë gëzon statusin e nënpunësit civil, trajnime të këtij lloji mund të sigurohen nëpërmjet ASPA (Shkolla e Administratës Publike) ose dhe nga vetë AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit).

Nga rezultatet e inventarit, vërejmë që duhet dhe një investim në pajisjet Hardware. Meqënëse Databaza Territoriale për disa grupe të dhënash do të kërkojë mirëmbajtje, përditësim dhe përpunim të informacionit, ky sektor duhet të pajiset me kompjutera të llojit Workstation (specifikime AKSHI), që do të përdoren nga specialistët e GIS-it. Databaza GIS si dhe materialet hartografike që do të përfitohen nga PPV, do të duhet të administrohen në një Server Qëndror, në këtë mënyrë do të evitohet humbja dhe vështirësia e qasjes në informacionin e dokumentuar nga stafi i Bashkisë. Serveri duhet të instalohet në një infrastrukturë të sigurtë që mundëson furnizim të pandërprerë me Energji, Network & Internet dhe sistem ventilimi. Për rregullat, rolet, kufizimet dhe mënyrën e qasjes në Databazë, nga punonjësit e njësisë vendore, duhet të krijohet një rregullore nga specialistët e Teknologjisë së Informacionit. Përsa i takon softwareve GIS, propozojmë që të përdoren softet Opensource që nuk do të ndikojnë në kosto të mëtejshme. Theksojmë që konsulenti, në momentin e dorëzimit të produktit përfundimtar, do të instalojë të gjithë softet e nevojshme për aksesimin e informacionit GIS, si dhe do të japi sugjerimet e nevojshme teknike për administrimin e informacionit nga ana e njësisë vendore. Nga konsulenti do të dorëzohen dhe Metadatat për të gjithë të dhënat GIS të PPV-së.

Nga ana e konsulentit është ndërtuar një faqe WebGIS: <http://www.geoportale.org/lizmap-webclient/master/lizmap/www/index.php/view/map>, e cila mund të hapet nëpërmjet cilitdo WebBrowser. Në këtë Webgis, përdoruesit e interesuar mund të aksesojnë dhe shikojnë informacionin hartografik, të përpunuar nga konsulenti gjatë fazës së parë dhe të dytë të planit.



Megjithatë përse i takon përcaktimit të metodologjive, proceseve të punës dhe investimeve, njësia vendore duhet të ketë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Publike Qëndrore dhe të sigurojë akses në sistemet GIS Qeveritare si: Gjeoportali Kombëtar, ALBSREP, Sistemi i Adresave etj. Sidomos aksesimi i shërbimeve online nga sistemet e mësipërme do të siguronte dhe një proces përditësimi sistematik dhe të saktë të të dhënave hartografike bazë të **Databazës territoriale GIS** si Ortofoto, Kadastër e Pronave dhe Sistem Adresash.

4.1.7 Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave

Të dhënat, e marra nga njësia, kanë qenë materiale hartografike në formate të ndryshme si Raster, Cad dhe GIS, kryesisht të PPV-ve të mëparshme.

Përveç materialeve të mbledhura nga AKPT dhe Bashkia, informacioni është mbledhur edhe nëpërmjet vëzhgimit së territorit dhe rievimit të zonave të njësive administrative, bazuar në një plan veprimi të hartuar paraprakisht.


Gjithashtu, informacion plotësues është mbledhur nëpërmjet formularëve – pyetësorë dhe burim i fundit dhe mjaft i vlefshëm i të dhënave, ka qenë edhe një direktori e sinkronizuar e AKPT-së ku është mbledhur informacion.

Baza e të dhënave GIS është përgatitur nga ana e konsulentit dhe do të dorëzohet në mbarim të projektit. Kjo bazë të dhënash është konform kërkesave të akteve ligjore në fuqi, si dhe kërkesave teknike të njësive vendore. Në parim modeli i të dhënave GIS është ndarë në 9 kategori kryesore (grupe të dhënash), të cilat janë:



Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

- Planifikim
- Ndarje Administrative
- Ndërtesa
- Kadastër
- Kulturë dhe Trashëgimi
- Përdorimi i Tokës
- Natyrë dhe Mjedis
- Shërbime Publike
- Infrastrukturë Rrugore

Për secilin nga këto grupe të dhënash, ekziton një model logjik prej të cilit janë përftuar të dhënat GIS në formatet GIS, si ESRI Shapefile ose Geographic Markup Language (gml).



Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit



Më poshtë, po ju paraqesim kategoritë e të dhënave si dhe shtresat e informacionit GIS (formati Shapefile) që janë dorëzuar si ***databazë territoriale GIS***.

Nr.Kat	Kategoritë	Nr.	Shtresat
I	Administrative	1	AB_Border.shp
		2	AB_LineOfConcern.shp
		3	AB_MiniMunicipality.shp
		4	AB_YellowLine.shp
II	Ndërtesë	5	BD_Building.shp
III	Kadastër	6	CD_Block.shp
		7	CD_Building.shp
		8	CD_CadastreZone.shp
		9	CD_Parcel.shp
IV	Planifikimi	10	GLP_Plan.shp
		11	GLP_RestrictedZone.shp
		12	GLP_Sector.shp
		13	GLP_Zone.shp
V	Përdorimi i Tokës	14	LU_Agriculture.shp
		15	LU_AirTraffic.shp
		16	LU_Cemetery.shp
		17	LU_Dock.shp
		18	LU_ExcavationAndMining.shp
		19	LU_Forest.shp
		20	LU_FloatingWater.shp
		21	LU_Heap.shp
		22	LU_Heath.shp

		23	LU_IndustrialAndCommercialZone.shp
		24	LU_Landfill.shp
		25	LU_Monument.shp
		26	LU_PublicFacility.shp
		27	LU_RecreationalZone.shp
		28	LU_ResidentialZone.shp
		29	LU_Railroad
		30	LU_Road.shp
		31	LU_Sea.shp
		32	LU_ShippingTraffic.shp
		33	LU_Square.shp
		34	LU_StandingWater.shp
		35	LU_Swamp.shp
		36	LU_Way.shp
		37	LU_ZoneOfMixedUse.shp
VI	Natyrë dhe Mjedis	38	NE_ChemicalsInStock.shp
		39	NE_ContaminatedZone.shp
		40	NE_DemolitionWasteSite.shp
		41	NE_DesolateIndustry.shp
		42	NE_FloodRiskZone.shp
		43	NE_FoundationSoil.shp
		44	NE_GarbageContainer.shp
		45	NE_GasStation.shp
		46	NE_GreenZone.shp

		47	NE_HillslideRiskZone.shp
		48	NE_LandFill.shp
		49	NE_PetrolStation.shp
		50	NE_PharmaceuticalIndustry.shp
		51	NE_Quarry.shp
		52	NE_RadonRiskZone.shp
		53	NE_SeismicRiskZone.shp
		54	NE_SeismicStation.shp
		55	NE_TransferStation.shp
		56	NE_Tree.shp
		57	NE_UrbanWasteSite.shp
		58	NE_WasteTreatmentSite.shp
VII	Shërbime Publike	59	PU_AntennaTower.shp
		60	PU_Cable.shp
		61	PU_ElectricPoint.shp
		62	PU_OpticalFibre.shp
		63	PU_PumpingStation.shp
		64	PU_SewageManhole.shp
		65	PU_SewagePipe.shp
		66	PU_Spring.shp
		67	PU_Substation.shp
		68	PU_TelecomLine.shp
		69	PU_TelecomPoint.shp
		70	PU_WaterDepot.shp

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

		71	PU_WaterManhole.shp
		72	PU_WaterPipe.shp
		73	PU_Well.shp
		74	PU_WLANHotspot.shp
VIII	Infrastrukturë Rrugore	75	RT_BusRoute.shp
		76	RT_BusStop.shp
		77	RT_Junction.shp
		78	RT_PublicParking.shp
		79	RT_RailwayLine.shp
		80	RT_Road.shp
		81	RT_TaxiStop.shp
		82	RT_TrafficLight.shp
IX	Sociale	83	SEC_Clinic.shp
		84	SEC_Hospital.shp
		85	SEC_Kindergarden.shp
		86	SEC_School.shp
		87	SEC_University.shp

Për çdo shtresë informacioni do të dorëzohet dhe një file Metadata përkatës, që do japi një përshkrim të detajuar mbi të dhënat. Kjo do t'i shërbejë stafit të bashkisë që të ketë informacionin e duhur si është krijuar e dhëna dhe se për çfarë qëllimi mund të përdoret.

```

60 <gmd:ID_ReferenceSystem>
61   <gmd:referenceSystemIdentifier>
62     <gmd:RS_Identifier>
63       <gmd:code>
64         <gmd:CharacterString>32434</gmd:CharacterString>
65       </gmd:code>
66     </gmd:RS_Identifier>
67   </gmd:referenceSystemIdentifier>
68 </gmd:ID_ReferenceSystem>
69 </gmd:referenceSystemInfo>
70 <gmd:identificationInfo>
71   <gmd:MD_DataIdentification>
72     <gmd:citation>
73       <gmd:Citation>
74         <gmd:title>
75           <gmx:CharacterString>AB_Minimality</gmx:CharacterString>
76         </gmd:title>
77         <gmd:date>
78           <gmd:CI_Date>
79             <gmd:date>
80               <gmx:Date>2016-05-18</gmx:Date>
81             </gmd:date>
82             <gmd:dateType>
83               <gmd:CI_DateTypeCode>
84                 <codeList"/></codeList>
85               </gmd:dateType>
86             </gmd:CI_Date>
87           </gmd:date>
88         </gmd:Citation>
89       </gmd:citation>
90     <gmd:abstract>
91       <gmx:CharacterString>Hidre e nenjësive të njësive vendore Kryje, Kurbis dhe Lezhe të harmonizuara sipas standartit të Regjistrimit Komercial</gmx:CharacterString>
92     </gmd:abstract>
93     <gmd:pointOfContact>
94       <gmd:CI_Responsibility>
95         <gmd:organizationName>
96           <gmx:CharacterString>UTS01.SMR</gmx:CharacterString>
97         </gmd:organizationName>
98         <gmd:contactInfo>
99           <gmd:CI_Contact>
100             <gmd:phoneNumber>
101               <gmd:CI_Telephone>
102                 <gmx:CharacterString>(+355) 00-000-000</gmx:CharacterString>
103               </gmd:CI_Telephone>
104             </gmd:phoneNumber>
105             <gmd:address>
106               <gmd:CI_Address>
107                 <gmd:electronicMailAddress>
108                   <gmx:CharacterString>info@uta01.com</gmx:CharacterString>
109                 </gmd:electronicMailAddress>
110               </gmd:CI_Address>
111             </gmd:address>
112           </gmd:contactInfo>
113         </gmd:responsibility>
114       </gmd:pointOfContact>
115     </gmd:identificationInfo>

```



Cathodic Coatings

185

Kontrolli dhe përditësimi i informacionit gjeohapësinor (kadastër, ndërtesë, sistem rrugor etj.) në zonat ku do të hartohet PDV.

Informacioni Gjeohapësinor, i gjeneruar gjatë PDV, duhet të integrohet dhe të jetë konform **Databazës territoriale GIS**.

- Baza hartografike për përmisimin e databazës territoriale GIS.
Për editimin, përditësimin dhe përmirësimin e databazës territoriale GIS, duhet të sigurohet aksesimi dhe ndërverprimi me Bd Shtetërore GIS si Gjeoportali Kombëtar, ALBSREP, Sistemi i Adresave etj.

Plani i veprimeve afat-gjatë:

- Përmirësimi i të dhënave të Kadastrës të pronave për zonat me zhvillim.
- Përditësimi sistematik i databazës, nëpërmjet rilevimit në terren të grupeve të dhënave kryesore si ndërtesa, sistem rrugor, zona rreziku etj.
- Krijimi i WebGIS të njësisë vendore, ku të shfaqet informacioni hartografik i Planit të Përgjishëm Vendor si dhe Planeve të Detajuar Vendorë.
- Trajnimi sistematik i stafit të bashkisë në implementimin e standarteve hartografike, GIS dhe TIK.

5 Aneksi i Hartave

ANALIZA E THELLUAR DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE TË TERRITORIT. BASHKIA KRUJE

Lista e materialit hartografik:

- U - 01 Harta bazë e njësisë vendore
- U - 02 Harta topografike
- U - 03 Harta gjeologo-inxhinierike
- U - 04 Harta gjeologjike
- U - 05' Harta hidrogeologjike
- U - 05 Harta e riskut hidrografike
- U - 06 Harta e riskut hidrologjik
- U - 07 Harta e zonimit sizmik
- U - 08 Harta e tokave natyrore
- U - 08' Harta e problemeve mjedisore
- U - 09 Harta e monumenteve të natyrës
- U - 10 Harta e monumenteve të kulturës
- U - 11 Harta e pozicionit strategjik në raport me rajonin
- U - 12 Harta e vlerësimit ekonomik
- U - 13 Harta e vlerësimit social
- U - 14 Harta e vlerësimit demografik
- U - 15 Analiza e planeve të mëparshme
- U - 16 Harta e pronave
- U - 17 Harta e rëndësisë kombëtare
- U - 17' Harta e elementeve përjashtuese
- U - 18 Harta e sistemeve bazë
- U - 19 Harta e tokave bujqësore
- U - 20 Harta e kategorive bazë të përdorimit të tokës
- U - 21 Harta e lartësive të objekteve
- U - 22 Harta e infrastrukturës rrugore
- U - 23 Harta e sistemit të kanalizimeve
- U - 24 Harta e tipologjive hapësinore
- U - 25 Harta e periferialitetit
- U - 26 Elemente të veçanta territoriale
- U - 27 Harta e intensitetit të ndërtimit

